



The AIRE Centre  
Advice on Individual Rights in Europe



E DREJTA EVROPIANE E

# AZILIT

PËRMES JURISPRUDENCËS

GUIDË PËR GJYQTARËT, VENDIMARRËSIT DHE PROFESIONISTËT E SË DREJTËS



---

E DREJTA EVROPIANE E

# AZILIT

PËRMES JURISPRUDENCËS

---

GUIDË PËR GJYQTARËT, VENDIMARRËSIT DHE PROFESIONISTËT E SË DREJTËS

# **E Drejta Evropiane e Azilit përmes Jurisprudencës – Guidë për gjyqtarët, vendimmarrësit dhe profesionistët e së drejtës**

## **Bordi editorial**

Biljana Braithwaite, Menaxhere Programi për Ballkanin Perëndimor, Qendra AIRE  
Catharina Harby, Konsulente Ligjore Senior, Qendra AIRE  
Gjyqtar Ledi Bianku, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut  
Nuala Mole, Juriste Senior, Qendra AIRE  
Marija Jovanovic, MJur (Oxon), DPhil (Oxon)

## **Kontribuesit Kryesorë**

Gjyqtar Ledi Bianku, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut  
Nuala Mole, Juriste Senior, Qendra AIRE  
Gjyqtar Lars Bay Larsen, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian  
Gjyqtar Hugo Storey, Gjyqtar i Gjykatës së Lartë dhe Kryetar i Seksionit  
Evropian të Shoqatës Ndërkombëtare të Gjyqtarëve të Ligjit për Refugjatë

© 2018 Qendra AIRE dhe Qendra Evropiane

Tirazhi 250 kopje

Versioni origjinal anglisht i këtij botimi është përkthyer në gjuhën boshnjake/  
kroate/malazeze/serbe/shqipe dhe maqedonase.

Përkthyen në shqip: Lorena Goxhobelli dhe Ina Xhepa

Dizenjuar nga KlikërDizajn

Shtypur: Kuća Štampe

## Përmbajtja

<b>Hyrje</b> .....	<b>9</b>
<b>Vështrim i Përgjithshëm i Sistemit për Mbrojtjen Ndërkombëtare të Personave në Rrezik</b> .....	<b>19</b>
<b>Përmbledhje dhe komente të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut</b> .....	<b>35</b>
<i>Neni 3 – Ndalimi i torturës</i> .....	35
Cruz Varas dhe të tjerë k. Suedisë, nr. 15576/89, 20 mars 1991.....	35
Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar [DHM], nr. 22414/93, 15 nëntor 1996.....	40
Ahmed k. Austrisë, nr. 25964/94, 17 dhjetor 1996.....	47
Jabari k. Turqisë, nr. 40035/98, 11 korrik 2000 .....	51
Bader dhe Kanbor k. Suedisë, nr. 13284/04, 8 nëntor 2005 .....	55
Salah Sheekh k. Holandës, nr. 1948/04, 11 janar 2007.....	60
Saadi k. Italisë [DHM], nr. 37201/06, 28 shkurt 2008.....	65
N. k. Mbretërisë së Bashkuar [DHM], nr. 26565/05, 27 maj 2008 .....	69
NA. k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 25904/07, 17 korrik 2008 .....	74
Ben Khemais k. Italisë, nr. 246/07, 24 shkurt 2009 .....	80
Al-Saadoon dhe Mufdhi k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 61498/08, 2 mars 2010 .....	85
Rahimi k. Greqisë, nr. 8687/08, 5 prill 2011.....	91
Sufi dhe Elmi k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 8319/07 dhe 11449/07, 28 qershor 2011.....	96

Abdulkhakov k. Rosisë, nr. 14743/11, 2 tetor 2012.....	101
Paposhvili k. Belgjikës, nr. 41738/10) 13 dhjetor 2016 .....	108
J.K. dhe të tjerë k. Suedisë, nr. 59166/12, 23 gusht 2016.....	114
<i><u>Neni 3 dhe Rregullorja e Këshillit Nr. 604/2013 e 26 qershorit 2013 (Rregullorja e Dublinit III dhe legjislacioni i mëparshëm përkatës)</u></i> .....	120
T.I. k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 43844/98, 7 mars 2000.....	120
M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë [DHM], nr. 30696/09, 21 janar 2011 .....	125
Samsam Mohammed Hussein dhe të tjerë k. Holandës dhe Italisë, nr. 27725/10, 2 prill 2013.....	133
Tarakhel k. Zvicrës [DHM], nr. 29217/12, 4 nëntor 2014.....	138
<i><u>Neni 4 - Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar</u></i> .....	143
Chowdury dhe të tjerë k. Greqisë .....	143
<i><u>Neni 5 - E drejta për Liri dhe Siguri</u></i> .....	149
Tabesh k. Greqisë, nr. 8256/07, 16 nëntor 2009 .....	149
Louled Massoud k. Maltës, nr. 24340/08, 27 korrik 2010 .....	153
<i><u>Neni 6 - E drejta për një proces të rregullt</u></i> .....	158
Othman (Abu Qatada) k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 8139/09, 17 janar 2012.....	158
<i><u>Neni 13 - E drejta për ankim efektiv</u></i> .....	164
I.M. k. Francës, nr. 9152/09, 2 shkurt 2012 .....	164
A.C. dhe të tjerë k. Spanjës, nr. 6528/11, 22 prill 2014.....	169

<i>Neni 4 i Protokollit nr. 4 – Ndalimi i dëbimit kolektiv</i> .....	174
Hirsi Jamaa dhe të tjerë k. Italisë [DHM], nr. 27765/09, 23 shkurt 2012 .....	174
Sharifi dhe të tjerë k. Italisë dhe Greqisë, nr. 16643/09, 21 tetor 2014 .....	180
Khlaifia dhe të tjerë k. Italisë, nr. 16483/12, 15 dhjetor 2016 .....	186
<b>Përmbledhje dhe komente të vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian</b> .....	<b>193</b>
<i>Rregullorja e Këshillit nr. 343/2003 e 18 shkurtit 2003 (Rregullorja e Dublinit II)</i> .....	193
N.S. k. Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme dhe M.E. dhe të tjerë k. Komisionerit për Refugjatët dhe Ministrit të Drejtësisë, Barazisë dhe Reformës Ligjore [DHM], C-411/10 dhe C-493/10, 21 dhjetor 2011 .....	193
MA, BT dhe DA k. Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme, C-648/11, 6 qershor 2013.....	198
Bundesrepublik Deutschland k. Kaveh Puid [DHM], C-4/11, 14 nëntor 2013 .....	202
Shamso Abdullahi k. Bundesasylamt [DHM], C-394/12, 10 dhjetor 2013.....	206
<i>Direktiva e Këshillit nr. 2004/83/EC e 29 prillit 2004 (Direktiva e Kualifikimit)</i> .....	211
Meki Elgafaji dhe Noor Elgafaji k. Staatssecretaris van Justitie [DHM], C-465/07, 17 shkurt 2009 .....	211
Aydin Salahadin Abdulla dhe të tjerë k. Bundesrepublik Deutschland [DHM], C-175/08, C-176/08, C-178/08 dhe C-179/08, 2 mars 2010 .....	215
Bundesrepublik Deutschland k. B dhe D [DHM], C-C-57/09 dhe C-101/09, 9 nëntor 2010 .....	219

Bundesrepublik Deutschland k. Y dhe Z [DHM], C-71/11 dhe C-99/11, 5 shtator 2012.....	224
Minister voor Immigratie en Asiel k. X, dhe Y dhe Z k. Minister voor Immigratie en Asiel, C-199/12 deri C-201/12, 7 nëntor 2013.....	229
Aboubacar Diakité k. Commissaire général aux réfugiés et aux apatrides, C-285/12, 30 janar 2014.....	234
A, B dhe C k. Staatssecretarías van Veiligheid en Justitie [GC], C-148/13 to C-150/13, 2 dhjetor 2014.....	
Mohamed M'Bodj k. État belge [DHM], C-542/13, 18 dhjetor 2014.....	238
Mohamed M'Bodj kundër État Belge.....	243
Andre Lawrence Shepherd k. Bundesrepublik Deutschland, C-472/13, 26 shkurt 2015 .....	248
<i>Direktiva e Këshillit nr. 2008/115/EC e 16 dhjetorit 2008 (Direktiva e Kthimit)</i> .....	252
Said Shamilovich Kadzoev (Huchbarov) [DHM], C-357/09 PPU, 30 nëntor 2009.....	252
Centre public d'action sociale d'Ottignies-Louvain-la-Neuve k. Moussa Abdida [DHM], C-562/13, 18 dhjetor 2014.....	256
<b>Përmbledhje dhe komente të vendimeve të gjykatave të brendshme .....</b>	<b>261</b>
<i>Cenimi i lirisë fetare si akt persekutimi –Neni 9(1) i Direktivës së Kualifikimit</i> .....	261
Gjermani nr. 1 (Gjykata Federale Administrative, 20 shkurt 2013 – BVerwG 10 C 23.12).....	261
<i>Persekutimi nga persona që nuk ushtrojnë funksione zyrtare – Neni 7 i Direktivës së Kualifikimit dhe neni 1A(2) i Konventës së Refugjatëve të 1951</i> .....	267

Mbretëria e Bashkuar nr. 1 (Horvath k. Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Çështjeve të Brendshme [2000] UKHL 37, 6 korrik 2000) .....	267
<i>Mbrojtja plotësuese – Neni 15(c) i Direktivës së Kualifikimit</i> .....	272
Francë nr. 1 (Conseil d’Etat, 3 korrik 2009, OFPRA k. M.A., n° 320295).....	272
Francë nr. 2 (CNDA, 2 shkurt 2015, M.A., n° 14017393).....	275
Gjermani nr. 2 (Gjykata Federale Administrative, 31 janar 2013 – BVerwG 10 C 15.12) ( <i>gjithashtu përmend ‘alternativën e mbrojtjes së brendshme’</i> ).....	277
<i>Alternativa e “mbrojtjes së brendshme” – Neni 8 i Direktivës së Kualifikimit</i> .....	281
Mbretëria e Bashkuar nr. 2 (Januzi k. Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Çështjeve të Brendshme & Ors [2006] UKHL 5, 15 shkurt 2006).....	281
<i>Viktimat e trafikimit – grup i veçantë shoqëror sipas kuptimit që i jep neni 1A(2) i Konventës për Refugjatët i 1951 dhe neni 10 i Direktivës së Kualifikimit, e ndryshuar</i> .....	286
Francë nr. 3 (Cour Nationale du Droit d’Asile, 24 mars 2015, n° 10012810) ( <i>gjithashtu përmend ‘alternativën e mbrojtjes së brendshme’</i> ).....	286
<i>Vlerësimi i besueshmërisë së provave në kërkesat për azil – Neni 4 i Direktivës së Kualifikimit dhe neni 46 i Direktivës për Procedurat e Azilit, e ndryshuar</i> .....	290
Suedi (Gjykata e Migracionit e Apelit, UM 122-6, 18 shtator 2006) .....	290
<i>Legjislacioni i brendshëm dhe Direktiva mbi Procedurat e Azilit</i> .....	295
Holanda nr. 1 (ABRvS, 201103520/1/V3, 25 qershor 2012) ( <i>E drejta e qëndrimit – Neni 7 i Direktivës për Procedurat e Azilit</i> ).....	295



Holanda nr. 2 (ABRvS, 201112955/1/V4, 29 qershor 2012)  
(Procedura e dytë apo të tjera të mëvonshme të azilit  
- Neni 32 i Direktivës për Procedurat e Azilit, neni 13  
i KEDNJ, ose neni 47 i KDTHBE).....299

## Hyrje

Persekutimi, konfliktet dhe varfëria detyruan, si asnjë herë më parë, një milion njerëz t'i drejtoheshin kufijve të Evropës në vitin 2015, sipas vlerësimit nga Agjencia e OKB-së për Refugjatët dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migrim. Numri i njerëzve të zhvendosur nga lufta dhe konfliktet është më i larti që Evropa Perëndimore dhe Qendrore ka parë që prej viteve 1990, kur shpërthyen konfliktet në ish-Jugosllavi. Pas një periudhe fillestare, kur dhjetëra mijëra njerëz u larguan nga Greqia drejt Ballkanit Perëndimor dhe atij të Veriut, dhe u gjendën para kufijve të mbyllur në shumë vende, ka filluar të marrë formë një përgjigje më e koordinuar evropiane.

Vendet e Ballkanit Perëndimor janë kryesisht vende transit për emigrantët dhe refugjatët. Por, me rritjen dramatike të numrit të emigrantëve dhe refugjatëve drejt Evropës në vitin 2015 dhe vendimin e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian për të vendosur kontrollë më të rrepta kufitare, ka pasur edhe një rritje të numrit të kërkesave për azil në vetë vendet e Ballkanit Perëndimor.

Me sa duket, një vërshim kaq i madh i njerëzve, që ka prekur shumë familje me fëmijë të vegjël, si dhe të mitur të pashoqëruar, ka qenë një sfidë për të gjitha vendet evropiane dhe burimet e tyre janë testuar seriozisht. Megjithatë, mbetet gjithsesi e rëndësishme që të drejtat e personave të cilët janë duke kërkuar mbrojtje ndërkombëtare të respektohen. Këto të drejta përfshijnë, për shembull, të drejtën për të kërkuar azil, për garantimin e masave mbrojtëse për sa i përket ndalimit dhe mbrojtjes nga keqtrajtimi, të cilat janë të parashikuara në dokumente të ndryshme ligjore të tilla si Konventa e Gjenevës për Statusin e Refugjatëve, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe e drejta e Bashkimit Evropian.

Ky botim është pjesë e një projekti më të gjerë, i cili synon të adresojë disa nga sfidat me të cilat përballen vendet e rajonit duke bërë të mundur rritjen e njohurive dhe kapacitetit të gjykatave të vendeve të Ballkanit Perëndimor për të siguruar zbatimin e duhur të standardeve ndërkombëtare në nivel të brendshëm dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të azilkërkuesve. Ne shpresojmë që ky botim t'i shërbejë edhe funksionarëve publikë, forcave të policisë, funksionarëve në administratën doganore dhe praktikantëve të ligjit duke u ofruar udhëzime se si zbatohet e drejta ndërkombëtare, evropiane dhe kombëtare e azilit dhe refugjatëve: kush ka të drejtë të marrë azil dhe çfarë të drejtash sjell ky status.

Ky libër ku përmbledhet një praktikë e gjerë ligjore, përmban 4 kapituj:

**Në kapitullin e parë,** bëhet një përshkrim i shkurtër i sistemit të mbrojtjes ndërkombëtare për personat në rrezik. Në të pasqyrohen ligjet dhe standardet ndërkombëtare dhe rajonale në lidhje me azilin, duke filluar me instrumentet e OKB-së, në veçanti Konventë e Gjenevës së 1951 për Statusin e Refugjatëve e duke vazhduar me KEDNJ dhe instrumentet përkatëse të Këshillit të Evropës dhe *acquis e BE* për azilin.

**Në kapitullin e dytë,** prezantohen përmbledhjet e 25 çështjeve më të rëndësishme të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg në lidhje me azilin, të shoqëruara me komente nga ekspertë. Një sërë dispozitash të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë relevante për çështjet e azilit, në veçanti neni 3, ndalimi i torturës dhe keqtrajtimit, i cili vendos për shtetet detyrimin e mos kthimit të personave që nuk u jepet statusi i refugjatit nëse kjo do i ekspozonte ata ndaj rrezikut të një trajtimi të tillë, por edhe t'u sigurojnë që ata të mbahen në kushte njerëzore. Rastet e përzgjedhura në këtë libër të jurisprudencës, marrin në konsideratë, ndër të tjera, autoritetin e Gjykatës së Strasburgut për të urdhëruar marrjen e masave të përkohshme sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës. Neni 39 i Rregullores së Gjykatës është përdorur për t'i kërkuar një shteti për të mos larguar një individ derisa sa Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut të shqyrtojë themelin e kërkesës, nevojat e veçanta të të miturve azilkërkues, të azilkërkuesve të mitur të pashoqëruar, periudhën e ndalimit dhe një sërë çështjesh të tjera. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut është drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha vendet e rajonit e për rrjedhojë jurisprudenca e trajtuar në këtë pjesë është me rëndësi të drejtpërdrejtë për vendimmarrësit.

**Kapitulli i tretë,** është një përmbledhje e 15 rasteve të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian në Luksemburg, shoqëruar edhe me komentet e ekspertëve. GJDBE-ja ka një rol të rëndësishëm në garantimin e interpretimit dhe zbatimit uniform të së drejtës së Bashkimit Evropian, përfshirë *acquis* të azilit, por edhe në garantimin që këto rregulla të respektojnë të drejtat themelore të njeriut. Karta e BE-së për të Drejtat Themelore zbatohet në tërësinë e *acquis* të azilit. Për më tepër, Shtetet Anëtare të BE-së përgjigjen para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg në lidhje me detyrimin e tyre për mbrojtje sipas së drejtës së BE-së, sa herë që këto detyrime përfshijnë një të drejtë ose detyrim sipas KEDNJ-së. Këto dy sisteme padyshim që kryqëzohen më njëra tjetrën dhe kjo do të shpjegohet më tej në këtë botim. Më tej, rëndësia e *acquis* të BE-së dhe jurisprudencës së GJDBE-së shkon përtej shteteve anëtare

të BE-së. Ndërsa vendet e Ballkanit Perëndimor janë të lidhura vetëm me KEDNJ dhe jurisprudencën e Strasburgut, legjislacioni i BE-së dhe jurisprudenca së Gjykatës së Luksemburgut për çështjet e azilit është e rëndësishme për rajonin në shumë mënyra.

Regjimi Evropian tashmë ka pasur një ndikim të rëndësishëm në ligjet dhe praktikën e shteteve në mbarë botën<sup>1</sup>. Kështu, jurisprudenca e GJDBE-së luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe interpretimin e së drejtës së refugjatëve në të gjithë globin, sidomos për shkak se instrumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar mbi të drejtën e refugjatëve, Konventa e Gjenevës e vitit 1951 nuk ka krijuar një organ mbikombëtar ligjor që të ofrojë interpretim përfundimtar dhe shqyrtim të vendimeve të gjykatave të brendshme që kanë të bëjnë me zbatimin e Konventës.

Për më tepër, gjykatat e Luksemburgut dhe Strasburgut shpesh i referohen vendimeve të njëra-tjetres për të mbështetur qëndrimet e tyre përkatëse, dhe Karta e BE-së, e cila është drejtpërdrejt e zbatueshme në *acquis* të BE-së, i referohet drejtpërsëdrejti KEDNJ-së kur është fjala për interpretimin e dispozitave të saj<sup>2</sup>. Jurisprudencat e Luksemburgut dhe Strasburgut janë të lidhura në mënyrë të pazgjdhshme, dhe për rrjedhojë është e nevojshme t'i njohësh mirë të dyja këto jurisprudenca.

Së fundmi, të gjitha vendet e rajonit aspirojnë të bëhen anëtarë të BE-së dhe si pjesë e procesit të integritimit, ata duhet të harmonizojnë kornizat e tyre respektive ligjore në përputhje me Kapitullin 24 të *acquis communautaires*. Prandaj, është me rëndësi të madhe për institucionet gjyqësore dhe të tjera trajtojnë çështjen e refugjatëve në Ballkanin Perëndimor të jenë të informuar për zhvillimet në jurisprudencën jo vetëm të GJEDNJ-së, por edhe të GJDBE-së.

**Në kapitullin e katërt**, ky material pasqyron një përzgjedhje të përmbledhjeve të dhjetë rasteve nga juridiksionet e disa shteteve evropiane, të cilat kanë përjetuar një nivel të lartë të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare, gjithashtu të

1 Helene Lambert, Jane McAdam, Maryellen Fullerton (eds.), *Shtetirja Globale e të Drejtës Evropiane të Azilit* (CUP 2013).

2 Neni 52(3) i Kartës parashikon se për aq kohë sa Karta përmban të drejtat e të cilat 'korrespondojnë me të drejtat e garantuara me KEDNJ-ja', 'kuptimi dhe fushëveprimi i tyre do të jetë i njëjtë' me ato të KEDNJ-së. Shembuj vendimesh ky gjykatat u referohen jurisprudencës së njëra tjetres mund të gjenden si p.sh. C-411/10 C-493/10, *N.S. k. Sekretari i Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme dhe ME dhe të Tjerë k. Komisionerit për Refugjatët dhe Ministrin të Drejtësisë, Barazisë dhe Reformës Ligjore*, vendim [Dhoma e Madhe] i 21 dhjetorit 2011, dhe *Tarakhel k. Zvicrës*, vendim [Dhoma e Madhe] i 4 nëntorit 2014, nr. 29217/12, të dyja të përfshira në këtë botim.

shoqëruara me komentet e ekspertëve. Gjykatat vendase në këto juridiksione zbatojnë një sërë normash ndërkombëtare, të tilla si Konventën e Gjenevës e vitit 1951 mbi Statusin e Refugjatëve, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të drejtën e BE-së dhe shpalsin një praktikë të mirë me skenarë të ndryshëm.

Ata që kanë kontribuar me ekspertizën e tyre të gjerë në hartimin e këtij libri me praktikë gjyqësore janë: Ledi Bianku, gjyqtar i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut; Nuala Mole, eksperte ligjore në Qendrën AIRE; Lars Bay Larsen, gjyqtar i Gjykatës së Drejtësisë i Bashkimit Evropian, dhe Hugo Storey, gjyqtar i Tribunalit të Lartë dhe President i Seksionit Evropian të Shoqatës Ndërkombëtare të Gjyqtarëve për të Drejtën e Refugjatëve.

Bordi Editorial për publikim përbëhet nga Biljana Braithwaite, menaxhere programi për Ballkanin Perëndimor, Qendra AIRE; Catharina Harby, konsulente ligjore, Qendra AIRE; Gjyqtari Ledi Bianku, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut; Nuala Mole, eksperte ligjore në Qendrën AIRE; dhe Marija Jovanovic, MJur (Oxon), DPhil (Oxon).

Përveç kësaj, ne jemi veçanërisht mirënjohës ndaj kontribuuesve nga Shoqata Ndërkombëtare e Gjyqtarëve për të drejtën e Refugjatëve: Harald Dörig, gjyqtar në Gjykatën Federale Administrative Gjermane (Gjermani); Florence Malvasio Presidente Seksioni, Gjykata Kombëtare për të Drejtën e Azilit (Francë); Liesbeth Steendijk, Këshilltare Shtetërore në Këshillin Holandez të Shtetit (Holandë); Yann Laurans, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian; Alessia Cicatiello, Qendra AIRE; dhe EDAL - Baza e të Dhënave Evropiane për të Drejtën e Azilit.

## Shkurtime

DPA - Direktiva mbi Procedurat e Azilit

KKT - Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese 1984

SPEA - Sistemi i Përbashkët Evropian i Azilit

KEDG - Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminim ndaj Grave 1979

KDTHBE - Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian 2000

GJDBE - Gjykata e Drejtësisë të Bashkimit Evropian

KDF - Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve 1989

KDPAK - Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2006

KE - Komuniteti Evropian

KEDNJ - Konventa Evropiane për të Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, 1950

KERD - Këshilli Evropian për Refugjatët dhe të Dëbuarit

GJEDNJ - Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

ZEE - Zona Ekonomike Evropiane

RRLEZ - Rrjeti Ligjor Evropian për Azilin

BE - Bashkimi Evropian

KGJ - Konventa e Gjenevës në lidhje me Statusin e Refugjatëve 1951

DHM - Dhoma e Madhe

PKDCP - Pakti Ndërkombëtarë për të Drejtat Civile dhe Politike 1966

PNPZHD- Pakti Ndërkombëtarë për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar 2006

KNEFDR – Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial 1966

PNDCPK – Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile, Politike dhe Kulturore, 1966

KNMDEA – Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Emigrantëve Ekonomikë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre 1990

GJNP – Gjykata Ndërkombëtare Penale

PZHB – Personat e Zhvendosur së Brendshmi

DNH – E drejta Ndërkombëtare Humanitare

SHA – Shtetet Anëtare

OJQ – Organizata Jo Qeveritare

DK – Direktiva Kualifikimit

DKP – Direktiva për Kushtet e Pritjes

TFBE – Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian 2007

DUDNJ – Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut 1948

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

ZKLBKBR – Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët

LIIB – Lufta e dytë Botërore

## **Tabela e Traktateve dhe Instrumentet të tjera Ndërkombëtarë dhe Rajonale**

- 1948 Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
- 1950 Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
- 1951 Konventa për Statusin e Refugjatëve
- 1958 Konventa e Gjenevës mbi Detin e Hapur
- 1958 Konventa e Gjenevës mbi Ujërat Territorial dhe Zonën e Puqur
- 1961 Karta Sociale Evropiane
- 1966 Konventa Ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial
- 1966 Konventa për të Drejtat Civile dhe Politike
- 1966 Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile, Politike dhe Kulturore
- 1967 Protokollin në lidhje me Statusin e Refugjatëve
- 1974 Konventa Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det
- 1984 Deklarata e Kartagjenës mbi Refugjatët
- 1984 Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese
- 1989 Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve
- 1990 Konventa e Dublinit për Përcaktimin e Shtetit Përgjegjës për Shqyrtimin e Kërkesave për Azil të paraqitura në një prej Shteteve Anëtare të Komunitetit Evropian
- 1998 Parimet Udhëzuese për Zhvendosjen e Brendshme
- 2000 Karta për të Drejtat Themelore e Bashkimit Evropian



- 2003 Direktiva e Këshillit e BE-së nr. 2003/9 mbi Standardet Minimale për Pritjen e Azilkërkuesve
- 2003 Rregullorja e Këshilli i BE nr. 343/2003 për Përcaktimin e Kritereve dhe Mekanizmat për Përcaktimin e Shtetit Anëtar Përgjegjës për Shqyrtimin e një Kërkesë për Azil e paraqitur në një Shtet Anëtar nga një shtetas i në vendi të tretë (Rregullorja Dublin II)
- 2004 Direktiva e Këshillit të BE-së nr. 2004/83 mbi Standardet Minimale për Kualifikimin dhe Statusin e Shtetasve të Vendeve të Treta apo Personave pa Shtetësi si Refugjatë ose si Persona që Kanë Nevojë për Mbrojtje Ndërkombëtare dhe Përmbajtja e Mbrojtjes së Dhënë (DK)
- 2005 Direktiva e Këshillit të BE-së nr. 2005/85 mbi Standardet Minimale për Procedurat për Dhënien dhe Heqjen e Statusit të Refugjatit (DPA)
- 2008 Direktiva e Këshillit të BE-së nr. 2008/115 për Standardet dhe Procedurat në Shtetet Anëtare për Kthimin e Shtetasve të Vendeve të Treta që Qëndrojnë në Mënyrë të Paligjshme (Direktiva e Kthimit)
- 2013 Rregullorja e Këshillit të BE-së nr. 604/2013 mbi Përcaktimin e Kritereve dhe Mekanizmave të Identifikimit të Shtetit Anëtar Përgjegjës për Shqyrtimin e një Kërkesë për Azil të Paraqitur në një nga Shtetet Anëtare nga një Shtetas i një Vendi të Tretë ose një Person pa Shtetësi (Rregullorja Dublin III)

## Shënime në lidhje me citimet dhe referencat

Në lidhje me vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, referenca do të japë emrin e çështjes në shkronja të pjerrëta, datën e vendimit - duke specifikuar nëse ai është vendim i Dhomës së Madhe në kllapa - dhe numrin e kërkesës:

*Emri k. Shtetit*, vendim [Dhoma e Madhe] mbi themelin/pranueshmërinë i datës, kërkesa nr. xxx/xx.

Në lidhje me vendimet e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropiane, referenca do të japë numrin me të cilin ato janë regjistruar në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë duke përdorur prefiksin C-, emrin e çështjes në shkronja të pjerrëta, datën e vendimit, duke sqaruar nëse është vendim i Dhomës së Madhe në kllapa:

C-numri, *emri i çështjes*, [Dhoma e Madhe] data e vendimit.



# Vështrim i Përgjithshëm i Sistemit për Mbrojtjen Ndërkombëtare të Personave në Rrezik

## Kuadri ligjor i Sistemit të Mbrojtjes Ndërkombëtare në Evropë

Shtetet janë përgjegjës për mbrojtjen e shtetasve të tyre. Abuzimi i qeverisë me shtetasit e saj apo dështimi për t'i mbrojtur, duke sjellë kështu shkelje apo rrezikun e shkeljes së të drejtave të tyre, mund të çojë në largimin e qytetarëve nga vendi i tyre dhe kërkim të sigurisë në një vend tjetër. Për shkak të pamundësisë apo mos vullnetit të Shtetit për të mbrojtur shtetasit e tij, apo kur vet ky i fundit, me anë të funksionarëve të tij kryen veprime që cenojnë të drejtat e shtetasve të tij, e drejta ndërkombëtare kërkon mbrojtjen e tyre nga Shtetet, në të cilat këta njerëz zhvendosen. Edhe pse një Shtet ndalohej nga e drejta ndërkombëtare për të dëbuar shtetasit e tij nga territori i tij, një ndalim i tillë nuk ekziston në rastin e personave që nuk janë shtetas të atij Shteti, një element i rëndësishëm ky i sovranitetit të një Shteti. Kështu, detyrimi ndërkombëtar i parashikuar për mbrojtjen e refugjatëve cenon në mënyrë të konsiderueshme një nga atributet e sovranitetit shtetëror.

Ata që kërkojnë një mbrojtje të tillë ndërkombëtare thuhet se kërkojnë “azil” dhe u referohen si “refugjatë”. Ata që lënë vendin e tyre për arsye të tjera por që mund të kthehen përsëri, konsiderohen thjesht emigrantë. Flukset migratore janë shpesh një përzierje e azilkërkuesve dhe emigrantëve të zakonshëm dhe shtetet kanë detyrime – por detyrime të ndryshme – për të dyja grupet. Respektimi i detyrimeve ndaj azilkërkuesve është më kërkues dhe për këtë, së pari, është e nevojshme të identifikohen ata që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Gjithashtu, emigrantët e tjerë duhet të trajtohen me dinjitet dhe në përputhje me normat e zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare.

## Ligjet dhe Standardet Rajonale dhe Ndërkombëtare mbi Azilin

Në Evropë zbatohen tre regjime kryesore ligjore, shpesh të mbivendosura, kundrejt personave të cilët janë objekt i detyrimit ndërkombëtar të parashikuar për t'u dhënë azil atyre që kanë nevojë për të:

- (I) instrumentet e OKB-së, në veçanti Konventa e Gjenevës e 1951 për Statusin e Refugjatëve;
- (II) KEDNJ dhe instrumente të tjera të Këshillit të Evropës që lidhen me të;
- (III) *Acquis* i BE për azilin, i zbatueshëm për të gjithë vendet anëtare të BE. Disa nga Shtetet jo anëtare të BE kanë marrëveshje me BE për zbatimin e një pjese të *acquis* për azilin.

## **(I) INSTRUMENTET E OKB**

Instrumentet e OKB-së, të cilat së bashku përbëjnë Kartën e të Drejtave të OKB-së, ofrojnë mbrojtje për ata që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare: p.sh. Konventa kundër Torturës dhe Dënimeve a Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese (neni 3), Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (neni 7); Konventa e katërt e Gjenevës e vitit 1949 (Neni 45, § 4). Përveç kësaj ka një numër instrumentesh jo-detyruese të OKB-së të tilla si Deklarata për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë (Neni 8) dhe Parimet mbi Parandalimin Efektiv dhe Hetimin e Ekzekutimeve të Paligjshme, Arbitrare dhe pa një Gjykim të Drejtë (Parimi 5) të cilat gjithashtu ofrojnë mbrojtje.<sup>3</sup>

## **KONVENTA E GJENEVËS E 1951 PËR STATUSIN E REFUGJATËVE**

**Instrumenti kryesor ndërkombëtar është Konventa e Gjenevës e 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve (“KGJ”)**, e miratuar nga OKB-ja, pas Luftës së Dytë Botërore për të siguruar një regjim ligjor që rregullonte statusin e të gjithë atyre qindra mijëra refugjatëve të cilët ishin zhvendosur në Evropë në vitin 1951.

KGJ ofron një paketë të plotë të të drejtave për një grup të përkufizuar në mënyrë strikte të personave që rrezikojnë të persekutohen në vendet e tyre. Neni 1A i Konventës së Gjenevës – siç është ndryshuar tashmë nga Protokollin e vitit 1967<sup>4</sup> - e përkufizon refugjatin si një person:

3 Kthimi për t'u përballur me një rrezik të keqtrajtimit, gjithashtu ndalohet, shprehimisht ose me anë të interpretimit, në një numër instrumentesh *rajonalë* të të drejtave të njeriut: Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut (neni 22), Deklarata e Kartagjenës, Konventa për Refugjatë e Organizatës së Bashkimit Afrikan (neni II), Deklarata e Kajros për Mbrojtjen e Refugjatëve dhe Personave të Zhvendosur në Botën Arabe (neni 2). Instrumentet rajonale specifike në Evropë do të analizohen në detaje më poshtë.

4 Protokollin e vitit 1967 heq kufizimet kohore dhe gjeografike të cilat në fillim ishin pjesë e KGJ: “Për qëllimet e këtij protokollin,

*“i cili për shkak të një frike të bazuar persekutimi për shkak të racës, fesë, shtetësisë, të përkatësive ndaj një grupi shoqëror ose të opinioneve të tij politike, gjendet jashtë vendit shtetësinë e të cilit ka dhe nuk ka mundësi ose për shkak të kësaj frikë nuk do t’i drejtohet këtij vendi për mbrojtje”.*

Megjithatë, neni 1F i Konventës së Gjenevës specifikon se një person nuk mund të njihet si refugjat nëse:

- a) ka kryer një krim kundër paqes, një krim lufte ose një krim kundër njerëzimit;
- b) ka kryer një krim ordiner të rëndë jashtë vendit ku kërkon strehim përpara se të pranohet si refugjat;
- c) është fajtor për kryerje veprimesh që bien në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

KGJ përcakton standardet minimale për trajtimin e personave të cilët kualifikohen për marrjen e statusit të refugjatit, si dhe përfitimet sociale që rrjedhin nga ky status.

Kështu, KGJ dhe Protokollin mbulojnë tre kategori kryesore:

- (I) Neni 1: përkufizimin e termit refugjat, duke përfshirë listën e arsyeve që pasjellin frikën e persekutimit së bashku me rrethanat në të cilat personat e huaj nuk mund të marrin statusin e refugjatit ose nëse e kanë e humbasin atë (neni 1C); Palestinezët kanë një regjim të posaçëm (neni 1D)<sup>5</sup>.
- (II) Nenet 2 deri 33: statusi ligjor i refugjatëve në vendin e azilit, të drejtat dhe detyrimet e tyre, duke përfshirë në veçanti të drejtën e parashikuar

.....  
 termi “refugjat” nënkupton [...] çdo person sipas përkufizimit të nenit 1 të Konventës, duke hequr fjalitë “si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur përpara datës 1 janar të vitit 1951 [...]” dhe fjalët [...] “si rezultat i ngjarjeve të tilla”, në nenin 1A (2). Ky protokoll do të zbatohet nga Shtetet Palë të këtij protokollin pa asnjë kufizim gjeografik [...]” Neni 1 (2) (3). Turqia nuk është palë e Protokollit të vitit 1967.

- 5 Neni 1D i KGJ-së parashikon se “Kjo Konventë nuk gjen zbatim ndaj personave që përfitojnë aktualisht nga mbrojtja ose asistencë e ndonjë organizimi ose e një institucioni të Kombeve të Bashkuara përveç Komisarariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për refugjatët. Kur kjo mbrojtje ose kjo asistencë ka pushuar për çfarëdo arsye, ndërsa fati i këtyre personave nuk është rregulluar përfundimisht në përputhje me rregullat përkatëse të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, këta persona përfitojnë nga regjimi i kësaj Konvente pa ndonjë formalitet të veçantë”.

në nenin 33(1) për mbrojtjen nga dëbimi apo “*kthimi*”, drejt një territori ku jeta apo liria e tyre do të rrezikoheshin

Siç përmendet më lart, disa persona në rrezik persekutimi, përjashtohen nga statusi i refugjatit (neni 1F). Por edhe ata që plotësojnë kushtet për të marrë statusin e refugjatit mund të humbasin të drejtën për të mos u kthyer sipas KGJ-së, nëse sjellja e tyre përbën kërcënim për vendin pritës. Lidhur me këtë neni 33 (2) parashikon:

“ Megjithatë, nga kjo dispozitë nuk do të përfitojë një refugjat për të cilin ka arsye të forta të mendohet se përbën një rrezik për sigurinë e vendit ku ai ndodhet ose sepse është dënuar me një dënim të formës së prerë për një krim veçanërisht të rëndë, pra përbën një kërcënim për bashkësinë e atij vendi”. Edhe pse ata humbasin mbrojtjen e Konventës së Gjenevës për sa i përket kthimit të tyre, ata megjithatë nuk pushojnë së qeni refugjatë.

(III) Detyrimet e shtetit kundrejt refugjatëve përfshijnë sigurimin e zbatimit dhe respektimit të së drejtës së tyre për të drejtat sociale dhe civile të parashtruara në KGJ (shih më lart (ii)). Neni 34 i GC parashikon asimilimin dhe natyralizimin:

“Shtetet Palë, brenda mundësive, lehtësojnë asimilimin dhe natyralizimin e refugjatëve. Ata përpiqen veçanërisht të përshpejtojnë procedurën e natyralizimit dhe të pakësojnë, për aq sa është e mundur, taksat dhe shpenzimet e kësaj procedure”.

Shtetet gjithashtu kanë detyrimin për të bashkëpunuar me ZKLBKBR-në ushtrimin e funksioneve të tij dhe për të lehtësuar detyrimin e tij për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitës së Konventës.

KGJ-ja nuk përcakton rregulla për procedurat apo kriteret që duhet të zbatohen në përcaktimin nëse një person është, apo jo, refugjat, edhe pse ZKLBKBR-ja ka publikuar një Manual <sup>6</sup>, ku përcaktohet udhëzime e dala kohë pas kohe nga

6 UNHCR, *Manual dhe Udhëzime mbi Procedurat dhe Kriteret për Përcaktimin e Statusit të Refugjatit në bazë të Konventës së vitit 1951 dhe Protokollit të vitit 1967 për Statusin e Refugjatëve*, 1 janar 1992.

Konkluzionet e Komitetit Ekzekutiv të saj<sup>7</sup>, ose në Udhëzues të tjerë<sup>8</sup>.

Megjithatë nuk ka asnjë organ mbikombëtar që të sigurojë shqyrtimin, veçanërisht shqyrtimin gjyqësor, të vendimeve kombëtare në lidhje me aplikimin dhe zbatimin e vendimeve në bazë të KGJ-së. Kjo sjell rritjen në nivele shqetësuese të pabarazisë dhe paqëndrueshmërisë si dhe mungesën e sigurisë ligjore ndërmjet vendimeve të ndryshme kombëtare në zbatim të KGJ-së. Përveç kësaj, azilkërkuesve të cilëve u është refuzuar statusi i refugjatit në nivel kombëtar nuk kanë mjet rekursi në një organ ndërkombëtar, aq më pak në një gjykatë, e cila të mund ta shqyrtojë këtë vendim. Disa nga instrumentet e tjera të OKB-së, të tilla si Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP), Konventa kundër Torturës (KKT), Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEDG), Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial (KEDR), Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (KDF), parashikojnë procedurën fakultative të ankimit individual pranë Komiteteve që të cilat i mbikëqyrin ato<sup>9</sup>, por KGJ-ja nuk e parashikon një mundësi të tillë.

## (II) KONVENTA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Nuk ka asnjë dispozitë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që t'i referohet shprehimisht refugjatëve apo azilit. GJEDNJ-ja nuk ka kompetencë për të vendosur nëse refuzimi i dhënies të statusit refugjat një personi sipas KGJ ka qenë i drejtë apo i gabuar, apo humbja e mbrojtjes nga *kthimi* sipas KGJ (*Ahmed k. Austrisë*<sup>10</sup>). Megjithatë, jurisprudenca e GJEDNJ-së e bën të qartë se neni 2 dhe neni 3 (*Bader dhe Kanbor k. Suedisë*<sup>11</sup>) të KEDNJ-së **ndalojnë kthimin**

7 UNHCR, Konkluzionet e Komitetit Ekzekutiv për Mbrojtjen Ndërkombëtare janë në dispozicion në: <http://www.unhcr.org/cgi-bin/texis/vtx/search?page=&comid=49eee4826&cid=49aea93a20&scid=49aea93a12&tid=49ec6f17f> (vizituar së fundmi më 13 janar 2016).

8 Udhëzimet e UNHCR mbi Mbrojtjen Ndërkombëtare janë në dispozicion në: <http://www.unhcr.org/cgi-bin/texis/vtx/search?page=home&skip=0&cid=49aea93ae2&comid=4a27bad46&keyeords=RSDguidelines> (vizituar së fundmi më 13 Janar 2016).

9 Çdokush mund të paraqesë një ankesë në Komision - secili prej traktateve të OKB-së ka ngritur një "organ të traktatit" (Komitet) ekspertësh për të monitoruar zbatimin e dispozitave të traktatit nga Shtetet Palë të saj - kundër një Shteti palë në traktatin në fjalë (nëpërmjet ratifikimit ose aderimit) i cili garanton të drejtat që pretendohet të jenë shkelur dhe pranon autoritetin e Komisionit për të shqyrtuar ankesat individuale, qoftë përmes ratifikimit apo aderimit në një Protokoll Fakultativ (si në rastin e PKDCP, KEDG, KDPAK, PNDPK dhe KDF) ose nëpërmjet një deklarate për këtë qëllim sipas një neni të veçantë të Konventës (si në rastin e KNEFDR, KKT, PNPZHD dhe KNMDEA).

10 *Ahmed k. Austrisë*, vendim i 17 dhjetorit 1996, nr. 25964/94, i përfshirë në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

11 *Bader dhe Kanbor k. Suedisë*, vendim i 8 nëntorit 2005, nr. 13284/04, i përfshirë gjithashtu në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.



## **në rastet kur personi rrezikon të përballet me një rrezik real të vdekjes apo të torturës, trajtimit çnjerëzor ose degradues<sup>12</sup>.**

Neni 34 i KEDNJ-së parashikon të drejtën e kërkesës individuale në GJEDNJ<sup>13</sup>. Kjo do të thotë se çdo person që pretendon se po shkelet apo është shkelur ndalimi i kthimit, mund t'i drejtohet GJEDNJ-së pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet e brendshme ligjore. Juridiksioni i GJEDNJ ka luajtur një rol të rëndësishëm në rishqyrtimin e vendimeve të organeve administrative kombëtare dhe vendimeve të gjykatave kombëtare që rishikonin këto vendime administrative. Gjithashtu GJEDNJ-ja ka fuqinë që të vendosë masa të përkohshme sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës për të pezulluar dëbimin apo kthimin që mund të shkaktojnë një dëm të pariparueshëm deri në vlerësimin nga ana e Gjykatës të pranueshmërisë dhe themelit të kërkesës. Më parë, konsiderohej se “urdhurat” në bazë të nenit 39 të Rregullores nuk ishin të detyrueshme, por në vendimet *Mamatkulov dhe Askarov k. Turqisë, Olaechea Cahuas k. Spanjës dhe Ben Khemais k. Italisë*<sup>14</sup>, GJEDNJ-ja u shpreh se mos respektimi i një urdhri sipas nenin 39 të Rregullores, pengon ushtrimin e së drejtës për kërkesë individuale në shkelje të nenit 34.

Ndalimi i KEDNJ-së vlen edhe për kthimin e personave në Shtetet e tjera përveç Shteteve nga të cilat janë larguar fillimisht, në qoftë se kjo do i ekspozonte ata ndaj rrezikut të dëmtimit apo ndaj rrezikut për t'u kthyer nga vendi ku po shkojnë dhe për t'u përballur me dëmtimin (*M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*<sup>15</sup>). Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet familjeve me fëmijë (*Tarakhel k. Zvicrës*<sup>16</sup>).

Ndalimi i parashikuar nga KEDNJ bazohet në një parashikim faktik të rrezikut të një dëmtimi serioz dhe jo në *arsyet* për të cilat ekziston frika e keqtrajtimit.

12 Protokoli 6 dhe 13 ndalon kthimin në rastet kur personit rrezikon dënimin me vdekje.

13 Neni 33 i cili rregullon çështjet ndër shtetërore, parashikon se “Çdo Palë e Lartë Kontraktuese mund t'i referojë Gjykatës çdo shkelje të pretenduar të dispozitave të Konventës dhe të protokolleve të saj nga një Palë tjetër e Lartë Kontraktuese”. Megjithatë, mundësia e rasteve ndërshtetërore, sidomos në kontekstin e Shteteve anëtare të BE-së, është veçanërisht e ndërlikuar dhe e pamundur.

14 *Mamatkulov dhe Askarov k. Turqisë*, vendim [Dhoma e Madhe] i 4 shkurtit 2005, nr. 46827/99 dhe 46951/99, *Olaechea Cahuas k. Spanjës*, vendim i 10 gushtit 2006, nr. 24668/03, dhe *Ben Khemais k. Italisë*, vendim i 24 shkurtit 2009, nr. 246/07, i përfshirë në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

15 *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*, vendim [Dhoma e Madhe] i 21 janarit 2011, nr. 30696/09, i përfshirë në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

16 *Tarakhel k. Zvicrës*, vendim [Dhoma e Madhe] i 4 nëntorit 2014, nr. 29217/12, i përfshirë gjithashtu në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

Ndryshe nga KGJ, nuk ka asnjë kërkesë sipas KEDNJ-së se ky rrezik duhet të bazohet në persekutimin për një nga arsytet e përcaktuara në nenin 1 të KGJ (*Salah Sheekh k. Holandës, NA k. Mbretërisë së Bashkuar, Sufi dhe Elmi k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>17</sup>). Persekutimi mjaftueshmërisht serioz mund të përbëjë keqtrajtimit i cili ndalohet nga neni 3, por është niveli i ashpërsisë së keqtrajtimit, apo situatës që është i rëndësishëm në kuadër të KEDNJ-së dhe jo arsytet e tij.

Shtetet janë të detyruara për “shqyrtimin më të kujdesshëm” të ekzistencës së rreziqeve në vendin e destinacionit të propozuar dhe nëse është e nevojshme duhet të bëjnë kërkime të hollësishme në këtë drejtim (*M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*<sup>18</sup>). Në rrethana ekstreme ndalimi mund të zbatohet në situata mjekësore që rrezikojnë seriozisht jetën e personit (*D. k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>19</sup>, *N. k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>20</sup>).

Ndalimi është **absolut** dhe askush nuk është i përjashtuar qysh në fillim nga mbrojtja që garanton KEDNJ (krahasuar me neni 1F të KGJ-së) (*Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>21</sup>). Individët nuk mund të humbasin mbrojtjen e garantuar nga KEDNJ as për shkak të sjelljes së tyre apo të perceptimit se përbëjnë kërcënim nga për shteti pritës (shih neni 33(2) të KGJ-së) (*Saadi k. Italisë, Othman k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>22</sup>). Pra neni 1F dhe neni 33(2) i KGJ-së janë të pa zbatueshme në thelb për çdo situatë të rregulluar nga KEDNJ. Konventa mbron të drejtat e atyre që janë ndaluar në det të hapur (*Hirsi Jamaa dhe të tjerët k. Italisë*<sup>23</sup>) ose që mbahen në zonat e transitit të aeroporteve (*Amuur k. Francës*<sup>24</sup>). Gjithashtu, GJEDNJ-ja ka përcaktuar disa standarde në lidhje me masat mbro-

17 *Salah Sheekh k. Holandës*, vendim i 11 janarit 2007, nr. 1948/04, *NA. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 17 korrikut 2008, nr. 25904/07, *Sufi dhe Elmi k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 28 qershor 2011, nr. 8319/07 dhe 11449/07, të përfshira në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

18 I përfshirë gjithashtu në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

19 *D. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 2 majit 1997, nr. 30240/96.

20 *N. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim [Dhoma e Madhe] i 27 majit 2008, nr. 26565/05, i përfshirë në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

21 *Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim [Dhoma e Madhe] i 15 nëntorit 1996, nr. 22414/93, i përfshirë gjithashtu në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

22 *Saadi k. Italisë*, vendim [Dhoma e Madhe] i 28 shkurtit 2008, nr. 37201/06, dhe *Othman (Abu Qatada) k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 17 janarit 2012, nr. 8139/09, të përfshira në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

23 *Hirsi Jamaa dhe të tjerët k. Italisë*, vendim [Dhoma e Madhe] i 23 shkurtit 2012, nr. 27765/09, e përfshirë gjithashtu në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

24 *Amuur k. Francës*, vendim i 25 qershor 1996, nr. 19776/92.

jtëse procedurale (*Jabari k. Turqisë*<sup>25</sup>), dhe neni 13 kërkon që të parashikohen mjete efektive ligjore për çdo shkëlqje të argumentuar të këtyre garancive. Këto mjete duhet të kenë efekt pezullues të menjëhershëm në mënyrë që askush të mos dëbohet ose kthehet në vendin nga ka ardhur përpara se t'u jepet një mundësi për rishqyrtimin efektiv të vendimit (*Gebremedhin k. Francës*<sup>26</sup>). Mjete të tilla ligjore kërkohen nga neni 13; neni 6 i KEDNJ-së, i cili garanton të drejtën për një gjykim të drejtë, nuk ka të bëjë me këto pretendime, pasi këto nuk kanë të bëjnë as me akuza penale dhe as me të drejta me karakter civil.

Ata që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare dhe që gjenden brenda juridiksionit të një Shteti, gëzojnë të gjitha garancitë e KEDNJ-së. Neni 5 i KEDNJ-së rregullon çështjet e ndalimit, duke përfshirë ndalimin e emigrantëve dhe azilkërkuesve (*Saadi k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>27</sup>). Neni 5 (1) (f) trajton specifikisht ndalimin e emigrantëve. Të gjitha garancitë përkatëse materiale dhe procedurale të parashikuara në nenin 5 paragrafi (1) deri në paragrafin (5), zbatohen për ndalimin e azilkërkuesve ose të azilkërkuesve që iu është refuzuar azili. Është shumë e rëndësishme që ndalimi të mos jetë arbitrar<sup>28</sup>, të mos jetë i tejzgjatur dhe - më e rëndësishmja - të autorizohet nga një dispozitë e qartë e së drejtës së brendshme ligjit kombëtar dhe të vendoset në pajtim të plotë me të. Neni 1 i Protokollit 4 rregullon kufizimet ndaj lirisë së lëvizjes të cilat nuk përbëjnë heqje të lirisë.

Me rëndësi kyçe është neni 4 i Protokollit 4 (N4P4) i cili ndalon **dëbimin kolektiv të të huajve**. Është e rëndësishme të theksohet se ndalimi nga N4P4 lidhet me **natyrën kolektive të procesit dhe mungesën e vlerësimit individual të çdo rasti**. Prandaj është e parëndësishme nëse të prekurit janë emigrantë të zakonshëm apo azilkërkues në rrezik - të gjithë janë të mbrojtur nga neni 4 i Protokollit 4<sup>29</sup>.

Kjo dispozitë vlen jo vetëm për dëbimin kolektiv të atyre që janë në territor (*Çonka k. Belgjikës*<sup>30</sup>), por është interpretuar se përfshin “kthimin mbrapsht”

25 *Jabari k. Turqisë*, vendim i 11 korrikut 2000, nr. 40035/98, e përfshirë në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

26 *Gebremedhin k. Francës*, vendim i 26 prillit 2007, nr. 25389/05.

27 *Saadi k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim [Dhoma e Madhe] i 29 janarit 2008, nr. 13229/03.

28 Neni 5(4) i KEDNJ-së parashikon se “Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirim, në qoftë se burgimi është i paligjshëm”.

29 Mbretëria e Bashkuar, Greqia, Turqia dhe Zvicra nuk janë palë të Protokollit nr. 4.

30 *Çonka k. Belgjikës*, vendim i 5 shkurtit 2002, nr. 51564/99.

të grupeve të njerëzve në det të hapur (*Hirsi Jamaa dhe të tjerë k. Italisë*<sup>31</sup>), ose kthimin kolektiv të atyre që kanë ardhur në territorin e një Shteti pa marrë në konsideratë rrethanat individuale të secilit prej personave të kthyer (*Khalifa dhe të tjerë k. Italisë*<sup>32</sup>, vendim që tashmë i është referuar Dhomës së Madhe). Gjithashtu ajo gjen zbatim edhe për kthimet të ngjashme në grup në kufijtë tokësorë (*ND dhe NT k. Spanjës* – në pritje të vendimit).

Ndryshe nga KGJ, GJEDNJ-ja në përgjithësi ka të bëjë vetëm me ndalimin e kthimit në rastet kur personi rrezikon keqtrajtimin ose kushte të papranueshme të jetesës. Ajo nuk përcakton detyrimin për njohjen, në vendin pritës, të një statusi të veçantë apo dhënien e përfitimeve të caktuara sociale, me përjashtim të rrethanave të veçanta, kur këto janë të garantuara me ligj por në mënyrë të paligjshme personit i janë mohuar (*M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*<sup>33</sup>).

### (III) ACQUIS I BE-së PËR AZILIN

BE-ja ka përgatitur një paketë masash të njohura si Sistemi i Përbashkët Evropian i Azilit (SPEA), i cili së bashku me jurisprudencën e GJEDNJ formon **acquis e BE-së për azilin** - të zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së<sup>34</sup>. Kjo paketë masash sjell regjimin e azilit në gjithë Shtetet ku vepron e drejta e BE-së duke përfshirë të gjitha parimet e përgjithshme të së drejtës të BE-së dhe Kartën e BE-së për të Drejtat Themelore. *Acquis* i BE për azilin ka për qëllim të korrigjojë brenda BE-së mungesën e vendimmarrjes së harmonizuar në bazë të KGJ-së të lartë përmendur dhe të dekurajojë praktikën e zgjedhjes së juridiksionit më të favorshëm nga azilkërkuesit. Ai nuk përfshin të gjithë parashikimet e KGJ-së (*Mohammad Ferooz Qurbani, C-481/13*<sup>35</sup>) dhe ka një objekt mbrojtje më të ngushtë se ai që ofron KEDNJ.

Instrumentet kryesore janë: Direktiva e Kualifikimit (DK)<sup>36</sup>, e cila përcakton se kush gëzon mbrojtje dhe çfarë lloj mbrojtje si dhe statusin dhe përfitimet

31 I përfshirë, gjithashtu, në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

32 *Khalifa dhe të tjerë k. Italisë*, vendim i 1 shtatorit 2015, nr. 16483/12.

33 I përfshirë, gjithashtu, në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

34 Danimarka nuk është pjesë e Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit.

35 C-481/13, *Mohammad Ferooz Qurbani*, vendim i 17 korrikut 2014.

36 Direktiva e Këshillit të BE-së nr. 2004/83 i 29 prillit 2004 mbi standardet minimale për kualifikimin dhe statusin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si refugjatë ose si persona që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë.

që vijnë me të; Direktiva mbi Procedurat e Azilit (DPA)<sup>37</sup>, ku përcaktohen procedurat që duhet të ndiqen në shqyrtimin e kërkesave për azil; Direktiva për Kushtet e Pritjes (DKP)<sup>38</sup>, në të cilën përcaktohen standardet minimale për pritjen, strehimin dhe/ose ndihmën financiare për azilkërkuesve; dhe Rregullorja e Dublinit (Dublini)<sup>39</sup>, e cila përcakton se cili Shtet i BE-së është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për azil dhe garanton që azilkërkuesit të kthehen në shtetin e identifikuar si përgjegjës sipas kriterëve të Dublinit<sup>40</sup>. Direktiva e Kthimit<sup>41</sup> nuk është pjesë e *acquis* për azil, por përcakton rregullat në lidhje me rregullimin apo kthimin e atyre emigrantëve që me vendim përfundimtar u është refuzuar e drejta për të qëndruar në një Shtet Anëtar.

DK jep përkufizimin, e zbatueshëm në të gjithë BE-së, të personave që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare sipas së drejtës së BE-së. Kjo Direktivë ofron njohjen si “refugjat” siç përcaktohen nga KGJ, ose për “mbrojtje plotësuese” për ata që rrezikojnë të pësojnë dëmtim serioz. Përkufizimi i “dëmtimit serioz” përputhet në një farë mase me mbrojtjen e ofruar nga KEDNJ. Megjithatë, DK, ashtu si KGJ por ndryshe nga KEDNJ, përjashton ata që konsiderohen të padëshirueshëm apo nuk meritojnë përfitimet sipas kësaj Direktive (neni 12). Gjithashtu, kjo Direktivë përcakton përfitimet që kanë të drejtë të marrin personat që gëzojnë mbrojtje (neni 20 deri 35).

DPA përcakton në mënyrë të detajuar garancitë procedurale dhe procedurat të cilat shtetet duhet të respektojnë në lidhje me ata që kërkojnë azil. Ajo gjen zbatim në territorin e Shtetit, kufijtë dhe ujërat territorial dhe jo në det të hapur (neni 3). Gjithashtu, direktiva identifikon një numër situatash, në të cilat këto procedura nuk gjejnë zbatim (neni 33).

DKP përcakton kushtet minimale materiale dhe sociale që u duhen siguruar

- 
- 37 Direktiva e Këshillit të BE-së nr. 2005/85, e 1 dhjetorit 2005 mbi standardet minimale për procedurat për dhënien dhe heqjen e statusit të refugjatit.
- 38 Direktiva e Këshillit të BE-së nr. 2003/9 e 27 janarit 2003 mbi standardet minimal për pritjen e azilkërkuesve.
- 39 Rregullorja e Këshillit të BE-së nr. 604/2013 e 26 qershorit 2013 mbi përcaktimin e kriterëve dhe mekanizmave për identifikimin e Shtetit Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për azil, paraqitur në një prej Shteteve Anëtare nga një shtetas i një vendi të tretë ose pa shtetësi (e ndryshuar).
- 40 Direktiva e Kualifikimit, Direktiva për Procedurat e Azilit, Direktiva për Kushtet e Pritjes dhe Rregullorja e Dublinit kanë ndryshuar. Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda nuk janë pjesë e versionit të ndryshuar të tyre - me përjashtim të Rregullores së Dublinit. Irlanda nuk është pjesë e Direktivës për Kushtet e Pritjes.
- 41 Direktiva e Këshillit të BE-së nr. 2008/115 e 16 dhjetorit 2008 mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta në Shtetet Anëtare për kthimin e shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme.

azilkërkuesve ndërsa presin shqyrtimin e kërkesave të tyre për azil. Nga kjo Direktivë përfitojnë edhe ata persona të cilët u nënshtrohen procedurave të kthimit sipas Dublinit (GJDBE, C-179/11, CIMADE & GISTI<sup>42</sup>).

Si DPA dhe DKP përmbajnë dispozita që lidhen me lirinë e lëvizjes dhe ndalimin (respektivisht neni 26 i DPA, dhe neni 8 i DKP).

Sistemi i Dublinit është baza ligjore, që zbatohet brenda BE-së, për të vendosur se cili shtet anëtar i BE-së është përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për azil. Ai përcakton kriteret që zbatohen për të përcaktuar Shtetin përgjegjës. Hapi i parë që duhet ndërmarrë kur një person kërkon azil në një Shtet Anëtar të BE-së është identifikimi i shtetit përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës. Shteti pritës duhet t'i kërkojë një Shteti tjetër Anëtar (ku azilkërkuesi ka p.sh. lidhje familjare) për të "marrë përgjegjësinë" e kërkesës për azil, por gjithashtu mund t'i kërkojë një tjetër Shtet Anëtar për të pritur azilkërkuesin, nëse kriteret përkatëse ë bëjnë atë Shtet përgjegjës. Kriteret zbatohet sipas një hierarkie të mirë përcaktuar, ku lidhjet familjare dhe interesi më i lartë i të miturit ka përparësi. Personat që aplikojnë për azil në një Shtet Anëtar normalisht transferohen tek një Shtet tjetër Anëtar nëse, sipas kriterëve të Dublinit, ky i fundit është Shteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së tyre. Pjesë e sistemit të Dublinit janë gjithashtu edhe disa shtete jo anëtare të BE-së (Islanda, Norvegjia dhe Zvicra).

Karta e BE-së për të Drejtat Themelore (cito) zbatohet në lidhje me funksionimin e tërësisë së *acquis* për azilin. Neni 19 (1) i Kartës ndalon dëbimin kolektiv të të huajve, ndalim që zbatohet pra në sajë të së drejtës së BE edhe në ato shtete që nuk janë palë e Protokollit 4 të KEDNJ. Neni 47 i Kartës parashikon se garancitë e një gjykimi të drejtë që gjenden edhe në nenin 6 të KEDNJ-së, zbatohen në të gjitha procedurat ku zbatohet Karta; kështu garancitë e një gjykimi të drejtë zbatohen në të gjitha çështjet e azilit sipas së drejtës së BE-së, edhe pse ato nuk zbatohen sipas KEDNJ-së.

Megjithatë nuk ka një akses praktik në GJDBE, krahasuar me aksesin në KEDNJ, për azilkërkuesit që pretendojnë se nuk kanë arritur të gëzojnë përfitimet sipas *acquis* ose Kartës. Individët e pakënaqur mund të kundërshtojnë veprimet ose mosveprimet e organeve kombëtare në lidhje me të drejtën e azilit të BE-së në gjykatat kombëtare të Shteteve Anëtare të BE-së. Këto gjykata mund të referojnë çështje të interpretimit të *acquis* ose Kartës në GJDBE për një vendim

42 C-179/11, CIMADE dhe Groupe d'information et de soutien des immigrés (GISTI) k. Ministre de l'Intérieur, de l'Outre-mer, des Collectivités territoriales et de l'Immigration, vendim i 27 shtatorit 2012.

paraparak<sup>45</sup>. Shumica e vendimeve të GJDBE në këtë material i përkasin kësaj procedure referimi. Gjithashtu Komisioni i BE-së mund të nisë “procedurat për shkelje” kundrejt shteteve të BE-së të cilat nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre sipas *acquis* për azilin të BE-së.

## **PËRMBLEDHJE**

Të tre regjimet e lartpërmendura, që mbivendosen me njëri-tjetrin, zbatohen në të njëjtën kohë për të gjitha Shtetet Anëtare të BE si dhe në ato Shtete të cilat edhe pse nuk janë anëtare të BE i kanë pranuar ato. Shtetet evropiane që nuk janë anëtare të BE-së nuk janë të detyruara sipas *acquis* të BE-së për azil, por vetëm sipas KGJ dhe KEDNJ (dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare). Zbatimi i këtyre regjimeve të njëjtën kohë është një ushtrim kompleks ligjor. Në këtë rast duhet kujtuar neni 53 i KEDNJ-së i cili parashikon se një vendim nuk është në përputhje me KEDNJ, nëse ai ofron një nivel më të ulët mbrojtjeje të të drejtave të njeriut se sa garantohet nga instrumente të tjera ndërkombëtare, në të cilat Shteti është palë.

## **DETYRIMET E AUTORITETEVE KOMBËTARE – ROJET KUFITARE, PERSONELI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR AZIL, GJYQTARËT, LIGJVËNËSIT**

Njerëzit që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare do të ndeshen me autoritetet shtetërore në një numër situatash dhe Shtetet kanë detyrime materiale dhe procedurale kundrejt tyre. Zyrtarët shtetërorë dhe gjyqtarët duhet të njihen me detyrimet materiale dhe procedurale jo vetëm sipas së drejtës kombëtare, por edhe sipas praktikës ligjore evropiane.

Ka një praktikë gjyqësore të konsiderueshme për sa i përket standardeve procedurale dhe materiale sipas së drejtës së BE-së për azilin. Ky material paraqet një sërë rastesh të përzgjedhura të listuara më poshtë.

45 Neni 267 i Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian (TFBE).

**VENDIME TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT:**

Gjithashtu, ka vendosur në një numër rastesh të drejtën e azilkërkuesit për të hyrë në territorin e Shtetit përgjegjës: Hirsi Jamaa dhe të tjerë k. Italisë [DHM], nr. 27765/09; Tabesh k. Greqisë nr. 8256/07; I.M. k. Francës, nr. 9152/09; A.C. dhe të tjerë k. Spanjës nr. 6528/11; Sharifi dhe të tjerë k. Italisë dhe Greqisë, nr. 16643/09; Khlaifia dhe të tjerë k. Italisë, nr. 16483/12 (në pritje në Dhomë të Madhe); N.D. dhe N.T. k. Spanjës, nr. 8675/15 dhe 8697/15;

Gjithashtu, ajo ka vendosur edhe për të drejtën për akses në procedurën e vlerësimit të kërkesës për azil: Ahmed k. Austrisë, nr. 25964/94; Jabari k. Turqisë, nr. 40035/98; Bader dhe Kanbor k. Suedisë, nr. 13284/04; N. k. Mbretërisë së Bashkuar [DHM], nr. 26565/05; Louled Massoud k. Maltës, nr. 24340/08; M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë [DHM], nr. 20696/09; Rahimi k. Greqisë, nr. 8687/08; Othman (Abu Qatada) k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 8139/09; I.M. k. Francës, nr. 9152/09; Hirsi Jamaa dhe të tjerë k. Italisë [DHM], nr. 27765/09; Samsam Mohammed Hussein dhe të tjerë k. Holandës dhe Italisë, nr. 27725/10; A.C. dhe të tjerë k. Spanjës, nr. 6528/11; Sharifi dhe të tjerë k. Italisë dhe Greqisë, nr. 16643/09; Tarakhel k. Zvicrës [DHM], nr. 29217/12; Khlaifia dhe të tjerë k. Italisë, nr. 16483/12 (në pritje në Dhomë të Madhe);

Gjykata ka vendosur edhe mbi përshtatshmërinë e masave mbrojtëse procedurale të procedurës për shqyrtimin e kërkesës për azil: Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar [DHM], nr. 22414/93; Ahmed k. Austrisë, nr. 25964/94; T.I. k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 43844/98; Jabari k. Turqisë, nr. 40035/98; NA. k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 25904/07; M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë [DHM], nr. 20696/09; Sufi dhe Elmi k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 8319/07 dhe 11449/07; I.M. k. Francës, nr. 9152/09; Hirsi Jamaa dhe të tjerë k. Italisë [DHM], nr. 27765/09; Samsam Mohammed Hussein dhe të tjerë k. Holandës dhe Italisë, nr. 27725/10; A.C. dhe të tjerë k. Spanjës, nr. 6528/11;

Vendime mbi themelin e mbrojtjes ndërkombëtare: Ahmed k. Austrisë, nr. 25964/94; Jabari k. Turqisë, nr. 40035/98; Bader dhe Kanbor k. Suedisë, nr. 13284/04; Salah Sheekh k. Holandës, nr. 1948/04; Saadi k. Italisë [DHM], nr. 37201/06; NA. k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 25904/07; M. M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë [DHM], nr. 20696/09; Sufi dhe Elmi k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 8319/07 dhe 11449/07; Othman (Abu Qatada) k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 8139/09; I.M. k. Francës, nr. 9152/09; Hirsi Jamaa dhe të tjerë k. Italisë [DHM], nr. 27765/09; Abdulkhakov k. Ruisë, nr. 14743/11; Tarakhel k. Zvicrës [DHM], nr. 29217/12;



E drejta për mjet ligjor efektiv ankimor ndaj një vendimi negativ: Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar [DHM], nr. 22414/93; T.I. k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 43844/98; Jabari k. Turqisë, nr. 40035/98; Salah Sheekh k. Holandës, nr. 1948/04; NA. k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 25904/07; Ben Khemais k. Italisë, nr. 246/07; Al-Saadoon dhe Mufdhi k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 61498/08; M.S.S. v k. Belgjikës dhe Greqisë [DHM], nr. 20696/09; Sufi dhe Elmi k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 8319/07 dhe 11449/07; I.M. k. Francës, nr. 9152/09; Hirsi Jamaa dhe të tjerë k. Italisë [DHM], nr. 27765/09; Samsam Mohammed Hussein dhe të tjerë k. Holandës dhe Italisë, nr. 27725/10; A.C. dhe të tjerë k. Spanjës, nr. 6528/11; Sharifi dhe të tjerë k. Italisë dhe Greqisë, nr. 16643/09; Tarakhel k. Zvicrës [DHM], nr. 29217/12; Khlaifia dhe të tjerë k. Italisë, nr. 16483/12 (në pritje në Dhomë të Madhe);

Detyrimi për të siguruar kushte pritjeje që respektojnë dinjitetin e azilkërkuesve: N. k. Mbretërisë së Bashkuar [DHM], nr. 26565/05; Tabesh k. Greqisë, nr. 8256/07; Louled Massoud k. Maltës, nr. 24340/08; M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë [DHM], nr. 20696/09; Rahimi k. Greqisë, nr. 8687/08; I.M. k. Francës, nr. 9152/09; Hirsi Jamaa dhe të tjerë k. Italisë [DHM], nr. 27765/09; Samsam Mohammed Hussein dhe të tjerë k. Holandës dhe Italisë, nr. 27725/10; Sharifi dhe të tjerë k. Italisë dhe Greqisë, nr. 16643/09; Tarakhel k. Zvicrës [DHM], nr. 29217/12; dhe të tjerë k. Italisë, nr. 16483/12 (në pritje në Dhomë të Madhe);

Ndalimi (ose kufizimi i lirisë së lëvizjes) në pritje të vendimit për kërkesën për azil: Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar [DHM], nr. 22414/93; Louled Massoud k. Maltës, nr. 24340/08; M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë [DHM], nr. 20696/09; Abdulkhakov k. Ruisë, nr. 14743/11;

Ndalimi (ose kufizimi i lirisë së lëvizjes) në pritje të kthimit: Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar [DHM], nr. 22414/93; Tabesh k. Greqisë, nr. 8256/07; Louled Massoud k. Maltës, nr. 24340/08; Rahimi k. Greqisë, nr. 8687/08; I.M. k. Francës, nr. 9152/09; Abdulkhakov k. Ruisë, nr. 14743/11; Sharifi dhe të tjerë k. Italisë dhe Greqisë, nr. 16643/09; Khlaifia dhe të tjerë k. Italisë, nr. 16483/12 (në pritje në Dhomë të Madhe);

Detyrimet e posaçme për kategoritë vulnerabël (fëmijët, familjet, të moshuarit ose personat me aftësi të kufizuara): Cruz Varas dhe të tjerë k. Suedisë, nr. 15576/89; Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar [DHM], nr. 22414/93; Bader dhe Kanbor k. Suedisë, nr. 13284/04; Saadi k. Italisë [DHM], nr. 37201/06; N. k. Mbretërisë së Bashkuar [DHM], nr. 26565/05; Rahimi k. Greqisë, nr. 8687/08; Samsam Mohammed Hussein dhe të tjerë k. Holandës dhe Italisë, nr. 27725/10; Tarakhel k. Zvicrës [DHM], nr. 29217/12.

## **Vendime të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian:**

Përkufizimi i dëmtimit serioz dhe shkalla e personalizimit të nevojshëm të situatës: Meki Elgafaji dhe Noor Elgafaji k. Staatssecretaris van Justitie [DHM], C-465/07;

Ndalimi sipas Direktivës së Kthimit: Said Shamilovich Kadzoev (Huchbarov) [DHM], C-357/09;

Heqja e statusit të refugjatit, kur situata është përmirësuar, ndër të tjera nga prania e aktorëve ndërkombëtare efektivë të mbrojtjes: Aydin Salahadin Abdulla dhe të tjerë k. Bundesrepublik Deutschland [DHM], C-175/08, C-176/08, C-178/08 dhe C-179/08;

Kthimet sipas Rregullores së Dublinit në një Shtet Anëtar ku ka defekte sistematike në procedurat e azilit dhe kushtet e pritjes: NS k. Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme, dhe ME dhe të Tjerë k. Komisionerit për Refugjatët, Ministrit të Drejtësisë, Barazisë dhe Reformës Ligjore [DHM], C-411/10 dhe C-493/10;

Zbatimi i parimit të interesit më të lartë të fëmijëve në të gjitha aspektet e Rregullores së Dublinit dhe të miturve të pashoqëruar: MA, BT dhe DA k. Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme C-648/11;

Rregullorja e Dublinit mund të kërkojë që dispozitat e saj të zbatohen në më shumë se një Shtet Anëtar në vijimësi: Bundesrepublik Deutschland k. Kaveh Puid [DHM], C-4/11;

Një azilkërkues mund të kundërshtojë një transferim sipas Rregullores së Dublinit, vetëm nëse vendimi kërkon transferimin e tij në një Shtet ku ekzistojnë mangësi sistematike në procedurën e azilit: Shamsu Abdullahi k. Bundesasylamt [DHM], C-394/12;

Një konflikt i brendshëm i armatosur duhet vlerësuar mbi bazën e fakteve dhe jo në karakterizimin e konfliktit sipas së drejtës ndërkombëtare humanitar: Aboubacar Diakitë k. Commissaire general aux refugies et aux apatrides C-285/12;

Nuk mund të thuhet se deklaratave të azilkërkuesit u mungon besueshmëria thjesht sepse ai nuk e bazon kërkesën e tij për azil qysh në fillim në orientimin

e tij seksual si shkak të persekutimit të tij: A, B dhe C k. Staatssecretarias van Veiligheid en Justitie [DHM], C-148/13 dhe C-150/13;

Shtetet që kërkojnë të kthejnë një person të sëmurë rëndë në bazë të Direktivës së Kthimit duhet të parashikojnë një mjet ankimor me efekt pezullues dhe të sigurojnë mbështetjen e nevojshme materiale në pritje të përgjigjes në lidhje me ankimin: Centre public d'action sociale d'Ottignies-Louvain-la-Neuve k. Moussa Abdida [DHM], C-562/13;

Asnjë e drejtë për përfitimin e ndihmës sociale dhe kujdesit shëndetësor nuk parashikohet sipas DK për personat të cilëve u janë dhënë leje humanitare jashtë fushëveprimit të DK: Mohamed M'Bodj k. Etat belge [DHM], C-542/13;

Përjashtimi nga statusi i refugjatit nuk mund të bazohet thjesht në faktin e anëtarësimit në një organizatë, por duhet të varet nga shkalla e përfshirjes personale në aktivitetet e ndaluara: Bundesrepublik Deutschland k. B dhe D [DHM] C-57/09 dhe C-101/09;

Jo të gjitha ndërhyrjet në lirinë e fesë përbëjnë persekutim, por nuk mund të pretendohet mos praktikimi i fesë nga azilkërkuesit në mënyrë që të jenë të sigurt: Bundesrepublik Deutschland k. Y dhe Z [DHM], C-71/11 dhe C-99/11; Minister voor Immigratie en Asiel k. X, dhe Y dhe Z k. Minister voor Immigratie en Asiel C-199/12 deri C-201/12; Andre Lawrence Shepherd k. Bundesrepublik Deutschland C-472/13.

# Përmbledhje dhe komente të çështjeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

## Neni 3 - Ndalimi i Torturës dhe i Dënimeve ose Trajtimeve Çnjerëzore dhe Poshtëruese

*Urdhëri i dëbimit në përputhje me nenet 3 dhe 8 të Konventës dhe nuk ka shkelje të Konventës, pavarësisht mosrespektimit të masës së përkohshme*

### **VENDIMI NË ÇËSHTJEN CRUZ VARAS DHE TË TJERË kundër SUEDISË** (Kërkesa nr. 15576/89) **20 mars 1991**

#### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit, Z. Hector Cruz Varas, gruaja e tij dhe djali i tyre, i lindur në vitin 1985, ishin shtetas kilianë.

Z. Cruz Varas u zhvendos në Suedi më 28 janar 1987 dhe aplikoi për azil një ditë më pas. Ai u bashkua me gruan dhe djalin më 5 qershor 1987.

Më 22 qershor 1987, në marrjen e tij të parë në pyetje nga ana e policisë, Z. Cruz Varas tregoi se kishte qenë i përfshirë në aktivitete të ndryshme politike në Kili, të cilat i kundërviheshin regjimit të Pinochet, i cili ishte në pushtet. Ai pohoi se ishte arrestuar disa herë. Më tej, kërkuesi, deklaroi se u largua nga Kili, pasi e kishte të pamundur të mbante shtëpinë ku ai jetonte me familjen e tij si dhe për shkak të gjendjes së tij të vështirë financiare.

Më 21 prill 1988, Bordi Kombëtar i Emigracionit refuzoi kërkesën për azil dhe vendosi dëbimin e tyre, me arsyetimin se nuk kishte baza të mjaftueshme për dhënien e statusit të refugjatit.

Pas kërkesave të pa suksesshme në drejtim të Qeverisë për të mos t'i dëbuar, kërkuesi pretendoi tek autoritetet të Policisë se kishte pengesa për zbatimin e urdhrin të dëbimit dhe kërkoi që rasti i tyre t'i referohej Bordit të Emigracionit. Këtë herë, kur u mor në pyetje nga policia në tetor 1988, Z. Cruz Varas parash-

troi arsye të reja në mbështetje të kërkesës së tij për azil. Ai pohoi se, që nga shkurti i vitit 1988 (pas mbërritjes së tij në Suedi), ai kishte punuar për Frente Patriótico Manuel Rodríguez (të FPMR), një organizatë radikale politike që ishte përpjekur në mënyrë aktive për të vrarë gjeneralin Pinochet. Kërkuesi deklaroi se, nëse kthehej në Kili, rrezikonte të persekutohej politikisht, torturohej dhe ndoshta edhe t'i merrej jeta.

Më 21 tetor 1988, autoritetet policore hodhën poshtë pretendimin e kërkuesve dhe vendosën të zbatonin urdhrin e dëbimit nga Kili më 28 tetor 1988. Megjithatë, kërkuesit nuk arritën në kohën e planifikuar për t'u nisur dhe dëbimi nuk u ekzekutua.

Në një letër të datës 30 dhjetor 1988 drejtuar autoriteteve të policisë, edhe një herë kërkuesit pretenduan se kishte pengesa për zbatimin e urdhrin të dëbimit. Gjatë marrjes në pyetje nga ana e autoritetit policor dy javë më vonë, Z. Cruz Varas dha një dëshmi të gjatë për torturat nga autoritetet kilian të cilave u ishte nënshtruar disa herë dhe se kishte frikë se këto do të përsëriteshin nëse ai kthehej.

Më 13 janar 1989, autoritetet policore ia kaluan çështjen Bordit të Emigracionit. Më 8 mars 1989, Bordi e referoi çështjen në Qeveri, duke shprehur mendimin se kishte pengesa për zbatimin e urdhrin të dëbimit.

Më 11 gusht 1989 Z. Cruz Varas i paraqiti dokumente të tjera të Qeverisë, në veçanti dy certifikata mjekësore në mbështetje të pretendimeve të tij se ishte torturuar. Raporte të tjera mjekësore nga mjekë suedeze, në lidhje me djalin e Z. Cruz Varas, tregonin se ai kishte probleme personaliteti dhe se kishte të ngjarë të pësonte dëme të rënda psikologjike, nëse dëbohej nga Suedia.

Më 5 tetor 1989, Qeveria përsëri nuk gjeti asnjë pengesë për zbatimin e urdhrin të dëbimit kundër kërkuesve. Edhe pse Komisioni vendosi të zbatojë nenin 36 të Rregullores së tij të Procedurës<sup>44</sup>, sipas së cilit dëbimi nuk duhej ekzekutuar derisa të shqyrtohej themeli i kërkesës, një ditë më pas Bordi procedoi me dëbimin e Z. Cruz Varas në Kili. Djali dhe gruaja e tij u fshehën në Suedi.

44 Komisioni ishte pjesë e mekanizmit të vjetër të Konventës, dhe u abrogua nga Protokollin 11, më 1998. Ekuivalenti i nenit 36 të rregullores mund të gjendet në nenin 39 të Rregullores së Gjykatës.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi pretendoi se dëbimi i Z. Cruz Varas në Kili përbënte shkelje të nenit 3 për shkak të rrezikut që u kanosej për t'iu nënshtruar torturës nga autoritetet kiliane. Më tej, ata pohuan se dëbimi do i shkaktonte djalit të tyre vuajtje të tilla që konsideroheshin se cenonin nenin 3.

Ata u ankuan gjithashtu se dëbimi i Z. Cruz Varas do të sillte ndarjen e familjes duke cenuar kështu të drejtën e tyre për respektimin e jetës familjare, të mbrojtur nga neni 8 i Konventës. Së fundi, kërkuesit pretenduan se dëbimi i Z. Cruz Varas pengonte paraqitjen efektive të kërkesës në Komision.

### Në lidhje me nenin 3

Në radhë të parë, Gjykata konfirmoi se, parimi që një vendim nga një Shtet Anëtar për të ekstraduar një të arratisur mund të konsiderohet në kundërshtim me nenin 3, vlen edhe për vendimet e dëbimit që nuk lidhem me ekstradimin.

Në rastin konkret, Gjykata theksoi se heshtja e plotë e Z. Cruz Varas - gjatë marrjes në pyetje nga policia në qershor të vitit 1987 dhe në tetor 1988 - si për aktivitetet e tij të pretenduara të fshehta dhe torturat nga policia kiliane, vinin në dyshim të konsiderueshëm besueshmërinë e tij. Gjithashtu, ndryshimet e vazhdueshme të historisë së tij gjatë marrjeve të ndryshme në pyetje nga organet policore, së bashku me mungesën e dokumenteve që mbështesnin pretendimet e tij për aktivitete të fshehta politike me FPMR, kontribuonin në krijimin e dyshimeve për vërtetësinë e rrëfimeve të kërkuesit.

Duke pasur parasysh se autoritetet suedeze kishin përvojë të konsiderueshme në trajtimin e azilkërkuesve nga Kili dhe se e kishin shqyrtuar gjerësisht kërkesën për azil të kërkuesit, Gjykata arriti në përfundimin se nuk ishin parashtruar arsye serioze për të besuar se nëse Z. Cruz Varas do të dëbohej në Kili ai do të përballej me rrezikun real të keqtrajtimit. Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të nenit 3 në lidhje me kërkuesin e parë.

Në lidhje me traumën që mund të pësonte kërkuesi nëse dëbohej, Gjykata arriti në përfundimin se edhe pse dukej se ai kishte vuajtur nga stresi post-traumatik, nuk kishte bazë të konsiderueshme që vërtetonte frikën e tij e për rrjedhojë dëbimi i tij nuk e tejkalonte pragun e caktuar në nenin 3 në këtë drejtim.

Për sa i përket dëbimit të djalit të kërkuesit, Gjykata konstatoi se as në këtë rast

faktet nuk nxirrnin në pah ndonjë shkelje.

### Në lidhje me nenin 8

Gjykata vuri në dukje se dëbimi i të tre kërkuesve u urdhërua nga Qeveria Suedeze, por gruaja dhe djali u fshehën në mënyrë që t'i shpëtonin zbatimit të urdhrit të dëbimit. Për më tepër, nuk kishte asnjë provë që vërtetonte se ekzistonin pengesa për të pasur jetë familjare në vendin e tyre.

Prandaj, Shteti Suedez nuk mund të bëhet përgjegjës për ndarjen e familjes dhe nuk kishte pasur shkelje të jetës familjare të kërkuesit, të mbrojtur nga neni 8.

### Në lidhje me nenin 25(1)<sup>45</sup>

Gjykata nuk u pajtua me vendimin e Komisionit se, mos respektimi i nenit 36 të Rregullores përbënte shkelje të nenit 25. Ajo vuri në dukje se neni 25 (1) kufizohet në nisjen e procedurës para Komisionit dhe për aplikimet individuale. Asnjë dispozitë e Konventës nuk autorizon Komisionin të urdhërojë masa të përkohshme. Do të ishte një shtrirje e gjerë e kuptimit të tekstit të nenit 25 nëse do të konkludohej prej fjalëve të saj “zotohen të mos pengojnë në ndonjë mënyrë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte”, se ekziston një detyrim për të respektuar nenin 36 të Rregullores së Komisionit.

Praktika e Palëve Kontraktuese ka treguar se ka qenë pothuajse në përputhje të plotë me nenin 36 të Rregullores. Megjithatë, një praktikë e tillë nuk sjell lindjen e një detyrimi. Gjithashtu, as parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare nuk vijnë në ndihmë për këtë çështje duke qenë se pyetjen nëse masat e përkohshme të vendosura nga tribunalet ndërkombëtare janë të detyrueshme apo jo ishte e diskutueshme dhe nuk ekzistonte asnjë rregull uniform ligjor.

Prandaj, Gjykata konstatoi se kompetenca për të urdhëruar masa të përkohshme detyruese nuk mund të nxirrej as nga neni 25 (1), *in fine* dhe as nga burime të tjera.

Së fundi, Gjykata u shpreh se pajtueshmëria me një urdhër në bazë të nenit 36 të Rregullores, me siguri do të kishin lehtësuar paraqitjen e rastit nga kërkuesit para Komisionit. Pavarësisht kësaj, nuk kishte prova se ata ishin penguar në

45 Neni 34 i versionit aktual të Konventës.

ushtrimin e së drejtës për kërkesë në një çdo shkallë të konsiderueshme. Në fakt, avokati i tyre kishte mundur t'i përfaqësonte ata plotësisht para Komisionit, pavarësisht mungesës së kërkuarit të parë gjatë seancës dëgjimore në Komision.

Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenin 25(1).

### 3. Koment

Rasti i *Cruz Varas* nuk paraqet ndonjë rëndësi të veçantë për sa i përket gjetjeve të tij se nuk kishte shkelje të neneve 3 dhe 8, por është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të jurisprudencës. Për herë të parë Gjykata vendosi se parimi i moskthimit në rastin kur kërkuari rrezikonte të përballej me tortura ose trajtim çnjerëzor ose poshtërues, vlen njësoj si në rastet e dëbimit ashtu si edhe në ato të ekstradimit. Ky parim, më parë vlente vetëm për rastet e ekstradimit<sup>46</sup>. Kështu, ky vendim përbën të parin e një sërë vendimesh në të cilat neni 3, në veçanti, është zbatuar për situatën e azilkërkuarve të refuzuar, të cilët përballeshin me kthimin në vendin e tyre të origjinës. Konstatimi se masat e përkohshme, të cilave u referohet Komisioni nuk janë të detyrueshme, ishte me rëndësi të madhe dhe erdhi si pasojë e mungesës së një dispozite për masa të përkohshme në Konventë, një lexim strikt i gjuhës së Rregullores dhe faktit se të dhënat tregonin se Shtetet përgjithësisht i respektonin vendime të tilla. Opinioni kundërshtues i fuqishëm i nëntë gjyqtarëve të shquar i hapi rrugën vite më vonë ndryshimit të qëndrimit të shumicës, në rastin e *Mamatkulov dhe Askarov k. Turqisë*<sup>47</sup>.

46 Shih *Soering k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 7 korrikut 1989, nr. 14038/88.

47 *Mamatkulov dhe Askarov k. Turqisë*, vendimi [Dhoma e Madhe] i 4 shkurtit 2005, nr. 46827/99 dhe 46951/99.



*Ekzekutimi i urdhrat të dëbimit të një shtetasi indian – prania e të cilit në Mbretërinë e Bashkuar, përbën një kërcënim për sigurinë kombëtare – cenon nenin 3*

## **VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN CHAHAL kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesa nr. 22414/93)

**15 nëntor 1996**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi kryesor në këtë çështje, Z. Karamjit Singh Chahal, është një shtetase indian, i lindur në vitin 1948, i cili hyri në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 1971 dhe në vitin 1974 mori leje qëndrimi pa afat. Kërkuesit e tjerë, gruaja e Z. Chahal-së dhe dy fëmijët e tyre ishin të gjithë Sikh.

Gjatë udhëtimit me familjen e tij në Indi, në janar të vitit 1984, Z. Chahal u përfshi në organizimin e një rezistence pasive në mbështetje të autonomisë së Punxhabit. Kërkuesi u arrestua, u mbaj i ndaluar për njëzet e një ditë në kushte jo higjienike dhe, sipas pretendimeve të tij, iu nënshtrua trajtimit çnjerëzor. Kur u kthye në Mbretërinë e Bashkuar në maj 1984, Z. Chahal u bë një figurë udhëheqëse e komunitetin Sikh. Në veçanti, ai ndihmoi në ngritjen e degëve të Federatës Ndërkombëtare të Rinisë Sikh (FNRS) në Mbretërinë e Bashkuar, një organizatë e ndaluar nga Qeveria indiane deri në mes të vitit 1985.

Ndërmjet 1985 dhe 1986, kërkuesi u arrestua tri herë. Në dy rastet e para kundër tij nuk u ngrit akuzë dhe u lirua. Herën e fundit që u arrestua, ai u shpall i pafajshëm nga akuzat për sulm dhe rrahje.

Më 14 gusht 1990 Sekretari i Shtetit për Çështjet e Brendshme vendosi që Z. Chahal të dëbohej pasi prania e tij e mëtejshme në Mbretërinë e Bashkuar nuk i shërbente interesave publike për arsye të sigurisë kombëtare. Kërkuesi u njoftua për dëbimin e tij më 16 gusht 1990. Ai u arrestua më pas me qëllim dëbimin e tij. Në të njëjtën ditë, Z. Chahal bëri kërkesë për azil, duke pretenduar se nëse kthehej në Indi do të torturohej dhe persekutohej politikisht. Më 27 mars 1991 Sekretari i Shtetit për Çështjet e Brendshme refuzoi t'i jepte kërkuesit statusin e refugjatit, duke mos pranuar se kishte një mundësi të arsyeshme që ai të persekutohej nëse dëbohej në Indi.

Për shkak se çështja kishte të bënte me sigurinë kombëtare, kërkuesi nuk

kishte të drejtën e ankimit në gjykatë kundër urdhrin të dëbimit. Megjithatë, më 10 qershor 1991 çështja u shqyrtua nga një panel këshillimor jo-gjyqësor prej tre personash, i kryesuar nga një gjyqtar i Gjykatës së Apelit. Z. Chahal u lejua të paraqitej personalisht para trupit gjykues, por nuk u lejua të përfaqësohej nga një avokat. Gjithashtu ai nuk u lejua për të parë dokumentet që provonin akuzat kundër tij. Më 25 korrik të vitit 1991, Sekretari i Shtetit për Çështjet e Brendshme nënshkroi urdhrin e dëbimit për Z. Chahal.

Më 9 gusht 1991 kërkuesi kërkoi rishqyrtim gjyqësor të vendimit të Sekretarit të Shtetit për Çështjet e Brendshme për refuzimin e azil dhe nxjerrjen e urdhrin të dëbimit. Vendimi i refuzimit të azilit u rrëzua dhe iu dërgua përsëri Ministrit të Brendshëm. Në qershor të vitit 1992 Sekretari i Shtetit për Çështjet e Brendshme vendosi përsëri refuzimin e azilit dhe u shpreh se, edhe nëse Z. Chahal rrezikonte të persekutohej në Indi, ai nuk gëzonte të drejtë për mbrojtjen *nga kthimi* në bazë të nenit 33 të Konventës së Gjenevës për shkak se konsiderohej kërcënim për sigurinë kombëtare. Dënimet penale të Z. Chahal u hodhën poshtë më vonë nga Gjykata e Apelit, por vendimi për refuzimin e azilit mbeti në fuqi.

Kërkuesi kërkoi edhe njëherë tjetër rishqyrtim gjyqësor, por kjo iu refuzua në shkurt 1993. Më tej ai apeloj në Gjykatën e Apelit, e cila vendosi rrëzimin e kërkesës në tetor 1993.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Z. Chahal u ankua se dëbimi i tij në Indi shkelte nenin 3. Ai pretendonte gjithashtu se ndalimi i tij në pritje të dëbimit përbënte shkelje të nenit 5 (1) të Konventës për shkak të kohëzgjatjes së tij të tepruar. Më tej, kërkuesi pohoi se i ishte mohuar mundësia që të shqyrtohej ligjshmëria e ndalimit të tij nga një gjykatë kombëtare, në shkelje të nenit 5 (4). Të katër kërkuesit u ankuan se dëbimi i mundshëm i Z. Chahal në Indi do të përbënte një shkelje të nenit 8. Gjithashtu kërkuesit pretenduan se nuk kishte një mjet ligjor në dispozicion të tyre për t'iu drejtuar gjykatave kombëtare, në kundërshtim me nenin 13.

### Në lidhje me nenin 3

Gjykata vuri në dukje se urdhri i dëbimit kundër Z. Chahal nxorri pasi prania e tij në Mbretërinë e Bashkuar konsiderohej se përbënte kërcënim për sigurinë kombëtare. Ajo përsëriti se neni 3 i Konventës, i cili zbatohet edhe në rastet e dëbimit, ndalon torturën dhe trajtimin çnjerëzor në terma absolutë, duke mos

lejuar asnjë përjashtim, edhe në rast të një emergjence publike që kërcënon jetën e kombit. Më tej Gjykata vazhdoi duke pohuar se, kur një person përballej me rrezikun real të trajtimit në kundërshtim me nenin 3, nëse dëbohej në një shtet tjetër, përgjegjësia e Shtetit Kontraktues për ta mbrojtur atë person kundër një trajtimi të tillë lind në rastin e dëbimit, dhe aktivitetet e personit në fjalë, megjithëse mund të jenë problematike ose të rrezikshme, nuk përbëjnë arsye thelbësore. Kështu, Gjykata hodhi poshtë argumentet e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar se kërcënimi i sigurisë kombëtare duhet të vihet në baraspeshe kundrejt çdo rreziku që mund t'i kanosej Z. Chahal.

Prandaj, Gjykata duhet të shqyrtonte nëse ekziston një rrezik real që Z. Chahal të keqtrajtohej në kundërshtim me nenin 3, nëse kthehej në Indi. Duke qenë se kërkuesi ende nuk ishte dëbuar, koha materiale për t'iu referuar ishte koha e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata dhe kështu kushtet në kohën e gjykimit ishin vendimtare.

Në përcaktimin e bazës së një rreziku të tillë, Gjykata vlerësoi gjendjen e përgjithshme në Indi, duke mbajtur parasysh gjithashtu se kërkuesi ishte mbështetës i njohur i separatistëve Sikh. Ajo vuri në dukje se, të paktën deri në mesin e 1994, policia në Punjab dhe në Indi në përgjithësi, me veprimet e saj nuk tregonte se respektonte të drejtat e njeriut të militantëve të dyshuar të Sikh. Edhe duke pasur parasysh ngjarjet inkurajuese që kishin ndodhur vitet e fundit në Punjab, asnjë dëshmi konkrete nuk kishte që të tregonte se forcat policore të Punjab po i nënshtroheshin një reforme themelore dhe Gjykata u shpreh se ende kishte probleme me respektimin e të drejtave të njeriut nga ana e forcave të sigurisë në Punjab.

Pas vlerësimit se, nëse Z. Chahal dëbohej në Indi, mund të ishte në rrezik nga forcat e sigurisë në Punjab që vepronin brenda ose jashtë kufijve shtetërore, Gjykata më tej analizoi pretendimet për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut nga ana e policisë të regjistruar diku tjetër në Indi dhe konstatoi se, pavarësisht nga përpjekjet e qeverisë indiane në sigurimin e garancive për qëllim garantimin e sigurisë së Z. Chahal-së, shkelje të tilla nga punonjës të forcave të sigurisë në Indi ishin një problem i vazhdueshëm.

Për më tepër, Gjykata mori parasysh profilin të lartë të kërkuesit si mbështetës i kauzës së separatistëve Sikh dhe u shpreh se, duke qenë se kërkuesi ishte i njohur për aktivitetin e tij, mund ta bënte atë një objektiv me interes për forcat e sigurisë që ndiqnin militantët e dyshuar të Sikh.

Për këtë arsye, Gjykata konstatoi se ekziston rreziku real që Z. Chahal t'i nënshtrohet trajtimit në kundërshtim me nenin 3 nëse kthehej në Indi. Prandaj, zbatimi i urdhrit të dëbimit të tij në Indi do të çonte në shkelje të nenit 3.

#### Në lidhje me nenin 5(1)

Gjykata solli në vëmendje se çdo heqje e lirisë sipas nenit 5 (1) justifikohet vetëm për atë kohë sa zgjasin procedurat e dëbimit, ndërsa për sa i përket ndalimit të Z. Chahal, Gjykata shqyrtoi kohëzgjatjen e marrjes së vendimeve në procedurat e brendshme dhe vërejti se rasti i kërkuarit duke qenë se kishte element të një rëndësie të madhe, kërkonte vëmendjen e duhur në shqyrtimin e të gjitha çështjeve dhe provave relevante. Ajo konstatoi se asnjë nga periudhat e pretenduara nga kërkuari nuk ishin ishte e tepruar, qoftë të marra më vete, qoftë së bashku. Për rrjedhojë, nuk ka pasur shkelje të nenit 5 (1) për sa i përket kohëzgjatjes së procedurave të brendshme.

Megjithatë, në lidhje me periudhën e zgjatur, gjatë së cilës Z. Chahal ishte mbajtur i ndaluar, ishte e nevojshme gjithashtu të vërtetohej ekzistenca e garancive të mjaftueshme kundër arbitraritetit. Duke qenë se Sekretari i Shtetit për Çështjet e Brendshme deklaroi se çështja kishte të bënte me sigurinë kombëtare, gjykatat e brendshme nuk mundeshin efektivisht të vlerësonin nëse vendimet për ndalimin e Z. Chahal ishin të justifikuara. Megjithatë procedura përpara panelit këshillimor ofronte garanci mbrojtjeje të mjaftueshme kundër arbitraritetit, pasi kishte mundësi të shqyrtonte plotësisht provat për sa i përket sigurisë kombëtare të përfaqësuar nga kërkuari.

Si përfundim, Gjykata u shpreh se edhe pse Z. Chahal ishte mbajtur i ndaluar për një kohëzgjatje e cila ngrinte shqetësime serioze, duke pasur parasysh zellin me të cilin autoritetet kombëtare kanë vepruar përgjatë gjithë procedurave të dëbimit dhe se kishte garanci të mjaftueshme kundër privimit arbitrar nga liria e tij, ndalimi i tij ishte në përputhje me kërkesat e nenit 5 (1), dhe kështu nuk ka pasur shkelje.

#### Në lidhje me nenin 5(4)

Gjykata duhet të vlerësonte nëse procedurat në dispozicion të kërkuarit për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit ofronin një kontroll të përshtatshëm nga gjykatat e brendshme.

Duke qenë se rasti kishte të bënte me sigurinë kombëtare, gjykatat e brendshme

nuk ishin në gjendje të shqyrtonin nëse vendimet për të arrestuar Z. Chahal dhe për ta mbajtur atë të ndaluar ishin apo jo të justifikueshme për arsye të sigurisë kombëtare. Për më tepër, edhe pse procedura para panelit këshillues padyshim që ishte një lloj kontrolli, duke pasur parasysh që kërkuesi nuk kishte të drejtë për përfaqësim ligjor dhe se paneli nuk kishte kompetencë të vendoste e këshillat e tij për Ministrin e Brendshëm nuk ishin të detyrueshme, paneli nuk mund të konsiderohet një “gjykatë” sipas kuptimit të nenit 5 (4).

Gjykata pranoi se përdorimi i dokumenteve konfidenciale mund të jetë i pashmangshëm në rastet kur përfshihet edhe çështja e sigurisë kombëtare. Megjithatë, kjo nuk do të thotë, se autoritetet kombëtare janë tërësisht të lira nga kontrolli efektiv i gjykatave të brendshme sa herë që ata pretendojnë se bëhet fjalë për sigurinë kombëtare dhe terrorizmin. Për këtë arsye, as procedurat për *habeas corpus* dhe për shqyrtim gjyqësor të vendimit për të ndaluar Z. Chahal para gjykatave të brendshme, as procedura e panelit këshillues, nuk përmbushnin kërkesat e nenit 5 (4). Kjo mangësi ishte e rëndësishme duke pasur parasysh se Z. Chahal ishin privuar nga liria e tij për një periudhë të gjatë kohore, çka sillte një shqetësim serioz.

Për rrjedhojë Gjykata konstatoi shkelje të nenit 5(4).

### Në lidhje me nenin 8

Duke qenë se Gjykata vendosi se dëbimi i Z. Chahal në Indi do të përbente shkelje të nenit 3 të Konventës dhe s’kishte arsye të dyshonte se Mbretëria e Bashkuar nuk do ta respektonte këtë vendim, ajo e konsideroi e panevojshme të vendoste në lidhje me pyetjen hipotetike nëse, në rastin e dëbimit në Indi, do të kishte gjithashtu shkelje të të drejtave të kërkuesve sipas nenit 8.

### Në lidhje me nenin 13

Duke pasur parasysh natyrën e pakthyeshme të dëmit që mund t’i shkaktohet kërkuesit, nëse rreziku i keqtrajtimit materializohet dhe rëndësinë që Gjykata i njeh nenit 3, ajo konstatoi se nocioni i një mjeti efektiv ligjor, sipas nenit 13, kërkonte shqyrtim të pavarur. Ky shqyrtim duhej kryer pavarësisht arsyeve të dëbimit të kërkuesit apo ndonjë kërcënimi të mundshëm për sigurinë kombëtare të Shtetit dëbues. Gjithashtu shqyrtimi nuk duhej bërë domosdoshmërisht nga një autoritet gjyqësor, por nëse do të bëhej nga një autoritet jo gjyqësor, kompetencat dhe garancitë që ai ofron janë përcaktuese nëse mjeti është efektiv apo jo. Në rastin konkret, as paneli këshillues dhe as gjykatat nuk

mund të rishikonin vendimin e Sekretarit të Shtetit për dëbimin e Z. Chahal në Indi në lidhje me çështjen e rrezikut që mund t'i kanosej nëse dëbohej, duke lënë mënjanë arsyet e sigurisë kombëtare. Për gjykatat mjaftonte që Sekretari i Shtetit të kishte balancuar rrezikun që i kanosej Z. Chahal nëse dëbohej kundrejt kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare. Më tej, në procedurat para panelit këshillues, kërkuesi nuk kishte të drejtë për përfaqësim ligjor, iu dha vetëm një shpjegim i përciptë i arsyeve të dëbimit dhe paneli nuk merrte vendime por vetëm këshillonte Ministrin e Brendshëm, këshilla këto jo të detyrueshme dhe jo publike. Në këto rrethana, paneli këshillues nuk konsiderohej se ofronte garancitë e nevojshme procedurale për qëllimet e nenit 13. Gjykata vuri në dukje se kishte vendosur edhe në raste të mëparshme të sjella para saj, se shqyrtimi gjyqësor ishte një mjet efektiv ligjor në rastet e azilit, por nëse në rastet kur përfshihet siguria kombëtare procedura e rishikimit gjyqësor dhe paneli këshillues nuk jepnin garanci të mjaftueshme procedurale, qoftë edhe të marra së bashku, Gjykata nuk mund t'i konsideronte se plotësonin kërkesat e nenit 13 i marrë së bashku me nenin 3.

### Në lidhje me nenin 50<sup>48</sup>

Gjykata u akordoi kërkuesve 45.000 £ për rimbursimin e shpenzimeve ligjore për zhvillimin e procedurave në Gjykatën e Strasburgut.

### **3. Koment**

Ky vendim historik afirmon dy elementë kryesorë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat janë përforcuar në shumë raste të tjera të mëvonshme. E para, dhe më e rëndësishmja, është se ndalimi i dëbimit në rastet kur kërkuesi mund të përballej me rrezikun e keqtrajtimit në kundërshtim me nenin 3 është absolute dhe nuk mund të vihet në balancë me interesat e sigurisë kombëtare<sup>49</sup>. Është e kuptueshme që Shtetet të hezitojnë të zbulojnë burimet e shërbimit të inteligjencës nga frika e komprometimit, por Gjykata e bën të qartë se ata duhet të gjejnë një mekanizëm tjetër për trajtimin e të huajve që dyshohet se kërcënojnë sigurinë kombëtare, zakonisht nëpërmjet të drejtës penale (edhe pse në rastin konkret duhet vënë në dukje se të gjitha akuzat penale kundër Z. Chahal ranë ose ai nuk u gjet fajtor për to).

48 Tani neni 41.

49 Shih gjithashtu *Saadi k. Italisë*, vendim [Dhoma e Madhe] i 28 shkurtit 2008, nr. 37201/06, i përfshirë në këtë kapitull, ku Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ndërhyri në përpjekje për të ri sjellë argumentet e ngritura në *Chahal*.

Së dyti, sistemi i panelit i “tre të urtëve “ dhe rishikimi i kufizuar gjyqësor nuk i plotësonte kërkesat e nenit 13 dhe duhej ndryshuar. Vendimi në rastin *Chahal* çoi në ngritjen, në Mbretërinë e Bashkuar, të Komisionit të Posaçëm të Apelit për Emigracionin (KPAE) i cili do të zgjidhte disa defekte të sistemit të konstatuara në çështjen *Chahal*. KPAE shqyrton raste qoftë që kanë të bëjnë me dokumente “publike” dhe “konfidenciale”. Kërkuesi dhe avokatët e tij kanë akses vetëm tek dokumentet publike, ndërsa ato konfidenciale i viheshin në dispozicion vetëm një Avokati Special (që ishte i pajisur me certifikatë sigurie) (AS). AS paraqet rastin e kërkuesit tek KPAE, por nuk i lejohet komunikimi me kërkuesin dhe avokatët e tij pasi njihet me materialet që nuk mund të bëhen publike. Gjyqtarët e KPAE vendosin nëse ata vlerësojnë të nevojshme që materiale konfidenciale të mbeten të tilla. Nëse ata vendosin se nuk është e nevojshme, Qeveria ose duhet t’i bëjë publike ato ose duhet të tërhiqet nga rasti (duke çuar në rrëzimin e vendimit për dëbimin dhe të vendimit të ndalimit). Vendimet e KPAE mund të shqyrtohen nga gjykatat e zakonshme, por edhe ato janë subjekt i kufizimeve të materialeve publike apo sekrete (dhe të pjesëve publike apo sekrete të vendimit të KPAE). Variante të ngjashme të sistemeve post-*Chahal* tashmë ekzistojnë në disa vende evropiane. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka pasur rastin të shqyrtojë pajtueshmërinë e këtyre sistemeve të reja me KEDNJ-në në raste të mëvonshme (shih p.sh. *Othman (Abu Qatada) k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>50</sup>) dhe të vërë në dukje mangësitë e tyre.

50 *Othman (Abu Qatada) k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 17 janarit 2012, nr. 8139/09, i përfshirë gjithashtu në këtë kapitull.

*Ekzekutimi i urdhrin të dëbimit të një shtetasi somalez cenon nenin 3*

## **VENDIM NË ÇËSHTJEN AHMED kundër AUSTRIË**

(Kërkesa nr. 25964/94)

**17 dhjetor 1996**

### **1. Faktet kryesore**

Z. Ahmed, shtetas somalez i lindur në vitin 1963, u largua Somalia dhe arriti në Vjenë në tetor të vitit 1990 nëpërmjet Sirisë dhe Holandës.

Ai kërkoi azil në nëntor të vitit 1990. Gjatë intervistës të realizuar nga Autoriteti i Sigurisë Publike të Austrisë së Poshtme, ai rrëfeu për aktivitetet e xhaxhait të tij si anëtar i Kongresit të Bashkuar Somalian (“KSB”), dhe deklaroi se babai i tij dhe vëllai u ekzekutuan në maj 1990 pasi dyshoheshin se ishin anëtarë të KSB-së dhe pjesëmarrës në akte rebelimi. Nga frika e arrestimit dhe vetëvrasjes kërkuesi u largua nga Somalia. Në maj të vitit 1992 Ministri i Brendshëm i dha Z. Ahmed statusin e refugjatit, duke i konsideruar pretendimet e tij të besueshme dhe të bazuar frikën e tij të persekutimit nëse kthehej në Somali.

Pas një vendimi të Gjykatës Rajonale në Graz që e dënonte kërkuesin me dy vite e gjysmë burgim për tentativë vjedhje, më 15 korrik 1994 Zyra Federale për Refugjatë në Graz urdhëroi heqjen e statusit e refugjatit për kërkuesin, bazuar në Ligjin për të Drejtën e Azilit, sipas të cilit një person mund të humbasë statusin e refugjatit nëse kryen një “krim veçanërisht serioz”. Apelimi i kërkuesit u hodh poshtë nga Ministri i Brendshëm.

Më 14 nëntor 1994, Autoriteti i Policisë Federale Graz lëshoi një urdhër dëbimi pa afat kundër kërkuesit dhe urdhëroi që, pas vuajtjes së dënimit, të mbahej i ndaluar deri në përfundimin e procedurave të largimit të tij nga vendi. Autoriteti i Sigurisë Publike Graz e hodhi poshtë ankesën e mëvonshme të Z. Ahmed, duke vërejtur se mos-ekzekutimi i urdhrin të dëbimit do të kishte efekte negative shumë më të rënda për komunitetin sesa do të sillte ekzekutimi i tij për kërkuesin.

Pasi u lirua me kusht, më 14 dhjetor 1994, kërkuesi u çua për t’u mbajtur në godinën e policisë në Graz në pritje të dëbimit të tij. Më 23 janar 1995 Tribunali i Pavarur Administrativ i Styria pranoi ankimin e paraqitur nga Z. Ahmed kundër masës së ndalimit dhe ai u lirua.



Më 10 prill 1995 Ministri i Brendshëm urdhëroi përsëri heqjen e statusit të refugjatit. Ai deklaroi se vepra penale e kryer nga kërkuesi tregonte qartazi prirjen e tij për të qenë agresiv, çka bënte të mundshme kryerjen e veprave të tjera penale në të ardhmen nga kërkuesi duke përbërë kështu rrezik për shoqërinë.

Më 26 prill 1995, Z. Ahmed deklaroi para Zyrës Federale për Refugjatë, se jeta e tij rrezikohej nëse kthehej në Somali. Ai iu referua përkeqësimit të situatës në vend që prej largimit të tij në vitin 1990 dhe faktit që i përkiste klanit Hawive, të cilët ishin të persekutuar nga gjeneralët në pushtet. Megjithatë, Zyra Federale për Refugjatët vendosi se dëbimi i kërkuesit ishte i ligjshëm, duke pranuar se vepra penale e kryer nga kërkuesi tregonte qartazi prirjen e tij për të qenë agresiv dhe kështu nuk mund të përjashtohej mundësia që ai të kryente vepra të tjera në të ardhmen. Ai konsiderohej i rrezikshëm për komunitetin, dhe për rrjedhojë fakti që Z. Ahmed rrezikonte nga persekutimi nëse kthehej në Somali nuk ndikonte në ligjshmërinë e dëbimit të tij.

Më 4 maj 1995, Autoriteti i Policisë Federale Graz rrëzoi një apelim tjetër të kërkuesit me arsyetimin se nuk kishte asgjë që të tregonte se nëse kthehej në Somali, ai mund të persekutohej apo të vuante dënime ose trajtime çnjerëzore. Kërkuesi e kundërshtoi këtë vendim tek Autoriteti i Sigurisë Publike të Styria, i cili hodhi poshtë këtë vendim. Në vijim, më 3 tetor të vitit 1995, Autoriteti i Policisë Federale Graz konstatoi se Z. Ahmed rrezikonte të persekutohej nëse kthehej në Somali. Prandaj, më 22 nëntor 1995 ai pezulloi urdhrin e dëbimit për një periudhë një vjeçare me të drejtë shtyrje.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Z. Ahmed pohoi se, nëse ai do të kthehej në Somali, do të ekspozohej ndaj rrezikut serioz të trajtimit të ndaluar nga neni 3 i Konventës.

### Në lidhje me nenin 3

Gjykata përsëriti se Shtetet Kontraktuese kanë të drejtë, si një çështje e së drejtës ndërkombëtare të mire përcaktuar, për të kontrolluar hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve. Edhe pse e drejta për azil politik nuk parashikohet në asnjë dispozitë të Konventës ose Protokolleve të saj, dëbimi i një të huaji nga një Shtet Kontraktues mund të ngrejë një problem sipas nenit 3 dhe kështu të sjellë përgjegjësinë e atij shteti në bazë të Konventës dhe detyrimit për moskthimin e azilkërkuesit, kur ka arsye serioze për të besuar se nëse personi në

fjalë kthehej ai do trajtohej në kundërshtim me nenin 3. Për më tepër, Gjykata konfirmoi natyrën absolute të ndalimit sipas nenit 3, i cili për rrjedhojë zbatohet pa kufizime apo mundësi derogimi dhe pavarësisht nga sjellja e individit.

Më 15 maj 1992 Ministri i Brendshëm austriak i kishte dhënë statusin e refugjatit Z. Ahmed, duke i konsideruar të besueshme deklaratat e tij se, në qoftë se kthehej në Somali, do të persekutohej. Humbja e statusit të refugjatit erdhi vetëm për shkak të dënimit dhe për këtë arsye pasojat e dëbimit të tij nuk u morën parasysh.

Për të vlerësuar rreziqet në rastin e një dëbimi, Gjykata shqyrtoi situatën në Somali në atë kohë. Në raportin e tij të datës 5 korrik 1995, Komisioni kishte theksuar se vendi ishte ende në gjendje lufte civile dhe lufta po zhvillohej ndërmjet disa grupeve që synonin kontrollin e vendit. Për më tepër, nuk kishte prova që tregonin se rreziqet ndaj të cilave do të ishte i ekspozuar kërkuesi në vitin 1992 kishin pushuar së ekzistuari apo se autoritetet shtetërore do të ishin në gjendje t'i garantonin atij mbrojtje.

Duke pasur parasysh se autoritetet austriake kishin vendosur pezullimin e ekzekutimit të dëbimit pasi vlerësonin se Z. Ahmed nuk mund të kthehej në Somali i sigurt që nuk do të ishte viktimë e trajtimit në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, Gjykata arriti në të njëjtin përfundim.

Kështu, Gjykata u shpreh se, për sa kohë kthimi i kërkuesit në Somali mund ta vendoste atë përballë rrezikut real të trajtimit në kundërshtim me nenin 3, dëbimi i tij do të shkelte nenin 3 të Konventës.

#### Në lidhje me nenin 50<sup>51</sup>

Për sa i përket dëmit jo material që kishte pësuar kërkuesi, Gjykata vlerësoi se konstatimi i shkeljes me këtë vendim për pezullimin e urdhrin të dëbimit, përbënte në vetvete shpërblim të drejtë.

Në lidhje me kostot dhe shpenzimet, Gjykata u shpreh se Shteti i paditur duhej t'i paguante kërkuesit 150 000 shilinga austriake brenda tre muajve.

51 Tani neni 41.

### 3. Koment

Rasti është shembulli paradigmatik i dallimeve të rëndësishme ndërmjet mbrojtjes së dhënë për një individ në bazë të Konventës së Gjenevës të vitit 1951 mbi Statusin e Refugjatëve (KGJ) dhe KEDNJ-së. Fusha e zbatimit të KGJ-së është e ngushtë dhe e kufizuar për ata që rrezikojnë persekutimin për një nga arsyet e parashikuara në nenin 1A të KGJ-së: racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose mendimit politik. Ata që, në bazë të këtyre kriterëve, njihen si refugjatë, u jepet mbrojtje nga *refoulement* (kthimi në vendin ku ata rrezikojnë persekutimin) sipas nenit 33 të KGJ-së. Megjithatë, në bazë të nenit 33 (2), refugjati mund të humbasë të drejtën e moskthimit nëse ka «baza të arsyeshme që të konsiderohet rrezik për sigurinë e vendit në të cilin ai është, ose ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për një veprë penale veçanërisht të rëndë dhe përbën rrezik për komunitetin e atij vendi». Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka bërë të qartë në këtë vendim se nuk kishte kompetencë për të vendosur nëse autoritetet austriake kishin zbatuar në mënyrë korrekte kushtin e «veprës penale veçanërisht të rëndë» për privimin e kërkuesit nga mbrojtja që i jepte parimi i moskthimit, në pajtim me detyrimet e KGJ-së. Gjykata nuk ka kompetencë për të vendosur në lidhje me kuptimin e dispozitave të KGJ-së. Sipas KEDNJ-së, mbrojtja u ofrohet personave të cilët, nëse ktheheshin në vendin e tyre, rrezikonin, gjykuar mbi bazën e një vlerësimi objektiv, të torturoheshin ose të trajtoheshin në mënyrë çnjerëzore ose poshtëruese (trajtim i ndaluar nga neni 3 i KEDNJ-së). Ata nuk janë të detyruar të tregojnë se rrezikojnë të persekutohen për një nga arsye e përcaktuara në nenin 1 të KGJ-së. Pavarësisht çfarë krimesh kishte kryer Z. Ahmed, testi për Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut ishte nëse ai do të ekspozohej ndaj një rrezikut të trajtimit në kundërshtim me nenin 3 nëse kthehej në Somali, për aq kohë sa KEDNJ-ja ndalonte kthimin e tij në këto kushte. *Acquis* i Bashkimi Evropian për azilin përfshin dy kriteret GC, statusin dhe mbrojtjen, si dhe në bazë të nenit 15 të Direktivës së Kualifikimit 2004/83/EC (DK) i jep statusin dhe mbrojtjen atyre që rrezikojnë një “dëmtim serioz”. Por ky status dhe mbrojtje nuk vlen për ata që janë të përjashtuar për shkak të sjelljes së tyre. Legjislacioni i BE-së dhe në veçanti KGJ-ja, nuk vendosin të njëjtat kufij si GJEDNJ-ja për sa i përket mbrojtjes së të huajve që rrezikojnë persekutimin në rast dëbimi. Gjithashtu nuk mund të thuhet se *acquis* i BE-së përfshin plotësisht garancitë e KGJ-së<sup>52</sup>.

52 Shih C-481/13, *Mohammad Ferooz Qurbani k. Staatsanwaltschaft Würzburg*, vendim i 17 korrikut 2014.

*Dëbimi i kërkuesit në Iran përbën shkelje të nenit 3***VENDIMI NË ÇËSHTJEN JABARI kundër TURQISË**

(Kërkesa nr. 40035/98)

**11 korrik 2000****1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Znj. Hoda Jabari, ishte shtetase iraniane e lindur në vitin 1973.

Në tetor të vitit 1997, Znj. Jabari u ndalua nga policët ndërsa ishte duke ecur me një burrë në Iran. Policët arrestuan çiftin dhe i mbajtën të ndaluar duke qenë se kërkuesja ishte e martuar. Pas disa ditësh ajo u liruar me ndihmën e familjes së saj. Në nëntor të vitit 1997 kërkuesja hyri në Turqi në mënyrë të paligjshme nga frika se mund të dënohej për tradhëti bashkëshortore, vepër penale sipas ligjit islam që dënohej me goditjen me gurë deri në vdekje ose rrahje me kamxhik.

Në shkurt të vitit 1998 kërkuesja përdori një pasaportë false gjatë përpjekjes për të shkuar në Kanada, por u arrestua nga policia franceze, ndërsa po kalonte transit në Francë dhe u kthye në Stamboll. Në Turqi, Znj. Jabari u arrestua me arsyetimin se kishte hyrë në vend me pasaportë të falsifikuar dhe u urdhërua dëbimi i saj.

Kërkuesja, kërkoi azil, por kërkesa e saj u refuzua nga autoritetet me arsyetimin se ishte bërë jashtë afati, pasi duhej të regjistrohej brenda pesë ditëve nga mbërritja e saj në Turqi, në përputhje me Rregulloren e Azilit të 1994.

Njëmbëdhjetë ditë pas arritjes së saj në shkurt 1998, zyra e ZKLB-së në Ankara i akordoi kërkueses statusin e refugjatit për shkak të frikës së mirë bazuar të persekutimit nëse kthehej në Iran, ku rrezikonte të bëhej subjekt i dënimeve çnjerëzore të tilla si vdekja e shkaktuar nga goditja me gurë ose rrahja me kamxhik ose litar.

Në prill të vitit 1998 ajo paraqiti një ankim në Gjykatën Administrative të Ankarasë ndaj urdhrimit të dëbimit të saj. Gjithashtu, ajo kërkoi pezullimin e ekzekutimit të tij. Ankimi i saj u hodh poshtë dhe nuk u vlerësua e nevojshme pezullimi i vendimit të kthimit të saj në Iran pasi nuk u konstatua paligjshmëri dhe zbatimi i tij nuk do t'i shkaktonte dëm të pariparueshëm kërkueses. Më 4 nëntor 1998, Gjykata Administrative e Ankarasë vërejti gjithashtu se kërkuesja nuk rrezikonte të dëbohej duke pasur parasysh se i ishte dhënë një leje qën-

drimi e përkohshme në pritje të vendimit në lidhje me kërkesën e saj sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në pajtim me nenin 39 të Rregullores. Gjykata Administrative e Ankarasë vendosi se nuk ishte i nevojshme pezullimi i urdhrit të dëbimit pasi ende nuk ishte nxjerrë një urdhër i tillë.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja pretendoi se kthimi saj në Iran do ta ekspozonte ndaj rrezikut real të keqtrajtimin, në shkelje të nenit 3 të Konventës. Ajo më tej pretendoi se legjislacioni i brendshëm nuk parashikonte asnjë mjet ligjor efektiv për të kundërshtuar vendimin që refuzonte kërkesën e saj për azil si të paraqitur jashtë afati, në shkelje të nenit 13 të Konventës.

### Në lidhje me nenin 3

Duke theksuar se neni 3 i Konventës, që përfshin një nga vlerat më themelore të një shoqërie demokratike, e ndalon në terma absolutë torturën apo dënimin ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese, Gjykata përsëriti nevojën për një shqyrtim rigoroz të çdo pretendimi se dëbimi drejt një vendi të tretë do e ekspozonte një person ndaj një trajtimi në kundërshtim me nenin 3.

Gjykata konstatoi se autoritetet e Shtetit të paditur nuk kishin bërë vlerësimin e duhur të pretendimit të kërkueses, përfshirë sesa i argumentuar ishte ky pretendim. Ajo vërejti se nuk ishte shqyrtuar baza faktike e frikës së pretenduar të kërkueses në rast kthimi në Iran, për shkak të zbatimit në mënyrë mekanike të afatit pesë-ditor për paraqitjen e një kërkesë për azil, të cilën Gjykata e konsideroi në kundërshtim me vlerat themelore të sanksionuara në nenin 3 të Konventës. Për më tepër, Gjykata Administrative e Ankarasë, në seancën dëgjimore të shqyrtimit të ankimit të Znj. Jabari, vlerësoi vetëm ligjshmërinë formale të dëbimit të saj dhe jo çështjen më serioze të përmbajtjes së kërkesës së saj për azil.

Gjykata e konsideroi të rëndësishëm faktin se zyra e ZKLKBR-së në Ankara i kishte njohur kërkueses statusin e refugjatit, pas zhvillimit të intervistës dhe vlerësimit të rrezikut që i kanosej nëse kthehej në Iran. Ajo vuri në dukje se Turqia e ka ratifikuar Konventën e Gjenevës dhe Protokollin e vitit 1967. Ajo kishte ushtruar të drejtën për përcaktimin e preferencës gjeografike në bazë të Konventës së vitit 1951 për të kufizuar dhënien e statusit të refugjatit azilkërkuesve nga vendet evropiane. Për arsye humanitare, Turqia lëshonte leje të përkohshme të qëndrimit të azilkërkuesve nga vendet jo Evropiane, të

cilat ishin njohur nga ZKLKBR-ja, por jo nga Turqia, si refugjatë në bazë të Konventës së Gjenezës të cilët do të transferohen në një vend të tretë nga kjo organizatë.

Sa i përket gjendjes në Iran, Gjykata nuk ishte e bindur që ajo kishte evoluar në atë masë që tradhtia bashkëshortore nuk konsiderohej vepër e dënueshme ndaj ligjit islamik.

Gjykata arriti në përfundimin se Znj. Jabari rrezikonte realisht të ishte subjekt i trajtimit në kundërshtim me nenin 3 në qoftë se kthehej në Iran e për rrjedhojë kthimi i saj atje, nëse zbatohet, përbënte shkelje të nenit 3 të Konventës.

### Në lidhje me nenin 13

Gjykata konfirmoi se autoritetet e brendshme nuk bënë asnjë vlerësim të pretendimit të Znj. Jabari se jeta e saj rrezikohej nëse dëbohej në Iran. Refuzimi për të shqyrtuar kërkesën e saj për azil për arsye të mos respektimit të kërkesave procedurale nuk mund të apelohej. Në fakt, kërkuesja arriti ta kundërshtonte ligjshmërinë e urdhrin të dëbimit të saj në gjykatë. Megjithatë, rishikimi gjyqësor nuk pezullonte zbatimin e tij dhe nuk bënte një shqyrtim të themelit të pretendimit të saj se ishte në rrezik. Duke pasur parasysh se largimi i kërkueses ishte në përputhje me kërkesat e ligjit të brendshëm, Gjykata Administrative e Ankarasë vendosi të mos shqyrtonte themelin e ankesës së saj, edhe pse ishte e diskutueshme mbi bazën e njohjes së statusit të refugjatit dhënë nga ZKLKBR-ja.

Sipas mendimit të Gjykatës, duke pasur parasysh natyrën e pakthyeshme të dëmit që mund të ndodhë në rast të torturës apo keqtrajtimit dhe rëndësisë të madhe i atribuohet nenin 3, mjeti efektiv sipas nenit 13 kërkon shqyrtim të pavarur dhe rigoroz të një pretendimi se mund të ekzistojnë arsye serioze për një rrezik real të trajtimit në kundërshtim me nenin 3, si dhe mundësinë e pezullimit të zbatimit të masës së kundërshtuar. Në rastin konkret, Gjykata vuri në dukje se Gjykata Administrative e Ankarasë nuk arriti t'i sigurojë kërkueses ndonjë prej këtyre masave mbrojtëse, dhe se procedurat e rishikimit gjyqësor nuk i përmbushnin kërkesat e nenit 13.

Kështu, Gjykata vendosi se ishte shkelur neni 13 i Konventës.

### Në lidhje me nenin 41

Gjykata hodhi poshtë pretendimet e Znj. Jabari për shpërblim të drejtë, duke

vendosur se konstatimi i një shkelje të mundshme të nenit 3 dhe një shkelje aktuale e nenit 13, përbën në vetvete shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për dëmin jo-material që kërkuesja kishte pësuar.

### 3. Koment

Siç është përmendur në pjesën narrative të këtij botimi, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk mund të vendosë mbi respektimin e dispozitave të Konventës së Gjenevës (KGJ) nga ana e Shteteve. Ky rast ilustron situatën e veçantë të azilkërkuesve në Turqi. Ata nuk janë subjekt i mbrojtjes të plotë ligjore të Konventës së Gjenevës, si një çështje e së drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës turke për shkak të përjashtimit gjeografik që kufizon dhënien e statusit të refugjatit sipas KGJ-së për ata që vijnë nga vendet Evropiane. Jo-evropianët që njihen si refugjatë nga ZKLKBR-ja normalisht do të lejohen të qëndrojnë përkohësisht deri sa të rivendosen diku tjetër jashtë Turqisë. Në mënyrë që të marrin mbrojtje *ligjore*, azilkërkuesit duhet të aplikojnë tek autoritetet turke brenda afateve të shkurtra kohore. Për shkak të zbatimit mekanik të këtyre afateve të shkurtra kohore, pa marrë parasysh përmbajtjen e kërkesës, e aq më pak «shqyrtim të kujdesshëm», siç e kërkon Konventa, Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 3 dhe 13. Turqia ende ruan përjashtimin gjeografik për sa i përket zbatimit të KGJ-së. Një ligj i ri ka hyrë në fuqi në vitin 2014. Sirianëve u jepet automatikisht mbrojtje e përkohshme dhe nuk kryejnë procedurat e përcaktimit të statusit të refugjatit individualisht. Shtetasit jo sirianë, jo-evropianët mund të aplikojnë tek ZKLKBR-ja për përcaktimin e statusit, por fluksi i madh i azilkërkuesve në Turqi e bën funksionimin e këtij procesi të paefektshëm për shumicën prej tyre.

*Zbatimi i një urdhri dëbimi për në Siri, ku kërkuesi ishte shpallur fajtor në mungesë për një vepër penale që dënohet me vdekje është në kundërshtim me nenet 2 dhe 3*

## **VENDIMI NË ÇËSHTJEN BADER DHE KANBOR kundër SUEDISË**

(Kërkesa nr. 13284/04)

**8 nëntor 2005**

### **1. Faktet kryesore**

Çështja kishte të bënte me kërkesën e dy shtetasve sirianë, Z. Kamal Bader Mohamed Shqip dhe Znj. Abdelhamid Mohammad Kanpur, si dhe të dy fëmijëve të tyre.

Ata arritën në Suedi më 25 gusht 2002 dhe të nesërmen paraqitën një kërkesë për azil pranë Bordit të Migracionit. Z. Bader, i cili ishte një mysliman sunit me origjinë kurde, deklaroi ndër të tjera se në dhjetor të vitit 1999, gjatë 9 muajve të burgimit të tij nga policia e sigurisë siriane, kishte qenë viktimë e torturës dhe keqtrajtimit. Më 27 qershor 2003, Bordi i Migracionit refuzoi kërkesën e familjes për azil dhe urdhëroi dëbimin e tyre në Siri, pasi konstatoi se ata nuk kishin treguar se rrezikonin të persekutoheshin nëse ktheheshin në Siri. Kërkuesit apeluan dy herë në Bordin e Apelit për të Huajt, por të dy ankesat u refuzuan dhe urdhri i dëbimit u la në fuqi.

Në janar të vitit 2004, familja paraqiti një tjetër kërkesë për azil në Bordin e Ankesave për të Huajt dhe kërkuan pezullimin e ekzekutimit të urdhrin të dëbimit. Ata iu referuan një vendimi, të dhënë më 17 nëntor 2003 nga Gjykata Rajonale në Aleppo, në të cilin deklarohet se Z. Bader ishte dënuar me vdekje, në mungesë, si bashkëpunëtor në një vrasje në bazë të Kodit Penal sirian. Disa ditë më vonë autoritetet suedeze vendosën pezullimin e ekzekutimit të urdhrin të dëbimit.

Më 26 janar 2004, kërkuesit paraqitën në Bordin e Ankesave për të Huajt një kopje të vërtetuar të vendimit për dënimin e tij me vdekje si bashkëpunëtor në vrasjen e kumatit të tij. Me kërkesë të Bordit të Ankesave për të Huajt, ambasada suedeze në Siri vërtetoi autenticitetin e vendimit dhe vërejtë se me shumë gjasa çështja do të rigjykohej sapo kërkuesi kthehej në Siri. Ambasada nuk kishte asnjë informacion të besueshëm se sa shpesh ekzekutoheshin dënimet me vdekje pasi ato bëheshin jashtë kontrollit dhe përgjegjësisë publike. Megjithatë, në atë kohë, gjykatat siriane shumë rrallë vendosnin dënim me vdekje.



Më 7 prill 2004, Bordi i Ankesave për të Huajt hodhi poshtë kërkesën për azil. Në bazë të hetimit të kryer nga një avokat vendas, i punësuar nga ambasada suedeze në Siri, shumica mendonte se nëse Z. Bader do të kthehej në Siri, procesi kundër tij do të ri-hapej dhe çështja kundër tij do rigjykohej nga fillimi. Nëse do dënohej, nuk do t'i jepej dënim me vdekje, pasi rasti kishte "lidhje me nderin". Prandaj frika e kërkuësve nga persekutimi në Siri, nëse ktheheshin, nuk ishte i bazuar dhe ata nuk ishin nevojë për mbrojtje.

Më 19 prill 2004, në zbatim të kërkesës së Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut sipas nenit 39 të Rregullores, Bordi i Migracionit vendosi pezullimin e ekzekutimit të urdhrin të dëbimit deri në një njoftim të mëvonshëm.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesit u ankuan se, nëse ktheheshin në Siri, Z. Bader do të përballej me rrezikun real të arrestimit dhe ekzekutimit në kundërshtim me nenet 2 dhe 3 të Konventës.

### Në lidhje me nenet 2 dhe 3

Si një parim i mirë-përcaktuar i së drejtës ndërkombëtare, Shtetet Kontraktuese kanë të drejtën për të kontrolluar hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve. Megjithatë, dëbimi i të huajve mund të ngrejë një problem sipas nenit 3 të Konventës, duke angazhuar kështu përgjegjësinë e atij Shteti për të mos dëbuar të huajin, nëse ka arsye serioze për të besuar se personi në fjalë do rrezikonte t'i nënshtrohej trajtimit në kundërshtim me nenin 3 në vendit ku do të kthehej. Për më tepër, përgjegjësia e një Shteti Kontraktues mund të lindë edhe në bazë të nenit 2 të Konventës ose nenit 1 të Protokollit nr. 6, i cili parashikon heqjen e dënimit me vdekje, kur i huaji dëbohet në një vend ku rrezikon seriozisht jetën e tij, si rezultat i zbatimit të dënimit me vdekje. Megjithatë, edhe pse Suedia e ka ratifikuar Protokollin nr. 13, fakti që një numër i madh i Shteteve të Këshillit të Evropës nuk e kishin nënshkruar apo ratifikuar ende Protokollin nr. 13, i cili parashikon heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat, e pengonte Gjykatën të konsideronte që ishte një praktikë e vendosur në Shtetet Kontraktuese për ta konsideruar zbatimin e dënimit me vdekje si trajtim çnjerëzor dhe poshtëruar në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, i cili ishte i pa derogueshëm. Për këtë arsye, Gjykata e vlerësoi çështjen vetëm në bazë të neneve 2 dhe 3 të Konventës.

Gjykata mori parasysh vendimin e 17 nëntorit 2003 nga Gjykata Rajonale në

Aleppo, që dënonte në mungesë Z. Bader për bashkëpunim në vrasje dhe e dënonte me vdekje. Gjykata vërejtë se përpjekjet e autoriteteve suedeze për të shqyrtuar ligjin dhe praktikën në Siri nuk ishin të mjaftueshme. Pikë së pari, ajo e konsideroi informacionin e dhënë nga ambasada suedeze në lidhje me faktin nëse çështja e kërkuesit mund të rigjykohej dhe nëse pas rigjykimit mund të dënohej përsëri me dënim kapital, të paqartë dhe jo të saktë. Së dyti, Gjykata vërejtë me habi faktin që ambasada suedeze nuk kishte kontaktuar avokatin mbrojtës të Z. Bader në Siri, edhe pse ai i dha emrin dhe adresën e tij, duke qenë se mund t'u kishte siguruar informacione të dobishme në lidhje me procesin para gjykatës siriane. Së fundi, edhe pse në vendim parashikohet mundësia e kërkuesit për të kërkuar rishqyrtimin e çështjes së tij, Gjykata vërejtë se autoritetet siriane nuk jepnin garanci që procesi ndaj kërkuesit mund të rihapej efektivisht dhe se prokurori nuk do të kërkonte përsëri dënimin me vdekje për kërkuesin. Në këto rrethana, autoritetet suedeze do e vinin Z. Bader përballë një rreziku serioz nëse e kthenin në Siri.

Gjykata vërejtë se Z. Bader kishte shfaqur një frikë të justifikuar dhe të bazuar të ekzekutimit të dënimit me vdekje ndaj tij nëse detyrohej të kthehej në vendin e tij. Për më tepër, duke pasur parasysh që ekzekutimet e dënimeve me vdekje në Siri kryheshin jashtë kontrollit dhe përgjegjësisë publike, Z. Bader ishte në stres dhe ankth për shkak të pasigurisë të papërbalueshme se kur, ku dhe si do të kryhej ekzekutimi i tij.

Për më tepër, Gjykata vërejtë se nuk kishte pasur asnjë dëshmi verbale në seancën dëgjimore të gjykimit në mungesë të kërkuesit, që të gjitha provat e shqyrtuara ishin paraqitur nga prokurori se as i akuzuari apo avokati mbrojtës i tij, nuk kishin qenë të pranishëm në seancë. Duke qenë se procedura kishte qenë e shkurtuar dhe nuk ishin respektuar të drejtat e palës mbrojtëse, procedura duhej konsideruar si një mohim flagrant i të drejtës për gjykim të drejtë. Gjykata vlerësoi se dënimi me vdekje i vendosur ndaj Z. Bader pas një gjykimi të padrejtë, në mënyrë të pashmangshme i shkaktonte kërkuesve frikë dhe ankth të shtuar për të ardhmen e tyre, nëse dëboheshin në Siri.

Në përfundim, Gjykata u shpreh se kishte arsye serioze për të besuar se, nëse kthehej në vendin e tij të origjinës, Z. Bader i nënshtrohej një rreziku real që të ekzekutohej dhe t'i nënshtrohej trajtimeve në kundërshtim me nenin 2 (duke qenë se dënimi me vdekje ishte vendosur pas një gjykimi të padrejtë) dhe nenin 3 (si pasojë e frikës dhe ankthit që do pësonte). Prandaj, Gjykata konstatoi se dëbimi i Z. Bader dhe familjes së tij në Siri, nëse zbatohet, do të përbënte shkelje të neneve 2 dhe 3 të Konventës.

## Në lidhje me nenin 41

Nuk u paraqitën pretendime për shpërblim të drejtë dhe rrjedhimisht Gjykata nuk vendosi lidhur me këtë.

### **3. Koment**

Ky është një vendim kompleks. Neni 2 si i tillë nuk e ndalon vendosjen e dënimit me vdekje, por Gjykata kohë më parë ka vendosur se është shkelje e nenit 3 nëse ky vendim merret pa një gjykim të drejtë<sup>53</sup>. Gjykata kishte vendosur në vitin 1989, në rastin e *Soering k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>54</sup>, se “fenomeni i dënimit me vdekje” në SHBA përbën shkelje të ndaluar nga neni 3. Protokollit nr. 6 i Konventës parashikon heqjen e dënimit me vdekje, përveç në kohë lufte. Protokollit nr. 13 parashikon heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat dhe ashtu siç Gjyqtari Cabral Barreto theksoi në mendimin e tij paralel, ndalon gjithashtu Shtetet që të ekspozojnë dikë ndaj një rreziku të tillë. Në kohën e rastit në fjalë, Protokollit nr. 13 kishte marrë numrin e nevojshëm të ratifikimeve për të hyrë në fuqi dhe ishte ratifikuar gjithashtu edhe nga Suedia. Në kohën e publikimit të këtij botimit, nga 47 Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës vetëm Armenia, Azerbajxhani dhe Rusia ende nuk e kanë ratifikuar atë (Rusia ende nuk e ka nënshkruar). Është mjaft e qartë nga ky vendim, që Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk do e kishte pranuar si në pajtim me KEDNJ-në dëbimin e kërkuesit nga një Shtet Kontraktues i KEDNJ-së për t’u përballur me dënimin me vdekje, por mund të ketë pasur vështirësi për të rënë dakord mbi rrugën për të arritur në këtë përfundim. Pas këtij rasti një numër kërkesash janë paraqitur në Gjykatë në lidhje me dëbimet që përballeshin me dënime me vdekje. Në çështjen *Rrapo k. Shqipërisë*<sup>55</sup> që kishte të bënte me një rast ekstradimi, Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 2 të Konventës dhe as të Protokollit nr. 13, pasi vërejti se ishin dhënë garanci të besueshme se nuk do të jepej dënimi me vdekje. Në *Al-Saadoon dhe Mufdhi k. Mbretërisë së Bashkuar*, pasi mbeti e paqartë nëse pas dorëzimit kërkuesit akuzoheshin në fakt për vepra penale që dënoheshin me vdekje, ata preferuan të marrin në konsideratë çështjen në këndvështrimin e elementëve të “frikës dhe ankthit” sipas nenit 3<sup>56</sup>.

As vendimi i parë e pranueshmërisë dhe as vendimi në themel nuk shpjegojnë

53 *Shih Öcalan k. Turqisë*, vendim [Dhoma e Madhe] i 12 majit 2005, nr. 46221/99.

54 *Soering k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 7 korrikut 1989, nr. 14038/88.

55 *Rrapo k. Shqipërisë*, vendim i 25 shtatorit 2012, nr. 58555/10.

56 *Al-Saadoon dhe Mufdhi k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 2 marsit 2010, nr. 61498/08, i përfshirë në këtë kapitull.

situatën e familjarëve të Z. Bader sipas KEDNJ-së, të cilët nuk rrezikonin të dënoheshin me vdekje. Të dy fëmijët ishin të moshës 5 dhe 6 vjeç në atë kohë. Ata ankoheshin se dëbimi i kërkuesit do të “rrezikonte shkatërrimin e familjes”. Por duke qenë se Gjykata konstatoi shkelje të nenit 2 dhe 3 në lidhje me të katër kërkuesit, supozohet se elementët e “frikës dhe ankthit” në këtë situatë vlenin në mënyrë të barabartë edhe për gruan dhe fëmijët.

*Në mungesë të alternativave për mbrojtje të brendshme, dëbimi në Somali i një kërkuesi të cilit i është refuzuar azili shkel detyrimin e ndalimit të torturës dhe keqtrajtimin*

## **VENDIMI NË ÇËSHTJEN SALAH SHEEKH kundër HOLANDËS**

(Kërkesa nr. 1948/04)

**11 janar 2007**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Abdirizak Salah Sheekh, ishte shtetas somalez nga Mogadisho, i cili i përkiste klanit të pakicës Ashraf.

Në vitin 1991, për shkak të luftës civile, familja e tij la çdo gjë në Mogadisho, dhe u vendos në një fshat, ku jetuan në kushte primitive. Familja nuk kishte mjete mbrojtjeje dhe si anëtarë të një klani minoritar, persekutoheshin nga klani Abgal i klanit familjar të Hawive, të cilët komandonin në fshat. Kërkuesi pretendoi se forcat e armatosur të klanit Abgal vranë të atin dhe vëllain dhe përdhunuan motrën e tij.

Më 12 maj 2003 Z. Salah Sheekh u largua nga Somalia dhe arriti në Amsterdam me një pasaportë false. Po atë ditë paraqiti një kërkesë për azil.

Më 25 qershor 2003 kërkesa e tij për azil u refuzua. Ministri për Imigracionin dhe Integrimin në Holandë vendosi se informacioni i dhënë nga kërkuesi në lidhje me datën e tij të lindjes nuk ishte i besueshëm. Më tej, Ministri nuk e konsideroi situatën në Somali të tillë që thjesht fakti që një azilkërkuës vinte nga ai vend, pavarësisht nëse i përkiste ose jo grupit të pakicës Ashraf, duhej t'i njihej statusi i refugjatit. Kërkuesi nuk kishte qenë anëtar apo simpatizant i një partie politike apo lëvizje dhe ai kurrë nuk ishte arrestuar apo ndaluar. Më tej, Ministri vërejti se problemet e përjetuara nga kërkuesi nuk ishin rezultat i veprimeve sistematike të diskriminimit, por ishin si pasojë e gjendjes së përgjithshme të paqëndrueshme në vend ku bandat kriminale shpesh, por në mënyrë arbitrare, frikësonin dhe kërcënonin njerëzit. Ministri arriti në përfundimin se nuk kishte asnjë rrezik real që kërkuesi t'i nënshtrohej trajtimin në kundërshtim me nenin 3, nëse kthehej në Somali. Duke pasur parasysh gjendjen e përgjithshme atje, Z. Salah Sheekh mund të vendosej në një zonë tjetër të Somalisë ku situata ishte disi më e sigurt.

Kërkuesi apeloj kundër refuzimit të kërkesës së tij për azil në 26 qershor 2003,

duke argumentuar, ndër të tjera, se përvojat e tij në Somali ishin rezultat i shfrytëzimit etnik, dhe se atje nuk kishte asnjë mundësi për t'u vendosur diku tjetër brenda vendit. Gjithashtu ai paraqiti një kundërshtim ndaj refuzimit për t'i dhënë një leje qëndrimi të veçantë për personat pa shtetësi. Ankesa iu refuzua, dhe Gjykata Rajonale e Hagës u shpreh se zoti Salah Sheekh mund të shkonte në një nga «zonat relativisht të sigurta» të Somalisë.

Më 16 janar 2004 kërkuesi, pasi mori dijeni se ndaj tij do të lëshohej dokumenti i udhëtimit me qëllim dëbimi nga Bashkimi Evropian dhe do të dëbohej në «zonat relativisht të sigurta» të Somalisë, depozitoi një kundërshtim në Ministri. Ai kërkoi nga Gjykata Rajonale e Hagës të lëshojë një masë të përkohshme në mënyrë që të parandalohet dëbimi i tij, në pritje të vendimit lidhur me apelimin.

Më 20 janar 2004, gjyqtari i Gjykatës Rajonale e refuzoi kërkesën e Z. Salah Sheekh për dhënien e një masë të përkohshme. Ai vendosi se dëbimi me dokumentet e udhëtimit të BE-së do të ishte i paligjshëm vetëm në qoftë se kishte informacion se personi që udhëtonte me këto dokumente nuk do të lejohej të hynte në atë territor. Asnjë informacion i tillë nuk ekzistonte.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Më 15 janar 2004, Z. Salah Sheekh paraqiti një kërkesë në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut. Autoritetet holandeze pezulluan urdhrin e dëbimit të kërkuesit, pas zbatimit të nenit 39 të Rregullores së Gjykatës që parashikonte marrjen e masave të përkohshme dhe ndalonte dëbimin e kërkuesit deri në zgjidhjen e çështjes para Gjykatës.

Duke marrë parasysh situatën e tij personale, konkretisht përkatësinë e tij në një pakicë, të vendosur në kontekstin e situatës së përgjithshme të drejtave të njeriut në Somali, Z. Salah Sheekh pretendoi se, nëse kthehej në Somali, rrezikonte t'i nënshtrohej torturës ose keqtrajtimit. Gjithashtu, ai u ankua se ai nuk kishte një mjet ligjor efektiv në dispozicion, duke qenë se Qeveria holandeze refuzoi të pezullonte dëbimin e tij, ndërkohë që ende pritej një vendim në lidhje me ankimin për mënyrën e dëbimit të tij. Ai u mbështet në nenet 3 dhe 13 të Konventës.

### Në lidhje me nenin 3

Konstatimi i përgjegjësisë së Shtetit dëbues sipas nenit 3 përfshin edhe vlerësimin e kushteve në vendin pritës. Një vlerësim i tillë duhet të jetë i përshtat-

shëm dhe i mbështetur në mënyrë adekuate nga materialet e brendshme si dhe materiale të tjera nga burime të besueshme, të tilla si Shtetet e tjera, agjencitë e OKB-së dhe organizatat e respektuara jo-qeveritare (OJQ).

Në rastin konkret, Gjykata duhet të vlerësonte nëse dëbimi në zona “relativisht të sigurta” në Somali, siç propozohet nga Qeveria Holandeze, cenonte nenin 3. Gjykata vuri në dukje se edhe në ato zona - në veri të Somalisë ku në përgjithësi situata ishte më e qetë se në jug dhe qendër - vërehej një ndryshim i konsiderueshëm ndërmjet individëve të cilët ishin nga ato zona dhe të ardhurve nga zona të tjera të Somalisë. Gjykata theksoi rëndësinë e përkatësisë në një klan, si një element i rëndësishëm dhe e konsideroi të pamundur që kërkuesi, i cili ishte anëtar i pakicës Ashraf dhe vinte nga jugu i Somalisë, të mund të merrete mbrojtje nga një fis i zonave “relativisht të sigurta”. Gjithashtu, ajo vuri në dukje se tre grupet më të rrezikuara në Somali konsideroheshin personat e zhvendosur brenda vendit, minoritetet dhe të kthyerit nga arratia. Nëse kërkuesi kthehej Holanda për t’u vendosur në një nga zonat “relativisht të sigurta”, ai do të përfshihej haptazi në të tre këto kategori.

Nuk është në kundërshtim me Konventën që Shtetet të vlerësonin mundësinë e dhënies së mbrojtjes së brendshme kur shqyrtojnë një kërkesë për azil. Megjithatë, Gjykata u shpreh se “duhej të ekzistonin disa garanci të tilla si: personi që do të dëbohej duhet të ishte në gjendje të udhëtonte në zonën në fjalë, të pranohej dhe të qëndronte atje. Mungesa e këtyre garancive mund të ngrinte një çështje sipas nenit 3». Në këtë drejtim, qëndrimi i autoriteteve të Somaliland dhe Puntland, të cilat ishin zonat relativisht të sigurta, ishte qartësisht kundër kthimit në territorin e tyre të jo-Somalilandezëve dhe refugjatëve. Përveç kësaj, autoritetet e Somaliland dhe Puntland deklaruan se nuk e pranonin dokumentin e udhëtimit të BE-së.

Pavarësisht kësaj, Qeveria e Holandës vazhdonte të këmbëngulte se kthimet në këto zona ishin ende të mundura, duke theksuar se, nëse personit të kthyer i refuzohej hyrja, ai do të lejohej të kthehej në Holandë. Gjykata u shpreh se, edhe në qoftë se Qeveria e bënte të mundur kthimin e azilkërkuesit në Somaliland ose Puntland, kjo nuk garantonte që kërkuesi kur të ishte atje do të lejohet ose do t’i bëhej e mundur qëndrimi në atë territor dhe duke qenë se Qeveria e Holandës nuk monitoronte procesin e dëbimit, ajo nuk do të kishte asnjë mënyrë për të verifikuar nëse kërkuesi do të pranohej ose jo. Duke parë qëndrimet e Puntland dhe Somaliland, lidhur me këtë çështje, Gjykata vërejtë se kishte shumë pak mundësi që Z. Salah Sheekh të lejohej të vendosej atje pas kthimit.

Për të përcaktuar nëse kërkuesit i kanosej një shkelje e nenit 3 nëse detyrohej të kthehej në zona të tjera të Somalisë të cilat konsideroheshin nga të gjithë të pasigurta, Gjykata vërejti se, duke qenë se Z. Salah Sheekh tashmë ishte viktimë e trajtimit çnjerëzor në Somali dhe parë që situata e përgjithshme nuk kishte pësuar ndonjë ndryshim thelbësor, nuk kishte asnjë tregues që kërkuesi do të ndodhej në një situatë të ndryshme nga ajo prej të cilës ai kishte ikur.

Në përfundim, Gjykata vërejti se kërkuesi dhe familja e tij ishin në shënjestër për shkak se i përkisnin pakicës Ashraf dhe për këtë arsye ata nuk kishin mjete mbrojtjeje në dispozicion. Gjykata deklaroi se nuk ishte e nevojshme që kërkuesi të tregonte ekzistencën e tipareve të tjera të veçanta që e dallonin atë personalisht për të vërtetuar se ishte në rrezik. Në ndryshim nga qëndrimi i mbajtur në çështjen e *Vilvarajah dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>57</sup>, Gjykata u shpreh se nëse kërkuesit, përveç faktit të përkatësisë tij në klanin Ashraf, i kërkohej të tregonte ekzistencën e tipareve të tjera dalluese, mbrojtja e ofruar nga neni 3 do të ishte iluzive.

Duke pasur parasysh situatën e përgjithshme në zonat “relativisht të pasigurta” të Somalisë, Gjykata vlerësoi se, nëse kthehet atje, kërkuesi mund të ekspozohet ndaj rrezikut të trajtimit në kundërshtim me nenin 3. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se dëbimi i Z. Salah Sheekh në Somali do të rezultonte në shkelje të nenit 3.

### Në lidhje me nenin 13

Gjykata vendosi se kërkuesi kishte pasur në dispozicion një mjet efektiv ligjor për sa i përket mënyrës se si do të kryhej dëbimi i tij e për rrjedhojë nuk konstatoi shkelje të nenit 13.

### Në lidhje me nenin 41

Kërkuesi nuk paraqiti asnjë kërkesë për shpërblim të drejtë dhe Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme shqyrtimin e kësaj çështje me iniciativën e saj.

## **3. Koment**

Ky vendim i rëndësishëm është një nga momentet kyçe në zhvillimin e jurisprudencës së Gjykatës. Në çështjen e *Vilvarajah dhe të tjerët k. Mbretërisë së*

57 *Vilvarajah dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 30 tetorit 1991, nr. 13163/87, 13164/87, 13165/87, 13447/87, 13448/87.



së *Bashkuar*, të vitit 1991, Gjykata vendosi se çdo mashkull i ri Tamil i kthyer në Sri Lanka duhej të tregonte “karakteristika të veçanta dalluese” që sillnin si pasojë ekspozim më të madh, krahasuar me meshkujt e tjerë të rinj Tamil, ndaj rrezikut të keqtrajtimit në kundërshtim me nenin 3, edhe pse ishte e njohur se të gjithë rrezikoheshin. Në çështjen e *Salah Sheekh* Gjykata pranoi se, nëse të gjithë anëtarët e një grupi të caktuar rrezikonin të keqtrajtoheshin për shkak të anëtarësisë së tyre në atë grup, mbrojta e ofruar nga neni 3 nuk do të ishte aspak efektive nëse secilit prej tyre do t’i duhej të tregonte se, përveç kësaj, ishte personalisht më i rrezikuar se personat e tjerë në të njëjtin grup. Ky vendim hapi një derë që iu ishte mbyllur, në çështjen *Vilvararajah*, të gjithë atyre që ishin me të vërtetë në rrezik për shkak të përkatësisë të tyre në një grup dhe jo për shkak të ndonjë veprimtarie të veçantë ose veçorie personale që mund t’i bënte ata më shumë objekt i keqtrajtimit sesa anëtarët e tjerë të grupit. Vendimi në çështjen *Salah Sheekh* vendosi një gur të rëndësishëm në zhvillimin e jurisprudencës të ardhshme në çështjen *NA. k. Mbretërisë së Bashkuar dhe Sufi dhe Elmi k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>58</sup>.

Qeveria holandeze ishte shumë e shqetësuar me çështjen e shterimit të mjeteve të brendshme ligjore. Ata pretenduan që rasti të deklarohet i papranueshëm për shkak të mos shterimit të mjeteve të brendshme ligjore nga ana e kërkuesit. Megjithatë, duke qenë se autoritetet përkatëse gjyqësore holandeze zbatuan testin e “rrethanave personale” të zbatuar në çështjen *Vilvarajah*, Gjykata vlerësoi se mjeti ligjor në dispozicion nuk do të sillte trajtimin e duhur të pretendimeve të kërkuesit i cili kërkonte një qëndrim ndryshe nga ai në rastin *Vilvarajah*. Konstatimi i Gjykatës se mjeti nuk ishte ai që kërkuesi duhet të përdorte ishte i lidhur pazgjidhshmërisht me vendimin mbi themelin për sa i përket parimit se të gjithë anëtarët e një grupi në rrezik meritonin mbrojtje.

58 *NA. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 17 korrikut 2008, nr. 25904/07, dhe *Sufi dhe Elmi k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 28 qershorit 2011, nr. 8319/07 dhe 11449/07, të përfshira në këtë kapitull.

*Dëbimi i të huajve në një vend ku mund të përballen me rrezikun real të torturës*

## **VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN SAADI kundër ITALISË**

(Kërkesa nr. 37201/06)

**28 shkurt 2008**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Nassim Saadi, ishte një shtetas tunizian i cili kishte lindur në vitin 1974 dhe jetonte në Milano të Italisë. Ai ishte babai i një fëmije tetëvjeçar, nëna e të cilit ishte shtetase italiane.

Në dhjetor të vitit 2001, kërkuesi mori, “për arsye familjare”, leje qëndrimi në Itali, të vlefshme deri në tetor të vitit 2002.

Në tetor të vitit 2002, Z. Saadi, i cili ishte i dyshuar, ndër të tjera, për terrorizëm ndërkombëtar, u arrestua dhe u vendos në paraburgim. Në maj të vitit 2005, Gjykata e Milanos për Krimet e Rënda bëri një riklasifikim të veprës penale për të cilën akuzohej kërkuesi, duke e ndryshuar nga terrorizëm ndërkombëtar në bashkëpunim për qëllime kriminale. Ajo e shpalli Z. Saadi fajtor për këtë veprë dhe për veprën penale të falsifikimit, duke e dënuar me katër vjet e gjashtë muaj burg. Si prokuroria dhe kërkuesi apeluan. Në datën që Dhoma e Madhe dha vendimin, procedurat përpara gjykatave italiane nuk ishin mbyllur ende.

Më 11 maj 2005, një gjykatë ushtarake në Tunizi dënoi kërkuesin në mungesë me 20 vjet burg për anëtarësim në një organizatë terroriste që vepronte jashtë vendit në kohë paqeje dhe për nxitje të terrorizmit.

Z. Saadi u lirua më 4 gusht të vitit 2006. Megjithatë, më 8 gusht të vitit 2006, Ministri i Brendshëm urdhëroi kthimin e tij në Tunizi në zbatim të dispozitave të ligjit 2005 “Për marrjen e masave urgjente për të luftuar terrorizmin ndërkombëtar”. Në urdhrin e Ministrit deklarohet se “ishte e qartë nga dokumentet në dosje” që kërkuesi kishte luajtur një “rol aktiv” në një organizatë përgjegjëse për sigurimin e mbështetjes logjistike dhe financiare për personat që ishin pjesë e grupeve fundamentaliste islamike në Itali dhe jashtë vendit. Për rrjedhojë kërkuesi u vendos në një qendër të qëndrimit të përkohshëm në Milano, në pritje të dëbimit të tij.

Z. Saadi kërkoi azil politik por iu refuzua në shtator të vitit 2006. Në të njëjtën

ditë ai depozitoi një kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Sipas nenin 39 të Rregullores së Gjykatës (në lidhje me masat e përkohshme), Gjykata i kërkoi qeverisë italiane për të pezulluar ekzekutimin e urdhrin të dëbimit të kërkuesit deri në një njoftim të mëvonshëm.

Koha maksimale e lejuar për mbajtjen e kërkuesit të ndaluar me qëllim dëbimit të tij përfundonte më 7 tetor të vitit 2006 dhe ai u lirua në atë datë. Megjithatë, më 6 tetor 2006 ndaj tij u lëshua një urdhër i ri dëbimi për në Francë (vendi nga ku kishte ardhur në Itali) dhe kështu ai u kthye përsëri në qendrën e qëndrimit të përkohshëm në Milano. Kërkuesi aplikoi për leje qëndrimi dhe kërkoi marrjen e statusit të refugjatit, por pa sukses. Më 3 nëntor 2006, pas marrjes së një informacioni që e bënte të qartë se nuk ishte i mundur dëbimi i tij në Francë, kërkues u lirua.

Në maj të vitit 2007, ambasada italiane në Tunizi, i kërkoi Qeverisë tuniziane një kopje të vendimit të pretenduar për dënimin e kërkuesit në Tunizi si dhe garanci diplomatike se, nëse kërkuesi kthehej në Tunizi, ai nuk do t'i nënshtrohej trajtimit në kundërshtim me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që t'i jepej mundësia të rihapte procedurat gjyqësore ku të merrte një gjykim të drejtë dhe të gjykohej drejtësisht. Në përgjigje, Ministri tunizian i Punëve të Jashtme i dërgoi dy herë Notë Verbale Ambasadës Italiane në korrik 2007 duke deklaruar se ai “pranonte transferimin në Tunizi të tunizianëve të burgosur jashtë vendit pasi identiteti i tyre të konfirmohej”, se legjislacioni tunizian u garantonte të drejtat të burgosurve dhe se Tunizia kishte aderuar në “traktatet dhe konventat përkatëse ndërkombëtare”.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkesa u paraqit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut më 14 shtator 2006. Më 29 mars 2007, Dhoma e së cilës iu caktua për shqyrtim, hoqi dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe, në bazë të nenit 30 të Konventës.

Kërkuesi pretendoi se dëbimi i tij në Tunizi do e vendoste përballë rrezikut për t'iu nënshtuar torturës ose trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Duke u bazuar në nenin 6, ai më tej pretendoi se në Tunizi i ishte mohuar në mënyrë flagrante drejtësia duke qenë se ishte dënuar në mungesë dhe nga një gjykatë ushtarake. Sipas nenit 8, ai u ankua se kthimi i tij në Tunizi do privonte partneren dhe djalin e tij nga prania dhe mbështetja e tij.

### Në lidhje me nenin 3

Gjykata vërejti se nuk mund ta nënvlerësonte rrezikun e terrorizmit dhe vuri në dukje se Shtetet po përballëshin me vështirësi të konsiderueshme në mbrojtjen e popujve të tyre nga dhuna terroriste. Megjithatë, kjo nuk duhet të vinte në dyshim natyrën absolute të nenit 3.

Në kundërshtim me argumentin e Mbretërisë së Bashkuar, si palë e tretë ndërrhyrëse në proces, e mbështetur nga Qeveria Italiane, Gjykata vërejti se nuk ishte e mundur të vihej në balancë rreziku i keqtrajtimit të një personi kundrejt rrezikshmërisë së tij për komunitetin, nëse nuk kthehej. Mundësia që personi të përbente një kërcënim serioz për komunitetin nuk pakësonte në asnjë mënyrë rrezikun që ai mund të vuante nëse dëbohej.

Për sa i përket argumentit se një rrezik i tillë duhej mbështetur në prova të forta (arritja e një standardi më të lartë nga çfarë kërkohet normalisht), kur personi përbente kërcënim për sigurinë kombëtare, Gjykata vërejti se një qasje e tillë nuk ishte në përputhje me natyrën absolute të nenit 3. Gjykata rikonfirmoi se, që dëbimi me forcë të konsiderohej në shkelje të Konventës, mjaftonte të tregohej se kishte arsye serioze për të besuar se ekzistonte rreziku që kërkuesi të ishte subjekt i keqtrajtimit në vendin pritës.

Gjykata iu referua raporteve të Amnesty International dhe Human Rights Watch, të cilat përshkruanin një situatë shqetësuese në Tunizi, të konfirmuar edhe nga një raport i Departamentit të Shtetit të SHBA. Këto raporte përmendnin raste të shumta të torturës të shkaktuara nga personat e akuzuar në bazë të ligjit të vitit 2003 “Për parandalimin e terrorizmit”. Raportet dëshmonin për mos hetimin e akuzave të torturës dhe të keqtrajtimit nga autoritetet kompetente tuniziane dhe përdorimin nga ana e tyre, rregullisht, të dëshmimeve të marra nën kërcënimin për ushtrim dhune. Për rrjedhojë, kërkuesi i përkiste grupit i cili rrezikonte të keqtrajtohej.

Më tej, Gjykata vuri në dukje se autoritetet tuniziane nuk kishin dhënë garancitë diplomatike të kërkuara nga Qeveria Italiane në maj 2007. Për më tepër, edhe nëse autoritetet tuniziane do të jepnin garanci diplomatike, kjo nuk e çlironte Gjykatën nga detyrimi për të shqyrtuar nëse këto garanci ishin të mjaftueshme për ta mbrojtur kërkuesin nga rreziku i trajtimit.

Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se, nëse do të zbatohet vendimi për kthimin e Z. Saadi në Tunizi, do të shkelte nenin 3.

### Në lidhje me nenet 6 dhe 8

Duke rikujtuar konstatimet e saj në lidhje me nenin 3 dhe duke mos pasur arsye për të dyshuar se Qeveria italiane nuk do të respektonte vendimin e Dhomës së Madhe, Gjykata nuk e shikonte të nevojshme për të vendosur nëse, në rastin e dëbimit në Tunizi, do të kishte shkelje të nenit 6 dhe nenit 8.

### Në lidhje me nenin 41

Gjykata u shpreh se konstatimi i shkeljes përbën në vetvete shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për dëmin jo material që kishte pësuar kërkuesi dhe i akordoi atij 8,000 € për kostot dhe shpenzimet.

## **3. Koment**

Një atribut i rëndësishëm i sovranitetit shtetëror është e drejta për të pranuar ose të dëbuar personat e huaj dhe vetëm nëse dëbimet e tilla do të ngrenë çështjen që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, Gjykata do të shqyrtojë pajtueshmërinë e dëbimeve të propozuara me detyrimet e Konventës. Gjykata gjithmonë ka deklaruar se ndalimi absolut i torturës ose dënimeve apo trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese zbatohet njëllë për të ndaluar dëbimin e një personi, të cilit i kanoset rreziku real i një trajtim të tillë. Në rastin e *Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>59</sup>, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar u përpoq të argumentonte se kur personi i huaj në fjalë përbente një kërcënim për sigurinë kombëtare ose rendin publik ndalimi nuk ishte absolut. Gjykata vendosi ndryshe. Në rastin *Saadi kundër Italisë*, Mbretëria e Bashkuar ndërhyri, pa sukses, në përpjekje për të bindur Gjykatën që të ndryshonte qëndrimin e saj të mbajtur në *Chahal*. Dhoma e Madhe vendosi njëzëri se, në qoftë se ekzistonte një rrezik real i ekspozimit ndaj trajtimit absolutisht të ndaluar, ndalimi i dëbimit ishte absolut. Në rastin e Z. Saadi një rrezik i tillë ekzistonte. Fakti se Tunizia ishte palë në instrumentet ndërkombëtare që ndalonin torturën, nuk ishte i mjaftueshëm përballë dëshmimeve se tortura atje praktikohet rëndom. Këtë qëndrim Gjykata ka mbajtur edhe në shumë raste të mëvonshme.

59 *Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim [Dhoma e Madhe] i 15 nëntorit 1996, nr. 22414/93, gjithashtu i përfshirë në këtë kapitull.

*Dëbimi i një shtetaseje nga Uganda, të sëmurë rëndë, nuk përbën trajtim poshtërues*

**VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN E N.  
kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesa nr. 26565/05)

**27 maj 2008**

**1. Faktet kryesore**

Kërkuesja, Znj. N., shtetase e Ugandës e lindur në vitin 1974, kishte hyrë në Mbretërinë e Bashkuar më 28 mars 1998 me një emër të rremë.

Ajo ishte e sëmurë rëndë dhe u shtrua në spital, ku u diagnostikua me HIV-pozitiv.

Brenda pak ditësh, avokatët e saj depozituan një kërkesë për azil në emër të saj, duke pretenduar se ajo ishte keqtrajtuar dhe dhunuar nga Lëvizja Kombëtare e Rezistencës në Uganda për shkak të lidhjes së saj me Ushtrinë e Rezistencës së Zotit dhe se jeta dhe siguria e saj ishin në rrezik në qoftë se kthehej në Uganda.

Në nëntor të vitit 1998, kërkuesja u diagnostikua me sëmundjen e dytë përcaktuese të SIDËS, sarcoma Kaposi. Në këtë fazë, numri i qelizave të saj CD4 kishte arritur deri në 10, krahasuar me ato të një personi të shëndetshëm që arrin in në rreth 500. Falë trajtimit me barna antiretrovirale të marra në Mbretërinë e Bashkuar gjendja e kërkueses filloi të stabilizohej dhe në vitin 2005, kur Dhoma e Lordëve shqyrtoi çështjen, numri i qelizave të saj CD4 kishte arritur në 414.

Me kërkesën e avokatit të kërkueses, në mars të vitit 2001 një mjek konsulent përgatiti një raport. Raporti bëri të qartë se, pa trajtimin intensiv për të rritur numrin e qelizave CD4, prognoza e kërkueses ishte “alarmuese” dhe nëse detyrohej të kthehej në Ugandë, ku nuk kishte “asnjë mundësi për të marrë trajtimin e nevojshëm mjekësor”, jeta e saj s’do të zgjaste më shumë se një vit.

Sekretari i Shtetit për Çështjet e Brendshme të Mbretërisë e Bashkuar refuzoi kërkesën për azil të kërkueses në 28 mars të vitit 2001, duke vërejtur se pretendimet e saj nuk ishin të besueshme pasi nuk kishte prova që dëshmonin se autoritetet e Ugandës ishin të interesuara për të. Pretendimi i kërkueses në bazë të nenit 3 të KEDNJ-së u hodh poshtë nga Sekretari i Shtetit i cili vuri në dukje se trajtimi i SIDËS në Ugandë ishte i krahasueshëm me atë të çdo vendi tjetër afrikan dhe se të gjitha barnat kryesore anti-virale gjendeshin në Ugandë.

Më 10 korrik 2002 apelimi i Znj. N. në lidhje me refuzimin e azilit u hodh poshtë, por u pranua në lidhje me nenin 3, duke iu referuar rastit *D. k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>60</sup>.

Sekretari i Shtetit e apeloj arsyetimin në bazë të nenit 3, duke pohuar se të gjithë ilaçet për SIDËN, të vëna në dispozicion nga Shërbimi Shëndetësor Kombëtar në Mbretërinë e Bashkuar, mund të blihen gjithashtu në Ugandë dhe shumica prej tyre mund të gjendeshin edhe me çmim të ulët në sajë të “projekteve të financuara” prej Kombeve të Bashkuara dhe programeve bilaterale për SIDËN të financuara nga donatorët. Për rrjedhojë, pas kthimit të saj në Ugandë, Znj. N. nuk do të përballej me “mungesë të plotë të trajtimit mjekësor» e si pasojë të përballej me “vuajtje të rënda fizike dhe mendore”. Tribunali i Apelit për Emigracionin e pranoi apelimin më 29 nëntor 2002 dhe vërejti se, edhe pse pranonte që shëndetësia e ofruar në Ugandë nuk ishte në nivelin e asaj që ofrohej në Mbretërinë e Bashkuar, kërkuesja mund të gjente trajtim mjekësor të përshtatshëm për gjendjen e saj në Ugandë.

Kërkuesja apeloj pa sukses në Gjykatën e Apelit dhe në Dhomën e Lordëve.

## 2. Vendim i Gjykatës

Bazuar në nenet 3 dhe 8, Znj. N. u ankua se, duke pasur parasysh sëmundjen e saj dhe mungesën e trajtimit të përshtatshëm mjekësor në Ugandë, kthimi i saj atje do t'i shkaktonte vuajtje dhe një vdekje më të shpejtë, çka përbënte trajtimin çnjerëzor dhe poshtëruës.

### Në lidhje me nenin 3

Gjykata përsëriti se neni 3 mund të zbatohet për të parandaluar dëbimin në një vend ku rreziku i keqtrajtimit vinte nga aktet e autoriteteve publike por edhe nga aktet e strukturave jo shtetërore, kur autoritetet nuk ishin në gjendje t'i ofronin kërkuesit mbrojtjen e përshtatshme. Në lidhje me pretendimet e kërkueses se rrezikonte t'i cenoheshin të drejtat e saj sipas nenit 3 për shkak të shëndetit të keq, Gjykata iu referuar jurisprudencës së saj për sa i përket rasteve të dëbimit duke vërejtur se nuk kishte konstatuar një shkelje të tillë që prej vendimit të saj në vitin 1997 në rastin *D. k. Mbretërisë së Bashkuar*, i cili përfshinte “rrethana të jashtëzakonshme” dhe “konsiderata të forta humanitare”, pasi kërkuesi ishte i sëmurë rëndë dhe afër vdekjes dhe nuk mund t'i garantohej kujdesi i duhur mjekësor në vendin e tij të origjinës.

60 *D. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 2 majit 1997, nr. 30240/96.

Gjykata vuri në dukje se të huajt që janë subjekt i dëbimit, në parim nuk mund të pretendonin të qëndronin në territorin e një prej Shteteve Kontraktuese për të vazhduar të merrnin përfitimet mjekësore, sociale apo lloje të tjera ndihme dhe shërbimesh të ofruara nga Shteti dëbues. Mundësia e përkeqësimit të situatës së kërkuesit, përfshirë jetëgjatësinë e tij, nëse largohej nga Shteti Kontraktues, nuk ishte në vetvete e mjaftueshme për të ngritur një çështje sipas nenit 3. Vetëm në raste të jashtëzakonshme, kur ka arsye të forta humanitare, dëbimi i një të huaji të sëmurë rëndë në një vend, ku kushtet për trajtimin e kësaj sëmundjeje ishin më të këqija krahasuar me ato në Shtetin Kontraktues, mund të ngrinin një çështje sipas nenit 3. Për më tepër, duke marrë parasysh edhe se niveli i trajtimit mjekësor në Shtetin Kontraktues dhe vendin e origjinës mund të ndryshonte në mënyrë të konsiderueshme, neni 3 nuk vendoste një detyrim për Shtetin Kontraktues për të eliminuar ndryshimet e tilla përmes sigurimit të kujdesit shëndetësor në mënyrë të pakufizuar për të gjithë të huajt, të cilët nuk kanë të drejtë për të qëndruar në territorin e saj. Ndryshe, mbajtja e një qëndrimi të kundërt do të vendoste një barrë shumë të madhe për Shtetet Kontraktuese.

Në rastin konkret, Gjykata vërejti se, megjithëse Znj. N. bëri një kërkesë për azil në Mbretërinë e Bashkuar dhe iu refuzua, kërkesa e saj sipas nenit 3 u bazua vetëm në gjendjen e saj të rëndë shëndetësore, si dhe në mungesën e trajtimit të duhur mjekësor në vendin e saj. Në këtë drejtim, Gjykata shqyrtoi informacionin e dhënë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, sipas së cilës barnat antiretroviral gjendeshin në Ugandë, edhe pse, për shkak të mungesës së burimeve financiare, ato mund t'i siguronin vetëm gjysma e atyre që kishin nevojë.

Gjykata pranoi se kthimi i kërkueses në Ugandë do të ndikonte në mënyrë të konsiderueshme në shëndetin dhe jetëgjatësinë e saj. Megjithatë, si rezultat i trajtimit mjekësor që ajo kishte marrë në Mbretërinë e Bashkuar gjendja e saj ishte bërë më e qëndrueshme dhe tashmë kërkuesja nuk ishte në situatë shëndetësore kritike. Mbretëria e Bashkuar nuk kishte detyrimin të vazhdonte t'i ofronte kujdes shëndetësor, pasi pretendimet e saj sipas nenit 3 dhe 8 të Konventës ishin shqyrtuar nga gjykatat e brendshme dhe Gjykata e Strasburgut.

Gjykata u shpreh se në pretendimet e kërkueses në lidhje me shpejtësinë e përkeqësimit të shëndetit të saj dhe nivelit të ndihmës dhe trajtimit mjekësor që do t'i ofrohej në Ugandë, ishin disi spekulative, veçanërisht në dritën e evoluimit të vazhdueshëm të situatës për sa i përket trajtimit të HIV dhe SIDËS në mbarë botën. Kështu, rasti i kërkueses nuk përfshinte “rrethana tepër të jashtëzakonshme” sa të bënin të mundur parandalimin e dëbimit të saj.



Rrjedhimisht, Gjykata vendosi se zbatimi i vendimit për ta kthyer kërkuesen në Ugandë nuk përbënte shkelje të nenit 3.

### Në lidhje me nenin 8

Gjykata vendosi se ishte e panevojshme shqyrtimi i pretendimeve sipas nenit 8, pasi nuk ngrihej ndonjë çështje tjetër sipas këtij neni.

### **3. Koment**

Pasi doli ky vendim çështje të njëjta janë çuar në mënyrë të përsëritur në Strasburg dhe duket se tërheqin një vëmendje të veçantë nga ana e Gjykatës<sup>61</sup>. Një kërkesë e ngjashme u çregjistrua nga lista e vendimeve për shqyrtim nga Dhoma e Madhe në rastin e *S.J. k. Belgjikës*<sup>62</sup>, pasi autoritetet belge i ofruan kërkueses dhe tre fëmijëve të saj të drejtën e pakufizuar për të qëndruar për shkak “të konsideratave të forta humanitare». Një tjetër rast ku janë ngritur të njëjtat çështje është aktualisht në Dhomë të Madhe<sup>63</sup>.

Duhet theksuar se në këto raste arsyetimi i Gjykatës bazohet në premisën se të huajt që janë subjekt i dëbimit, në parim, nuk mund të pretendojnë të qëndrojnë në territorin e një Shteti Kontraktues, në mënyrë që të vazhdojnë të përfitojnë nga ndihma apo shërbimet mjekësore, sociale apo të tjera të ofruara nga shteti dëbues. Mundësia e përkeqësimit të situatës së kërkuesit, përfshirë jetëgjatësinë e tij, nëse largohet nga Shteti Kontraktues, nuk ishte në vetvete e mjaftueshme për të ngritur një çështje sipas nenit 3. Pra e drejta për të qëndruar në një Shtet Kontraktues për arsye shëndetësore është shumë e jashtëzakonshme dhe duhet të kalojë një prag shumë të lartë, të vendosur nga Gjykata në rastin e *D. k. Mbretërisë së Bashkuar*. Në këtë rast, kërkuesi ishte i sëmurë rëndë, afër vdekjes dhe nuk mund t'i garantohej kujdesi mjekësor në vendin e tij të origjinës, St. Kitts. Për më tepër, ai nuk kishte asnjë familjar të gatshëm apo të aftë për t'u kujdesur për të apo t'i ofronte qoftë edhe ndihmë bazë përsa i përket ushqimit, strehimit dhe mbështetjes shoqërore. Duket se në këtë rast kombinimi i të gjithë këtyre faktorëve dhe kushteve në të cilat kërkuesi do të vdiste kanë qenë të një rëndësie të veçantë për analizën e nenit 3 nga Gjykata.

61 Shih p.sh. *S.H.H. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 29 janarit 2013, nr. 60367/10, *I.K. k. Austrisë*, vendim i 28 marsit 2013, nr. 2964/12, dhe *Senchishak k. Finlandës*, vendim i 18 nëntorit 2014, nr. 5049/12.

62 *S.J. k. Belgjikës*, çregjistruar nga lista e çështjeve për gjykim me vendimin e Dhomës së Madhe të 19 marsit 2015, nr. 70055/10.

63 *Paposhvili k. Belgjikës*, seanca në Dhomë të Madhe më 16 shtator 2015, nr. 41738/10.

Është e rëndësishme të theksohet se Gjykata në të gjitha rastet që kanë të bëjnë me kujdesin mjekësor nënvizon faktin se rreziku i hasur nga kërkuesit pas kthimit nuk buron nga aktet e qëllimshme ose mosveprimet e autoriteteve publike shtetërore, por nga sëmundje natyrale dhe mungesa e burimeve të mjaftueshme për t'u trajtuar në vendin pritës. Gjithashtu, ajo bën njëfarë testi balancimi, duke thënë se detyrimi sipas nenit 3 i Shteteve Kontraktuese që të sigurojnë kujdes shëndetësor të pakufizuar për të gjithë qytetarët e huaj, të cilët nuk kanë të drejtë për të qëndruar në territorin e saj, do të vendoste një barrë shumë të madhe për Shtetet Kontraktuese.

Është interesante të shikohet nëse do të vazhdojë të ruhet pragu i vendosur në çështjen *D. k. Mbretërisë së Bashkuar* edhe në rastin para Dhomës së Madhe, *Paposhvili k. Belgjikës* (të përmendur më lart).

*Propozimi për dëbimin e azilkërkuesve Tamil në Sri Lanka në shkelje të nenit 3 dhe zbatimi i masave të përkohshme në raste të ngjashme*

## **VENDIMI NË ÇËSHTJEN N.A. kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesa nr. 25904/07)

**17 korrik 2008**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Z. N.A., i lindur në vitin 1975, ishte shtetas sri lankez dhe i përkiste etnisë Tamil. Më 17 gusht 1999, ai arriti në Mbretërinë e Bashkuar në mënyrë klandestine dhe një ditë më pas bëri kërkesë për azil me arsyetimin se kishte frikë se nëse kthehej në Sri Lanka do të keqtrajtohej nga ushtria e Sri Lankës dhe Tigrat Çlirimtarë të Tamil Eelam (të ashtuquajturit “Tigrat Tamil”).

Z. N.A. shpjegoi se ishte arrestuar dhe ndaluar nga ushtria gjashtë herë ndërmjet viteve 1990 dhe 1997 pasi dyshohej se ishte i përfshirë me Tigrat Tamil. Në çdo rast, ishte liruar pa akuzë. Gjatë njërës ose ndoshta më shumë prej këtyre periudhave të ndalimit, ai ishte keqtrajtuar dhe si pasojë, këmbët e tij kishin plagë nga të goditurat me shkopinj gome. Gjithashtu, Z. N.A. ishte fotografuar dhe i ishin marrë shenjat e gishtave. Në një nga këto raste, i ati i tij kishte nënshkruar një dokument për të siguruar lirimin e tij. Ai kishte frikë nga Tigrat Tamil, sepse vëllai i tij kishte punuar për ta, dhe ata ishin përpjekur për të rekrutuar edhe Z. N.A. në dy raste.

Kërkesa e tij për azil ishte refuzuar nga Sekretari i Shtetit për Punët e Brendshme më 30 tetor 2002. Ankesa e tij kundër këtij vendimi u rrëzua nga një Gjyqtar më 27 korrik 2003, i cili vendosi se, megjithëse rrëfimi i kërkuesit ishte i besueshëm, frika e tij e keqtrajtimit nga ana e ushtrisë pas kthimit në Sri Lanka ishte i pajustificuar.

Z. N.A. iu dha urdhri i largimit të tij nga Mbretëria e Bashkuar më 1 prill 2006. Më 3 prill 2006, Sekretari i Shtetit refuzoi të marrë në konsideratë parashtrimet e tij të mëtejshme duke i konsideruar se përbënin një kërkesë të re për azil. Edhe pse ishte e njohur se situata e përgjithshme në Sri Lanka ishte përkeqësuar kjo nuk do të thoshte se duhet të ndaloheshin të gjitha kthimet atje. Nuk kishte asnjë dëshmi se Z. N.A. mund të cenohej personalisht pas kthimit të tij apo se autoritetet e Sri Lankës kishin ndonjë interes për të, duke pasur parasysh edhe faktin se ai kishte qenë jashtë për një periudhë të gjatë kohore.

Pasi kërkesat e njëpasnjëshme për shqyrtim gjyqësor të vendimit për ta kthyer kërkuuesin në Sri Lanka dështuan, më 25 qershor 2007 autoritetet përkatëse nxorën urdhrin e ri për largimin e tij. Në atë datë, pas paraqitjes së një kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Gjykata vendosi zbatimin e nenit 39 të Rregullores së Gjykatës (në lidhje me masat e përkohshme) dhe i kërkoj Qeverisë të mos kthente kërkuuesin deri në një njoftim të mëvonshëm. Për më tepër, rastit iu dha përparësi sipas nenit 41 të Rregullores.

Gjatë vitit 2007, në Gjykatë erdhi një numër në rritje kërkesash nga tamilët për marrjen e masave të përkohshme, të cilët po detyroheshin të ktheheshin në Sri Lanka nga Shtetet Kontraktuese, në veçanti nga Mbretëria e Bashkuar. Në tetor të vitit 2007, Kancelari i Seksioni i dërgoi një letër Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar ku deklaronte se shpresonte në ndihmën e saj, duke mos urdhëruar më për momentin largimin e tamilëve që ndodheshin në të njëjtën situatë si Z. N.A. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar u përgjigj se nuk mund ta pranonte kërkesën e Gjykatës, pasi situata aktuale në Sri Lanka nuk e përligjte pezullimin e largimit të të gjithë tamilëve, të cilët pretendonin se kthimi i tyre në vendin e tyre të origjinës do t'i vinte përballë rrezikut të keqtrajtimit. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar i sugjeroi Gjykatës që vështirësitë nga rritja e numrit të kërkesave për masa të përkohshme nga tamilët të trajtoheshin më mirë nga vetë Gjykata duke marrë një vendim kryesor i cili do të ofronte udhëzime lidhur me këtë çështje.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuuesi pretendoi se, nëse kthehej në Sri Lanka, rrezikonte realisht të keqtrajtohej në shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtërues) dhe/ose në shkelje të nenit 2 (e drejta për jetën) të Konventës.

### Në lidhje me nenin 2

Gjykata vendosi se pretendimet sipas nenit 2 ishin të pandashme nga ato sipas nenit 3 dhe prandaj duheshin trajtuar në kuadër të shqyrtimit të këtij të fundit.

### Në lidhje me nenin 3

Megjithëse ishte e ditur që gjendja e përgjithshme e të drejtave të njeriut në Sri Lanka ishte përkeqësuar, Gjykata duhet të vlerësonte nëse situata kishte ndryshuar konsiderueshëm, sa të pranohej se rrezikoheshin të gjithë tamilët

që ktheheshin atje dhe, si pasojë, nëse kthimi i kërkuesit atje do të përbënte shkelje të nenit 3.

Në vlerësimin e saj, Gjykata së pari mori parasysh parimet e përgjithshme të zbatueshme për rastet e dëbimit dhe pastaj përcaktoi qëndrimin e saj nisur nga informacioni objektiv që i ishte parashtruar. Mbi këtë bazë, ajo vlerësoi rrezikun për shtetasit sri lankezë që i përkisnin etnisë Tamil që ktheheshin në Sri Lanka dhe rrethanat individuale të rastit të kërkuesit në mënyrë që të vendoste nëse do të kishte shkelje të Konventës, nëse ai kthehej në vendin e tij.

Sipas mendimit të Gjykatës, fakti që ka pasur një përkeqësim të gjendjes së sigurisë në Sri Lanka dhe një rritje respektive të shkeljeve të të drejtave të njeriut, nuk përbënte një rrezik të përgjithshëm për tamilët e kthyer në vend. Vlerësimi i këtij rreziku mund të bëhej vetëm për raste individuale. Prandaj, në parim, ishte legjitime të vlerësohej rreziku individual i të kthyerve, në bazë të një liste «faktorësh rreziku», të hartuara nga autoritetet përkatëse të Mbretërisë së Bashkuar, nëpërmjet aksesit direkt në informacione objektive dhe dëshmime të ekspertëve. Megjithatë, Gjykata theksoi se një numër faktorësh të cilat nuk përbëjnë një rrezik real kur konsiderohen më vete, mund të përbëjnë rrezik nëse merren në mënyrë kumulative, në një situatë dhune të përgjithshme dhe sigurie së shtuar. Për pasojë, si vlerësimi i rrezikut për tamilët që kishin një «profil të caktuar» ashtu edhe vlerësimi nëse aktet individuale të dhunës të marra së bashku mund të përbënin shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut mund të bëhet vetëm rast pas rasti, duke treguar ekzistencën e karakteristike dalluese të cilat e vendosnin personin përballë rrezikut real të keqtrajtimit në kundërshtim me nenin 3.

Informacioni para Gjykatës, tregonte për akte torture sistematike dhe keqtrajtimit nga ana e autoriteteve të Sri Lankës ndaj tamilëve në përpjekjen për të luftuar Tigrat Tamilë. Përveç kësaj, autoritetet e Sri Lankës kishin mjetet teknologjike dhe procedurat për të identifikuar në aeroportin e Kolombos personat që iu ishte refuzuar azili dhe ata që kërkoheshin nga autoritetet.

Lidhur me rrezikun e pretenduar nga Tigrat Tamilë, Gjykata pranoi se çdo rrezik në Kolombo nga Tigrat Tamilë drejtohej vetëm kundrejt tamilëve të profilit të lartë - d.m.th. tamilë që ishin aktivistë të opozitës, ose ato që shiheshin si renegatë apo tradhtarë. Si rrjedhojë, Z. N.A. nuk rrezikonte realisht të keqtrajtohej nëse kthehej në Kolombo.

Në vlerësimin e pozitës së saj në raport me autoritetet e Sri Lankës, Gjykata shqyrtoi forcën e pretendimit të kërkuesit se kthimi në vendin e tij do e vinte përballë një rrezikut real, si rezultat i akumulimit të faktorëve të rrezikut, në dritën e zhvillimeve të fundit në vend. Faktorë të tjerë relevantë rreziku që u morën parasysh në rastin e Z. N.A. ishin: fakti që babai i tij kishte nënshkruar një dokument për të siguruar lirin e tij, prania e shenjave të dhunës, të cilat rrisnin rrezikun kumulativ të keqtrajtimit, mosha, gjinia dhe prejardhja e kërkuesit, ekzistenca e të dhënave të regjistruara më parë si anëtar i dyshuar i Tigrave Tamil, kthimi i tij nga Londra dhe fakti se kishte bërë një kërkesë për azil jashtë vendit. Të gjitha këto kontribuonin në rrezikun e identifikimit, marrjen në pyetje, kontrollin dhe ndalimin në aeroport dhe, ndoshta në një mundësi më të vogël, në Kolombo. Gjithashtu, Gjykata vuri në dukje se fakti që kishte kaluar mbi dhjetë vjet nga koha e arrestimit dhe ndalimit të kërkuesit nga autoritetet e Sri Lankës, nuk ishte konsideruar si vendimtar duke qenë se interesi i këtyre autoriteteve në kategori të veçanta të të kthyerve mund të ndryshonte me kalimin e kohës, duke u rritur ose duke rënë, në përgjigje të zhvillimeve të brendshme si dhe për shkak të mundësisë së pasjes së dosjeve përkatëse nga autoritetet.

Gjykata mori parasysh situatën aktuale të dhunës së përgjithshme në Sri Lanka dhe konsideroi të gjithë faktorët të marrë së bashku në rastin e kërkuesit. Ajo theksoi se personat që konsideroheshin me interes nga autoritetet Sri Lanka në përpjekjet e tyre për të luftuar Tigra Tamil ishin të ekspozuar në mënyrë sistematike ndaj akteve të torturës dhe keqtrajtimit. Ekzistonte një rrezik real që autoritetet në aeroportin Kolombo të kishin akses në dosjen mbi ndalimin e kërkuesit dhe në qoftë se kjo do ndodhte, të marra së bashku me faktorë të tjerë të rrezikut tek të cilat mbështetej kërkuesi, ky i fundit mund të ndalohej dhe t'i nënshtrohej kontrollit fizik. Në këtë mënyrë autoritetet do zbulonin plagët e tij. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konstatoi se këto ishin arsye serioze për të konkluduar se kërkuesi përbente interes për autoritetet e Sri Lankës në përpjekjet e tyre për të luftuar Tigra Tamilë.

Rrjedhimisht, Gjykata vendosi unanimisht se kthimi i kërkuesit në Sri Lanka, në kohën aktuale, do të shkelte nenin 3, duke e ekspozuar Z. N.A. ndaj rrezikut real të keqtrajtimit.

#### Në lidhje me nenin 41

Kërkuesi nuk parashtrroi pretendime në lidhje me dëmin material ose jo material në bazë të nenit 41, por Gjykata i akordoi atij 4451 euro për kostot dhe shpen-

zimet nga të cilat, më pak se 850 euro kërkuesi i ka marrë tashmë si ndihmë ligjore nga Këshilli i Evropës.

### 3. Koment

Në këtë rast, Gjykata u përball me pretendimin se kur situata në një vend të caktuar përbënte një rrezik të përgjithshëm për këdo që jetonte në atë vend, kthimi në atë vend, për çfarëdo lloj arsye, do të përbënte shkelje të nenit 3. Ky pretendim u ngrit në një kohë kur kishte një numër të madh kërkesash për zbatimin e nenit 39 të Rregullores së Gjykatës, në lidhje me kthimin në Sri Lanka. Ky vendim ishte përgjigjja që Gjykata i dha të gjithë shtetasve të Sri Lanka në atë kohë.

Në vlerësimin e saj, Gjykata, në radhë të parë theksoi se i duhej dhënë vëmendja e duhur përkeqësimit të gjendjes së sigurisë në vendin e destinacionit - Sri Lankës në këtë rast - dhe dhunës në rritje në përgjithësi dhe sigurisë së shtuar. Së dyti, ajo vuri theksin tek nevoja për t'i trajtuar në mënyrë kumulative të gjithë faktorët e mundshëm të rrezikut, të identifikuar nga kërkuesi si të zbatueshme për rastin e tij.

Veçanërisht në lidhje me pikën e parë, ky vendim shënon një hap themelor në praktikën gjyqësore të Gjykatës në rastet e azilit. Në të vërtetë, rëndësia e veçantë e këtij vendimi qëndron në faktin se Gjykata pranon për herë të parë se situata e përgjithshme në një vend të caktuar mund të jetë arsye e mjaftueshme për të konkluduar se kthimi i një personi në atë vend, do të përbënte në vetvete shkelje të nenit 3 të Konventës. Megjithatë, ajo e bën të qartë se ka një prag shumë të lartë dhe do të zbatohet këtë parim vetëm në situata shumë të rënda dhe të jashtëzakonshme. Në rrethanat e rastit konkret dhe bazuar në materialet objektive që kishte në dispozicion, Gjykata konstatoi se situata në Sri Lanka, në kohën e vlerësimit të Gjykatës, nuk ishte aq problematike sa, vetëm për shkak të situatës së përgjithshme, të konkludohej se kthimi i çdo personi në Sri Lanka do të përbënte shkelje të nenit 3.

Më pas Gjykata iu kthye pikës së dytë, qasjes kumulative. Ajo u shpreh se gjendja e përgjithshme e dhunës në Sri Lanka e kombinuar me karakteristikat personale të kërkuesit, të marra së bashku, e bënë kthimin e kërkuesit në Sri Lanka në kundërshtim me detyrimet sipas nenit 3 të Konventës. Gjykata mori parasysh sidomos faktin që kërkuesi ishte arrestuar gjashtë herë ndërmjet viteve 1990 dhe 1997, se ishte keqtrajtuar në burg dhe se ishte regjistruar ndalimi i tij në të paktën një rast, moshën, gjininë dhe origjinën e kërkuesit, të

dhënat se ai ishte ose mund të kishte qenë anëtar i opozitës Tamil, se i ishte refuzuar azili jashtë vendit dhe kështu me radhë.

Të gjithë këta faktorë të marrë së bashku, duke përfshirë gjendjen e përgjithshme dhe karakteristikat personale të kërkuesit, bënë që Gjykata të arrinte në përfundimin se kthimi i tij në Sri Lanka do të përbënte shkelje të nenit 3.



*Respektimi i masave të përkohshme të vendosura nga Gjykata*

## **VENDIMI NË ÇËSHTJEN BEN KHEMAIS kundër ITALISË**

(Kërkesa nr. 246/07)

**24 shkurt 2009**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Essid Sami Ben Khemais, shtetas tunizian i lindur në vitin 1968, ishte në burg në Tunizi.

Në shkurt të vitit 2002, gjykatat italiane dënuan Z. Ben Khemais me pesë vjet burg për anëtarësim në një organizate kriminale. Ai e kreu plotësisht dënimin e tij. Në mars të vitit 2006, Gjykata e Rrethit të Komos e dënoi përsëri me burg për agresion dhe urdhëroi dëbimin e tij nga Italia pas përfundimit të kohës së dënimit. Rezultati i ankesës së parashtruar nga kërkuesi në Gjykatën e Kasacionit ishte i panjohur.

Ndërkohë, me një vendim të 30 janarit 2002, Gjykata Ushtarake Tuniziane e dënoi në mungesë kërkuesin me dhjetë vjet burg për anëtarësimin në një organizatë terroriste. Ai dënim u bazua ekskluzivisht në deklaratat e një të bashkë-akuzuari.

Z. Ben Khemais depozitoi kërkesën e tij në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në janar të vitit 2007. Në mars të 2007, në pajtim me nenin 39 të Rregullores së Gjykatës, Gjykata iu drejtua Qeverisë italiane se ishte e dëshirueshme dhe në interes të palëve e të mbarëvajtjes së procesit para Gjykatës, që të pezullohej urdhri për dëbimin e kërkuesit në pritje të një vendimi mbi themelin e çështjes.

Megjithatë, më 2 qershor 2008, përfaqësuesi i kërkuesit informoi Kancelarin e Gjykatës se klienti i tij ishte dërguar në aeroportin e Milanos me qëllimin për ta kthyer në Tunizi. Më 11 qershor Qeveria italiane informoi Gjykatën se ishte lëshuar një urdhër dëbimi ndaj kërkuesit më 31 maj 2008, për shkak të rolit të tij në veprimtaritë e ekstremistëve islamikë. Gjykata Penale e Milanos konstatoi, ndër të tjera, se ai përbënte një kërcënim për sigurinë kombëtare, sepse mund të rivendoste kontaktet me ekstremistët islamikë me qëllim rifillimin e aktiviteteve terroriste jo vetëm në Itali por edhe në nivel ndërkombëtar. Kërkuesi u kthye në Tunizi më 3 qershor 2008.

Qeveria italiane dorëzoi gjithashtu në Gjykatë dokumentet e garancive diplo-

matike që kishte marrë nga autoritetet tuniziane. Sipas këtyre dokumenteve, kërkuesi nuk do t'i nënshtrohej torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës apo ndalimit arbitrar. Atij do t'i jepet trajtim i duhur mjekësor dhe do të lejohej të pranonte vizita nga avokati dhe anëtarët e familjes së tij.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u bazuar në nenet 2, 3 dhe 6, kërkuesi pretendoi se dëbimi i tij në Tunizi e kishte ekspozuar atë ndaj rrezikut të vdekjes, torturës dhe mohimit flagrant të drejtësisë. Sipas nenit 34, ai pohoi se zbatimi i urdhrit të kthimit të tij kishte shkelur të drejtën e tij për kërkesë individuale para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

### Në lidhje me nenin 3

Gjykata përsëriti se, në vendimin e Dhomës së Madhe në çështjen *Saadi k. Italisë*<sup>64</sup>, kishte arritur në përfundimin se raportet ndërkombëtare përmendnin raste të shumta dhe të përsëritura të torturës dhe keqtrajtimit të përhapura në Tunizi kundrejt personave të dyshuar apo të shpallur fajtor për terrorizëm dhe se në raportet e vizitave të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq në burgjet tuniziane nuk përjashtonin rrezikun e trajtimit në kundërshtim me nenin 3.

Në rastin konkret, Gjykata nuk gjeti asnjë arsye për të ndryshuar konkluzionet e saj, të cilat, për më tepër, ishin konfirmuar nga raporti i Amnesty International i vitit 2008 për Tunizinë. Gjithashtu, në këtë raport, thuhej se edhe pse shumë prej të burgosurve ankoheshin se ishin torturuar ndërkohë që mbareshin të ndaluar nga policia, “pothuajse në të gjitha rastet, autoritetet kishin dështuar të kryenin hetime apo të vendosnin autorët para drejtësisë”. Pamundësia e përfaqësuesit të Z. Ben Khemais-së para Gjykatës së Strasburgut, për të vizituar klientin e tij konfirmonte vështirësitë që përjetonin të burgosurit tunizianë për të kontaktuar avokatë të pavarur të huaj, edhe kur ata ishin palë në procedurat gjyqësore para gjykatave ndërkombëtare. Pasi kërkuesit dëboheshin në Tunizi, avokatët e tyre rrezikonin ta gjenin veten në situatën e pamundësisë për të verifikuar rrethanat e tyre dhe për të konstatuar ndonjë ankesë që ata mund të ngrinin në lidhje me trajtimin ndaj tyre. Edhe për Qeverinë Italiane dukej se ishte e pamundur për të ndërmarrë ndonjë kontroll pasi ambasadori i tyre nuk mund ta kontaktonte kërkuesin në vendin ku ai mbahej.

64 *Saadi k. Italisë*, vendim [Dhoma e Madhe] i 28 shkurtit 2008, nr. 37201/06, i përfshirë në këtë kapitull.

Në këto rrethana, Gjykata nuk mund të pranonte argumentin e Qeverisë se garancia e dhënë nga autoritetet tuniziane siguronte mbrojtje efektive kundër rrezikut serioz të keqtrajtimit të kërkuarit. Lidhur me këtë, ajo përsëriti parimin e afirmuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE) në Rezolutën nr. 1433 (2005), sipas së cilës Shtetet nuk mund të mbështeten vetëm tek garancitë diplomatike përveçse kur mungesa e një rreziku keqtrajtimi është konstatuar në mënyrë të qartë.

Gjithashtu, Gjykata vuri në dukje se autoritetet tuniziane kishin raportuar se kërkuari kishte marrë shumë vizita nga anëtarët e familjes së tij dhe avokati e tij tunizian. Ky i fundit kishte deklaruar se klienti i tij nuk kishte pretendime për keqtrajtim, që konfirmohej nga një raport mjekësor bashkëlidhur garancisë diplomatike. Megjithatë, pavarësisht se kjo tregonte që kërkuari nuk ishte keqtrajtuar në javët pasuese të kthimit të tij, absolutisht nuk jepte siguri për fatin e kërkuarit në të ardhmen.

Prandaj, Gjykata vendosi se zbatimi i urdhrin të dëbimit të kërkuarit në Tunizi cenonte nenin 3.

#### Në lidhje me nenin 2 dhe 6

Gjykata nuk e vlerësoi të nevojshme të shqyrtonte nëse zbatimi i urdhrin të dëbimit të kërkuarit shkelte edhe nenet 2 dhe 6.

#### Në lidhje me nenin 34

Gjykata theksoi se niveli i mbrojtjes që Gjykata mund t'i ofronte kërkuarit në lidhje me të drejtat e përcaktuara në nenet 2 dhe 3, ishte kufizuar në mënyrë të pakthyeshme pas dëbimit të tij. Ka pak rëndësi që dëbimi ishte kryer pas shkëmbimit të vëzhgimeve midis palëve; dëbimi e kishte privuar konstatimin e mundshëm të një shkelje nga të gjitha efektet e dobishme pasi kërkuari ishte dëbuar në një vend që nuk ishte palë në Konventë dhe ku rrezikonte t'i nënshetrohej trajtimit në kundërshtim me Konventën.

Për më tepër, ishte e nënkuptuar në nocionin e ushtrimit efektiv të së drejtës për kërkesë që gjatë procedurës në Strasburg, Gjykata duhet të vazhdonte të ishte në gjendje për të shqyrtuar kërkesën bazuar në procedurën normale të saj. Autoritetet tuniziane, megjithatë, kishin konfirmuar se përfaqësuesi i Z. Ben Khemais para Gjykatës nuk autorizohej për të vizituar klientin e tij në burg.

Për më tepër, Gjykata vuri në dukje se Qeveria Italiane, përpara së të dëbonte kërkuesin, nuk kishte kërkuar heqjen e masës së përkohshme të urdhëruar sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës dhe kishte proceduar me dëbimin e tij pa marrë garancinë diplomatike të cilave iu ishin referuar në vëzhgimet e tyre.

Për rrjedhojë, kërkuesi nuk kishte qenë në gjendje për të çuar më tej të gjitha argumentet në favor të mbrojtjes së tij dhe vendimi i Gjykatës ishte privuar nga të gjitha efektet e dobishme. Fakti se kërkuesi ishte larguar nga juridiksioni i Italisë përbënte një pengesë serioze për përmbushjen nga ana e Qeverisë italiane të detyrimeve sipas Konventës për të mbrojtur të drejtat e kërkuesit dhe rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur, të konstatuara nga Gjykata. Kështu, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 34.

### Në lidhje me nenin 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 10,000 euro në lidhje me dëmin jo material dhe 5,000 euro për kostot dhe shpenzimet.

### **3. Koment**

Një pjesë e madhe e praktikës gjyqësore të Gjykatës është e përkushtuar ndaj përsëritjes se parimi i shtetit të së drejtës - i cili qëndron në themel të Konventës - kërkon që Shtetet të respektojnë vendimet e gjykatave të tyre<sup>65</sup>. Ky rast tregon se Gjykata, po me kaq insistim, kërkon që parimi i shtetit të së drejtës të zbatohet ndërkombëtarisht. Neni 39 i Rregullores së Gjykatës është adoptuar në mënyrë që t'i mundësojë Gjykatës parandalimin e një dëmtimi serioz të pakthyeshëm ndaj kërkuesit, i cili është në pritje të shqyrtimit të çështjes së tij në themel para Gjykatës. Ky nen nuk zbatohet automatikisht dhe kërkuesit duhet të bëjnë një kërkesë të mirë argumentuar në mënyrë që të përfitojnë nga “urdhri sipas nenit 39 të Rregullores”. Praktika normale e Shteteve Anëtare të Konventës ishte respektimi i urdhrave të tillë, por që prej vendimit të Dhomës së Madhe në çështjen *Mamatkulov dhe Askarov k. Turqisë*<sup>66</sup> u bë e qartë se ekziston një detyrim ligjor sipas nenit 34 të Konventës për Shtetet që të veprojnë në përputhje me urdhrat sipas 39 të Rregullores. Në rastin konkret Italia nuk e bëri këtë. Akoma më i papranueshëm ishte fakti që kthimi i Ben Khemais në Tunizi kishte ndodhur në kuadër të një situatë shumë të ngjashme me atë

65 Shih p.sh. *Burdov k. Rusisë*, vendim i 15 janarit 2009, nr. 33509/04.

66 *Mamatkulov dhe Askarov k. Turqisë*, vendim [Dhoma e Madhe] i 4 shkurtit 2005, nr. 46827/99 dhe 46951/99.

që kishte ekzistuar në çështjen *Saadi v. Italisë*<sup>67</sup>. Në atë çështje, të dhënë nga Dhoma e Madhe vetëm katër muaj para kthimit të Z. Ben Khemais, Gjykata prerazi riafirmoi natyrën absolute të ndalimit të kthimit të të dyshuarve për veprimtari terroriste, kur ekziston rreziku real që ata t'i nënshtrohen torturës ose trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës. Gjykata i kushtoi vëmendje të veçantë faktit që Shteti nuk kishte kërkuar nga Gjykata që të tërhiqte nenin 39, për të cilin e dinte që ishte ende në fuqi para zbatimit të urdhrin të dëbimit. Për pasojë, Gjykata vendosi se ishte shkelur neni 34, i cili parashikonte të drejtën për ushtrimin e pacenuar të së drejtës për kërkesë individuale në Gjykatë.

67 *Saadi k. Italisë*, vendim [Dhoma e Madhe] i 28 shkurtit 2008, nr. 37201/06, i përfshirë në këtë kapitull. Gjithashtu, shih *Rrapo k. Shqipërisë*, vendim i 25 shtatorit 2012, nr. 58555/10, ku Gjykata vendosi vetëm shkelje e nenit 34.

*Transferimi i dy shtetasve irakenë, të ndaluar nga autoritetet britanike,  
tek autoritetet irakene shkelte Konventën*

## **VENDIMI NË ÇËSHTJEN AL-SAADON AND MUFDHI kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesa nr. 61498/08)

**2 mars 2010**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit, Z. Al-Saadoon dhe Z. Mufdhi, ishin shtetas irakenë të lindur në vitin 1952 dhe 1950. Ata ishin myslimanë sunitë nga Iraku jugor dhe ish-zyrtarë të lartë të partisë Ba'ath. Në kohën e dhënies së vendimit nga Gjykata, ata mba-heshin të ndaluar në burg, në afërsi të Bagdadit.

Pas pushtimit të Irakut nga ana forcave të armatosura të koalicionit ndërkombëtar, më 20 mars 2003, kërkuesit u arrestuan nga forcat britanike dhe u mbajtën të burgosur në qendrat e kontrolluara prej tyre, si të dyshuar, ndër të tjera, për organizim të veprimtarive të dhunshme kundër forcave të koalicionit. Në tetor të vitit 2004, Policia Ushtarake Mbretërore e Mbretërisë së Bashkuar, konkludoi se kërkuesit kishin qenë të përfshirë në vdekjen e dy ushtarëve britanikë, duke u bërë pritë e më pas duke i vrarë në jug të Irakut më 23 mars 2003.

Në dhjetor të vitit 2005, autoritetet britanike vendosën t'ia përcjellin çështjen gjykatave penale të Irakut. Në maj të vitit 2006, kërkuesit u paraqitën para Gjykatës Penale të Basrës nën akuzat për vrasje dhe krime lufte. Gjykata Penale në Basra lëshoi urdhër arresti dhe autorizoi vazhdimin e mbajtjes së tyre në burg nga forcat ushtarake britanike në Basra. Më pas, Gjykata Penale në Basra vendosi se akuzat kundër kërkuesve, përbënin krime lufte dhe gjykimi i tyre ishte kompetencë e Tribunalit të Lartë të Irakut ("TLI"). Rasti iu transferua TLI-së i cili, më 27 dhjetor 2007, u kërkoi zyrtarisht forcave britanike transferimin e kërkuesve. Kjo kërkesë u përsërit disa herë deri në maj të vitit 2008.

Më 12 qershor 2008, kërkuesit kërkuan rishqyrtim të çështjes në Angli, duke kundërshtuar, ndër të tjera, ligjshmërinë e transferimit të tyre. Rasti u gjykua nga Gjykata Rajonale Angleze e cila, më 19 dhjetor 2008, e deklaroi të ligjshëm transferimin e kundërshtuar. Gjykata vërejti se duke qenë se kërkuesit ishin mbajtur të burgosur në një strukturë ushtarake britanike, ata ishin brenda juridiksionit të Mbretërisë së Bashkuar, siç parashikohej nga neni 1 (detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut) i Konventës Evropiane të të Drejtave të

Njeriut. Megjithatë, gjykata vendosi se sipas së drejtës ndërkombëtare publike, Mbretëria e Bashkuar ishte e detyruar të dorëzonte kërkuesit përveç nëse kishte prova të qarta se Shteti pritës kishte për qëllim t'i keqtrajtonte në masën që përbënte krim kundër njerëzimit. Ajo nuk gjeti asnjë arsye thelbësore për të besuar se, nëse kërkuesit transferoheshin, ndaj tyre do zhvillohej një gjykim haptazi i padrejtë dhe se do të bëheshin objekt i torturave ose trajtimit çnjerëzor ose poshtërues. Edhe pse ekzistonte rreziku që kërkuesit të dënoheshin me vdekje pasi të dorëzoheshin tek autoritetet irakene, dënimi me vdekje në vetvete nuk ishte i ndaluar nga e drejta ndërkombëtare.

Kërkuesit apeluan në Gjykatën e Apelit por ajo u hodh poshtë më 30 dhjetor 2008. Gjykata e Apelit konstatoi se ekzistonte rreziku real që kërkuesit të ekzekutoheshin nëse transferoheshin. Megjithatë, ai arriti në përfundimin se Britania e Madhe nuk po ushtronte juridiksionin e saj duke qenë se kërkuesit mbaheshin të ndaluar në territorin e Irakut dhe sipas urdhrave të gjykatave irakene. Pra Konventa nuk zbatohet dhe Mbretëria e Bashkuar duhej të respektonte sovranitetin e Irakut dhe transferimin e kërkuesve.

Menjëherë pas këtij vendimi, kërkuesit iu drejtuan Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për urdhërimin e një mase të përkohshme, sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës, për të ndaluar autoritetet britanike të kryenin transferimin. Gjykata urdhëroi një masë të përkohshme më 30 dhjetor 2008. Një ditë më pas Qeveria Britanike informoi Gjykatën se, kryesisht për shkak se mandati i OKB-së, i cili autorizonte forcave britanike të kryenin arrestime, ndalime dhe burgime në Irak, përfundonte më 31 dhjetor 2008, në mesnatë, ata nuk mund të zbatonin masën e përkohshme dhe i kishin transferuar kërkuesit në kujdestarinë e Irakut po atë ditë, më herët.

Më 16 shkurt 2009, kërkuesit nuk u lejuan të apelonin në Dhomën e Lordëve.

Gjykimi i kërkuesve përpara TLI-së filloi në maj të vitit 2009 dhe përfundoi në shtator 2009. Ky tribunal vendosi rrëzimin e akuzave kundër tyre dhe lirimin e tyre të menjëhershëm. Pas apelimit të prokurorit, Gjykata e Kasacionit e Irakut e ktheu çështjen për hetim të mëtejshëm nga autoritetet irakene dhe për rigjykim. Kërkuesit vazhdonin të ishin të ndaluar në kohën e dhënies së vendimit nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesit u ankuan për transferimin e tyre tek autoritetet irakene. Ata u

mbështetën në nenin 2, nenin 3, nenin 6 të Konventës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 13. Ata gjithashtu u ankuan për faktin se ishin transferuar tek autoritetet irakene, pavarësisht urdhrit të Gjykatës sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës, duke shkelur kështu nenet 13 dhe 34.

### Në lidhje me juridiksionin

Më 30 korrik 2009, Gjykata mori vendim në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës në të cilën pretendohet se autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar kishin pasur kontroll të plotë dhe ekskluziv, së pari me anë të ushtrimit të forcës ushtarake dhe pastaj ligjërish, mbi objektet e paraburgimit në të cilat ishin mbajtur kërkuesit. Gjykata vërejti se kërkuesit kishin qenë brenda juridiksionit të Mbretërisë së Bashkuar deri në transferimin e tyre fizik tek autoritetet irakene më 31 dhjetor 2008.

### Në lidhje me nenin 3

Gjykata theksoi se 60 vjet më parë, kur u hartua Konventa, dënimi me vdekje nuk konsiderohej se shkelte standardet ndërkombëtare. Megjithatë, kishte pasur një evolucion të mëvonshëm drejt heqjes së plotë të këtij dënimi, ligjërish dhe në praktikë, në të gjitha Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës. Kështu u miratuan dy Protokolle të Konventës, Protokollin nr. 6, i cili hoqi dënimin me vdekje në kohë lufte dhe Protokollin nr. 13 i cili e hoqi atë në të gjitha rrethanat. Mbretëria e Bashkuar i kishte ratifikuar të dy. Kështu, neni 2 i Konventës kishte ndryshuar duke ndaluar dënimin me vdekje në të gjitha rrethanat. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se dënimi me vdekje, që përfshinte shkatërrimin e qëllimshëm dhe me paramendim të një qenie njerëzore nga ana e autoriteteve shtetërore, duke i shkaktuar dhimbje fizike dhe vuajtje intensive psikologjike si rezultat i dënjës se do ekzekutohej, mund të konsiderohej çnjerëzor dhe poshtëruar dhe, si i tillë, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës.

Gjykata pranoi gjetjet e gjykatave kombëtare, të cilat kishin vendosur pak para se të ndodhte transferimi, se kishte arsye serioze për të besuar se ekzistonte rreziku real që kërkuesit të dënoheshin me vdekje dhe të ekzekutoheshin. Më tej, ajo vërejti se autoritetet irakiane ende nuk kishte dhënë asnjë garanci që nuk do t'i ekzekutonin kërkuesit. Për më tepër, edhe pse ishte i pamundur parashikimi i rezultatit të hetimit dhe gjykimit të ri të urdhëruar nga gjykata irakene, kishte ende arsye serioze për të besuar se kërkuesit rrezikonin realisht të dënoheshin me vdekje, nëse gjykoreshin nga një gjykatë irakene.



Dënimi me vdekje kishte hyrë përsëri në fuqi në Irak në gusht të vitit 2004. Megjithatë, pa marrë ndonjë garanci nga autoritetet irakene, autoritetet britanike, në dhjetor 2005, kishin vendosur referimin e çështjes së kërkuesve gjykatave irakene dhe në maj 2006 kishte filluar procesi në Gjykatën Penale në Basra. Gjykata konsideroi se të paktën që nga kjo datë kërkuesit i ishin nënshtruar frikës për shkak të ekzekutimit, duke u shkakuar vuajtjeve të konsiderueshme mendore, të cilat kishin vazhduar dhe duhet të ishin intensifikuar që nga data kur ata u transferuan fizikisht tek autoritetet irakene.

Qeveria argumentoi se ata nuk kishin mundësi tjetër përveç se të respektonin sovranitetin e Irakut dhe të transferonin kërkuesit tek gjykatat e Irakut, kur iu kërkua, pasi ata ishin shtetas irakenë që mbaheshin të ndaluar në territorin e Irakut. Megjithatë, Gjykata nuk ishte e bindur se për të siguruar të drejtat e kërkuesve sipas Konventës duhej, në mënyrë të pashmangshme, të shkelej sovraniteti i Irakut. Nuk dukej se ishin bërë përpjekje reale për të negociuar me autoritetet e Irakut në mënyrë që të parandalohesh rreziku i dënimit me vdekje.

Për sa më sipër, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesin ishin trajtuar në mënyrë çnjerëzore dhe poshtëruese, në shkelje të nenit 3.

#### Në lidhje me nenin 6

Gjykata pranoi gjetjet e gjykatave kombëtare se, në datën e transferimit, nuk dihej nëse kërkuesit rrezikonin të gjykoheshin haptazi në mënyrë të padrejtë nga TLI. Tani që gjyqi kishte përfunduar, ishte e qartë se nuk kishte prova para Gjykatës që hidhnin dyshime mbi këtë vlerësim. Si përfundim Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 6.

#### Në lidhje me nenet 13 dhe 34

Gjykata nuk u bind se Qeveria kishte ndërmarrë ndonjë hap ose i kishte ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm, për të vepruar në pajtim me urdhrin e Gjykatës sipas nenit 39 për të mos transferuar kërkuesit tek autoritetet irakene. Mos respektimi i urdhrin të Gjykatës dhe transferimi i kërkuesve jashtë juridiksionit të Mbretërisë së Bashkuar i kishte ekspozuar ata ndaj rrezikut të rëndë dhe një dëmi të pariparueshëm dhe kishte zhveshur nga efektiviteti në mënyrë të pajustificueshme ankimin në Dhomën e Lordëve. Prandaj, Gjykata konstatoi shkelje të neneve 13 dhe 34 të Konventës.

## Në lidhje me nenin 41

Gjykata u shpreh se konstatimi i shkeljes ishte shpërblim i drejtë i mjaftueshëm për dëmin jo material që kishin pësuar kërkuesit dhe u akordoi atyre në total 40,000 euro për kostot dhe shpenzimet.

### **3. Koment**

Gjykata konstatoi në *Banković dhe të tjerët k. Belgjikës dhe 16 Shteteve të tjera Kontraktuese*<sup>68</sup> se nuk ka pasur ushtrim të juridiksionit, kur Palët Kontraktuese në Konventë bombarduan një stacion televiziv në Beograd gjatë operacioneve të NATO-s të vitit 1999. Megjithatë, ky rast riafirmon jurisprudencën e mëparshme të Gjykatës se juridiksioni për qëllimet e nenit 1 të KEDNJ-së lind kur një Shtet mban një person të ndaluar edhe pse ndalimi ndodh në territorin e një Shteti tjetër. Pasi përcaktohet juridiksioni, Shteti ka përgjegjësinë për garantimin e të drejtave të parashikuara në Konventë e individëve të prekur.

Gjykata diskutoi gjerësisht detyrimet e Mbretërisë së Bashkuar në bazë të nenit 2 (e drejta për jetën) dhe Protokolleve nr. 6 dhe nr. 13 (heqja e dënimit me vdekje), duke theksuar se ata duhet të interpretohen në mënyrë strikte. Pa e shpjeguar pse, por duke theksuar se nuk ishte e qartë nëse akuzat e reja ndaj kërkuesve mund të çonin në dënimin e tyre me vdekje, Gjykata vendosi që të vendosë për pretendimet sipas nenit 3 dhe të mos vendosë mbi pretendimet në bazë të nenit 2 ose të Protokolleve.

Në jurisprudencën e mëparshme Gjykata, ishte shprehur se vendosja e dënimit me vdekje, pas një gjykimi të padrejtë përbën shkelje të nenit 3<sup>69</sup>. Në rastin konkret, Gjykata konstatoi se Mbretëria e Bashkuar nuk kishte marrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar që kërkuesit nuk do t'i nënshtroheshin dënimit me vdekje duke cenuar kështu të drejtat e tyre sipas nenit 3 për shkak të frikës dhe ankthit më të cilën ata do të përballeshin. Ndalimi absolut sipas nenit 3 kishte përparësi krahasuar me marrëveshjen ndërkombëtare ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar dhe Irakut. Është e rëndësishme të theksohet se ky

68 *Bankovic dhe të tjerët k. Belgjikës dhe 16 Shteteve të tjera Kontraktuese*, [Dhomë e Madhe] vendim i 12 dhjetorit 2001, nr. 52207/99.

69 Shih Öcalan k. Turqisë, vendim [Dhoma e Madhe] i 5 majit 2005, nr. 46221/99, për sa i përket dënimit me vdekje të dhënë gjatë një gjykimi të pa drejtë nga një gjykatë pavarësia dhe paanësia e së cilës nuk ishin të sigurta. Shih gjithashtu *Bader dhe Kanbor k. Suedisë*, vendim i 8 nëntorit 2005, nr. 13284/04, i përfshirë në këtë kapitull, ku kërkuesi dënohej me vdekje in absentia.

vendim mund të interpretohet si një lexim i përditësuar i nenit 2 të Konventës në lidhje me dënimin me vdekje. Për këtë qëllim është me vlerë të citohet paragrafi 120 i vendimit të Gjykatës ku thuhet se *“është e qartë nga vendimi i Dhomës së Madhe në çështjen Oçalan se tashmë pranohej që neni 2 kishte ndryshuar duke hequr kështu përjashtimin që lejon dënimin me vdekje. Për më tepër, siç u tha më lart, qëndrimi kishte evoluar që atëherë. Të gjithë, përveç dy prej Shteteve Anëtare, tashmë e kanë nënshkruar Protokollin e nr. 13 dhe të gjithë, përveç tre prej Shteteve që e kanë nënshkruar, e kanë ratifikuar atë. Këto shifra, së bashku me praktikën e vazhdueshme të Shteteve në respektimin e ndalimit të dënimin me vdekje, janë tregues të rëndësishëm se neni 2 kishte ndryshuar në mënyrë të tillë që të ndalonte dënimin me vdekje në të gjitha rrethanat. Përkundrejt këtij sfondi, Gjykata nuk e konsideron formulimin e fjalisë së dytë të nenit 2 (1) si një pengesë për interpretimin e shprehjes “trajtimin çnjerëzor ose poshtëruës” në nenin 3 se përfshinte edhe dënimin me vdekje ( krahaso me Soering, cituar më lart, para. 102-04) “.*

Gjithashtu, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 34, si pasojë e dështimit për të respektuar urdhrin e Gjykatës sipas nenit 39 të Rregullores për mos transferimin e kërkuessve tek autoritetet irakene. Që në çështjen *Mamatkulov dhe Askarov k. Turqisë*<sup>70</sup>, Gjykata e ka bërë të qartë se Shtetet kanë detyrimin për të respektuar urdhrin sipas nenit 39 të Rregullores. Vetëm Gjykata Evropiane mund të tërheqë një urdhër sipas nenit 39, pasi ishte dhënë. Gjyqtari britanik dha një mendim paralel në lidhje me konstatimin e një shkelje të nenit 3, por votoi kundra për sa i përket konstatimeve në bazë të nenit 34.

70 *Mamatkulov dhe Askarov k. Turqisë*, vendim [Dhoma e Madhe] i 4 shkurtit 2005, nr. 46827/99 dhe 46951/99.

*Kujdesi i pamjaftueshëm dhe ndalim i paligjshëm i një azilkërkuessi minoren i pashoqëruar*

## **VENDIMI NË ÇËSHTJEN RAHIMI kundër GREQISË**

(Kërkesa nr. 8687/08)

**5 prill 2011**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuessi, Eivas Rahimi, i lindur në vitin 1992, ishte 15 vjeç kur mbërriti në Greqi si një i mitur i pashoqëruar. Ai ishte larguar nga Afganistani në vitin 2007, pas vdekjes së prindërve të tij, për shkak të konfliktit të armatosur. Sipas kërkuessit, jeta e tij ishte në rrezik, pasi ishte i pambrojtur për shkak të moshës së tij të re, ishte jetim dhe shteti afgan nuk mund të ofronte asnjë mbrojtje.

Pas mbërriti në ishullin e Lesbos, ai u arrestua dhe u dërgua në një kamp për refugjatët. Atje qëndroi nga 19-21 korriku 2007, në pritje të një urdhri për dëbimin e tij. Ndërkohë që mbahej i ndaluar, ai nuk u informua mbi mundësinë për të kërkuar azil apo për të drejtat e tij të tjera ligjore në një gjuhë që ai mund ta kuptonte. Ai mbahej së bashku persona të tjerë madhorë dhe në kushte jo higjienike.

Më 20 korrik u lëshua një urdhër dëbimi për kërkuessin, ku përmendej fakti se do të shoqërohej nga kushëriri i tij, N.M. Kërkuessit nuk iu ofrua asnjë ndihmë nga autoritetet për lirin e tij. Atij nuk iu caktua kujdestar ligjor dhe jetonte në rrugët e Athinës, derisa mori ndihmë nga një OJQ lokale.

Në shtator 2007 autoritetet refuzuan kërkesën e tij për azil politik ndërkohë që kërkesa e tij në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut ishte ende në pritje për t'u shqyrtuar.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Duke u bazuar në nenet 3 dhe 13, kërkuessi u ankua për mungesën e mbështetjes së duhur për statusin e tij si i mitur i pashoqëruar. Gjithashtu, ai u ankua në lidhje me kushtet në qendrën e ndalimit. Më tej, në bazë të nenit 5(1), (2) dhe (4), ai pretendoi se gjendja e tij si rezident i paligjshëm i mitur ishte shpërfillur vazhdimisht dhe ai nuk ishte informuar për arsyet e arrestimit apo të mjeteve ankimore që kishte në dispozicion.

## Në lidhje me nenet 3 dhe 13

### *Nëse kërkuesi ishte i shoqëruar*

Pyetja nëse Eivas ishte i shoqëruar, për të cilët palët nuk pajtoheshin, ishte vendimtare për sa i përket detyrimeve që Shteti kishte ndaj tij. Duke i bazuar konstatimet në regjistrimin e kërkesës për azil politik dhe raportit të shkruar nga një OJQ lokale (Arsis), Gjykata vlerësoi se që prej 27 korrikut 2007 kërkuesi nuk kishte qenë i shoqëruar nga një i afërm i ngushtë.

Në periudhën nga 19 deri 27 korrik 2007, autoritetet, në bazë të një procedure të paqartë, i kishin caktuar kërkuesit një person të rritur për ta shoqëruar, me inicialet N.M. Gjykata vuri në dukje impaktin e rëndësishëm që kishte, *në rrethanat personale të kërkuesit*, vendimi i autoriteteve për t'i caktuar një person të rritur si kujdestarin e tij dhe që do e *përfaqësonte para autoriteteve*. Dokumentet zyrtare nuk përmbanin informacione që të tregonin për një lidhje familjare ndërmjet kërkuesit dhe N.M.

Për këto arsye, Gjykata konstatoi në mënyrë të qartë se kërkuesi ishte një i mitur i pashoqëruar.

### *Shterimi i mjeteve të brendshme ligjore*

Në broshurën informuese që autoritetet i kishin dhënë, ku përshkruheshin disa nga mjetet ligjore në dispozicion, përmendej mundësia për të bërë një ankesë tek shefi i policisë, por nuk jepeshin detaje rreth kësaj procedure. Gjykata vuri në dukje se i mituri nuk kishte pasur një përfaqësues ligjor gjatë ndalimit të tij. Përveç kësaj, broshura informuese ishte e shkruar në arabisht, ndërkohë që gjuha amtare e kërkuesit ishte Farsi. Për këtë arsye, Gjykata nuk mund ta konsideronte broshurën informuese në lidhje me mjetet ligjore në dispozicion të kuptueshme.

Më tej, Gjykata vlerësoi nëse shefi i policisë ishte një autoritet i cili plotësonte kërkesat e paanshmërisë dhe objektivitetit, të nevojshme për ta bërë një mjet ligjor efektiv. Sa i përket legjislacionit në fuqi, ai nuk i njihte gjykatave të drejtën për të shqyrtuar kushtet e jetesës në qendrat e ndalimit për të huajt ilegalë dhe të urdhëronte lirimin e tyre mbi këtë bazë. Prandaj, Gjykata hodhi poshtë kundërshtimin e Qeverisë për mos-shterimin e mjeteve të brendshme ligjore.

### *Kushtet e ndalimit në Qendrën Pagani*

Gjykata vuri në dukje se në raportet e disa organizatave të mirë-respektuara ndërkombëtare tregoheshin kushtet e tmerrshme në Qendrën Pagani, e cila përbëhej nga pesë magazina të mëdha, ku mbaheshin shtatëqind e njëzet emigrantë ndërkohë që kishte një kapacitet strehimi për treqind njerëz. Qendra nuk kishte ambiente të mjaftueshme për të miturit. Në lidhje me kushtet e jetesës të qendrës, raportoheshin kushte të tmerrshme. Mbi njëqind persona kishin dy tualete të përbashkëta dhe të ndaluarit ndanin dyshekët ose flinin në dysheme. Gjykata vërejti në veçanti tualetet e përmytura, ventilimin e dobët dhe një mjedis të përgjithshëm jo të shëndetshëm.

Gjykata konstatoi se kushtet e ndalimit në Qendrën Pagani, përbënin trajtim poshtëruës. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës.

Për më tepër, duke pasur parasysh konsideratat e mësipërme në lidhje me çështjen e shterimit të mjeteve të brendshme ligjore, Gjykata arriti në përfundimin se shteti kishte dështuar gjithashtu të përmbushte edhe detyrimet e tij sipas nenit 13 të Konventës.

### *Periudha pas lirimimit të kërkuesit*

Gjykata vërejti se sjellja e autoriteteve, të cilët ishin treguar indiferentë për mirëqenien e kërkuesit, i kishte shkaktuar atij një ankth dhe shqetësim të thellë, deri në momentin që i kishte ardhur në ndihmë OJQ-ja lokale. Duke qenë se kërkuesi bënte pjesë në kategorinë më vulnerabël të shoqërisë, si i mitur, autoritetet duhet të merrnin masat e duhura për ta mbrojtur dhe për t'u kujdesur, veçanërisht duke i caktuar një kujdestar. Gjykata iu referua vendimit *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*<sup>71</sup>, në të cilën kishte vënë në pah “gjendjen e veçantë të pasigurisë dhe cenueshmërisë të azilkërkuesve që jetonin në Greqi” dhe i gjeti autoritetet përgjegjëse “për shkak të mosveprimit të tyre”. Pragu i ashpërsisë që kërkohet të arrihet sipas nenin 3, në rastin kërkuesit ishte arritur dhe Gjykata u shpreh se Shteti nuk i kishte vepruar në pajtim me detyrimet e tij sipas nenit 3.

Duke pasur parasysh konstatimet e saj në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme ligjore, Gjykata u shpreh se Shteti kishte dështuar gjithashtu të plotësonte edhe detyrimet e tij sipas nenit 13.

71 *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*, vendim [Dhoma e Madhe] i 21 janarit 2011, nr. 30696/09, i përfshirë gjithashtu në këtë kapitull.

### Në lidhje me nenin 5(1)

Gjykata konstatoi shkelje të së drejtës për liri dhe siguri sipas nenit 5, pasi ndalimi i kërkuesit ishte rezultat i zbatimit në mënyrë automatike të legjislacionit kombëtar, pa marrë parasysh rrethanat e veçanta të kërkuesit si një i mitur i pashoqëruar. Autoritetet nuk kanë marrë parasysh interesin më të mirë të kërkuesit, si i mitur, dhe as kanë shqyrtuar mundësinë e zëvendësimit të masës së ndalimit me një masë më pak drastike.

Gjykata dyshonte nëse autoritetet kishin vepruar në mirëbesim në vendosjen e masës së ndalimit, prandaj ndalimi i kërkuesit nuk ka qenë “i ligjshëm” sipas kuptimit të nenit 5 (1) (f).

### Në lidhje me nenin 5(4)

Kërkuesi e kishte pasur të pamundur në praktikë për të kontaktuar një avokat. Duke qenë se broshura informuese ishte në një gjuhë të pakuptueshme për të dhe nuk kishte asnjë kujdestar që mund ta përfaqësonte ligjërisht, Gjykata vëren se kërkuesi nuk kishte pasur mundësi të shfrytëzonte mjetet ligjore në dispozicion.

Rrjedhimisht, ka pasur një shkelje të nenit 5(4).

### Në lidhje me nenin 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 15,000 euro në lidhje me dëmin jo material që ai kishte pësuar dhe 1,000 euro për kostot dhe shpenzimet.

## **3. Koment**

Ky rast ngre një numër problemesh dhe tregon se sa komplekse dhe problematike është gjendja e azilkërkuesve, në përgjithësi, kur ata arrijnë në brigjet greke. Megjithatë, rëndësia e veçantë e këtij rasti qëndron në faktin se kërkuesi ishte një fëmijë i pashoqëruar dhe pa të afërm në gjendje për të ndihmuar. Këtij fakti iu kushtua një vëmendje e veçantë nga Gjykata në dhënien e vendimit<sup>72</sup>.

72 Vëmendje e veçantë i është kushtuar statusit të fëmijëve të pashoqëruar edhe nga Rregullorja e Dublinit III - shih nenin 6 të «Rregullores (BE) nr. 604/2013 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 qershor 2013, i cili përcakton kritereve dhe mekanizmeve për përcaktimin e Shtetit Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkese për mbrojtje ndërkombëtare të paraqitur në një prej Shteteve Anëtare nga një shtetas i vendeve të treta ose një person pa shtetësi (e ndryshuar) », Fletorja

Kjo vëmendje, për herë të parë, u reflektua në vlerësimin e statusit të kërkuesit. Gjykata ishte shumë e kujdesshme në vlerësimin se, masat e ndërmarra nga autoritetet greke për t'i caktuar një kujdestar që të përfaqësonte kërkuesin për tetë ditë, në korrik të vitit 2007, kishin qenë të pamjaftueshme duke çuar kështu në dhënien e statusit kërkuesit si një fëmijë i pashoqëruar. Në këtë mënyrë, Gjykata theksoi rëndësinë e veçantë që kanë procedurat e kujdestarisë në rastet e azilkërkuesve të mitur të pashoqëruar. Rregullsia e këtyre procedurave mund të përcaktojë detyrimet e ardhshme të organeve të brendshme shtetërore, në lidhje me azilkërkuesit. Nëse procedura nuk ka qenë e rregullt dhe nuk është marrë në konsideratë interesi më i lartë i fëmijës, ndaj të miturit të pashoqëruar, zbatohen një sërë të drejtash të veçanta.

Kjo gjetje paraprake i hapi rrugën analizës së mëtejshme të Gjykatës për sa i përket: kushtet të ndalimit të kërkuesit në qendrën e ndalimit në Pagani <sup>73</sup> duke i gjetur ato poshtëruese dhe jo të përshtatshme për fëmijët. Në vazhdim të vendimit të saj në çështjen *M.S.S. k. Greqisë dhe Belgjikës*, Gjykata deklaroi se është një argument që merr një rëndësi të veçantë, në rastin e një të mituri, moskujdesi i autoriteteve për kërkuesin pasi u lirua, duke u konsideruar kështu trajtim poshtërues.

Gjithashtu me rëndësi të veçantë janë konstatimet e Gjykatës në lidhje me nenin 5(1) dhe (4) të Konventës. Gjykata vërejti se fakti që kërkuesi ishte një i mitur nuk ishte marrë parasysh nga autoritetet në zbatimin në mënyrë automatike të legjislacionit kombëtar në lidhje me masën e ndalimit si dhe mundësinë efektive për të përdorur mjetet ligjore kundër këtij ndalimi. Këto përfundime kërkonin vëmendjen e veçantë autoriteteve kombëtare në marrjen e masave të sigurisë ndaj fëmijëve të pashoqëruar që kërkojnë azil në Evropë.

-----  
Zyrtare e Bashkimit Evropian L (180/31).

73 Për konstatime të ngjashme mbi kushtet në qendrën e ndalimit Pagani shih gjithashtu *Mahmundi dhe të tjerë k. Greqisë*, vendim i datës 31 korrik 2012, nr. 14902/10, dhe *Ahmade k. Greqisë*, vendim i datës 25 shtator 2012, nr. 50520/09.



*Dëbimi i dy shtetasve somalezë në Mogadisho përbënte shkelje të nenit 3*

**VENDIMI NË ÇËSHTJEN SUFI AND ELMI  
kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesat nr. 8319/07 dhe 11449/07)

**28 qershor 2011**

**1. Faktet kryesore**

Çështja kishte të bënte me një kërkesë nga dy shtetas somalezë, të cilët nëse ktheheshin në Mogadisho, rrezikonin të vriteshin apo t'i nënshtroheshin keqtrajtimit.

Kërkuesit, Abdisamad Adow Sufi dhe Abdiaziz Ibrahim Elmi, ishin shtetas somalezë të lindur më 1987 dhe 1969 respektivisht.

Kërkuesi i parë, Z. Sufi, kishte hyrë në Mbretërinë e Bashkuar në mënyrë klandestine më 30 shtator 2003. Më 30 tetor 2003 ai kërkoi azil me pretendimin se i përkiste grupimit të Reer-Hamar të klanit të pakicës Ahansi dhe se ishte viktimë e persekutimit nga forcat e armatosura Hawiye, të cilët i kishin vrarë të atin dhe motrën dhe e kishin plagosur dhe atë rëndë.

Në prill të vitit 2005 kërkesa e tij për azil u refuzua dhe më vonë, në maj të vitit 2005, ankesa e tij kundër vendimit të refuzimit u rrëzua me argumentin se, ndër të tjera, rrëfimi i tij nuk ishte i besueshëm.

Kërkuesi i dytë, Z. Elmi, ka lindur në Hargeisa, kryeqyteti i shtetit të vetësh-pallur të Somaliland. Ai ishte anëtar klanit Isaaq, që përbënte shumicën. Ai iu bashkua babait e tij, një oficer i lartë në ushtri gjatë regjimit Barré, në Mbretërinë e Bashkuar më 18 tetor 1988.

Pas vdekjes së babait të tij, më 26 prill 1989, Z. Elmi paraqiti një kërkesë për azil, duke përdorur si arsye pozicionin e të atit në ushtrinë somaleze. Më 31 tetor 1989 ai u njoh si refugjat dhe më vonë iu dha leje për të qëndruar deri në vitin 1993. Më 7 janar 1994 iu dha leje qëndrimi pa afat në Mbretërinë e Bashkuar.

Pas kryerjes së një numri veprash të rënda penale - duke përfshirë vjedhje e kanosje për jetën në rastin e Z. Sufi dhe grabitje dhe furnizimin me drogë të kategorisë A (kokainë dhe heroinë) në rastin e Z. Elmi - ndaj të dy kërkuesve u lëshuan urdhrat e dëbimit. Ata apeluan pa sukses.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u bazuar në nenet 2 dhe 3 të Konventës, kërkuesit u ankuan se kthimi i tyre në Somali do të vinte në rrezik real jetën e tyre ose do t'i ekspozonte ndaj rrezikut të keqtrajtimit. Gjithashtu, ata pretenduan se kthimi ishte një ndërhyrje disproporcionale në të drejtat e tyre sipas nenit 8 të Konventës.

Kërkuesit iu drejtuan Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut më 21 shkurt 2007 dhe 14 mars 2007, respektivisht.

Sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut urdhëroi vendosjen e masave të përkohshme në favor të të dy kërkuesve, për të parandaluar kthimin e tyre në Mogadisho deri sa të përfundonte shqyrtimi i kërkesave të tyre para Gjykatës.

### Në lidhje me nenin 3

Gjykata vendosi të shqyrtonte pretendimet e kërkuesve sipas neneve 2 dhe 8 në kontekstin e shqyrtimit të pretendimit lidhur me nenin 3.

Gjykata përsëriti se ndalimi i torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese ishte absolut, pavarësisht nga sjellja e viktimave. Kështu sjellja e kërkuesve, pavarësisht se ishte e padëshirueshme apo e rrezikshme, nuk merrej në konsideratë.

Në shqyrtimin e një rasti dëbimi, Gjykata vërejti se duheshin analizuar të gjitha rrethanat për të përcaktuar nëse ekzistonin arsye serioze për të besuar se kërkuesi do të përballej me një rrezik real të trajtimit në kundërshtim me nenin 3, në rast se dëbohej. Kthimi i kërkuesit, pavarësisht pasjes dijeni lidhur me këtë rrezik, ishte padyshim në shkelje të nenit 3. Për këtë qëllim, Gjykata specifikoi se jo çdo situatë e dhunës së përgjithshme çon në një rrezik të tillë. Në fakt, situata e përgjithshme e dhunës do të ishte e një intensiteti të mjaftueshëm për të krijuar një rrezik të tillë vetëm “në rastet më ekstreme”.

Sipas konstatimeve të Tribunalit të Imigracionit dhe Azilit të Mbretërisë së Bashkuar nuk kishte mos-dakordësi për sa i përket faktit se, që nga fundi i vitit 2008, Mogadisho nuk ishte një vend i sigurt për të jetuar për shumicën e qytetarëve të saj. Për më tepër, sipas disa raporteve lidhur me këtë vend, gjendja në Mogadisho ishte përkeqësuar në vitin 2010 dhe 2011, duke rezultuar në bombardimet dhe ofensiva ushtarake pa dallim dhe dhuna ishte përhapur kudo

dhe ishte e paparashikueshme. Kjo kishte shkaktuar mijëra viktima civile dhe zhvendosjen e qindra mijëra personave nga qyteti.

Rrjedhimisht Gjykata u shpreh se niveli i dhunës në Mogadisho ishte i një intensiteti të mjaftueshëm për të çuar në një rrezik real të trajtimit në shkelje të nenit 3 për të gjithë ata që jetonin në kryeqytet. Nuk përjashtohej mundësia që një individ me lidhjet e duhura, të mund të merrte mbrojtje në Mogadisho, por vetëm lidhjet në nivele të larta mund ta siguronin këtë mbrojtje dhe dikush i cili nuk kishte qenë në Somali prej disa kohësh e kishte të pamundur të kishte lidhje të tilla. Prandaj dhuna ishte e një niveli të tillë intensiteti që çdokush që jetonte në Mogadisho, me përjashtim të atyre që kishin lidhje shumë të mira me “aktorë” të fuqishëm, do të ishte në rrezik real të trajtimit në kundërshtim me nenin 3.

Megjithatë, neni 3 nuk pengonte Shtetet Kontraktuese të mbështeteshin në alternativën e zhvendosjes së brendshme, sipas së cilës personi mund të udhëtonte, të pranohej dhe të vendosej në një zonë tjetër të vendit, ku ai kishte lidhje të ngushta familjare, pa u ekspozuar ndaj një rreziku real të trajtimit të ndaluar sipas këtij neni. Gjykata pranoi mundësinë që një i kthyer të udhëtonte nga Aeroporti Ndërkombëtar i Mogadisho drejt një pjese tjetër të Somalisë jugore dhe qendrore e cila ishte e sigurt. Megjithatë, një i kthyer, i cili nuk kishte jetuar prej shumë kohësh në Somali, do ishte i ekspozuar ndaj një rreziku real keqtrajtimit nëse zona ku ai qëndronte - ose ku mund t'i nevojitej të udhëtonte - kontrollohej nga al-Shabaab, një prej fraksioneve ndërluftuese, pasi ai nuk do të njihnte rregullat strikte islame të vendosura atje duke u bërë kështu subjekt i mundshëm i ndëshkimeve të tilla si rrahjet, rrahjet me kamxhik, goditjet me gurë dhe ndëshkimet trupore.

Gjykata e vlerësoi logjikisht të mundshme, që një i kthyer, i cili nuk kishte lidhje të ngushta familjare, apo nuk mund të udhëtonte në mënyrë të sigurt në një zonë ku ai i kishte lidhje të tilla, të kërkonte strehim në një kamp për Personat e Zhvendosur Brenda vendit (PZHB) ose për refugjatët. Prandaj, Gjykatës iu desh të marrë parasysh kushtet në këto dy kampe. Kushtet në qendrat kryesore - Korridori Afgoooye në Somali dhe kampet Dadaab në Kenia - ishin tepër të dëshpërueshme aq sa arrinin pragun e nenit 3. Furnizimi me ushqim dhe ujë ishte shumë i kufizuar në Korridorin Afgoooye. Në kampet Dadaab, edhe pse ofrohej ndihmë humanitare, për shkak të mbipopullimit ekstrem, ambientet e strehimit, furnizimi me ujë dhe kushtet sanitare ishte në nivele minimale. Prandaj çdo i kthyer të detyruar të kërkonte strehim në këto kampe, rrezikonte realisht të ekspozohej ndaj trajtimit në kundërshtim me nenin 3.

Në lidhje me rrethanat personale të kërkuesve, Gjykata konstatoi se nëse Z. Sufi do të qëndronte në Mogadisho, ai do të përballej me rrezikun real të keqtrajtim-it në kundërshtim me nenin 3. Më tej, në qoftë se atij do t'i jepej mundësia për të jetuar diku tjetër brenda vendit, më shumë gjasa ai të zgjidhte Qoryoley, zona e vetme ku ai kishte lidhje të ngushta familjare dhe ku dhuna e përgjithshme ishte në një intensitet më të vogël, por gjithsesi nën kontrollin e al-Shabaab. Në këtë rast, Z. Sufi rrezikonte t'i cenoheshin të drejtat e njeriut.

Gjykata, në kundërshtim me sugjerimin e Qeverisë, pranoi se Z. Sufi nuk do të ishte i sigurt nëse “*sillej sipas rregullave*”. Duke pasur parasysh se Z. Sufi kishte mbërritur në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2003, kur ishte vetëm gjashtëmbëdhjetë vjeç, Gjykata theksoi se rreziku ishte edhe më i lartë për somalezët që kishin jetuar jashtë vendit për një kohë të gjatë, duke e bërë të pamundur që ata ta fshinin këtë fakt. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi se kishte shumë gjasa që kërkuesi të përfundonte në një kamp për refugjatët ose PZHB, ku kushtet ishin mjaftueshëm të tmerrshme për të arritur pragun e nevojshëm të nenit 3.

Sa i përket kërkuesit të dytë, Gjykata u shpreh se Z. Elmi rrezikonte realisht të keqtrajtohej nëse do të qëndronte në qytetin Mogadisho. Edhe pse ishte anëtar i klanit Isaaq, i cili përbënte shumicën, Gjykata nuk e konsideroi këtë fakt si dëshmi të lidhjeve mjaft të fuqishme që t'i garantonin atij mbrojtje në Mogadisho. Duke mos pasur asnjë dëshmi të lidhjeve të ngushta familjare askund në Somalinë jugore apo qendrore dhe duke pasur parasysh se kishte shkuar në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 1998, kur ishte vetëm nëntëmbëdhjetë vjeç e nuk kishte jetuar nën regjimin represiv të Al-Shabaab, Gjykata u shpreh se Z. Elmi me shumë gjasa do të kërkonte strehim në kampin e refugjatëve ose PZHB, ku rrezikonte të keqtrajtohej në kundërshtim me nenin 3. Për më tepër, edhe pse Z. Elmi kishte lindur në Hargeisa, Gjykata konstatoi se, fakti që ndaj tij ishte lëshuar urdhër kthimi për në Mogadisho, binte në kundërshtim me pohimin e Qeverisë se ai do të pranohej në Somaliland.

Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se kthimi kërkuesve në Mogadisho do të shkelte nenin 3 të Konventës.

#### Në lidhje me nenin 41

Gjykata vendosi se Mbretëria e Bashkuar do t'i paguante Z. Sufi dhe Z. Elmi 14,500 euro dhe 7,500 euro, respektivisht, për kosto dhe shpenzime. Kërkuesit nuk parashtruan pretendime për dëme materiale dhe jo materiale.

### 3. Koment

Ky vendim ka një rëndësie të veçantë, kryesisht për dy arsye. Së pari, ndërsa në çështjen *N.A. k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>74</sup> Gjykata pranoi që një azilkërkues mund të mos kthehej në vendin tij, nëse gjendja e përgjithshme e dhunës dhe mungesës së rendit do e ekspozonin atë ndaj rrezikut të trajtimit në kundërshtim me nenin 3, në vendimin e çështjes *Sufi dhe Elmi*, Gjykata pranoi se kjo ishte në fakt situata në Somali. Vendimi në çështjen *Sufi dhe Elmi* konsiderohet si rasti kryesor që lidhet me rrezikun e përgjithshëm të keqtrajtimit.

Për të arritur në këtë përfundim, Gjykata shqyrtoi në mënyrë të kujdeshme situatën në Somali. Gjykata vlerësoi besueshmërinë e burimeve të ndryshme të informacionit për të kuptuar situatën në Somali. Arsyeja e dytë se pse ky vendim është i një rëndësie të veçantë, qëndron në vendosjen e kritereve në lidhje me burimet e informacionit mbi gjendjen në vendin e destinacionit. Në vlerësimin e burimeve të informacionit, Gjykata u shpreh se duhet të merren parasysh në veçanti pavarësia, besueshmëria dhe objektiviteti i tyre. Gjatë vlerësimit të raporteve mbi një vend, Gjykata sugjeroi që pesha që ato do të merrnin të varej nga kompetenca dhe reputacioni i autorit, serioziteti i hetimeve mbi bazën e të cilave ishin përpiluar, detajet dhe konsistenca e konkluzioneve të tyre dhe vërtetimi i tyre nga burime të tjera. Gjithashtu, Gjykata deklaroi se rëndësi i duhej dhënë edhe pranisë dhe kapacitetit raportues të autorit të raportit në atë vend. Gjykata e pranoi se këto konsiderata zbatohen veçanërisht për organizatat ndërkombëtare, të tilla si agjencitë e Kombeve të Bashkuara.

Në bazë të kësaj qasjeje metodologjike, Gjykata arriti në përfundimin se situata në Somali, siç tregohet nga burimet e informacionit të marra në konsideratë nga Gjykata, ishte aq e rënduar në atë kohë sa çdo kthim në atë vend do të përbënte shkelje të nenit 3 të Konventës. Megjithatë ajo e bëri të qartë se një konstatim i tillë ishte i një natyre përjashtimore dhe zbatohet vetëm kur situata në vendin e destinacionit ishte jashtëzakonisht e keqe duke e bërë shumë të vështirë çdo alternativë tjetër, si p.sh zhvendosjen e brendshme.

74 *N.A. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 17 korrikut 2008, nr. 25904/07, i përfshirë gjithashtu në këtë kapitull.

*Rrëmbimi dhe transferimi i paligjshëm i një azilkërkuesi uzbek, ndaj të cilit ishte nxjerrë një urdhër ekstradimi, nga Rusia në Taxhikistan ishte në shkelje të Konventës*

## **VENDIMI NË ÇËSHTJEN ABDULKHAKOV kundër RUSISË**

(Kërkesa nr. 14743/11)

**2 tetor 2012**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Z. Murodzhon Adikhamzhonovich Abdulkhakov, ishte një shtetas Uzbek i lindur në vitin 1979 dhe praktikues i fesë myslimane. Në maj të vitit 2009, pas djegies së një stacioni policor në Khanabad, ai u thirr për t'u pyetur në stacionin e policisë lokale. Ai u rrah në mënyrë që të tregonte përfshirjen e tij në aktivitete ekstremiste në atë zonë. Pasi të afërmit e tij u kishin dhënë ryshfet policisë, kërkuesi u lirua. Megjithatë, ai u gjobit për pjesëmarrje në tubime të paligjshme fetare dhe kryerjen e ritualit të lutjes jashtë xhamisë.

Më 24 gusht 2009 Z. Abdulkhakov u nis për në Kazakistan dhe më 4 nëntor 2009 për në Federatën Ruse. Plani i tij ishte për të udhëtuar më tej në Ukrainë dhe të aplikonte atje për marrjen e statusit të refugjatit. Megjithatë, më 9 dhjetor 2009, menjëherë pas mbërritjes në Moskë, kërkuesi u arrestua dhe u mbajt i ndaluar pasi një gjykatë në Uzbekistan kishte lëshuar një urdhër arresti në bazë të pjesëmarrjes së tij në një organizatë ekstremiste e natyrës fetare, separatiste ose fundamentaliste.

Paralelisht, në 22 dhjetor 2009, Z. Abdulkhakov aplikoi për marrjen e statusit të refugjatit në Federatën Ruse. Ai pretendoi se ishte persekutuar në Uzbekistan për bindjet e tij fetare dhe kishte frikë se nëse kthehej do të torturohej me qëllim pranimin e autorësisë për kryerjen e veprave penale të cilat ai nuk i kishte kryer. Megjithatë, kërkesa e tij u refuzua me arsyetimin se autoritetet në Uzbekistan kishin ushtruar një kontroll legjitim të imtësishëm në lidhje me jetën fetare të popullsisë së saj vetëm me qëllimin për të kufizuar ndikimin e organizatave radikale islamike.

Gjatë periudhës 2009-2011, ndalimi i kërkuesit u zgjat katër herë radhazi për arsye se procedurat e ekstradimit ishin ende në pritje për t'u zbatuar. Më 9 qershor 2011, Z. Abdulkhakov më në fund u lirua, pasi u konstatua se koha maksimale e ndalimit e lejuar nga ligji, kishte përfunduar.

Më 16 qershor 2011 kërkuesi kërkoi për azil të përkohshëm bazuar në pretendimin se rrezikonte të keqtrajtohej dhe persekutohej për bindjet e tij fetare nëse kthehej në vendin e tij. Kërkesa e tij u refuzua në fillim, por shërbimi rus i emigracionit e ktheu për rishqyrtim. Procedurat për dhënien e përkohshme të azilit ishte ende në pritje për t'u shqyrtuar në kohën e daljes së vendimit të Gjykatës Evropiane.

Më 14 mars të vitit 2011, pavarësisht se procedurat për dhënien e përkohshme të azilit ishin ende në pritje për t'u shqyrtuar, Gjykata e Lartë Ruse la në fuqi urdhrin e autoriteteve të lëshuar më 14 maj 2010 për ekstradimin e Z. Abdulkhakov në Uzbekistan. Gjykata Supreme vërejtë se garancitë diplomatike të dhëna nga autoritetet uzbeke ishin të mjaftueshme për t'i siguruar kërkuesit mbrojtjen adekuate kundër çdo keqtrajtimit të mundshëm nëse kthehej në vendin e tij.

Megjithatë, për shkak të urdhrin për vendosjen e masës së përkohshme, të lëshuar nga Gjykata Evropiane në bazë të nenit 39 të Rregullores së Gjykatës, urdhri i ekstradimit nuk u zbatua dhe si pasojë Z. Abdulkhakov nuk mund të ekstradohej në Uzbekistan deri në një njoftim të mëtejshëm.

Më 23 gusht 2011, kërkuesi, së bashku me dy persona të tjerë, u rrëmbye në Moskë nga një grup meshkujsh të veshur me rroba civile. A u fut forcërisht në një furgon, një qese e zezë plastike iu vu në kokë dhe u dërgua në aeroport nga ku u nis për në Taxhikistan duke anashkuar check-in, kontrollin kufitar dhe të sigurisë. Pasi arriti atje, Z. Abdulkhakov iu dorëzua policisë së Taxhikistanit dhe u mbajt i ndaluar në funksion të ekstradimit të tij në Uzbekistan. Ai u mbajt i ndaluar për tre muaj dhe pasi u lirua, ai më pas u fsheh.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkesa u dorëzua në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut më 6 mars 2011.

Kërkuesi pretendoi se, në qoftë se kthehej në Uzbekistan, rrezikonte seriozisht t'i nënshtrohej torturës, dhunës ose trajtimit çnjerëzor ose poshtërues, do të ekspozohej ndaj ndjekjes për shkak të besimit fetar, ndalimi i tij në pritje të ekstradimit kishte qenë i paligjshëm dhe nuk kishte pasur një shqyrtim gjyqësor të ligjshmërisë së ndalimit të tij, në shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtërues), nenit 5 (e drejta për liri dhe siguri), nenit 13 (e drejta për ankim efektiv) dhe neni 34 (e drejta për kërkesë individuale) të Konventës.

### Mbi përcaktimin e fakteve

Duke pasur parasysh se palët nuk u pajtuan në lidhje me rrethanat e largimit të Z. Abdulkhakov për në Taxhikistan, Gjykata vazhdoi me përcaktimin e fakteve të kësaj çështjeje. Nga informacioni i dhënë, Gjykata nuk mund të mos pranonte pretendimin e kërkuesit se autoritetet ruse ishin implikuar në rrëmbimin e tij, si të besueshme. Asnjë shpjegim i mundshëm nuk ishte dhënë nga Qeveria e Ruisë në lidhje me faktin sesi Z. Abdulkhakov kaloi kontrollin kufitare dhe doganore të aeroportit pa pasaportë (e cila ishte mbajtur nga autoritetet ruse) dhe pa asnjë hyrje të regjistruar në kontrollin kufitar. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se vërtetohej pretendimi i kërkuesit se ishte rrëmbyer dhe transferuar kundër vullnetit të tij tek autoritetet e Taxhikistanit, me dijeni dhe përfshirjen pasive ose aktive të autoriteteve ruse.

### Në lidhje me nenin 3

Gjykata shqyrtoi nëse kërkuesi mund të përballej me rrezikun e trajtimit në kundërshtim me nenin 3 nëse kthehej në Uzbekistan dhe nëse, duke e dërguar në Taxhikistan, Federata Ruse kishte shkelur detyrimet e saj sipas të njëjtit nen.

Sa i përket çështjes së parë, Gjykata iu referua jurisprudencës së saj në lidhje me rreziqet e keqtrajtimit në rast ekstradimi apo dëbimit në Uzbekistan. Në të gjitha këto raste ajo kishte gjetur, duke iu referuar materialeve ndërkombëtare nga burime të ndryshme të besueshme, se situata e përgjithshme e të drejtave të njeriut në Uzbekistan ishte alarmante, duke treguar për raste të vazhdueshme serioze të keqtrajtimit të të burgosurve (veçanërisht nëse ishin të përfshirë me organizata fetare të ndaluara) dhe një praktikë sistematike dhe pa dallim të torturës ndaj personave në paraburgim. Për më tepër nuk kishte prova konkrete për të treguar ndonjë përmirësim thelbësor. Duke pasur parasysh konsideratat e mësipërme dhe prejardhjen e kërkuesit, Gjykata arriti në përfundimin se ai do të përballej rrezikun serioz për t'iu nënshtruar torturës ose trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës, nëse kthehej në Uzbekistan, duke e konsideruar dëbimin në Uzbekistan të kërkuesit në shkelje të nenit 3.

### Në lidhje me nenin 13

Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme që të shqyrtohen më vete pretendimet sipas nenit 13 pasi kanë në thelb të njëjtat argumente që tashmë ishin shqyrtuar sipas nenit 3.



## Në lidhje me nenin 5

Lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 5, kërkuesi pretendoi paligjshmërinë e ndalimit të tij për periudhën 9 dhjetor 2009 deri më 8 shkurt 2010, pasi nuk ishte i bazuar në një vendim gjyqësor; mungesën e shpejtësisë në shqyrtimit të ankimeve të tij kundër urdhrave të ndalimit të 7 shtator dhe 8 dhjetorit 2010; dhe mungesën e një procedure efektive për të kundërshtuar ndalimin e tij pas 20 janarit 2011.

Gjykata vërejti se e drejta ruse nuk përmban asnjë dispozitë specifike që përcakton një procedurë për urdhërimin e ndalimit në pritje të bërjes së një kërkesë për ekstradim. Në rastin konkret, kërkesa për ekstradim nuk ishte bërë deri më 30 dhjetor 2009 dhe baza ligjore për ndalimin e kërkuesit nga 9 deri më 30 dhjetor 2009 ishte e panjohur. Më tej, pas marrjes së kërkesës, ndalimi i Z. Abdulkhakov ishte bazuar në një dispozitë të Kodit të Procedurës Penale Rus i cili, për shkak të mungesës së rregullave të qarta procedurale, nuk ishte as i qartë dhe as i parashikueshëm në zbatimin e tij. Prandaj, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 5(1) (f).

Ndërsa për sa i përket ndalimit të kërkuesit për periudhën 8 shkurt 2010 deri më 9 qershor 2011, Gjykata e konsideroi të ligjshme pasi ishte shtyrë me vendim të një gjykate ruse e cila vendosi afate në përputhje me dispozitat e të drejtës së brendshme. Prandaj, ndalimi i kërkuesit gjatë kësaj periudhe kohore nuk ishte i paligjshëm dhe as arbitrar.

Për të përcaktuar nëse ankesat në apel ishin shqyrtuar me shpejtësinë e duhur, duheshin konsideruar elementë të tillë si kujdesi i treguar nga autoritetet, vonesat për faj të kërkuesit dhe çdo faktor tjetër që shkakton vonesa, për të cilat shteti nuk ishte përgjegjës. Në dritën e rrethanave të çështjes në fjalë, shqyrtimi i dy ankesave të kërkuesit ishte bërë për një periudhë prej tetëdhjetë e dy ditë dhe tridhjetë e pesë ditë pas paraqitjes së tyre, respektivisht. Prandaj, Gjykata konstatoi se kohëzgjatja e shqyrtimit të këtyre ankesave nuk mund të konsiderohet në përputhje me kërkesën e “shpejtësisë» sipas nenit 5 (4).

Lidhur me mungesën e një procedure efektive për rishikimin e masës së ndalimit të Z. Abdulkhakov pas 20 janarit 2011 dhe siç ishte vënë në dukje nga Gjykata në vendimet e mëparshme, mjeti ligjor që kërkohet nga neni 5 (4) duhej zbatuar në dritën e një faktori të ri i rëndësishëm i cili kishte dalë pas vendimit për vendosjen e masës së parë të ndalimit dhe në intervale kohore të arsyeshme. Faktori i ri i rëndësishëm ishte urdhri i Gjykatës për vendosjen

e masës së përkohshme sipas nenit 39 të Rregullores. Kërkuesi kishte të drejtë që ankesa e tij të shqyrtohej nga një gjykatë pa vonesë të paarsyeshme. Megjithatë, ligjshmëria e ndalimit të kërkuesit u shqyrtua dhe lirimi i tij u urdhërua vetëm tre muaj më vonë. Në rrethana të tilla, Gjykata konstatoi se rishikimi i ligjshmërisë së ndalimit të kërkuesit nuk ishte bërë “në intervale të arsyeshme” në shkelje të nenit 5 (4).

#### Në lidhje me nenin 34

Kërkuesi ishte transferuar në Taxhikistan pesë muaj pasi gjykata kishte lëshuar një urdhër se kërkuesi nuk duhej të ekstradohej në Uzbekistan deri në një njoftim të mëvonshëm, sipas nenit 39 të Rregullores. Edhe pse ndalimi për të ekstraduar kërkuesin në Uzbekistan ishte respektuar formalisht, transferimi i tij në Taxhikistan, i cili nuk ishte palë në Konventë, e kishte nxjerrë kërkuesin jashtë mbrojtjes së Konventës duke e ekspozuar atë ndaj rrezikut të keqtrajtimin në Uzbekistan dhe duke e bërë jo efektive masën e përkohshme, qëllimi i së cilës ishte ruajtja e *status quo* në pritje të shqyrtimit të kërkesës nga Gjykata duke mundësuar kështu zbatimin efektiv të vendimit të saj përfundimtar.

Për këtë arsye Federata Ruse nuk kishte vepruar në përputhje me masën e përkohshme, në shkelje të detyrimit të saj në bazë të nenit 34, për të mos penguar ushtrimin efektiv të së drejtës së kërkuesit për t’iu drejtuar Gjykatës.

#### Në lidhje me nenin 41

Gjykata u shpreh se Federata Ruse duhej t’i paguante Z. Abdulhakovit 30,000 euro në lidhje me dëmin jo material dhe 7800 euro për kostot dhe shpenzimet.

### **3. Koment**

Ky rast ka të bëjë me tre aspekte të rëndësishme të cilat Gjykata i ka trajtuar veçmas në veprimtarinë e saj gjyqësore.

Situata e parë ka të bëjë me të ashtuquajturën transferim i jashtëzakonshëm. Gjykata e ka trajtuar këtë çështje për herë të parë në *El-Masri k. Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*<sup>75</sup>. Në vendimin e dhënë nga Dhoma e Madhe për këtë rast por edhe në vendime të dhomave të tjera që kanë trajtuar të njëjtën çësht-

75 *El Masri k. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë*, vendim [Dhoma e Madhe] i 13 dhjetorit 2012, nr. 39630/09.

je<sup>76</sup>, Gjykata ka theksuar se transferimi i jashtëzakonshëm “i cili ka për qëllim shmangien e procesit të rregullt ligjor, shkelmon parimin e shtetit të së drejtës dhe vlerat e mbrojtura nga Konventa”. Këto situata, të quajtura “vrime të zeza” dhe të konsideruara “në kundërshtim të hapur me parimet themelore të njohura nga të dy juridiksionet (angleze dhe amerikane) dhe nga e drejta ndërkombëtare”<sup>77</sup>, kanë marrë një vëmendje të veçantë nga Gjykata. Në rastin në fjalë, ashtu si në rastet *El-Masri dhe Al Nashiri dhe Husein*, Gjykata u përball me detyrën e vështirë për të përcaktuar faktet e çështjes<sup>78</sup>. Gjykata konstatoi se mundësia e vetme që Z. Abdulkhakov të largohej nga Rusia pa pasaportë, pa u regjistruar në kontrollin kufitar dhe më pas ta gjente veten në duart e autoriteteve të Taxhikistanit kundër vullnetit të tij, ishte përfshirja pasive ose aktive e autoriteteve ruse në transferimin e tij<sup>79</sup>. Rreziqet që shoqërojnë largime të tilla të paligjshme janë gjithmonë më të larta dhe Gjykata konstatoi shkelje të nenit 3 në këtë drejtim.

Rasti është shumë i rëndësishëm edhe nga pikëpamja e nenit 5 të Konventës. Së pari, Gjykata arriti në përfundimin se ndalimi i kërkuesit nga autoritetet ruse gjatë periudhës nga 9 deri më 30 dhjetor 2009, në mungesë të një kërkesë për ekstradim, ka qenë në kundërshtim me nenin 5(1) (f) të Konventës. Ky përfundim konfirmon qasjen e vazhdueshme të Gjykatës se ndalimi i një personi sipas nenit 5 (1) (f) të Konventës mund të justifikohet vetëm në funksion të ekstradimit të tij ose largimit nga territori. Kur kjo perspektivë nuk ka një bazë të qartë ligjore ose duket të jetë e largët, ndalimi nuk është i justifikuar në bazë të atij neni të Konventës<sup>80</sup>. Neni 5 (4) është shkelur edhe sepse periudha prej 82 ditësh dhe 35 ditësh për të shqyrtuar masat e ndalimit nuk mund të konsidero-

76 Shih gjithashtu *Babar Ahmad dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 10 prillit 2012, nr. 24027/07, 11949/08, 36742/08, 66911/09 dhe 67354/09, *Othman (Abu Qatada) k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 17 janarit 2012, nr. 8139/09, të përfshira në këtë kapitull, dhe *Al Nashiri k. Polonisë dhe Husein (Abu Zubaydah) k. Polonisë*, vendimet të 24 korrikut 2014, nr. 28761/11 dhe 7511/13.

77 Shih vendimin e Gjykatës së Apelit të Anglisë dhe Uellsit (Seksioni Civil), Abbasi dhe një Tjetër k. Sekretarit të Shtetit për Punë të Jashtme dhe Komonuelthit dhe Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme, [2002] EWCA CIV 1598, 6 nëntor 2002.

78 Shih gjithashtu vendimin më të fundit *Nasr dhe Ghali k. Italisë*, vendim i 23 janarit 2016, nr. 44883/09, veçanërisht parag. 219-235 në lidhje me faktet e secilës çështje.

79 Shih gjithashtu paragrafët 246-247 të vendimit *Nasr dhe Ghali k. Italisë*, megjithëse në atë çështje detyra e Gjykatës u lehtësua nga konstatimet e juridiksioneve italiane.

80 Shih gjithashtu *Louled Massoud k. Maltës*, vendim i 27 korrikut 2010, kërkesa nr. 24340/08, përfshirë gjithashtu në këtë botim, si dhe *Quinn k. Francës*, vendim i 22 marsit 1995, kërkesa nr. 18580/91, dhe *Ali k. Zvicrës*, vendim i 5 gushtit 1998, kërkesa nr. 24881/94.

hen si të shpejta sipas kësaj dispozite<sup>81</sup>, dhe ndalimi i kërkuesit për periudhën 8 dhjetor 2010 dhe 9 qershor 2011 nuk i ishte nënshtruar një rishikimi gjyqësor.

Së fundi, me rëndësi të veçantë është në këtë rast edhe çështja sipas nenit 34 të Konventës. Megjithëse Gjykata kishte urdhëruar, sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës, autoritete ruse që të mos merrnin asnjë masë me qëllim largimin e kërkuesit, ky urdhër nuk u respektua. Mos respektimi i urdhrave të tilla nga Gjykates për marrjen e masave të përkohshme ka qenë një shqetësim në rritje gjatë viteve të fundit. Mospajtimi me këto urdhra ishte shumë problematik, sepse cenonte efikasitetin e procedurës para Gjykatës<sup>82</sup>. Kjo është arsyeja pse Gjykata ka konstatuar vazhdimisht shkelje të nenit 34 të Konventës, në të gjitha rastet kur nuk ishin respektuar urdhrat e saj sipas nenit 39 të Rregullores. Në rastin *Savridin Dzhurayev k. Ruisë*, Gjykata nxori një urdhër sipas nenit 46 në këtë drejtim, duke theksuar se “është e pakonceptueshme që autoritetet kombëtare të lejohen të shmangin zbatimin e një mase të përkohshme si ajo e dhënë në rastin në fjalë, duke përdorur një tjetër procedurë të brendshme për largimin e kërkuesit në vendin e destinacionit ose, edhe më alarmuese, duke lejuar largimin arbitrarisht në mënyrë haptazi të paligjshme”<sup>83</sup>.

81 Shih *Sanchez-Reisse k. Zvicrës*, vendim i 21 tetorit 1986, nr. 9862/82, ku ishin në diskutim periudha 31 dhe 41 ditore.

82 Në rastin *Mamatkulov dhe Askarov k. Turqisë*, vendim [Dhoma e Madhe] i 4 shkurtit 2005, nr. 46827/99 dhe 46951/99, për herë të parë, Gjykata arriti në përfundimin se, mos respektimi i masave të përkohshme të përcaktuara sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës nga ana e një Shteti, konsiderohet shkelje e detyrimeve të tij sipas nenit 34 të Konventës. Shih gjithashtu p.sh. *Olaechea Cahuas k. Spanjës*, vendim i datës 10 gusht 2006, nr. 24668/03; *Ben Khemais k. Italisë*, vendim i 24 shkurtit 2009, nr. 246/07, të përfshira në këtë kapitull; *Groni k. Shqipërisë*, vendim i 7 korrikut 2009, nr. 25336/04; *Al-Saadon dhe Mufdhi k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 2 marsit 2010, nr. 61498/08, përfshirë gjithashtu në këtë kapitull; *Labsi k. Sllovakisë*, vendim i 15 majit 2012, nr. 33809/08; dhe *Rrapo k. Shqipërisë*, vendim i 25 shtatorit 2012, nr. 58555/10.

83 *Savridin Dzhurayev k. Ruisë*, vendim i 25 prillit 2013, nr. 71386/10.

*Dështimi i autoriteve për të marrë në konsideratë shëndetin e kërkuesit gjatë procedurave të dëbimit të tij, do të kishte çuar në trajtim cjerezor dhe poshtërues, në shkellje të nenit 3*

## **VENDIM I DHOMËS SË MADHË NË ÇËSHTJEN PAPOSHVILI kundër BELGJIKËS**

(Kërkesë nr. 41738/10)

**13 dhjetor 2016**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Georgie Paposhvili, ishte një shtetas gjeorgjian i lindur në vitin 1958 që jetonte në Bruksel. Ai ndërroi jetë më 7 qershor 2016. Më 20 qershor 2016 gruaja e kërkuesit dhe tre fëmijët e tyre shprehën dëshirën për të vazhduar procedurat para Gjykatës.

Z. Paposhvili mbërriti në Belgjikë më 25 nëntor 1998, shoqëruar nga gruaja e tij dhe fëmija i tyre gjashtë vjeçar. Çifti më pas pati edhe dy fëmijë të tjerë. Midis viteve 1998 dhe 2007 z. Paposhvili u shpall fajtor për një numër veprash penale, përfshirë grabitje me dhunë dhe pjesëmarrje në një organizatë kriminale. Ndërkohë që vuantë dënimit me burgim, z. Paposhvili u diagnostikua me një sërë sëmundjesh, përfshirë leukeminë limfotike kronike dhe tuberkulozin, për të cilat mori trajtim spitalor. Duke u mbështetur në nenet 3 dhe 8 të Konventës, ai paraqiti disa kërkesa të pasuksesshme për rregullimin e statusit të tij të qëndrimit në Belgjikë për arsye të jashtëzakonshme dhe mjekësore, me pretendimin se nëse kthehej në Gjeorgji nuk do mund të merrte trajtimin e nevojshëm.

Në gusht të vitit 2007, Ministri i Brendshëm lëshoi një urdhër për dëbimin e kërkuesit dhe ndalimin për t'u rifutur në Belgjikë për dhjetë vjet pasi përbënte rrezik për rendin publik. Urdhri do të bëhej i zbatueshëm pasi z. Paposhvili të përfundonte dënimin e tij, por në fakt nuk u zbatua, pasi ai ishte duke u trajtuar. Më 7 korrik 2010, Zyra e të Huajve lëshoi një urdhër për largimin e tij nga vendi, së bashku me një urdhër për ndalimin e tij. Kërkuesi u transferua në një vendqendrim për emigrantët e paligjshëm me qëllim kthimin e tij në Gjeorgji dhe u pajis me dokumentet e udhëtimit.

Më 23 korrik 2010, z. Paposhvili bëri kërkesë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut për zbatimin e një mase të përkohshme sipas nenit 39 të Rregullores me qëllim pezullimin e dëbimit të tij nga Belgjika. Gjykata vendosi pezullimin e dëbimit të tij. Më pas kërkuesi u lirua. Afati për zbatimin e urdhrit

për të lënë territorin belg u shty disa herë. Në nëntor të vitit 2009, gruaja e kërkuesit dhe tre fëmijët e tij u lejuan të qëndronin në Belgjikë. Në periudhën 2012 - 2015 z. Paposhvili u arrestua disa herë për vjedhje dyqani.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi, duke u mbështetur në të drejtën e jetës sipas nenit 2 dhe ndalimin e trajtimit çnjerëzor ose poshtërues sipas nenit 3, pretendonte se kishte arsye të konsiderueshme për të besuar se nëse dëbohej në Gjeorgji, do të përballej me rrezikun real të trajtimit çnjerëzor e degradues apo vdekje të parakohshme. Ai gjithashtu pretendoi, sipas nenit 8, se nëse dëbohej nuk do mund të qëndronte me familjen e tij, e cila ishte mbështetja e vetme morale për të.

Më 17 prill 2014, një Dhomë e Gjykatës vendosi se nuk ka pasur shkelje të neneve 2, 3 dhe 8 të Konventës. Më 20 prill 2015, kolegji i Dhomës së Madhe pranoi kërkesën në emër të kërkuesit për referimin e çështjes tek Dhoma e Madhe sipas nenit 43 të Konventës. Gjykata konstatoi se duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve dhe rolin e sistemit të Konventës, fakti që kërkuesi kishte ndërruar jetë nuk përbënte pengesë për vazhdimin e gjykimit të çështjes.

### Neni 2 dhe 3

Gjykata ripohoi të drejtën e të gjitha Shteteve Kontraktuese për të kontrolluar hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve. Megjithatë, nëse ekzistonte besimi i bazuar se personi në fjalë, pas dëbimit, do të përballej me një rrezik real për t'iu nënshtruar torturës ose trajtimit çnjerëzor dhe degradues, neni 3 i detyronte shtetet të mos e dëbonin personin në fjalë. Çfarë konsiderohej keqtrajtim varej nga rrethanat e rastit, të tilla si kohëzgjatja e trajtimit, efektet fizike dhe mendore, dhe në disa raste, gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës. Vuajtjet e shkaktuara për shkak të një sëmundje mund të përfshiheshin në fushëveprimin e nenit 3, nëse ato përkeqësohen për shkak të trajtimit nga ana e autoriteteve shtetërore.

Gjykata pasi analizoi jurisprudencën e saj, arriti në përfundimin se zbatimi i deri tanishëm i nenit 3 nuk ofronte mbrojtjen e nevojshme për të huajt të cilit ishin të sëmurë rëndë (në ndryshim nga ata që ishin në prag të vdekjes). Gjykata vlerësoi se “rastet e tjera shumë të jashtëzakonshme”, në kuptimin e vendimit në çështjen *N. kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>84</sup> të cilat mund të ngrenë

84 *N. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim [DHM] i 27 majit 2008, nr. 26565/05, i përfshirë në këtë seksion.

një çështje sipas nenit 3, i referohen situatave që kanë të bëjnë me dëbimin e një personi të sëmure rëndë, kur ka arsye thelbësore për të besuar se ai do të përballet me rrezikun real, për shkak të mungesës së trajtimit të duhur në vendin pritës ose mungesës së aksesit ndaj një trajtimi të tillë, të përkeqësimit serioz, të shpejtë dhe të pakthyeshëm të gjendjes së tij shëndetësore, çka do të conte në vuajtje të shtuara ose në një reduktim të ndjeshëm të jetëgjatësisë.

Shteti është i detyruar të vlerësojë rreziqet me të cilat kërkuesi mund të përballet nëse do të dëbohet në vendin pritës, në mënyrë që të përmbushë detyrimin e tij negativ për të mos ekspozuar personin ndaj rrezikut të keqtrajtimit. Shteti duhet të verifikojë nëse trajtimi shëndetësor në shtetin pritës është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm në praktikë për trajtimin e sëmundjes së kërkuesit dhe nëse personi në fjalë ka faktikisht mundësi për ta marrë një trajtim të tillë. Nëse ekzistojnë dyshime serioze në lidhje me ndikimin e dëbimit, Shteti kthyes duhet të marrë garanci individuale dhe të mjaftueshme nga Shteti pritës që personit do ti ofrohet trajtimi i duhur. Në rastin në fjalë, kërkuesi, kishte parashtruar informacione të hollësishme mjekësore, se si trajtimi në Belgjikë kishte bërë që gjendja e tij shëndetësore të ishte e qëndrueshme dhe se nëse trajtimi ndërpritej, nuk do ti mbeteshin më shumë se gjashtë muaj jetë. Gjithashtu kërkuesi kishte pohuar se në Gjeorgji mungonte qoftë trajtimi, qoftë transplantimi i organeve të dhuruara.

Pavarësisht fakteve të mësipërme, kërkesat e z.Paposhvili për tu pajisur me letra të rregullta qëndrimi për arsye mjekësore u refuzua nga Zyra e të Huajve. Bordi i Ankesave për të Huajt konstatoi se, kur autoriteti administrativ parashtronte arsyet për përjashtim, nuk ishte e nevojshme që ai të shqyrtonte provat mjekësore të paraqitura. Lidhur me ankesat e bazuara në nenin 3 të Konventës, Bordi i Ankesave për të Huajt vuri në dukje se vendimi që refuzonte lejen për të qëndruar nuk ishte shoqëruar me një masë largimi, kështu që rreziku i ndërprerjes së trajtimit mjekësor të kërkuesit në rast se kthehej në Gjeorgji ishte thjesht hipotetik. *Conseil d'État*, në të cilin kërkuesi apeloj për çështje të ligjit, mbështeti arsyetimin e Bordit të Ankesave për të Huajt.

Duke qenë se raportet mjekësore të kërkuesit nuk ishin marrë parasysh nga Zyra për të Huaj apo Bordi i Ankesave për të Huajt në prespektivën e nenit 3 gjatë procedurave për lejimin ose jo të qëndrimit të kërkuesit, Gjykata arriti në përfundimin se nëse kërkuesi kthehej në Gjeorgji, do të shkelej neni 3 i Konventës. Kështu, Gjykata e konsideroi të panevojshëm shqyrtimin e pretendimeve sipas nenit 2 të Konventës.

## Neni 8

Bordi i Ankesave për të Huajt e hodhi poshtë kërkesën e z. Paposhvili sipas nenit 8, me arsyetimin se vendimi që refuzonte lejen e qëndrimit nuk ishte i shoqëruar me një masë largimi. Megjithatë, Gjykata vlerësoi se autoritetet kombëtare duhet të bënin një vlerësim të ndikimit që do të kishte dëbimi i z. Paposhvili në jetën familjare të tij në dritën e gjendjes së tij shëndetësore; kjo përbënte një detyrim procedural për autoritetet në mënyrë që të garantonin efektivitetin e së drejtës për respektimin e jetës familjare. Shteti duhet të kishte shqyrtuar nëse do të mundej familja e kërkuarit ta ndiqte atë në Gjeorgji nëse dëbohej dhe nëse nuk do mundej, a kërkonte garantimi i të drejtës së z. Paposhvili për respektimin e jetës së tij familjare që ai të lejohej të qëndronte në Belgjikë, për kohën që i kishte mbetur për të jetuar. Kështu, Gjykata vendosi që nëse z. Paposhvili do të ishte dëbuar në Gjeorgji pa vlerësuar këto faktorë, do të kishte pasur gjithashtu një shkelje e nenit 8 të Konventës.

## Neni 41

Gjykata u shpreh se konstatimi i shkeljes së neneve 3 dhe 8 të Konventës përbënte shpërblim të drejtë në lidhje me çdo dëm jo material që z. Paposhvili mund të kishte pësuar. Gjithashtu ajo vendosi që Belgjika t'i paguante familjes së z. Paposhvilit 5,000 € në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

## **3. Komente**

Ky vendim është me interes për një numër të madhë rastesh që kanë të bëjnë me dëbimin e personave të sëmurë në një destinacion, ku mungesa e trajtimit të duhur mjekësor mund të angazhojë nenin 3. Është e njohur tashmë se Konventa ndalon dëbimin ose ekstradimin e personave nëse ata do të ekspozoheshin ndaj një rreziku real të torturës ose trajtimit apo ndëshkimit çnjerëzor ose poshtëruar, qoftë nga agjentë shtetërorë apo jo shtetërorë. Megjithatë, këto raste nuk kanë të bëjnë me keqtrajtim të qëllimshëm, por me pamundësinë e autoriteteve të shtetit pritës për t'i ofruar personit në fjalë një trajtim të përshtatshëm për kushtet e tij mjekësore. Përveç parimit të përgjithshëm që Shtetet kanë të drejtën të rregullojnë hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve, në raste specifike që kanë të bëjnë me kushtet shëndetësore të personave, arsyetimi i Gjykatës bazohet edhe në premisën se të huajt që janë subjekt i dëbimit, nuk mundën, në parim, të pretendojnë të drejtën për të qëndruar në territorin e një Shteti Kontraktues në mënyrë që të vazhdojnë të përfitojnë nga trajtime mjekësore, sociale ose forma të tjera ndihme dhe shërbimesh të



ofruara nga shteti që e dëbon. Prandaj shumica e këtyre rasteve shpallen të papranueshme nga Gjykata.<sup>85</sup>

Megjithatë, në rastin *D. k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>86</sup>, për herë të parë Gjykata konstatoi se kur ekziston një kombinim i jashtëzakonshëm i faktorëve, largimi i një individi i cili edhe pse nuk rrezikonte të keqtrajtohej, do të përballej me kushte çnjerëzore dhe degraduese për shkak të mungesës së trajtimit të duhur mjekësor në vendit të tij të destinacionit, do të përbënte një shkelje të nenit 3. Në atë rast rrethanat e jashtëzakonshme ishin se kërkuesi gjendej në situatë kritike shëndetësore dhe dukej të ishte afër fundit të jetës, nuk mund t'i garantohet një kujdes mjekësor në vendin e tij të origjinës dhe nuk kishte familjarë atje të gatshëm apo të aftë për t'u kujdesur për të apo t'i ofronin qoftë strehim, ushqim apo mbështetjes sociale.

Pas rasti të D.-së, Gjykata pati mundësinë të gjykonte themelin e çështjes *N. kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>87</sup>. Gjykata në këtë vendim konfirmoi parimet e përgjithshme të zbatuara në rastin e D.-së Megjithatë, shumica e Dhomës së Madhe, duke kujtuar pragun e lartë të kërkuar në zbatimin e nenin 3, vendosi se dëbimi i N. nuk do të shkelte nenin 3. Shumica vlerësuan se N. në ndryshim nga D. nuk ishte në fund të jetës së tij dhe medikamentet e AIDS gjendeshin në Ugandë, megjithëse jo aq të aksesueshme apo në cilësinë që gjendeshin në Mbretërinë e Bashkuar. Shumica e gjyqtarëve pohuan se KEDNJ-ja ishte kryesisht për mbrojtjen e të drejtave civile dhe politike dhe jo për mbrojtjen e të drejtave ekonomike, sociale apo kulturore. Tre gjyqtarë të Dhomës së Madhe dolën fuqimisht kundra arsyetimit dhe gjetjeve të fakteve të shumicës, duke i konsideruar si të papranueshme. Ata ishin veçanërisht kritik ndaj supozimit se shqetësimet rreth burimeve në vendin pritës mund të ndiknin situatat në të cilat angazhohej qartazi neni 3.<sup>88</sup>

Pas vendimit *N. kundër Mbretërisë së Bashkuar* e njëjta pyetje është ngritur në mënyrë të përsëritur para Gjykatës dhe duket se tërheq veçanërisht vëmendjen e Gjykatës së Strasburgut.<sup>89</sup> Një përpjekje tjetër nga Dhoma e Madhe për t'u

85 Shih për shëmbull *Karara k. Finlandës*, vendim i 29 majit 1998, nr. 40900/98, S.C.C. k. *Suedisë*, vendim i 15 shkurtit 2000, nr. 46553/99, *Arcila Henao k. Hollandës*, vendim i 24 qershorit 2003, nr. 13669/03, *Ndangoya k. Suedisë*, vendim i 24 qershorit 2004, nr. 17868/03, dhe *Amegnigan k. Hollandës*, vendim i 25 nëntorit 2004, nr. 25629/04.

86 *D. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 2 majit 1997, nr. 30240/96.

87 *N. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim [DHM] i 27 majit 2008, nr. 26565/05, i përfshirë në këtë seksion.

88 Shih mendimin e fortë kundra të gjyqtarëve Tulkens, Bonello dhe Spielman.

89 Shih për shëmbull *S.H.H. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 29 janarit 2013, nr. 60367/10, *I.K. k. Austrisë*, vendim i 28 marsit

marrë me këtë çështje në rastin e *S.J. k. Belgjikës*, u përjashtua pas një oferte nga autoritetet belge për lejimin e qëndrimit të pakufizuar për kërkuesen dhe tre fëmijët e saj, bazur në “konsiderata të forta humanitare”.<sup>90</sup>

Rasti *Paposhvili* ishte hera e katërt që Gjykata e trajtoi këtë temë në një formacion të Dhomës së Madhe. Siç tha gjykatësi Lemmens në mendimin e tij paralel, vendimi i Paposhvilit “qartëson jurisprudencën tonë në mënyrë që të plotësohet ky boshllëk duke ruajtur pragun e lartë për zbatimin e nenit 3 të Konventës”. Ai vazhdoi duke thënë se “vendimi mund të shihet si përgjigje e Gjykatës ndaj shqetësimit të shprehur nga Bordi i Gjyqtarëve për të Huajt, lidhur me problemin e zbatimit të rreptë të jurisprudencës së N. kundër Mbretërisë së Bashkuar”. Pavarësisht nga fakti se vendimi unanim i Dhomës së Madhe ruan pragun e lartë “të rrethanave të jashtëzakonshme” të vendosur në çështjen *D. k. Mbretërisë së Bashkuar* dhe të konfirmuar në çështjen *N. k. Mbretërisë së Bashkuar*, sqaron se në këto lloj rastesh është i nevojshëm një vlerësim më rigoroz i rrezikut. Në fakt vendimi pranon se jo vetëm kur jemi në kushte të kërcënimit të jetës kemi të bëjmë me rrethana të jashtëzakonshme. Kjo qasje ofron një interpretim më autonom të nenit 3 krahasuar me nenin 2 dhe konfirmon edhe një herë qëndrimin në rastin *F.G. k. Suedisë*<sup>91</sup>, duke theksuar nevojën për një analizë të të gjithë faktorëve relevantë në situatën personale dhe familjare të azilkërkuesit sipas nenit 3 dhe gjithashtu nenit 8 të Konventës.

2013, nr. 2964/12, dhe *Senchishak k. Finlandës*, vendim i 18 nëntorit, nr. 20145049/12.

90 *S.J. k. Belgjikës*, vendim [DHM] i 19 marsit 2015, nr. 70055/10.

91 *F.G. k. Suedisë*, vendim [DHM] i 23 marsit 2016, nr. 43611/11.

*Dëbimi në Irak i ekspozon kërkuesit ndaj një rreziku real keqtrajtimi*

## **VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN J.K. DHE TË TJERË kundër SUEDISË**

(Kërkesë nr. 59166/12)

**23 gusht 2016**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit, z. J.K., gruaja dhe djali i tij, janë shtetas irakenë të cilët kanë lindur në vitet 1964, 1965 dhe 2000 respektivisht.

Që prej viteve 1990 z. J.K. drejtonte biznesin e tij të ndërtimit dhe transportit me klientë ekskluzivisht amerikanë. Zyra e tij ndodhej në bazën ushtarake të Shteteve të Bashkuara “Victoria Camp” në Bagdad, Irak.

Kërkuesit kishin qenë subjekt i kërcënimeve serioze dhe dhunës nga al-Kaeda në periudhën midis viteve 2004 dhe 2008. Në veçanti, në vitin 2004, ndaj kërkuesit të parë pati një tentativë për vrasje. Në vitin 2005, vëllai i tij u rrëmbye nga anëtarët e al-Kaidës, të cilët kërcënonin se do ta vrisnin për shkak të bashkëpunimit të kërkuesit të parë me amerikanët. Vëllai i tij u lirua përmes ryshfetit dhe kërkuesit u larguan menjëherë nga Iraku.

Kërkuesit u vendosën në Jordani ku qëndruan deri në dhjetor 2006, përpara se të ktheheshin në Irak. Menjëherë pas kthimit të tyre, shtëpia e tyre ishte objektivi i një sulmi me bombë. Forcat amerikane arrestuan agresorin, i cili pranoi se ishte paguar nga al-Kaeda për të vrarë z. J.K dhe gjithashtu deklaroi emrat e gjashtëmbëdhjetë njerëzve të cilët ishin caktuar për të vrojtuar kërkuesit. Më pas, kërkuesit u shpërngulën në Siri. Al-Kaeda shkatërroi shtëpinë e tyre në Irak, si dhe rezervat e biznesit të z. J.K.

Në janar 2008 kërkuesit u kthyen përsëri në Bagdad. Në tetor 2008 z. J.K. dhe vajza e tij u sulmua me armë zjarri ndërkohë që udhëtonin me makinë. Në atë atentat vajza e tij mbeti e vrarë. Pas kësaj z. J.K e la punën dhe së bashku me familjen lëvizën nëpër vende të ndryshme në Bagdad. Rezervat e biznesit të J.K. u sulmuan katër ose pesë herë nga anëtarët e al-Kaidës, të cilët kishin kërcënuar rojet.

Në dhjetor 2010 z. J.K. aplikoi për azil dhe leje qëndrimi në Suedi. Në gusht të 2011 ai paraqiti një kërkesë tjetër dhe po ashtu gruaja dhe djali i tij në shtator 2011

Më 22 nëntor 2011 Agjencia e Migracionit refuzoi kërkesën e tyre për leje qëndrimi dhe urdhëroi dëbimin e tyre nga Suedia. Kërkuesit u ankuan në Gjykatën e Migracionit, e cila në prill të vitit 2012 la në fuqi vendimin e Agjencisë së Migracionit, me arsyetimin se ngjarjet e pretenduara nga kërkuesit kishin ndodhur në të kaluarën e largët dhe se z. J.K. nuk bënte më punën për shkak të së cilës Al-Kaeda e kishte kërcënuar e dhunuar. Gjithashtu, Gjykata e Migracionit vërejti se edhe nëse do kishte kërcënime të tjera, autoritetet irakene të zbatimit të ligjit dukeshin se ishin të gatshme dhe në gjendje t'u ofronin kërkuesve mbrojtjen e nevojshme.

Kërkuesit më pas u ankuan në Gjykatën e Apelit të Migracionit, por ankesa e tyre u refuzua në gusht 2012. Më 29 gusht 2012, kërkuesit paraqitën një kërkesë në Agjencinë e Migracionit për rishqyrtim të çështjes së tyre, e cila u refuzua 26 shtator 2012.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkesa u parashtua në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut më 13 shtator 2012. Më 18 shtator 2012, Presidenti i Seksionit të Tretë vendosi të zbatonte nenin 39 të Rregullores së Gjykatës, duke i kërkuar shtetit suedez mos dëbimin e kërkuesve ndërkohë që çështja e tyre ishte në shqyrtim nga kjo Gjykatë.

Më 4 qershor 2015, një Dhomë e Gjykatës konstatoi se zbatimi i urdhrin për dëbim nuk përbënte shkelje të nenit 3. Me kërkesë të kërkuesve, çështja iu referua Dhomës së Madhe sipas nenit 43 të KEDNJ-së.

Kërkuesit pretenduan se nëse ktheheshin në Irak ishin nën një rrezik real të keqtrajtimit, në shkelje të nenit 3.

### Neni 3

Gjykata vërejti se, për shkak se kërkuesit ende nuk ishin ekstraduar apo deportuar në kohën që shqyrtohej çështja e tyre, periudha e kohës për të cilën do të bëhej vlerësimi i rrezikut ishte ajo para procedurave para kësaj Gjykate.

Gjatë shqyrtimi të pretendimet të kërkuesve sipas nenin 3, Gjykata iu referua raporteve nga departamentet qeveritare të vendeve të ndryshme dhe nga shoqata të pavarura ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ajo pranoi që, edhe pse situata e sigurisë në Bagdad ishte përkeqësuar që prej vlerësimit të bërë nga Agjencia e Migracionit dhe Gjykata e Migracionit, inten-

siteti i dhunës nuk kishte arritur në nivelin që do të përbënte një rrezik real të trajtimit në kundërshtim me nenin 3.

Megjithatë, Gjykata konstatoi se rrethanat personale të kërkuesve të marra së bashku me reduktimin e kapaciteteve të autoriteteve irakene për t'i mbrojtur ata, krijonte një rrezik real të keqtrajtimit në rast të kthimit të tyre në Irak.

Sa i përket rrethanave personale të kërkuesve, Gjykata konstatoi në veçanti se ata dhanë një dëshmi koherente dhe të besueshme të ngjarjeve, e cila ishte në përputhje me informacionet e marra nga burime të besueshme dhe objektive rreth gjendjes së përgjithshme në Irak por kishte gjithashtu elementë të cilët e bënë historinë e tyre të dallueshme nga situata e përgjithshme e rrezikshme në vend. Në veçanti, z. J.K. i përkiste një grupi personash që kishin pasur dhe vazhdonin të kishin marrëdhënie me forcat e armatosura amerikane dhe në të vërtetë kërkuesit, në të kaluarën, ishin keqtrajtuar nga Al Kaeda. Gjykata pranoi që konsideratat e mësipërme ishin një tregues i fortë se kërkuesit vazhdonin të ishin nën rrezikun e keqtrajtimit në rast kthimi në Irak. Edhe pse ishte detyrim i autoriteteve suedeze të përjashtonin çdo dyshim për një rrezik të tillë të mundshëm, ata kishin dështuar ta bënin këtë në rastin në fjalë.

Sa i përket aftësisë së autoriteteve irakene për të mbrojtur kërkuesit, Gjykata, duke marrë parasysh informacionet nga burime të besueshme dhe objektive, konstatoi se pavarësisht mungesës në rritje që prej vitit 2010 të kapaciteteve dhe integritetit të forcave të sigurisë dhe sistemit ligjor të Irakut, niveli i mbrojtjes i ofruar nga autoritetet irakene mund të konsiderohej i mjaftueshëm për publikun e gjerë në Irak. Megjithatë, ajo nuk ishte e bindur nëse autoritetet irakene do të ishin në gjendje t'u siguronin mbrojtje efektive personave që i përkisnin një grupi të targetuar nga forcat terroriste, siç ishin kërkuesit.

Duke pasur parasysh faktorët e lartpërmendur, të marrë në mënyrë kumulative, Gjykata vendosi se ishin parashtruar dëshmi substanciale për të besuar se kërkuesit rrezikonin realisht të trajtoheshin në kundërshtim me nenin 3 nëse do të ktheheshin në Irak. Kështu, dëbimi i tyre në Irak do të cenonte nenin 3 të Konventës.

#### Neni 41

Gjykata hodhi poshtë kërkesën për kompensimin e dëmit material, me arsyetimin se nuk ishte vërtetuar një dëm i tillë. Gjithashtu, ajo refuzoi edhe pre-

tendimin e kërkuesve për dëmin jo material, duke argumentuar se konstatimi i shkëljes së nenit 3 përbënte në vetvete shpërblim të drejtë. Gjykata u njohu kërkuesve të drejtën për të marrë 10,000 € për kostot dhe shpenzimet.

### 3. Komete

Çështja J.K. dhe të tjerë k. Suedisë shënon një zhvillim tjetër në jurisprudencën e Gjykatës. Në kushtet e një situatë të përkeqësuar të sigurisë në përgjithësi, e shënuar nga një rritje e dhunës sektare, sulmeve dhe përhapjes së grupit të ISIS, Gjykata vërejtë se zona të mëdha të territorit të Irakut ishin jashtë kontrollit efektiv të qeverisë së Irakut. Në dritën e situatës komplekse dhe të paqëndrueshme të sigurisë, ajo vuri në dukje se kapacitetet e autoriteteve irakene për të mbrojtur qytetarët ishin reduktuar. Megjithatë në kohën e vendimit, mbrojtja nga autoritetet irakene ende mund të konsiderohej e mjaftueshme për publikun e gjerë, situata ishte e ndryshme për individët që i përkisnin një grupi të targetuar nga forcat terroriste, sic ishin kërkuesit. Rrethanat personale të kërkuesve të marra së bashku me kapacitetet e reduktuara të autoriteteve irakene për t'i mbrojtur ata, krijojnë një rrezik real keqtrajtimi në rast të kthimit të tyre në Irak.

Mund të thuhet se faktet e këtij rasti janë tipike për një rast që ka të bëjë me azilin përpara GJEDNJ-së. Megjithatë, siç u shpreh Gjyqtari Bianku në fjalën e tij në seminarin për hapjen e vitit gjyqësor të GJEDNJ-së më 27 janar 2017 në Strasburg, Dhoma e Madhe në mënyrë të matur dhe të mirëmënduar gjeti mundësinë për të risjellë, sistemuar dhe konsoliduar parimet e zbatueshme në rastet e azilit. Vlera e shtuar e vendimit në rastin J.K. qëndron në faktin se ai jep një përmbledhje të kriterëve ligjorë që duhet të merren parasysh në rastet e azilit. Kështu, Gjykata, pas analizimit të parimeve udhëzuese që rrjedhin nga jurisprudenca e GJEDNJ-së dhe Komisioneri i Lartë për Refugjatë, ofroi listën e mëposhtme të parimeve të përgjithshme të zbatueshme në rastet e azilit:

1. Natyra e përgjithshme e detyrimeve që rrjedhin nga neni 3 - duke rithekësuar karakterin absolut të të drejtave të mbrojtura nga ky nen;
2. Parimi i mos kthimit - qoftë direkt apo indirekt në vendet ku ata janë në rrezik<sup>92</sup>;
3. Parimet e përgjithshme mbi zbatimin e nenit 3 në rastet e dëbimit - duke kujtuar të drejtën e shteteve për të rregulluar hyrjen, qëndrimin dhe dë-

92 Shih *Hirsi Jamaa dhe të tjerët kundër Italisë*, vendim [DHM] i datës 24 shkurt, nr. 27765/09, dhe *Khlaifia dhe të tjerët kundër Italisë*, vendim [DHM] i datës 15 dhjetor 2016, nr. 16483/12, të dyja të përfshira në këtë seksion.

- bimin e të huajve, përveç rasteve kur ata ishin nën rrezikun e torturës ose trajtimeve të krahasueshme në vendin e destinacionit.;
4. Rreziku i keqtrajtimit nga grupe private – jo vetëm rreziku që mund tu kanoset nga autoritet shtetërore<sup>93</sup>;
  5. Parimi *ex nunc* i vlerësimit të rrethanave – të përgjithshme dhe individuale<sup>94</sup>;
  6. Parimi i subsidiaritetit;
  7. Vlerësimi i ekzistencës së një rreziku real<sup>95</sup>;
  8. Shpërndarja e barrës së provës<sup>96</sup>;
  9. Kqtrajtimet e mëparshme, tregues të ekzistencës së një rreziku real;
  10. Përkatësia në një grup të targetuar<sup>97</sup>.

Ky dekalog i ofruar nga vendimi në rastin J.K. është, sipas mendimit të Gjykatës, testi që do të përdoret në shqyrtimin dhe vlerësimin e çështjeve të azilit sipas KEDNJ-së, të paktën në lidhje me nenin 3. Vendimi në rastin J.K. ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të rasteve të azilit si në nivel kombëtar ashtu edhe në Gjykatën e Strasburgut. Ajo është hartuar në një mënyrë të tillë kryesisht për të kodifikuar jurisprudencën lidhur me çështjen e azilit dhe për të lehtësuar bashkëpunimin dhe dialogun me juridiksionet kombëtare në mënyrë që të mundësohet më në fund zgjidhja e rasteve të azilit në nivel kombëtar në përputhje me këto parime të përgjithshme të Konventës.

Ajo që e bën veçanërisht interesant këtë vendim të Gjykatës është se, duke përcaktuar parimet përmes të cilave do të shqyrtohen rastet e azilit, ajo derivon nga qëndrimi tradicional i saj. Qëndrimi tradicional, gjithmonë kishte si pikënisje *“... të drejtën e Shteteve kontraktuese për të kontrolluar hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve, e drejtë kjo e mirë përcaktuar në të drejtën ndërkombëtare dhe që i nënshtrohej detyrimeve që rridhnin nga traktatet, përfshirë*

93 Shih p.sh. *Salah Sheekh kundër Hollandës*, vendim i datës 11 janar 2007, nr. 1948/04, *Ahmed kundër Austrisë*, vendim i datës 17 dhjetor, nr. 25964/94 dhe *Sufi dhe Elmi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i datës 28 qershor 2011, nr. 8319/07 dhe 11449/07, të gjitha të përfshira në këtë seksion.

94 Shih *F.G. k. Suedisë*, [DHM] vendim i datës 23 mars 2016, nr. 43611/11.

95 Shih *Sufi dhe Elmi k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i datës 28 qershor 2011, nr. 8319/07 dhe 11449/07, gjithashtu të përfshira në këtë seksion.

96 Shih *Tarakhel k. Zvicrës*, [DHM] vendim i datës 4 nëntor 2014, nr. 29217/12.

97 Në vendimin për çështjen *Salah Sheekh kundër Hollandës*, të datës 11 janar 2007, nr. 1948/04, gjithashtu i përfshirë në këtë udhëzues, Gjykata konstatoi se kërkuesve, të cilët i përkisnin një grupi njerëzish që ishin nën rrezikun e keqtrajtimit të ndaluar, nuk u kërkohet domosdoshmërisht të tregonin se ata ishin më në rrezik sesa anëtarët e tjerë të grupit, por testi mbetej personal për të gjithë ata që i përkisnin një grupi të caktuar.

*Konventën*<sup>98</sup>. Më pas, Gjykata vërejti se “Dëbimi, ekstradimi ose ndonjë masë tjetër për të larguar një të huaj mund të ngrejë një çështje sipas nenit 3 të Konventës dhe për rrjedhojë të sjellë përgjegjësinë e shtetit dëbues sipas Konventës, kur janë parashtruar dëshmi substanciale që të bëjnë të besosh se personi në fjalë, nëse dëbohet në vendin pritës, do të përballet me një rrezik real trajtimi në kundërshtim me nenin 3. Në rrethana të tilla, neni 3 nënkupton një detyrim për të mos e dëbuar personin në atë vend”<sup>99</sup>. Interesante është që ky rregull është përmbysur disi në vendimin në rastin J.K. Është me të vërtetë e rëndësishme të theksohet se në vendimin J.K. Dhoma e Madhe kujton së pari karakterin absolut të nenit 3 dhe pastaj vazhdon me kriteret e tjera. Pavarësisht interpretimit kumulativ të të gjitha kriterëve, pyetja është nëse një riorganizim i tillë shërben si udhërrëfyes për analizën gjyqësore të rasteve të azilit në Strasburg ose në nivel kombëtar, duke treguar se cili element ka përparësi ndaj të tjerëve në marrjen e një vendimi në një rast konkret.

98 Shih, ndër të tjera, Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendimi i datës 28 maj 1985, nr. 9214/80, 9473/81 dhe 9474/81, Boujlifa kundër Francës, vendimi i datës 21 tetor 1997, nr. 25404/94 dhe Hirsi Jamaa dhe të tjerët kundër Italisë, vendim [DHM] i datës 23 shkurt 2012, nr. 27765/09.

99 Shih p.sh. *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i datës 7 korrik 1989, nr. 14038/88, *Ahmed kundër Austrisë*, vendimi i datës 17 dhjetor, nr. 25964/94, *Jabari kundër Turqisë*, vendimi i datës 11 korrik 2000, nr. 40035/98 dhe *Salah Sheekh kundër Hollandës*, vendimi i datës 11 janar 2007, nr. 1948/04, nga të cilat tre të fundit janë përfshirë gjithashtu në këtë seksion.



### **Neni 3 dhe Rregullorja e Këshillit nr. 604/2013 e 26 qershorit 2013 (Rregullorja e III e Dublinit) (dhe legjislacioni i mëparshëm që mbulon të njëjtën fushë)**

*Urdhri i transferimit në përputhje me Konventën e Dublinit<sup>100</sup>*

## **VENDIM MBI PRANUESHMËRINË NË ÇËSHTJEN T.I. kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesa nr. 43844/98)

**7 mars 2000**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, T.I., ishte shtetas nga Sri Lanka i lindur në vitin 1969.

Deri në maj të vitit 1995, kërkuesi kishte jetuar në Jaffna, një zonë të kontrolluar nga LTTE, një organizatë Tamil e cila ishte e përfshirë në një luftë të armatosur për pavarësi.

Nga viti 1993 deri në qershor të 1994, kërkuesi pretendoi se ishte detyruar të punonte për LTTE, derisa më në fund u burgos për tre muaj në një ambient në Vasavilan. Në prill të vitit 1995, kërkuesi arriti të largohej për në Kolombo, ku u arrestua nga ushtria e Sri Lankës, pasi dyshohej se ishte anëtar i LTTE. Ai u mbajt i ndaluar deri më 20 shtator të vitit 1995 dhe u morr në pyetje për lidhjet e tij me LTTE. Gjatë kësaj kohe, ai pretendoi se ishte torturuar dhe keqtrajtuar nga ushtarët. Pas liritimit të tij, kërkuesi u kap dy herë nga ENDLF, një grup Tamil pro Qeverisë dhe u dërgua në kampin e tyre për t'u pyetur në lidhje me përfshirjen e tij me LTTE. Ai pretendoi se ishte rrahur në të dyja rastet. Pas shpërthimit të një kamioni që mbante naftë në afërsi të shtëpisë së tij, kërkuesi u arrestua më 23 tetor 1995 dhe u dërgua në stacionin policor për t'u pyetur. Ai pohoi se ishte rrahur me shkopinj gome dhe se kishin vendosur një shufër hekuri të nxehtë tek krahu i tij.

Në janar të vitit 1996, menjëherë pas liritimit të tij, kërkuesi u largua Sri Lanka dhe arriti në Gjermani më 10 shkurt 1996, ku kërkoi azil. Kërkesa e tij për azil u refuzua më 26 prill 1996 nga ana e Zyrës Federale për Njohjen e Refugjatëve të Jashtëm. Ai u ankua në Gjykatën Administrative bavareze, Regensburg, por ankesa e tij u hodh poshtë në prill të vitit 1997. Gjykata Administrative vuri në

100 Konventa e Dublinit e 1990 u zëvendësua me Rregulloren II të Dublinit në vitin 2003 dhe së fundmi, në vitin 2013, me Rregulloren III të Dublinit.

dukje se veprimet e LTTE nuk mund t'i atribuoheshin shtetit dhe se kërkuesi nuk rrezikonte të persekutohej politikisht nëse kthehej në jug të Sri Lankës. Përveç kësaj, ajo e konsideroi rrëfimin e kërkuesit si të gënjeshtërt dhe nuk e gjykoi të besueshëm.

Më 16 shtator 1997, kërkuesi u largua nga Gjermania, udhëtoi për në Itali dhe më 19 shtator të 1997 arriti në Mbretërinë e Bashkuar. Më 20 shtator 1997 ai kërkoi azil atje.

Më 15 janar të vitit 1998, qeveria e Mbretërisë së Bashkuar i kërkoi Gjermanisë të pranojë përgjegjësinë për kërkesën për azil të aplikantit në bazë të Konventës së Dublinit. Qeveria gjermane ra dakord dhe më 28 janar 1998 Sekretari i Shtetit urdhëroi largimin e kërkuesit për në Gjermani, duke refuzuar shqyrtimin në themel të kërkesës për azil të tij.

Më 10 shkurt 1998, kërkuesi kërkoi shqyrtimin gjyqësor, por iu refuzua. Më 10 qershor 1998, Gjykata e Apelit e hodhi poshtë kërkesën e re të tij dhe një muaj më pas kërkesa e tij për t'u lejuar t'i drejtohej Dhomës së Lordëve gjithashtu u refuzua. Më 19 gusht 1998, Sekretari i Shtetit njoftoi kërkuesin se ishte i bindur që Gjermania ishte një vend i tretë i sigurt. Ai vuri në dukje se ishte e qartë që autoritetet gjermane kishin detyrimin ligjor për të vlerësuar çdo material të ri që iu paraqitej. Më 19 gusht 1998, u nxor urdhri për largimin e kërkuesit në Gjermani.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi pretendoi se vendimi i largimit të tij nga Mbretëria e Bashkuar në Gjermani, nga ku do të kthehej menjëherë në Sri Lanka, shkelte nenet 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës. Ai pohoi se, nëse kthehej në Sri Lanka, rrezikonte realisht të përballej me trajtim në kundërshtim me nenin 3. Ai pohoi se autoritetet gjermane nuk do ta rishqyrtonin kërkesën e tij për azil nëse ai kthehej në Gjermani pasi dëshmitë e tij ishin konsideruar si jo relevante. Sipas nenit 13, ai deklaroi se shqyrtimi gjyqësor nuk ishte një mjet efektiv ligjor duke qenë se, në kontekstin e kthimit në një vend të tretë të konsideruar të sigurt në bazë të Konventës së Dublinit, gjykatat e Mbretërisë së Bashkuar nuk kishin bërë një "shqyrtim të detajuar" të kërkesave për azil.

### Në lidhje me nenin 3

Gjykata konstatoi se largimi i tërthortë drejt një vendi të tretë - gjithashtu Shtet

Kontraktues - nuk ndikon në përgjegjësinë e Mbretërisë së Bashkuar për të garantuar që Z. T.I. të mos ekspozohet ndaj trajtimit në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, si rezultat i urdhrimit të dëbimit. Gjithashtu, Mbretëria e Bashkuar nuk mund të mbështetet në mënyrë automatike në rregullimet e Konventës së Dublinit në lidhje me përcaktimin e përgjegjësisë ndërmjet vendeve evropiane për shqyrtimin e kërkesave për azil. Prandaj Gjykata duhet të shqyrtojë nëse Mbretëria e Bashkuar ka respektuar detyrimet e saj për të mbrojtur Z. T.I. nga shkeljet e nenit 3 të Konventës.

Lidhur me këtë, Gjykata vërejtë se para saj nuk ishin parashtruar argumente thelbësore, as nga Mbretëria e Bashkuar dhe as nga qeveria Gjermane, në lidhje me themelin e kërkesës për azil të Z. T.I. Megjithatë, ajo u shpreh se materialet e paraqitura nga Z. T.I. veçanërisht dy raportet mjekësore që mbështesnin fuqimisht pretendimet e tij se ishte torturuar, ngrinin shqetësime serioze për rreziqet me të cilat ai mund të përballej nëse kthehej në Sri Lanka, qoftë nga LTTE nëse kthehej në familjen e tij në Jaffna, qoftë nga forcat qeveritare të cilat dyshonin për përfshirjen e tij me LTTE.

Gjykata konstatoi se, pas mbërritjes në Gjermani, Z. T.I. mund të bënte një kërkesë të re për azil, duke qenë e sigurt për garancitë e ofruara nga qeveria gjermane se kërkuesi nuk do të përballej me kthimin e menjëhershëm dhe pa u respektuar procedurat formale drejt Sri Lankës. Duke qenë se urdhri i mëparshëm i dëbimit ishte lëshuar më shumë se dy vjet më parë, që kërkuesi të kthehej në vendin e tij duhej më parë të nxirrej një urdher i ri dëbimi, i cili mund të shqyrtohej nga Gjykata Administrative dhe kundër të cilit Z. T.I. mund të bënte një kërkesë për mbrojtje të përkohshme.

Gjykata pranoi se vendimi i mëparshëm gjyqësor i cili vinte shumë në pikëpyetje besueshmërinë e kërkuesit do të peshohej kundër një kërkesë për mbrojtje në këtë kontekst. Megjithatë, garancitë e dhëna nga Qeveria Gjermane në lidhje me të drejtën dhe praktikën e brendshme e bënë Gjykatën të besonte se, nëse pranohej nga autoritetet, pretendimet e Z. T.I. mund të ishin objekt i mbrojtjes së dhënë për personat që mund të përballeshin me rrezikun për jetën. Për më tepër, Gjykata nuk gjeti asnjë bazë mbi të cilën mund të supozonte se Gjermania nuk do t'i akordonte kërkuesit mbrojtje kundër kthimit në Sri Lanka, nëse do kishte argumente të forta se ai do të përballej me rrezikun real të torturës dhe keqtrajtimit.

Prandaj, Gjykata u shpreh se nuk ishte vërtetuar që ka pasur një rrezik real që Z. T.I. do të dëbohej nga Gjermania në Sri Lanka në shkelje të nenit 3. Prandaj,

Mbretëria e Bashkuar nuk kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj dispozite duke vendosur transferimin e kërkuarit në Gjermani.

Për rrjedhojë, kjo pjesë e kërkesës u refuzua si e pabazuar.

### Në lidhje me nenet 2 dhe 8

Duke marrë parasysh gjetjet e saj sipas nenit 3 të Konventës, Gjykata konstatoi se nuk ngrihej asnjë çështje më vete që të kërkonte shqyrtim sipas këtyre dispozitave.

### Në lidhje me nenin 13

Gjykata theksoi se në vendimet e saj të mëparshme, shqyrtimin gjyqësor e kishte konsideruar një mjet ligjor efektiv në lidhje me pretendimet e ngritura në bazë të 3 të Konventës në kontekstin e dëbimit dhe ekstradimit dhe nuk gjente asnjë arsye që ta ndryshonte këtë qëndrim në rastin në fjalë. Kërkuari kishte pasur mundësi të kundërshtonte arsyetimin e vendimit të Sekretarit të Shtetit për kthimin e kërkuarit në Gjermani në bazë të marrëveshjeve të arritura në bazë të Konventës së Dublinit.

Gjykata vërejt se themeli i kërkesës së Z. T.I. në bazë të Konventës binte në fushëveprimin e shqyrtimit të gjykatave, të cilat kishin mundësi t'i ofronin atij zgjidhjen që ai kërkonte.

Rrjedhimisht, kërkesa e Z. T.I. në lidhje me këtë u refuzua si e pabazuar.

## **3. Koment**

Ky vendim mbi pranueshmërinë është me rëndësi thelbësore për sqarimin e çështjes së përgjegjësisë së Shteteve sipas Konventës, kur ata krijojnë ose aderojnë në sisteme të tjera ndërkombëtare që krijojnë për ta të drejta dhe detyrime në nivel ndërkombëtar apo evropian.

Pyetja kryesore ishte nëse Mbretëria e Bashkuar ishte e detyruar, në bazë të Konventës, për të vlerësuar rreziqet e mundshme me të cilat mund të përballej kërkuari, nëse largohej nga Gjermania, shtetin përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës e tij për azil sipas Konventës së Dublinit të 1990.

Rasti ka të bëjë me regjimin juridik të krijuar në vitin 1990 nga Konventa e

Dublinit, një regjim i cili në vetvete u përfshi në të drejtën e BE-së nga Rregulloret e mëvonshme Dublin II dhe Dublin III, respektivisht në 2003 dhe 2013. Megjithatë, mesazhi ligjor i përpunuar në këtë vendim në lidhje me Konventën e Dublinit është plotësisht i zbatueshëm për Rregulloren e III të Dublinit.

Ky vendim, pavarësisht faktit që Gjykata e shpalli kërkesën të papranueshme si haptazi të pabazuar në rrethanat e caktuara të rastit, përcakton parimet e mëposhtme të zbatueshme për regjimin e Dublinit:

- (I) kthimi në një Shtet Kontraktues ndërmjetës nuk prek përgjegjësinë e Shtetit dërgues për të siguruar që kërkuesi nuk ekspozohet ndaj trajtimit në kundërshtim me nenin 3;
- (II) Shteti dërgues nuk mund të mbështetet automatikisht në rregullimet e bëra në Konventën e Dublinit;
- (III) kur Shtetet kanë krijuar organizata dhe marrëveshje ndërkombëtare bashkëpunimi, mund të ketë ndikime për të drejtat themelore.

Prandaj, Gjykata u shpreh se kthimi i një azilkërkuesi nga një Shtet Anëtar i BE-së në një tjetër, në kuadër të sistemit të Dublinit, mund të lindë përgjegjësinë e Shtetit dërgues dhe mund të çojë në shkelje të Konventës për shkak të rrezikut të ' të kthimit zinxhir' - që nënkupton se vendi pritës më pas mund të dëbojë personin në një vend ku kishte arsye serioze për të besuar se mund të përballej me një rrezik real keqtrajtimi. Prandaj, që sistemi i Dublin të funksionojë, është e nevojshme që shtetet përgjegjëse sipas këtij regjimi të bëjnë vlerësimin e duhur të rreziqeve në rastin e kthimit të azilkërkuesve në vendet e tyre të origjinës.

*Autoritetet belge nuk duhet të kishin dëbuar azilkërkuesin në Greqi për shkak të situatës së përgjithshme që përballnin azilkërkuesit në Greqi*

**VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN M.S.S.  
kundër BELGJIKËS DHE GREQISË**

(Kërkesa nr. 30696/09)

**21 janar 2011**

**1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, M.S.S., shtetas afgan, u largua nga Kabuli në fillim të vitit 2008 dhe, duke udhëtuar nëpërmjet Iranit dhe Turqisë, hyri në Bashkimin Evropian përmes Greqisë.

Më 10 shkurt 2009, ai mbërriti në Belgjikë, ku kërkoi azil. Duke u mbështetur në Rregulloren “Dublin II”, Zyra belge për të Huajt, paraqiti një kërkesë tek autoritetet greke për të marrë përgjegjësinë e shqyrtimit të kërkesës për azil. Ndërkohë që rasti ishte ende në pritje, ZKLKBR-ja i dërgoi një letër Ministrit të Belgjikës për Migracioni dhe Politikat e Azilit nëpërmjet së cilës ngrinte shqetësimin për mangësitë në procedurat e azilit dhe kushtet e pritjes të azilkërkuesve në Greqi dhe rekomandonte pezullimin e transferimeve në Greqi. Megjithatë, në fund të majit të vitit 2009, Zyra për të Huajt e urdhëroi kërkuesin të largohej për në Greqi, ku të paraqiste një kërkesë për azil. Zyra për të Huajt nuk mori asnjë përgjigje nga autoritetet greke brenda periudhës dy mujore të parashikuar nga Rregullorja, çka konsiderohej si një pranim i heshtur i kërkesës së saj. Ajo argumentoi se Belgjika nuk ishte vendi përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për azil sipas Rregullores së Dublinit II dhe se nuk kishte asnjë arsye për të dyshuar se autoritetet greke nuk do të respektonin detyrimet e tyre në çështjet e azilit.

Kërkuesi depozitoi një ankesë në Bordin e Apelit për të Huajt, duke argumentuar se rrezikonte të mbahej i ndaluar në kushte të tmerrshme në Greqi, se kishte mangësi në sistemin e azilit në Greqi dhe se kishte frikë se autoritetet greke do ta kthenin në Afganistan, pa u shqyrtuar arsyet se pse ai ishte larguar nga ai vend, ku ai pretendonte se i kishte shpëtuar tentativës për vrasje nga talebanët në hakmarrje për faktin se kishte punuar si përkthyes i trupave të forcave ajrore të stacionuara në Kabul.

Pas refuzimit të kërkesës së tij për shtyrjen e ekzekutimit, kërkuesi u transferua në Greqi më 15 qershor 2009. Me të mbërritur në aeroportin e Athinës, ai

u vu menjëherë në paraburgim në një ndërtesë aty pranë, ku sipas deklaratave të tij, ishte vendosur mbyllur në një hapësirë të vogël bashkë me 20 të burgosur të tjerë, aksesi në tualet i kufizuar, të burgosurit nuk lejoheshin jashtë në ajër të hapur, u jepej shumë pak për të ngrënë dhe duhej të flinte në dyshekë të pistë, ose në dysheme. Që prej lirimit të tij dhe lëshimit të një karte azilkërkuese, më 18 Qershor 2009, ai jetoi në rrugë, pa asnjë mjet jetese.

Pas përpjekjes për t'u larguar nga Greqia me një kartë të rreme identiteti, kërkuesi u arrestua dhe u dërgua përsëri në qendrën e ndalimit pranë aeroportit ku qëndroi për një javë. Ai pretendoi se gjatë kësaj periudhe ishte rrahur nga policia. Pas lirimit, ai jetoi në rrugë, duke marrë ndihmë herë pas here nga banorët vendas dhe kisha. Pasi iu rinovua karta e azilkërkuesit në dhjetor të vitit 2009, u ndërmoren hapa për t'i gjetur strehim, por kërkuesi në parashtrimet e tij e mohonte që kjo gjë të kishte ndodhur ndonjëherë.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi pretendoi se kushtet e ndalimit dhe të jetesës së tij në Greqi përbënin trajtim çnjerëzor dhe poshtëruës në kundërshtim me nenin 3 dhe se e drejta greke nuk parashikonte asnjë mjet ligjor efektiv në lidhje me ankesat e tij sipas neneve 2 (e drejta për jetën) dhe 3, duke shkelur kështu detyrimin sipas nenit 13. Më tej, ai u ankua se Belgjika e kishte ekspozuar atë ndaj rreziqeve që vinin si pasojë e mangësive në procedurën e azilit në Greqi, në kundërshtim me nenet 2 e 3 të Konventës dhe të kushteve shumë të këqija të ndalimit dhe jetesës në të cilat detyroheshin të qëndron azilkërkuesit, në shkelje të nenit 3. Ai më tej pohoi se nuk kishte asnjë mjet efektiv ligjor të parashikuar në të drejtën belge në lidhje me këto ankesa, në kundërshtim me nenin 13.

Më 11 qershor 2009, kërkuesi paraqiti një kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Më 2 korrik 2009 Gjykata urdhëroi vendosjen e një mase të përkohshme në zbatim të nenit 39 të Rregullores së Gjykatës duke i kërkuar Greqisë mos dëbimin e kërkuesit në Afganistan deri në përfundimin e procedurës para Gjykatës .

Më 16 mars 2010, Dhoma së cilës iu caktua çështja hoqi dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe.

### Në lidhje me nenin 3 (mbi kushtet e ndalimit në Greqi)

Gjykata ishte e vetëdijshme për barrën me të cilën duhet të përballeshin Shtetet

në kufijtë e jashtëm të BE-së nga rritja e fluksit të migrantëve dhe azilkërkuesve dhe vështirësitë në pritjen e tyre në aeroportet e mëdha ndërkombëtare. Megjithatë kjo nuk e përjashtonte Greqinë nga detyrimet e saj sipas nenit 3, duke pasur parasysh karakterin absolut të kësaj dispozite.

Kur kërkuesi mbërriti në Athinë nga Belgjika, autoritetet greke kishin qenë në dijeni të identitetit të tij dhe për faktin se ai ishte një kërkues potencial azili. Pavarësisht kësaj, ai u vu menjëherë në paraburgim, pa iu dhënë asnjë shpjegim. Raporte të ndryshme nga organet ndërkombëtare dhe organizatat jo-qeveritare të viteve të fundit konfirmonin se vendosja sistematike e azilkërkuesve në paraburgim, pa i informuar më parë për arsyet, ishte një praktikë e përhapur e autoriteteve greke. Pretendimet e kërkuesit se ishte trajtuar brutalisht nga organet e policisë gjatë periudhës së dytë të ndalimit përputheshin me dëshmitë e shumta, të mbledhura nga organizatat ndërkombëtare, në veçanti nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT). Gjetjet nga KPT-së dhe ZKLKBR-së konfirmonin edhe pretendimet e kërkuesit në lidhje me kushtet johigjienike dhe të mbipopullimit në qendrën e ndalimit pranë aeroportit ndërkombëtar të Athinës.

Pavarësisht faktit se kërkuesi ishte mbajtur i ndaluar për një periudhë relativisht të shkurtër kohe, Gjykata u shpreh se kushtet e ambienteve ku mbahej i ndaluar ai kishin qenë të papranueshme. Ajo konstatoi se, ndjenja e arbitraritetit, inferioritetit dhe ankthit si dhe efekti i madh që padyshim kishin pasur kushte të tilla në dinjitetin e personit, të marra së bashku, përbënin trajtim poshtërues. Përveç kësaj, si azilkërkues, ai ishte veçanërisht vulnerabël për shkak të emigrimit dhe përvojave traumatike që kishte përjetuar. Gjykata arriti në përfundimin se kishte shkelje të nenit 3.

### Në lidhje me nenin 3 (mbi kushtet e jetesës në Greqi)

Neni 3, në përgjithësi, nuk i detyron Shtetet Anëtare për t'i dhënë refugjatëve ndihmë financiare për t'u siguruar një standard të caktuar jetese. Megjithatë, Gjykata vlerësoi se, situata në të cilën kërkuesi e kishte gjetur veten ishte veçanërisht e rëndë. Pavarësisht detyrimeve të autoriteteve greke, sipas legjislacionit të tyre dhe Direktivës së Pritjes të BE-së, ai jetoi për muaj në varfëri të skajshme, duke mos pasur mundësi të përmbushte nevojat e tij më elementare, ushqimin, higjienën dhe një vend për të jetuar dhe duke pasur në të njëjtën kohë frikën e ndonjë sulmi apo grabitje. Rrëfimi i kërkuesit mbështetej nga raportet e shumë organizmave ndërkombëtare, në veçanti Komisionerit të i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut dhe ZKLKBR-s.



Situata, për të cilën ankohej kërkuesi, kishte filluar që prej transferimit të tij në Greqi në qershor të vitit 2009 dhe lidhej me statusin e tij si azilkërkues. Nëse autoritetet do e kishin shqyrtuar kërkesën e tij për azil menjëherë, mund t'ia kishin lehtësuar ndjeshëm vuajtjen kërkuesit. Për faj të tyre, kërkuesi e kishte gjetur veten në një situatë të papajtueshme me nenin 3. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi se kishte shkelje të kësaj dispozite.

### Në lidhje me nenin 13 i lexuar së bashku me nenin 2 dhe nenin 3 (përsa i përket Greqisë)

Palët e pranonin se situata në Afganistan vazhdonte të ishte e pasigurt dhe ky ishte një problem i përhapur. Për sa i përket rreziqeve me të cilat kërkuesi mund të përballej nëse kthehej në atë vend, së pari ishte përgjegjësia e autoriteteve greke për të shqyrtuar kërkesën e tij. Shqetësimi kryesor i Gjykatës ishte nëse ekzistonin garancitë efektive të nevojshme për ta mbrojtur atë kundër largimit arbitrar.

Ndërkohë që legjislacioni grek përmbante një numër garancish të tilla, për vite me radhë ZKLKBR-ja, Komisioneri Evropian për të Drejtat e Njeriut dhe organizata të tjera, në mënyrë të përsëritur dhe të vazhdueshme, kishin raportuar se legjislacioni përkatës nuk zbatohej në praktikë dhe se procedurat e azilit kishin mangësi strukturore.

Në problemet e identifikuara renditeshin: informacion i pa mjaftueshëm në lidhje me procedurat që duheshin ndjekur, mungesa e një sistemi të besueshëm komunikimi mes autoriteteve dhe azilkërkuesve, mungesa e trajnimit të stafit përgjegjës për kryerjen e intervistave me ta, mungesa e përkthyesve dhe e ndihmës ligjore efektive duke i privuar kështu azilkërkuesit nga mbrojtja ligjore. Si rezultat, shumë pak kërkesa azili kishin mundësinë të shqyrtoheshin seriozisht. Në të vërtetë, një raport i ZKLKBR-ës i vitit 2008 tregonte se, më pak se 0.1% e kërkesave të azilit në shkallë të parë rezultonin të suksesshme, krahasuar me normën mesatare prej 36.2% në pesë nga gjashtë vendet e BE-së të cilat, së bashku me Greqinë, kishin numrin më të madh të kërkesave për azil.

Në dritën e këtyre mangësive dhe pas shqyrtimit të efikasitetit të mjeteve ligjore ankimore që qeveria greke pretendonte se kishin qenë në dispozicion të kërkuesit, Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 13, i marrë së bashku me nenin 3. Në funksion të këtij konstatimi, Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme të shqyrtonte pretendimet sipas nenit 13, të marrë së bashku me nenin 2.

### Në lidhje me nenet 2 dhe 3: vendimi i autoriteteve belge për të ekspozuar kërkuesin ndaj procedurave të azilit në Greqi

Gjykata vërejt se autoritetet belge duhet të kishin qenë në dijeni për mangësitë procedurale të azilit në Greqi kur nxorën urdhrin e dëbimit kundër kërkuesit dhe për rrjedhojë nuk duhej të pritej që ai të mbante të gjithë barrën e provës në lidhje me rreziqet me të cilat do të përballej nëse kthehej në Greqi. ZKLLK-BR-ja e kishte lajmëruar Qeverinë belge për këtë situatë, ndërkohë që çështja e kërkuesit ishte në shqyrtim e sipër. Gjykata në vitin 2008 kishte vendosur në një rast se kthimi i një azilkërkuesi në Greqi, në bazë të Rregullores së Dublinit II, nuk shkelte Konventën, por që prej asaj kohe raporte dhe materiale të shumta ishin hartuar nga organet dhe organizatat ndërkombëtare të cilat pranonin vështirësitë praktike në zbatimin e sistemit të Dublinit në Greqi.

Në këtë kontekst, autoritetet belge nuk duhej vetëm të supozonin se kërkuesi do të trajtohej në përputhje me standardet e Konventës, por duhej të verifikonin se si autoritetet greke zbatonin në praktikë legjislacionin e tyre për azilin. Autoritetet belge dështuan ta bënin një verifikim të tillë dhe kështu transferimi i kërkuesit nga Belgjika në Greqi ishte në shkelje të nenit 3. Nuk kishte nevojë të shqyrtoheshin edhe pretendimet sipas nenit 2 të Konventës.

### Në lidhje me nenin 3: vendimi i autoriteteve belge për ta ekspozuar kërkuesin ndaj kushteve të ndalimit dhe jetës në Greqi

Gjykata tashmë kishte konstatuar se kushtet e ndalimit dhe të jetesës së kërkuesit në Greqi kishin qenë poshtëruese. Këto fakte ishin njohur dhe të verifikueshme fare thjesht nga një numër i madh burimesh, para transferimit të kërkuesit. Në këtë pikëpamje, Gjykata u shpreh se duke transferuar kërkuesin në Greqi, autoritetet belge me vetëdije e kishin ekspozuar atë ndaj kushteve të ndalimit dhe jetesës që përbënin trajtim poshtërues, në shkelje të nenit 3.

### Në lidhje me nenin 13 i marrë së bashku me nenin 2 dhe nenin 3 (përsa i përket Belgjikës)

Lidhur me pretendimin se nuk kishte asnjë mjet ligjor efektiv të parashikuar në të drejtën belge në dispozicion të kërkuesit që të kundërshtonte urdhrin të dëbimit, Qeveria belge argumentoi se një kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të këtij urdhri mund të parashtrohej tek Bordi i Ankesave për të Huajt.

Megjithatë, Gjykata konstatoi se procedura nuk i plotësonte kërkesat e përcak-

tuara nga jurisprudenca e Gjykatës, sipas së cilës çdo ankesë ku pretendohet se dëbimi në një vend tjetër do e ekspozonte ankuesin ndaj trajtimit të ndaluar nga neni 3, duhet shqyrtuar në mënyrë rigorozë dhe organi kompetent duhet të kishte mundësinë ta shqyrtonte në themel dhe të ofronte një zgjidhje të drejtë. Duke pasur parasysh procedurën e shqyrtimit të ankesave në Bordin e Ankesave për të Huajt, e cila kufizohet kryesisht në verifikimin e dëshmimeve konkrete të dëmit që mund të rezultojë nga shkelja e mundshme e nenit 3, kërkuesi nuk kishte asnjë mundësi që t'i jepet një zgjidhje në favorin e tij. Për pasojë, kishte pasur shkelje të nenit 13 i marrë në lidhje me nenin 3. Gjykata nuk e vlerësoi të nevojshme shqyrtimin e pretendimeve sipas nenit 13 i marrë në lidhje me nenin 2.

### Në lidhje me nenin 46

Gjykata e konsideroi të nevojshme urdhërimin e masave individuale të nevojshme për ekzekutimin e vendimit në lidhje me kërkuesin, pa cenuar masat e përgjithshme të nevojshme për të parandaluar shkelje të tjera të ngjashme në të ardhmen. Greqia detyrohet të shqyrtonte, pa vonesë, themelin e kërkesës për azil të M.S.S, duke respektuar kërkesat e Konventës dhe të mos dëbonte atë deri në përfundimin e këtyre procedurave.

### Në lidhje me nenin 41

Gjykata vendosi se Greqia duhet t'i paguante kërkuesit 1,000 euro në lidhje me dëmin jo material dhe 4.725 euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet. Më tej, ajo vendosi se Belgjika detyrohet t'i paguante kërkuesit 24,900 euro në lidhje me dëmin jo material dhe 7.350 euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

## **3. Koment**

Vendimi i Gjykatës në rastin *M.S.S.* solli risi në disa aspekte. Ai shënon herën e dytë që Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vendosur se dëbimi i një personi në një Shtet tjetër të Këshillit të Evropës, i cili gjithashtu është palë i KEDNJ-së e për rrjedhojë ka detyrimin t'u sigurojë të gjithë personave në juridiksionin e tij të drejtat dhe liritë e parashikuara në Konventë, përbënte shkelje të Konventës<sup>101</sup>. Në *M.S.S.*, për herë të parë, Gjykata vendosi se kthimi i një personi në një vend të Bashkimit Evropian shkelte Konventën, një mundësi e cila ishte përmendur qysh në *T.I. k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>102</sup>. Në çështjen *M.S.S.*,

101 Shih gjithashtu *Shamayev dhe të Tjerë k. Gjeorgjisë dhe Rusisë*, vendim i 12 prillit 2005, nr. 36378/02.

102 *T.I. k. Mbretëria e Bashkuar*, vendim i 7 marsit 2000, nr. 43844/98, gjithashtu e përfshirë në këtë kapitull.

Gjykata konstatoi se Belgjika shkeli nenin 3 duke kthyer kërkuesin në Greqi për shkak të kushteve të ndalimit dhe kushteve të tij të përgjithshme të jetesës në Greqi, si dhe të rrezikut të dëbimit zinxhir në rast se kërkuesit i refuzohej azili. Një tjetër mesazh i rëndësishëm i këtij konstatimi është se, supozimi se sistemi i BE-së për mbrojtjen e të drejtave themelore është në përputhje me KEDNJ-në, siç është shtjelluar në rastin *Bosphorus Airlines*,<sup>103</sup> është në vetvete i kundërshtueshëm. Në të vërtetë ky ishte një mesazh shumë i fortë dhe i qartë se sistemi Dublinin nuk ishte në gjendje t'i përgjigjej situatave të flukseve masive të azilkërkuesve, sidomos kur me këtë problem duhet të përballëshin vetëm disa shtete anëtare të BE-së.

Shkelja e të drejtave të kërkuesit si pasojë e kushteve të tij të jetesës, për të cilën Greqia u gjet përgjegjëse për shkelje të nenit 3, është gjithashtu e rëndësishme. Kjo është hera e parë që Gjykata e Strasburgut gjen shkelje të nenit 3 të Konventës për shkak të kushteve të papërshtatshme të jetesës së një personi në gjendje të lirë. Ka pasur dy arsye kryesore që e çuan Gjykatën në një përfundim të tillë. Së pari, autoritetet greke e lanë kërkuesin në kushte varfërie pasi nuk arritën të përmbushnin detyrimet e tyre ligjore, në këtë rast detyrimet ndaj azilkërkuesve në bazë të së drejtës së BE-së dhe në veçanti Direktivës nr. 2003/9 (Direktiva për Kushtet e Pritjes) ndërkohë që e vonuan për muaj shqyrtimin e kërkesës së tij për azil. Së dyti, Gjykata vlerësoi se kërkuesi, duke qenë se ishte azilkërkues, i përkiste një grupi vulnerabël. Vendimi në rastin M.S.S. ndoshta nuk sinjalizon për një të drejtë të përgjithshme për strehim apo mirëqenie, por ai padyshim e ka çuar jurisprudencën e Gjykatës përpara, në drejtim të mbrojtjes sociale për ata që janë në “kushte të veçanta pasigurie dhe cenueshmërie”

Pika e tretë e rëndësishme është gjetja e Belgjikës përgjegjëse për shkelje të nenit 13. Sistemi i Dublinit, si shumë mekanizma të së drejtës së BE-së për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Anëtare (p.sh. Mandati Evropian i Arrestit dhe dispozita të tjera për bashkëpunim ndërkufitar në fushën penale), justifikon uljen e masave mbrojtëse procedurale për shkak të parimit të besimit të ndërsjellë ndërmjet shteteve anëtare të BE-së dhe prezumimit që të gjitha Shtetet anëtare të BE-së respektojnë të drejtat e njeriut. Megjithatë, duke qenë se raportet e shumta dhe të vazhdueshme, por edhe ky rast në Strasburg, e kishin bërë të qartë se Greqia nuk ofronte garancitë e duhura procedurale dhe materiale në lidhje me azilkërkuesit, Gjykata kërkonte një “shqyrtim të

103 *Bosphorus Hava Yollari Turizmve Ticaret Anonim Şirketi k. Irlandës*, vendim [Dhoma e Madhe] i 30 qershorit 2005, nr. 45036/98.

detajuar dhe rigoroz” të kërkesës për t’u siguruar që kthimi në Greqi nuk do të rezultonte në shkelje të nenit 3. Kjo mund të sinjalizojë një nevojë për ta rimenduar sistemin e Dublinit, siç argumenton Gjyqtari Rozakis në mendimin e tij paralel, sidomos në situata të flukseve masive të azilkërkuesve që arrijnë në brigjet e vetëm disa prej Shteteve anëtare të BE-së.

*Kthimi në Itali i azilkërkuesit me dy fëmijë të vegjël në bazë të Rregullores së Dublinit II*

**VENDIMI MBI PRANUESHMËRINË NË ÇËSHTJEN SAMSAM MOHAMMED HUSSEIN DHE TË TJERË kundër HOLANDËS DHE ITALISË**

(Kërkesa nr. 27725/10)

**2 prill 2013**

**1. Faktet kryesore**

Kërkuesja, Samsam Mohammed Hussein, shtetase somalez, anëtare e klanit Hawiye/Abgal, u largua nga Somalia dhe hyri në Itali në gusht 2008.

Pasi arriti në Itali, kërkueses iu morën shenjat e gishtave dhe pasi u regjistrua si emigrante ilegale u transferua në një qendër pritjeje. Në janar të vitit 2009, pasi aplikoi për mbrojtje ndërkombëtare, iu dha mbrojtje plotësuese në Itali, si dhe leja e qëndrimit për të huajt, të vlefshme që të dyja për tre vjet.

Në maj të 2009, kërkuesja depozitoi një kërkesë për azil në Holandë. Në atë kohë ajo ishte shtatë muaj shtatzënë dhe, gjatë intervistave me autoritetet holandeze të emigracionit, pohoi se, edhe pse në Itali i ishin marrë shenjat e gishtave, ajo nuk kishte mundur të aplikonte për azil atje dhe se nuk i kishin dhënë asnjë ndihmë. Gjithashtu, ajo pohoi se ndërsa flinte në një stacion hekurudhor në Firence ishte përdhunuar dhe për pasojë kishte mbetur shtatzënë. Në gusht të vitit 2009 lindi djali i saj Nahyaan dhe në mars të vitit 2010 kërkesa e Znj. Mohammed Hussein për azil u refuzua nga autoritetet holandeze. Ata u kërkuan autoriteteve italiane të merrnin përsipër përgjegjësinë për kërkesën për azil të Znj. Mohammed Hussein, në bazë të Rregullores së Dublinit II.

Znj. Mohammed Hussein paraqiti, por pa sukses, një kërkesë të dytë në Holandë mbi bazën e zhvillimeve të reja për sa i përkiste gjendjes së saj, duke përfshirë lindjen e vajzës së saj Nowal në shkurt të vitit 2011 - e cila vuante nga një sëmundje lëkure - si dhe martesë tradicionale në prill 2010 në Holandë me një burrë tjetër dhe ndarja e tyre e mëvonshme.

Kur transferimi i saj për në Itali u caktua për në 17 qershor 2010, ajo paraqiti një kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila ishte edhe në emër të fëmijëve të saj Nahyaan dhe Nowal. Për të siguruar zhvillimin e duhur të procedurës përpara saj, Gjykata urdhëroi një masë e përkohshme sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës, duke i kërkuar Qeverisë së Holandës të mos e

kthenin Znj. Mohammed Hussein dhe fëmijët e saj në Itali, pa përfunduar procedurat para Gjykatës së Strasburgut.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Znj. Mohammed Hussein u ankua kundër të Holandës dhe Italisë. Ajo pohoi se transferimi i saj në Itali do të cenonte nenin 3 më vete si dhe në lidhje me nenin 13. Kërkesja deklaroi se, gjatë qëndrimit në Itali, nuk kishte marrë mbështetje nga autoritetet italiane dhe kishte qenë e detyruar të jetonte në rrugë. Më tej, ajo pretendoi se, nëse autoritetet holandeze do transferonin atë dhe fëmijët e saj në Itali, ata do të përfundonin në të njëjtën situatë dhe do të vuanin të njëjtën mungesë mbështetjeje, duke rrezikuar kështu edhe dëbimin arbitrar në Somali, ku ajo rrezikonte të dënohej për kryerjen e një krimi nderi. Duke u bazuar në nenin 8, Znj. Mohammed Hussein më në fund deklaroi se, nëse transferohej në Itali, nuk do të ishte në gjendje të rriste fëmijët e saj në kushte të përshtatshme.

Më tej, në ankesën e saj kundër Italisë, Znj. Mohammed Hussein pretendoi se kishte qenë objekt i trajtimit në kundërshtim me nenin 3, për shkak të kushteve të saj të jetesës.

### Në lidhje me nenin 3

Gjykata vuri në dukje se kishte mospërputhje në deklaratat e kërkuesses: fillimisht ajo u ankua se nuk kishte qenë në gjendje për të aplikuar për azil në Itali, më pas, në përgjigjen e saj ndaj parashtrimeve të Qeverisë italiane në Gjykatë, ajo konfirmoi se i ishte ofruar mundësia e qëndrimit në qendrat e pritjes për azilkërkuessit.

Gjykata konfirmoi natyrën absolute të nenit 3. Megjithatë, vlerësimi i rrezikut në rast se kërkesja kthehej ishte relativ: në varësi të gjendjes së përgjithshme në vend, konkretisht Italisë, nëse transferohej atje, dhe/ose Somalisë, duke konsideruar pasojat e parashikueshme të transferimit të kërkuesses në Itali dhe *kthimit* të saj të mundshëm në Somali, si dhe rrethanat personale të kërkuesses. Gjykata u shpreh se neni 3 nuk mund të interpretohet si detyrim i Shteteve për t'u siguruar të gjithë personave brenda juridiksionit të tyre një shtëpi dhe se kjo dispozitë nuk përbën ndonjë detyrim të përgjithshëm për t'u dhënë refugjatëve ndihmë financiare në mënyrë që të mbanin një standard të caktuar jetese. Gjykata përsëriti se, në mungesë të arsyeve humanitare jashtëzakonisht bindëse kundër kthimit, fakti që kushtet materiale dhe të jetesës të kërkuesses do të përkeqësoheshin pas largimit nga Shteti Kontraktues, nuk ishin arsye

të mjaftueshme në vetvete për të angazhuar përgjegjësinë e këtij Shteti Kontraktues në lidhje me nenin 3 .

Në rastin e Znj. Mohammed Hussein, Gjykata vuri në dukje se, tre ditë pas mbërritjes së saj në Itali, ajo ishte dërguar në një qendër pritjeje për azilkërkuessit. Më tej, Gjykata theksoi se kërkuessja ishte pajisur me një leje qëndrimi për një periudhë tre-vjeçare, që i jepte të drejtën për të përfituar nga skemat e përgjithshme për ndihmë sociale, kujdes shëndetësor, strehim social dhe arsim, në të njëjtën mënyrë si përgjithësisht shtetasit italianë.

Për më tepër, Gjykata konstatoi se, ndërkohë që qëndronte në qendrën e pritjes, ku kishte marrë kujdes mjekësor, kërkuessja, siç tregohet nga dosja e saj, nuk kishte kërkuar ndonjëherë ndihmë për gjetjen e një pune dhe/ose strehim alternativ, për të shmangur rrezikun e të mbeturit pa pastrehë dhe të jetuarit në skamje. Gjykata arriti në përfundimin se, trajtimi i Znj. Mohammed Hussein në Itali nuk arrinte nivelin e kërkuar minimal të ashpërsisë që të binte brenda fushës së veprimit të nenit 3.

Në vlerësimin e rrezikut pas transferimit në Itali, Gjykata vërejti se autoritetet holandeze do të njoftnin paraprakisht autoritetet italiane, në mënyrë që të përgatiteshin për ardhjen e tyre. Gjithashtu, Gjykata konstatoi se kërkuessja, si nënë e vetme me dy fëmijë, do të përfitonte një trajtim të veçantë, pasi konsiderohej person vulnerabël sipas së drejtës së brendshme italiane. Së fundmi, duke marrë në konsideratë raportet e paraqitura nga institucionet dhe organizatat qeveritare dhe joqeveritare mbi skemat e pritjes së azilkërkuessve në Itali, Gjykata u shpreh se nuk tregojë ndonjë mangësi sistemore në këtë sistem.

Gjykata pranoi se kishte vend për përmirësime, duke pasuar parasysh disa mungesa apo trajtimin që kishte marrë kërkuessja në gusht të vitit 2008 në Itali. Kështu, Gjykata u shpreh se Znj. Mohammed Hussein kishte dështuar të tregonte se ajo dhe fëmijët e saj nuk kishin pasur mundësi të përfitonin nga burimet në dispozicion në Itali apo se, në qoftë se do të haste në vështirësi, autoritetet italiane nuk do t'i përgjigjeshin në mënyrë adekuate çdo kërkesë për mbështetje apo ndihmë të mëtejshme. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se pretendimet e Znj. Mohammed Husseinit sipas nenit 3 kundër Holandës dhe Italisë ishin haptazi të papabazuara.

### Në lidhje me nenin 13

Gjykata u shpreh se Znj. Mohammed Hussein nuk ishte përpjekur të kundërsht-



tonte veprimet dhe/ose vendimin e marrë nga autoritetet italiane në lidhje me kërkesën e saj për azil, ndërsa në Holandë e kishte kundërshtuar vendimin e marrë nga autoritetet administrative dhe gjyqësore holandeze, megjithëse pa sukses. Për më tepër, ajo nuk kishte treguar se nuk do të kishte një mjet efektiv ligjor në dispozicion, nëse paraqiste një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në Itali.

Kështu, Gjykata arriti në përfundimin se pretendimet e kërkuarit në lidhje me nenin 13 ishin haptazi të pabazuara.

### Në lidhje me nenin 8

Gjykata konstatoi se pretendimet e Znj. Mohammed Husein sipas nenit 8 ishin tërësisht të pambështetura dhe duhet të refuzoheshin si të pabazuara.

### **3. Koment**

Duhet thënë se ky vendim erdhi pas vendimit në çështjen *M.S.S. k. Greqisë dhe Belgjikës*<sup>104</sup> dhe gjithashtu pas vendimit të Dhomës së Madhe të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian në çështjen *NS k. Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Brendshëm dhe M.E. dhe të Tjerë k. Komisionerit për Kërkesat për Azil, Ministrit të Drejtësisë, Barazisë dhe Reformës Ligjore*<sup>105</sup>.

Siç shpjegohet në komentin e vendimit *NS k. Sekretarit të Shtetit për Punët e Brendshme*, Gjykata e Luksemburgut pranoi se, supozimi që azilkërkuarit do të trajtoheshin në një mënyrë që ishte në përputhje me të drejtat themelore të njeriut, duhet të konsiderohet i kundërshtueshëm. Kjo ishte në përputhje me vendimin e GJEDNJ-së në çështjen *M.S.S.* Gjykata e Luksemburgut arriti në përfundimin se Shtetet Anëtare, përfshirë gjykatat e tyre, nuk mund t'i dërgonin azilkërkuarit në vendin e parë të hyrjes, kur ata (Shtetet Anëtare) nuk mund të mos ishin në dijeni se, mangësi sistemore në procedurat e azilit dhe kushtet e pritjes së azilkërkuarve në atë Shtet Anëtar, përbënin baza të forta për të besuar se azilkërkuari do të përballëj me rrezikun real që t'i nënshtrohej trajtimit çnjerëzor ose poshtëruar<sup>106</sup>.

104 *M.S.S. k. Greqisë dhe Belgjikës*, vendim [Dhoma e Madhe] i 21 janarit 2011, nr. 30696/09, i përfshirë gjithashtu në këtë kapitull.

105 C-411/10 dhe C-493/10, *NS k. Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Brendshëm dhe M.E. dhe të Tjerë k. Komisionerëve për Kërkesat për Azil, Ministrit të Drejtësisë, Barazisë dhe Reformës Ligjore*, vendim [Dhoma e Madhe] i 21 dhjetorit 2011, i përfshirë në praktikën gjyqësore të GJDBE-së.

106 Mund të jetë interesante për t'u shtuar se, në vendimin e Dhomës së Madhe të 5 prillit 2016, në çështjet e bashkuara

Megjithëse me një terminologji disi të ngjashme - nocioni “sistemor” është përdorur edhe në vendimin e GJEDNJ-së në çështjen *M.S.S. k. Greqisë dhe Belgjikës*, Gjykata Luksemburgut duket se ka përcaktuar pragun e “mangësive sistemore” për të përjashtuar zbatimin e transferimeve nga një Shtet Anëtar në një tjetër, në bazë të sistemit të Dublinit. Vendimi në çështjen *Mohammed Hussein* ndjek të njëjtën qasje, duke konstatuar se gjendja e përgjithshme e azilkërkuesve në Itali nuk kishte ndonjë mangësi sistemore. Gjykata, gjithashtu, vuri në dukje se kërkuesja, një nënë e vetme me dy fëmijë, do ishte në gjendje për të gjetur strehim të përshtatshëm për nevojat e saj në Itali. Duhet të theksohet se autoritetet italiane pranuan kërkesën e bërë nga autoritetet holandeze për të marrë përgjegjësinë për kërkesën për azil të kërkueses sipas nenit 10(1) të Rregullores së Dublinit II. Gjithashtu, është me vlerë për t'u vënë në dukje se sipas praktikës holandeze në rastet e largimeve të personave në nevojë në bazë të sistemit të Dublinit, kërkohet vëmendje dhe garanci të veçanta nga vendi i destinacionit dhe transferimi ndodhte vetëm pas marrjes së garancive të tilla.

-----

C-404/15 dhe C-659/15, Pál Aranyosi dhe Robert Căldăraru k. Generalstaatsanwaltschaft Bremen, në lidhje me ekzekutimin e Urdhrit Evropian të Arrestit, kur ka dyshime për kushtet e paraburgimit në Shtetin Anëtar që e nxjerr urdhër arrestin, GJDBE-ja arriti në përfundimin se “[...] kur ka dëshmi objektive, të besueshme, specifike dhe të përditësuar në lidhje me kushtet e paraburgimit në Shtetin Anëtar që nxjerr urdhër arrestin, të cilat tregojnë se ka mangësi, që mund të jenë sistematike apo të përgjithësuara, ose që mund të ndikojnë në grupe të caktuara të njerëzve, ose që mund të ndikojnë në vende të caktuara të burgimit, autoriteti gjyqësor zbatues duhet të përcaktojë, specifikisht dhe saktësisht nëse ka arsye serioze për të besuar se, personin ndaj të cilit është lëshuar urdhër arresti evropian, për qëllime të kryerjes së një ndjekje penale ose ekzekutimin e një dënimi me burg, do të ekspozohet, për shkak të kushteve të ndalimit të tij në Shtetin Anëtar që nxjerr urdhër arrestin, ndaj rrezikut real të trajtimit çnjerëzor apo poshtëruar, sipas kuptimit të nenit 4 të Kartës, në rast të dorëzimit të tij në atë Shtet Anëtar”.

*Kthimi i një familje afgane azilkërkuesish në Itali sipas Rregullores së “Dublinit”, pa garanci individuale në lidhje me kujdesin ndaj tyre, do të ishte në shkelje të nenit 3*

**VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN TARAKHEL  
kundër ZVICRËS**  
(Kërkesa nr. 29217/12)  
**4 nëntor 2014**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit, Golajan Tarakhel, i lindur në vitin 1971, gruaja e tij Meryam Habibi, e lindur në vitin 1981 dhe gjashtë fëmijët e tyre të mitur, të lindur mes viteve 1999 dhe 2012, ishin shtetas afganë të cilët jetonin në Lozanë, në Zvicër.

Z. Tarakhel dhe Znj. Habibi ishin njohur dhe martuar në Pakistan para se të jetonin në Iran për 15 vite. Më pas ata u larguan nga Irani për në Turqi, nga ku morën një anije për në Itali. Çifti dhe pesë fëmijët e tyre më të mëdhenj, zbarkuan në bregdetin italian në korrik të vitit 2011, para se t'i nënshtroheshin procedurës së identifikimit EURODAC dhe të dërgoheshin në institucionin e pritjes. Kërkuesit, pasi u përcaktua identiteti i tyre, u transferuan në Qendrën e Pritjes të Azilkërkuesve (CARA) në Bari.

Në fund të korrikut të vitit 2011, kërkuesit u larguan nga CARA pa leje dhe udhëtuan për në Austri, ku kërkuan azil por pa sukses. Më pas udhëtuan për në Zvicër dhe paraqitën atje një kërkesë për azil në nëntor të vitit 2011. Në janar të 2012, Zyra Federale e Migracionit (ZFM) në Zvicër vendosi të mos shqyrtojë kërkesën për azil pasi bazuar në Rregulloren e Dublinit të Bashkimit Evropian, shteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës ishte Italia.

Më pas, ZFM-ja urdhëroi kthimin e kërkuesve në Itali. Kërkuesit apeluan në Gjykatën Administrative Federale, e cila e hodhi poshtë ankesën në shkurt të vitit 2012. Pas kësaj, kërkuesit i kërkuan ZFM-së që rihapte procedurat e për dhënien e azilit në Zvicër, por kjo u hodh poshtë nga Gjykata Federale Administrative në mars të vitit 2012 me arsyetimin se kërkuesit nuk kishin paraqitur argumente të reja.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesit u ankuan se, në qoftë se ktheheshin në Itali, “në mungesë të garan-

cive të veçanta në lidhje me kujdesin e tyre”, do t’i nënshtroheshin trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës, si rezultat i “mangësive sistemore” në kushtet e pritjes për azilkërkuesit në Itali, në shkëlqje të nenit 3. Më tej, ata pretenduan shkëlqje të nenit 13 pasi autoritetet zvicerane nuk i kishin konsideruar siç duhej rrethanat e tyre personale dhe nuk e kishin marrë parasysh situatën e tyre si një familje në procedurat për kthimin e tyre në Itali, të cilat ishin tepër formale, automatike dhe arbitrare.

### Në lidhje me nenin 3

Gjykata ritheksoi parimin e përgjithshëm se dëbimi i azilkërkuesve nga një Shtet Kontraktues, mund të sjellë përgjegjësinë e atij Shtetit sipas nenit 3, nëse ka argumente thelbësore për të besuar se personi në fjalë do të përballej me rrezikun real të torturës ose trajtimit apo dënimit çnjerëzor ose poshtëruës në vendin pranues. Përveç kësaj, Gjykata nënvizoi faktin se një azilkërkues është “një anëtar i një grupi të veçantë, të diskriminuar dhe vulnerabël të popullsisë që ka nevojë për mbrojtje të veçantë”.

Gjykata iu referua Rekomandimeve të ZKLKBR-së dhe raportit të vitit 2012, të Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës, të cilët raportonin për një numër mangësish në kushtet e pritjes së azilkërkuesve në Itali. Kishte një mungesë të hapësirave në qendrat e pritjes, çka do të thoshte se një numër i madh i azilkërkuesve kishin mbetur pa strehim.

Në vitin 2013, ZKLKBR-ja kishte identifikuar një sërë problemesh që lidheshin me cilësinë e shërbimeve të ofruara, që ndryshonin në varësi të madhësisë së objekteve dhe të mungesës së koordinimit në nivel kombëtar. Komisioneri për të Drejtat e Njeriut, në raportin e tij të vitit 2012, kishte vërejtur ekzistencën e problemeve në lidhje me ndihmën ligjore, kujdesin dhe ndihmën psikologjike në qendrat e pritjes emergjente, kohën e marrë për të identifikuar personat në nevojë dhe ruajtjen e unitetit të familjes gjatë transferimeve.

Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se struktura dhe situata e përgjithshme e pritjes së azilkërkuesve në Itali, ngrihte dyshime serioze për kapacitetet e sistemit. Si rrjedhojë, mundësia që një numër i konsiderueshëm i azilkërkuesve mund të mbeteshin pa strehim, ose të qëndronin në objektet e mbipopulluara pa asnjë intimitet, apo edhe në kushte jo të shëndetshme e të dhunshme, nuk mund të hidhej poshtë si e pabazë. Prandaj, ishte e nevojshme të shqyrtohej situata individuale e kërkuesve në dritën e situatës së përgjithshme që mbi-zotëronte në Itali, në kohën përkatëse, në lidhje me kushtet e pritjes.

Duke pasur parasysh se ambientet e pritjes në Itali ishin të papërshtatshme, Shteti zviceran ishte përgjegjës për të marrë garancitë e mjaftueshme nga autoritetet italiane, që kërkuesve do t'u viheshin në dispozicion ambiente me kushte të përshtatshme për moshën e fëmijëve të tyre dhe se familja do të qëndronte së bashku, nëse ktheheshin në Itali. Edhe pse ZFM-ja ishte kontaktuar nga autoritetet italiane në lidhje me strehimin e familjes, autoritetet zvicerane nuk kishin marrë informacion mjaftueshëm të detajuar që të mund të ishin të sigurt se kërkuesit do të trajtoheshin në mënyrë të përshtatshme.

Në mungesë të garancive të tilla individuale, Gjykata konstatoi se do të kishte shkelje të nenit 3 të Konventës nëse kërkuesit do të ktheheshin në Itali pa u marrë më parë garanci të tilla individuale specifike në raport me situatën e tyre individuale dhe familjare.

### Në lidhje me nenin 13 i shqyrtuar së bashku me nenin 3

Duke iu referuar intervistës së kërkuesve përpara ZFM-së dhe mundësisë për të apeluar në Gjykatën Federale Administrative, Gjykata konsideroi se kërkuesit kishin në dispozicion një mjet ankimor efektiv në lidhje me pretendimet e tyre sipas nenit 3. Prandaj, pretendimet e tyre sipas nenit 13 u refuzuan si të pabazuara.

### Në lidhje me nenin 41

Gjykata vendosi që Zvicra t'i paguante kërkuesve 7,000 euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

## **3. Koment**

Në të drejtën e azilit të BE-së, shteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare përcaktohet nga kriteret e parashikuara në Rregulloren e Dublinit. Në rastin e *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*<sup>107</sup> Dhoma e Madhe e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut vendosi se kthimi i azilkërkuesve, në zbatim të kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e Dublinit nga Belgjika në kushtet e tmerrshme të cilat i prisnin në Greqi shkelte nenin 3 të Konventës. Pas M.S.S. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian vendosi në rastin e *NS k. Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Brendshëm dhe M.E dhe të Tjerët k. Ko-*

107 *M.S.S. k. Greqisë dhe Belgjikës*, vendim [Dhoma e Madhe] i 21 janarit 2011, nr. 30696/09, i përfshirë gjithashtu në këtë kapitull.

*misionerëve për Kërkesat për Refugjatë*<sup>108</sup>, të përfshira gjithashtu në këtë publikim. Në këtë vendim, Gjykata e Luksemburg deklaroi se Shtetet Anëtare të BE-së nuk mund të transferonin një azilkërkues në «Shtetin Anëtar përgjegjës» sipas kuptimit të Rregullores së Dublinit, kur mangësitë sistemore në procedurat e azilit dhe në kushtet e pritjes të azilkërkuesve në atë Shtet Anëtar, për të cilat nuk mund të mos kishin dijeni, ishin të tilla sa të përbënin një rrezik real trajtimit çnjerëzor ose poshtërues.

Pas këtij vendimi, pyetja ishte nëse, “mangësi sistemore” ishte testi i vetëm që i detyronte Shtetet të mos kthenin azilkërkuesit përsëri në Shtetin Anëtar ku kishin hyrë për herë të parë. Duhet përmendur edhe se vetë GJEDNJ-ja e aplikoi këtë test në disa vendime që mori në vitin 2012 dhe 2013<sup>109</sup>.

Vendimi në rastin *Tarakhel*<sup>110</sup> ishte mundësia për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje. Ky rast kishte të bënte me kthimin e azilkërkuesve nga Zvicra në Itali. Zvicra nuk është, sigurisht, vend anëtar i BE-së, por ajo kishte një marrëveshje me BE-në për zbatimin e Rregullores së Dublinit. Kushtet në Itali nuk ishin aq të tmerrshme nga pikëpamja sistemore ose sistematike si në Greqi, por Gjykata nuk kishte para saj informacion të mjaftueshëm për të hedhur dyshime mbi faktin nëse Italia do e zbatonte në mënyrë të rregullt, sidomos Direktivën për kushtet e pritjes të BE-së sa i përket akomodimit të kërkuesve.

Ky vendim i rëndësishëm i Dhomës së Madhe e bën të qartë se azilkërkuesit vulnerabël, veçanërisht familjet me fëmijë të vegjël, nuk mund të ktheheshin për t'u përballur me kushtet të cilat nuk dihej si do ishin në Itali, në bazë të Rregullores së Dublinit. Vendimi e bën të qartë se nuk është testi i “mangësive sistemore të përgjithshme” që duhej zbatuar, por testi i vlerësimit të rrethanave individuale. Në këtë vendim Gjykata vendosi shkëlqe të kushtëzuar, duke i detyruar autoritetet zvicerane për të marrë garanci individuale në lidhje me çdo familje, sa i përket kushteve që i prisnin në Shtetin ku do ktheheshin. Duhet të theksohet se garancitë e veçanta janë mbrojtje të parashikuara si parim në vetë Rregulloren e Dublinit<sup>111</sup>. Pas këtij vendimi, duket se autoritetet italiane kanë reaguar duke

108 C-411/10 dhe C-493/10, NS k. Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme dhe M.E. dhe të Tjerë k. Komisionerëve për Kërkesat për Azil, Ministrit të Drejtësisë, Barazisë dhe Reformës Ligjore, vendim [Dhoma e Madhe] i 21 dhjetorit 2011, i përfshirë në praktikën gjyqësore të GJDBE-së.

109 Shih për shembull vendimin në çështjen *Samsam Mohammed Hussein dhe të Tjerë k. Holandës dhe Italisë*, vendim i 2 prillit 2013, nr. 27725/10, i përfshirë në këtë kapitull.

110 *Tarakhel k. Zvicrës*, vendim [Dhoma e Madhe] i 4 nëntorit 2014, nr. 29217/12, i përfshirë në këtë kapitull.

111 Shih veçanërisht nenin 17 dhe Kapitullin VI të Rregullores së Dublinit.

i ofruar garanci të veçanta për azilkërkuesit në nevojë, përfshirë familjet me fëmijë të vegjël<sup>112</sup>. Duket se deri tani Gjykata ka pranuar se garancitë e tilla janë në përputhje me kërkesat e vendimit *Tarakhel*<sup>113</sup>.

-----  
112 Kjo garanci u dha nëpërmjet dy letrave qarkulluese, të 8 qershorit 2015 dhe 15 shkurtit 2016, nga Njësia e Dublinit e Ministrisë Italiane të Punëve të Brendshme.

113 Shih vendimet e papranueshmërisë në rastet e *J.A. dhe të Tjerë k. Holandës*, vendim i 3 nëntorit 2015 nr. 21459/14, *A.T.H. k. Holandës*, vendim i 17 nëntorit 2015 nr. 54000/11 dhe *Rasul k. Finlandës*, vendim i 14 qershorit 2016 nr. 13630/16.

## Neni 4 - Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar

*Shkelje e detyrimit të Shtetit për të parandaluar, hetuar dhe dënuar personat përgjegjës për trafikimin e qënieve njerëzore*

### **VENDIMI PËR ÇËSHTJEN CHOWDURY DHE TË TJERË KUNDËR GREQISË**

(Kërkesë nr. 21884/15)

**30 mars 2017**

#### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit, 42 shtetas nga Bangladeshi që jetojnë në Greqi, kishin punuar si mbledhës luleshtrydhës në një fermë në Manolada nga tetorit i vitit 2012 deri në shkurt të vitit 2013, pa pasur leje pune, Për punën e bërë atyre u ishte premtuar një rrogë prej 22 € për shtatë orë punë dhe 3 € për çdo orë shtesë mbi orarin e punës. Ata punonin çdo ditë nga ora 7:00 deri në orën 19:00 nën mbikëqyrjen e rojeve të armatosur. Punëdhënësit e tyre i kishin kërcënuar se do të paguheshin vetëm nëse vazhdonin të punonin. Kërkuesit jetonin në kasolle të improvizuara pa tualete e ujë të rrjedhshëm.

Në shkurt 2013, mars 2013 dhe prill 2013 punëtorët zhvilluan greva duke kërkuar të paguheshin për punën e bërë, por pa sukses. Më 17 prill 2013 punëdhënësit rekrutuan më shumë emigrantë nga Bangladeshi. Duke qënë të frikësuar për mos marrjen e pagave, 100-150 punëtorë të sezonit të vjeljes së luleshtrydheve 2012-2013 tentuan tu afroheshin dy punëdhënësve për të kërkuar pagat e tyre. Një nga rojet hapi zjarr në drejtim të tyre duke plagosur rëndë 30 punëtorë, ku 21 prej të cilëve ishin kërkuesit në këtë çështje. Të plagosurit u dërguan në spital dhe u morën në pyetje nga policia.

Dy punëdhënësit, së bashku me rojen i cili kishte hapur zjarr dhe një rojë tjetër të armatosur, u arrestuan dhe u gjykuan për veprën penale të tentativës për vrasje - më pas u riklasifikua si dëmtime të rënda trupore - dhe për trafikim të qënieve njerëzore. Me një vendim të datës 30 korrik 2014, gjykata asiz rrëzoi akuzat ndaj tyre për trafikimin e qënieve njerëzore dhe dënoi rojën e armatosur dhe një nga punëdhënësit për dëmtime të rënda trupore dhe përdorim të paligjshëm të armëve të zjarrit. Dënimet e tyre me burgosje u zëvendësuan më dënime me gjobë. Gjithashtu, ata u urdhëruan t'u paguanin 35 punëtorëve, të cilët ishin njohur si viktimat, 1.500 euro, pra 43 € secilit prej tyre. Dy të dënuarit apeluan kundër këtij vendimi. Në kohën e vendimit të Gjykatës, ankesa e tyre ishte në pritje dhe kishte efekt pezullues.



Më 21 tetor 2014 punëtorët kërkuan nga prokurori pranë Gjykatës së Kasacionit të apelonte vendimin e gjykatës asiz, duke argumentuar se akuzat për trafikimin e qenieve njerëzore nuk ishin shqyrtuar siç duhej. Kjo kërkesë u hodh poshtë dhe pjesa e vendimit të gjykatës asiz që rrëzonte akuzat për trafikimin e qenieve njerëzore mori formë të prerë.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit pretenduan, duke u mbështetur në nenin 4 (2) të Konventës, se kishin kryer punë të detyruar. Gjithashtu, ata pretenduan se Shteti kishte detyrimin të parandalonte trafikimin e tyre, duke miratuar masa parandaluese dhe të ndëshkonte punëdhënësit.

### Neni 4

Gjykata bëri dallimin ndërmjet robërimit dhe punës së detyruar. Ajo vërejti se gjykatat kombëtare e kishin barazuar në mënyrë efektive konceptin e trafikimit me robërimin; një koncept që kërkon që viktima të ndiejë se gjendja e tij është e përhershme. Ky nuk mund të konsiderohet rasti i kërkuesve, pasi ata ishin punëtorë sezonalë. Megjithatë, faktet në fjalë, dhe në veçanti kushtet e punës së kërkuesve, çonin në konstatimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të punës së detyruar të përcaktuar në nenin 3a të “Protokollit të Palermos” dhe nenin 4 të Konventës së Këshillit të Evropës mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, ku parashikohet se shfrytëzimi përmes punës është një aspekt i trafikimit njerëzor. Gjykata riafirmoi se puna e detyruar nënkuptonte kufizime, qoftë fizike apo morale. Gjithashtu, e rëndësishme për Gjykatën në konstatimin nëse kishin të bënin me trafikim të qenieve njerëzore dhe punë të detyruar, ishte natyra e punës dhe intensiteti i saj.

Gjykata më pas shqyrtoi detyrimet e Shtetit sipas nenit 4 (2) dhe vuri në dukje se ato kishin detyrimin të miratonin një kuadër ligjor dhe administrativ që ndalonte dhe dënonte punën me dhunë ose të detyruar, robërimin apo skllavërimin. Lidhur me këtë, Gjykata vuri në dukje se Greqia kishte ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në vitin 2014. Më tej, Gjykata konkludoi se, në mënyrë që për Shtetin të lindte një detyrim pozitiv, siç është detyrimi për të hetuar, Shteti duhet të ketë qenë i vetëdijshëm për rrethanat që mund të çonin drejt përfundimit se kishte njerëz që i nënshtroheshin trajtimit të ndaluar. Në rastin në fjalë, Gjykata vërejti se Shteti ishte njoftuar, edhe para ngjarjeve të 17 prillit 2013, për situatën në plantacione e luleshtrydheve në Manolada nga raporte dhe artikuj

të shtypit. Debate kishte pasur edhe në Parlament, ku tre ministra urdhëruan inspektime dhe hartimin e akteve ligjore që synonin përmirësimin e situatës së migrantëve. Edhe Zyra e Ombudsmanit kishte paralajmëruar disa ministra dhe organe shtetërore, por nuk u arritën rezultate të prekshme deri në vitin 2013. Për më tepër, punonjësit e stacionit të policisë të Amaliada duket se ishin në dijeni për mos pagimin e punëtorëve nga punëdhënësit e plantacioneve të luleshtrydhes, pasi një oficer i policisë kishte pranuar gjatë dëshmisë së dhënë në gjykatën asiz, se punonjësit e fermës ishin ankuar për këtë situatë. Kështu, Gjykata vërejti se masat operationale të marra nga autoritetet nuk kishin qenë të mjaftueshme për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore dhe për të mbrojtur kërkuesit nga trajtimi të cilit u ishin nënshtruar.

Për të shqyrtuar efektivitetin e hetimit dhe procedurat gjyqësore të ndërmarra, pra për të parë nëse Shteti kishte përmbushur detyrimin e tij sipas nenit 4, Gjykata i ndau kërkuesit në dy grupe, ata që kishin marrë pjesë në procedurat para gjykatës kompetente dhe ata të cilët nuk kishin marrë pjesë në këto procedura. Lidhur me këta të fundit, Gjykata vuri në dukje se ata kishin paraqitur një ankesë më 8 maj 2013 duke pretenduar se ishin punësuar në fermën që i përkiste T.A. dhe N.V në kushtet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të punës së detyruar. Ankesa e tyre ishte hedhur poshtë pasi prokurori vërejti që nëse vërtetë ata do të kishin qenë viktimë, do ta kishin raportuar ngjarjen më 17 prill 2013, në vend që të prisnin deri më 8 maj 2013. Gjykata u shpreh se duke mos verifikuar vërtetësinë e akuzave, prokurori nuk kishte respektuar detyrimin e tij për të kryer një hetim. Neni 13 i Konventës së Këshillit të Evropës mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore parashikonte një “periudhë rikuperimi dhe reflektimi” prej së paku 30 ditësh, në mënyrë që personi në fjalë të mund ta rimerrte veten nga situata e krijuar, t’i shpëtonte ndikimit të trafikantëve dhe të merrte një vendim pasi të ishte mirë informuar për të bashkëpunuar me autoritetet kompetente. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 4 (2) të Konventës në lidhje me detyrimin procedural për të kryer një hetim efektiv. Për sa i përket kërkuesve të cilët kishin marrë pjesë në procedurat para gjykatës kompetente, Gjykata vuri në dukje se gjykata kombëtare i kishte liruar të pandehurit nga akuzat për trafikim, pasi lëvizja e punëtorëve nuk ishte e kufizuar. Sidoqoftë, kufizimi i lëvizjes nuk është një kushti i vetëm që të jemi në kushtet e punës së detyruar apo trafikim njerëzor. Në çdo rast, Gjykata vërejti se kërkuesit nuk kishin leje pune apo leje qëndrimi në Greqi dhe për rrjedhojë çdo përpjekje për të lënë punën mund të sillte rrezikun e dëbimit. Për më tepër, duke qenë se nuk ishin paguar nuk mund ta linin punën për shkak të pamundësisë financiare.

Për më tepër, dënimi me burgim i të pandehurve për lëndime të rënda trupore ishte konvertuar në një dënim financiar prej 5 € për cdo ditë burgim. Gjykata asiz kishte urdhëruar T.A. dhe një nga rojet e armatosura për të paguar të dy 1,500 €, ose 43 € për cdo punonjës të dëmtuar. Megjithatë, neni 15 i Konventës së Këshillit të Evropës mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore kërkonte që Shtetet Kontraktuese, përfshirë Greqinë, të garantonin të drejtën e viktimave për t'u kompensuar nga personat që kanë kryer veprën penale ndaj tyre dhe, ndër të tjera, për të krijuar një fond kompensimi për viktimat.

Kështu, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 4 (2) të Konventës në lidhje me detyrimin procedural të Shtetit për të kryer një hetim efektiv mbi gjendjen e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të punës së detyruar të pretenduar nga kërkuesit dhe për të garantuar procedura efektive gjyqësore.

#### Neni 41

Gjykata vendosi se Greqia duhet t'i paguante secilit prej kërkuesve, të cilët kishin marrë pjesë në procedurat para gjykatës kompetente 16,000 € dhe 12,000 € kërkuesve të tjerë në lidhje me të gjitha dëmet e pësuar, si dhe 4,363.64 € për të gjithë kërkuesit në lidhje me kostot dhe shpenzimeve.

### **3. Komente**

Qëndrimi që mbajti Gjykata në këtë vendim është një risi dhe përbën një shtojcë dhe sqarim thelbësor për praktikën gjyqësore të Gjykatës sipas nenit 4, e cila deri më tani ka qenë mjaft e kufizuar. Analiza e Gjykatës ndjek hapa progresivë dhe impakti i këtij vendimi është në katër aspekte.

Aspekti i parë i rëndësishëm i këtij vendimi ka të bëjë me fushën e zbatimit të nenit 4 dhe përkufizimin e punës së detyruar. Situata e kërkuesve në rastin në fjalë ishte e ndryshme nga ajo në rastet e tjera ku Gjykata kishte përdorur nenin 4 e për rrjedhojë ajo vërejti se situata e tyre nuk përbënte robërim,<sup>114</sup> kryesisht për shkak se kërkuesit ishin punonjës sezonalë dhe, të paktën në teori, mund të largoheshin nga feramat e luleshtrydheve në Manolada ku punonin. Megjithatë, Gjykata vendosi se kërkuesit ishin në situatën e punës së detyruar dhe trafikimit njerëzor. Fakti që kërkuesit i frikësoheshin mos pagimit të detyrimeve financiare të prapambetur nga punëdhënësi, fakti që ata puno-

114 Shih në krahasim me çështjen *Siliadin k. Francës*, vendim i 26 korrikut 2005, nr. 73316/01, dhe *C.N. dhe V. k. Francës*, vendim i 11 tetorit 2012, nr. 67724/09.

nin për orë të tëra dhe të rrethuar nga rojet, nën kërcënimet e vazhdueshme të punëdhënësit e tyre që i paguanin shumë pak, i mjaftuan Gjykatës për të konkluduar se kërkuesit ishin në situatën e punës të detyruar dhe trafikimit njerëzor. Qendra AIRE, në cilësinë e palës së tretë ndërhyrëse në këtë çështje, theksoi veçanërisht rëndësinë e përcaktimit të elementeve përbërës të nenit 4 (2).<sup>115</sup>

Shumë i lidhur me aspektin e parë të impaktit të këtij vendimi është aspekti i dytë - përdorimi në arsyetimin e Gjykatës së Konventës së Këshillit të Evropës mbi Veprimin Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Për të arritur në përfundimin se situata e kërkuesve duhej të konsiderohej punë e detyruar dhe trafikim, si dhe për të qartësuar përcaktimin e situatës së tyre nga gjykatat vendase, Gjykata e Strasburgut e bazoi analizën e saj mbi këtë Konventë,<sup>116</sup> dhe në Protokollin e Palermos<sup>117</sup> të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar. Gjykata e përdori Konventën e Trafikimit të Këshillit të Evropës edhe për të përcaktuar fushëveprimin e detyrimeve pozitive që Shtetet kanë sipas nenit 4 të Konventës. Gjykata theksoi se detyrimet pozitive të Shteteve Anëtare sipas nenit 4 të Konventës duhet të interpretohen në bazë të Konventës për Trafikimin dhe interpretimeve të GRETA-s (një grup ekspertësh përgjegjës për monitorimin e zbatimit të saj). Është e rëndësishme të theksohet se në kohën e ngjarjeve në fjalë, Konventa e Trafikimit ende nuk ishte në fuqi në Greqi, por kjo nuk e pengoi Gjykatën që t'i referohej asaj me qëllim qartësimin e përkufizimit të punës së detyruar, trafikimit të qenieve njerëzore dhe shtrirjen e detyrimeve pozitive të Shteteve në situata të tilla.

Analiza e detyrimeve pozitive të Shteteve përbën kontributin e tretë të madh të këtij vendimi. Duke iu referuar *Siliadin kundër Francës*, Gjykata rikujtoi se, përveç miratimit të masave parandaluese, mbrojtjes së viktimave dhe kryerjes së hetimeve, detyrimet pozitive të Shtetit përfshijnë edhe kriminalizimin dhe dënimin efektiv të çdo akti që synon mbajtjen e një personi në situata të tilla - ky është një udhërrëfyes për Gjykatën gjatë kryerjes së analizës së saj. Gjykata analizoi së pari detyrimin për të pasur një kornizë ligjore dhe rregulluese, së dyti, masat operacionale dhe së treti, efektivitetin e hetimit dhe të procedurave gjyqësore. Megjithëse Gjykata konstatoi se Greqia kishte përmbushur

115 Shih ndërhyrjen nga Qendra AIRE në paragrafin 85 të vendimit.

116 Konventa e Këshillit të Evropës mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, e hapur për firmosje më 16 maj 2005 dhe hyrë në fuqi më 1 shkurt 2008.

117 Protokollin për të Parandaluar, Shtypur dhe Dënuar Trafikimin e Personave, Vecanërisht i Grave dhe Fëmijëve i miratuar nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 55/25. Ajo hyri në fuqi më 25 dhjetor 2003.

aspektin e parë të detyrimeve të saj pozitive sipas nenit 4 (2), ajo kishte kishte dështuar të respektonte elementët e dytë dhe të tretë të këtyre detyrimeve.

Arsyeja e katërt se pse ky vendim është veçanërisht i rëndësishëm, qëndron në statusin e 42 kërkuesve. Ata ishin të gjithë emigrantë nga Bangladeshi dhe vulnerabiliteti i tyre jo vetëm që kishte kontribuar në abuzimin e tyre nga punëdhënësi dhe për rrjedhojë shtetet duhet të tregonin një vëmendje të veçantë në këtë drejtim, por ka një rëndësi vendimtare në kualifikimin ligjor të abuzimit të tyre. Gjykata në mënyrë specifike iu referua situatës së tyre vulnerabël që i bëri kërkuesit të pranonin të punonin në ato kushte në fermën në Manolada dhe të mos ishin në gjendje të largoheshin dhe të kërkonin mundësi të tjera punësimi.

## Neni 5 – E drejta për Liri dhe Siguri

*Arrestimi një shtetasi afgan, në pritje të dëbimit, për posedim të dokumenteve të falsifikuara të udhëtimit*

### **VENDIMI NË ÇËSHTJEN TABESH kundër GREQISË**

(Kërkesa nr. 8256/07)

**26 nëntor 2009**

#### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Z. Rafk Tabesh, shtetas afgan i cili kishte hyrë në Greqi në mënyrë të parregullt, u dënua për posedim të dokumenteve të falsifikuara të udhëtimit. Autoritet urdhëruan dëbimin e tij për shkak të dënimit të tij penal dhe vendosën qëndrimin e tij në paraburgim në pritje të largimit bazuar në pretendimin se kërkuesi përbënte rrezik për publikun dhe mund të arratisesh.

Ai u mbajt për shtatë ditë në ambientet e Policisë Kufitare në Kordelio para se të transferohej në Drejtorinë e Policisë për të Huajt në Selanik. Kërkuesi e kundërshtoi ndalimin e tij por kërkesa e tij u rrëzua në janar të vitit 2007 nga Kryetari i Gjykatës Administrative të Selanikut. Më 28 mars 2007, kërkuesi u lirua pasi periodha maksimale tre-mujore e parashikuar nga ligji për ndalimin e tij kishte përfunduar dhe ai nuk mund të dëbohej në Afganistan pasi nuk kishte dokumente udhëtimi.

#### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi u ankua se, kushtet e ndalimit të tij në ambientet e Policisë Kufitare Kordelio dhe në Drejtorinë e Policisë për të Huajt në Selanik, përbënin trajtim çnjerëzor dhe poshtëruar në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Gjithashtu, ai pretendoi shkelje të nenit 5 (1) pasi autoritetet vendore nuk kishin dhënë arsye të mjaftueshme për të justifikuar ndalimin e tij dhe se ndalimi i tij për një periudhë maksimale ligjore prej tre muajsh ishte i tepruar, pasi dëbimi i tij në Afganistan ishte i pamundur për shkak të mungesës së dokumenteve të udhëtimit. Më tej, kërkuesi pretendoi se nuk kishte pasur një rishqyrtim gjyqësor efikas të ndalimit të tij, në kundërshtim me nenin 5 (4).

#### Në lidhje me nenin 3

Në vlerësimin nëse kushtet e paraburgimit të kërkuesit mund të konsidero-

heshin si çnjerëzore dhe poshtëruese, Gjykata theksoi natyrën absolute të kësaj dispozite dhe nevojën që trajtimi të arrijë një nivel minimal ashpërsie. Kërkuesi pretendoi se, ambientet e Policisë Kufitare në Kordelio ishin të mbi-populluara, të burgosurit nuk kishin mundësi të kryenin ushtrime fizike, qëndronin në kushte jo higjienike dhe nuk kishin akses në pjesën e jashtme. Në lidhje me pretendimet e kërkuesit për kushtet në Drejtorinë e Policisë së Selanikut për të Huajt, Gjykata vërejti se ato mbështeteshin nga konstatimet e një raportit të Avokatit të Popullit dhe në raportet e Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT).

Gjykata, ndalimin e kërkuesit për tre muaj në mjediset e nën komitetit ekzekutiv të policisë të Selanikut për të huajt, e konsideroi trajtim poshtëruës sipas kuptimit të nenit 3 të Konventës. Duke pasur parasysh këtë përfundim, Gjykata e vlerësoi të panevojshëm për të marrë një vendim më vete në lidhje me kushtet e ndalimit në ambientet e policisë kufitare të Kordelio, ku kërkuesi qëndroi shtatë ditët e para të ndalimit të tij.

### Në lidhje me nenin 5

Në lidhje me nenin 5 Gjykata konstatoi se Gjykata Administrative nuk e kishte shqyrtuar pretendimin e kërkuesit që dëbimi i tij nuk ishte i mundur, pasi vendi i tij i origjinës nuk i kishte konfirmuar shtetit Grek se ai ishte shtetas i tij. Duke risjellë në vëmendje vendimin e saj më të hershëm në rastin *Saadi k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>118</sup> Gjykata konstatoi se ndalimi i kërkuesit për tre muaj ishte arbitrar, pasi ai nuk mund të dëbohej pa dokumente udhëtimi dhe autoritetet greke nuk kishin ndër marrë hapat e nevojshëm për ta pajisur me këto dokumente. Në këto kushte kohëzgjatja e ndalimit të tij e kishte tejkaluar kohën logjike të nevojshme për të arritur qëllim e ndjekur dhe për rrjedhojë ka pasur shkelje të nenit 5(1)(f).

Gjithashtu, Gjykata vërejti se legjislacioni kombëtar (ligji nr. 3386/2005) nuk parashikonte mundësinë që një person i huaj, i ndaluar në pritje të dëbimit të tij, të kundërshtonte drejtpërdrejt ligjshmërinë e ndalimit duke qenë se vendimi i dëbimit dhe vendimi i ndalimit ishin të kombinuara. Kjo do të thoshte se një kundërshtim i suksesshëm në gjykatë për një masë ndalimi thjesht do rezultonte në dhënien e 30 ditë kohë për të lënë territorin, ndërsa kërkesa në gjykatën administrative për të anuluar apo pezulluar një vendim dëbimi nuk do të sillte lirimin nga paraburgimi.

118 *Saadi k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim [Dhoma e Madhe] i 29 janarit 2008, nr. 13229/03.

Duke marrë parasysh faktorët e mësipërm, Gjykata gjeti mangësi në të drejtën e brendshme në shkëlje të nenit 5(1) dhe 5(4).

### Në lidhje me nenin 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 8,000 euro për dëmin jo material dhe 3,500 euro për kostot.

### **3. Koment**

Ky vendim mund të konsiderohet si një mesazh i hershëm paralajmërues për situatën ligjore dhe faktike në lidhje me azilkërkuesit në Greqi, çështje, të cilat për fat të keq, do të paraqiteshin shpesh në Gjykatë. Kjo tashmë është një situatë e njohur dhe shqetësim i thellë për të gjithë kontinentin.

Në lidhje me nenin 3 të Konventës, vlen të përmendet se Gjykata i bazoi gjetjet e saj në raportet e Ombudsmanit grek dhe të Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT). Faktet e konstatuara nga institucionet e pavarura dhe të specializuara përbëjnë një burim të çmuar informacioni për Gjykatën në përmbushjen e funksionit të saj gjyqësor, duke pasur parasysh se ajo mund të mos ketë qasje të drejtpërdrejtë, dhe në përgjithësi nuk mund ta ketë.

Mesazhi i dytë i rëndësishëm në lidhje me nenin 3 është se, Gjykata në konstatimin e një shkëlje të këtij neni, u përqendrua në analizën për kushtet e ndalimit në ambientet e Drejtorisë së Policisë për të Huajt në Selanik. Gjykata konkludoi se ambientet e këtij stacioni policor ishin konceptuar vetëm për periudha të shkurtra burgimi dhe jo për periudha të gjata si në rastin e kërkuesit. Mbajtja e njerëzve deri në 3 muaj në mjedise të tilla përbënte shkëlje të nenit 3 të Konventës. Ky vendim i vitit 2009, në lidhje me një situatë të ndodhur në vitin 2007, tregonte se sistemi i ndalimit të azilkërkuesve në Greqi, nuk ishte në përputhje me Konventën në atë kohë.

Pika e dytë me interes në këtë vendim ka të bëjë me faktin se, ashtu si në çështjen *Saadi k. Mbretërisë së Bashkuar*, kërkuesi nuk mund të kthehej në Afganistan pasi nuk kishte asnjë dokument që vërtetonte shtetësinë e tij dhe autoritetet afgane nuk kishin konfirmuar se kërkuesi ishte shtetas i tyre. Kjo situatë, e kombinuar me mungesën e masave të shpejta nga ana e autoriteteve greke për ta sqaruar këtë situatë dhe ndalimin e kërkuesit për tre muaj, ndërkohë që perspektiva e kthimit në Afganistan nuk ishte realiste, përbënte shkëlje të nenit 5(1) të Konventës.



Mesazhi tjetër me interes që Gjykata përcolli nëpërmjet këtij vendimi ka të bëjë me legjislacionin grek në bazë të nenit 5 (4) të Konventës. Siç shpjegohet në përmbledhjen e këtij vendimi, rezultati i vetëm i mundshëm pozitiv i ankesës kundër ndalimit, në bazë të ligjit grek në fuqi, ishte urdhri për të lënë territorin brenda 30 ditëve. Në këto kushte, alternativat në dispozicion të kërkuarit ishin ose ankimi - në këtë rast e vetmja gjë që fitonte kërkuari ishte një afat 30 ditor për t'u larguar nga territori, pa vlerësimin e duhur nëse kjo përbënte shkelje të nenit 3 - ose qëndrimi në Greqi, por në paraburgim dhe në kushte që përbënin trajnim në kundërshtim me nenin 3, siç vendosi edhe Gjykata. Kjo është arsyeja pse Gjykata arriti në përfundimin se legjislacioni grek ishte në kundërshtim me nenin 5(4) të Konventës.

*Ndalimi i paligjshëm i një shtetasi algjerian në Maltë*

## **VENDIMI NË ÇËSHTJEN LOULED MASSOUD kundër MALTËS**

(Kërkesa nr. 24340/08)

**27 korrik 2010**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Z. Louled Massoud, ishte shtetas algjerian i lindur në 1960.

Z. Louled Massoud kishte hyrë në Maltë nga Libia, me anije, në qershor të vitit 2006. Ai nuk kishte asnjë dokument me vete dhe u dërgua menjëherë në ambientet e policisë. Më pas ai u akuzua dhe u shpall fajtor nga Gjykata e Magjistratëve me akuzën se kishte ndihmuar persona të tjerë për të hyrë në Maltë. Ai u dënua me tetëmbëdhjetë muaj burg.

Më 17 prill 2007, ndërkohë që ishte në burg, kërkuesi aplikoi për azil dhe u intervistua në të njëjtën ditë. Pasi shleu dënimin dhe u lirua më 27 qershor 2007, Z. Louled Massoud u vendos në një qendër ku mbaheshin personat në pritje të vendimit në lidhje me të kërkesën e tyre për azil. Kërkesa e tij për azil ishte refuzuar më 24 prill 2007. Ai e kundërshtoi këtë vendim por ankesa e tij u hodh poshtë, me argumentin se nuk kishte paraqitur dëshmi bindëse që do të përballej me rrezikun real të persekutimit, nëse kthehej në vendin e tij.

Z. Louled Massoud qëndroi i ndaluar, në pritje të dëbimit, sipas politikës së emigracionit të qeverisë, deri më 6 janar 2009, kur urdhri i tij largimi u shfuqizua duke pasur parasysh pamundësinë e dëbimit të tij eventual. Kërkuesi u ankua se kushtet në ambientet ku ishte mbajtur i ndaluar kishin qenë të papërshtatshme, të mbipopulluara, jo higjienike, me kujdes të kufizuar mjekësor, pa mundësi për aktivitete konstruktive dhe me mundësi të kufizuara rekreative.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Z. Louled Massoud pretendoi se ishte trajtuar në mënyrë çnjerëzore dhe poshtëruese si pasojë e kushteve në të cilat mbahej i ndaluar, në shkelje të nenit 3 të Konventës. Ai deklaroi se, sistemi ligjor maltez, nuk kishte vënë në dispozicion të tij asnjë mjet ligjor të shpejtë dhe efikas, në kundërshtim me nenin 5(4). Më tej, kërkuesi u ankua se ndalimi i tij pas marrjes së vendimit në lidhje me kërkesën e tij për azil kishte qenë arbitrar dhe i paligjshëm, në shkelje të nenit 5(1). Së fundmi, Z. Louled Massoud pohoi se, pasi ishte arrestuar në mbërritje,

pas një udhëtimit të gjatë në det, ishte mbajtur i ndaluar pa u informuar rreth bazës ligjore dhe faktike, siç kërkohet nga neni 5(2) të Konventës.

### Në lidhje me nenin 3

Kërkesa nuk u pranua pasi nuk ishin shteruar mjetet e brendshme ligjore, duke qenë se kërkuesi nuk kishte ngritur padi në lidhje me pretendimet sipas nenit 3 në gjykatat e brendshme kombëtare.

### Në lidhje me nenin 5(4)

Gjykata vlerësoi efektivitetin e çdo mjeti ekzistuese ligjor sipas së drejtës së brendshme malteze.

Në radhë të parë, Gjykata vërejtë se, në bazë të nenit 409A të Kodit Penal, gjykatat të cilat kishin kompetencë për shqyrtimin e kërkesave i kishin të kufizuara këto kompetenca. Në veçanti, ata nuk mund të shqyrtonin rrethanat e tjera të cilat e bënin ndalimin të paligjshëm, të tilla si papajtueshmëria me të drejtat e mbrojtura nga Konventë, parimet e përgjithshme të mishëruara në të, dhe qëllimin e kufizimeve të nenit 5(1). Rrjedhimisht, Gjykata hodhi poshtë argumentin e Qeverisë se kërkuesi duhet t'i kishte përdorur këto mjete ligjore.

Gjykata më tej mori në analizë të drejtën e ankimit përpara Bordit të Ankesave për Migracionin (BAM). Ai vuri në dukje se dispozitat ligjore përkatëse e kufizonin lirimin nga paraburgimi në rastet kur identiteti i të paraburgosurit ishte verifikuar. Për më tepër, duke pasur parasysh se këto procedura zgjatën të paktën një muaj dhe se mund të zgjasnin tre muaj ose më shumë, Gjykata theksoi se ka pasur raste që vendimi nuk ishte dhënë akoma ndërkohë që personi ishte liruar, duke e bërë këtë procedurë pa ndonjë efekt ligjor në praktikë. Kështu, procedurat para BAM-it nuk mund të konsideroheshin se përmbushnin kërkesat e një afati të shkurtër shqyrtimi, siç kërkohet nga neni 5 (4).

Së fundi, përsa i përket ankimit kushtetues, Gjykata u shpreh se këto procedura ishin komplekse për qëllimet e nenit 5(4) dhe paraqitja e një kërkesë në kushtetuese nuk garantonte një rishikim të shpejtë të ligjshmërinë së ndalimit të kërkuesit.

Në përfundim, Gjykata u shpreh se Z. Louled Massoud nuk kishte pasur në dispozicion të tij një mjet ligjor efektiv dhe të shpejtë, të parashikuar në të drejtën e brendshme për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit të tij. Për këtë arsye,

Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 5(4).

### Në lidhje me nenin 5(1)

Periudha e ndalimit, për qëllimet të kërkesës, llogaritej nga 27 qershori i vitit 2007, data kur kërkuesi ishte vendosur në një qendër ndalimi, në pritje të shqyrtimit të kërkesës së tij për azil, deri në 6 janar 2009, kur ai u lirua. Pra, ajo zgjati tetëmbëdhjetë muaj dhe nëntë ditë. Gjykata duhet të vlerësonte nëse kjo ishte e tepërt dhe nëse autoritetet e kishin kryer procedurën e dëbimit me kujdesin e duhur.

Vonesa, pavarësisht se nuk ishte aq problematike sa në raste të tjera, nuk ka ardhur për shkak pritjes së vendimit të gjykatave, pasi vendimi në lidhje me kërkesën e tij për azil ishte marrë para ndalimit të tij. Edhe duke pasur parasysh se kërkuesi ishte pa dokumente, Gjykata konstatoi se Qeveria nuk e kishte ndjekur çështjen aktivisht dhe nuk kishte hyrë në negociata me autoritetet algjeriane për të përshpejtuar dërgimin e një dokumenti identiteti. Për më tepër, ishte e pamundur që autoritetet të mos kishin në dispozicion asnjë masë tjetër për të ndërmarrë përveç ndalimit të zgjatur të kërkuetit për të siguruar dëbimin e tij të mundshëm, në mungesë të një perspektive të afërt të dëbimit të tij.

Në dritën e sa më sipër, Gjykata dyshonte se arsyet e ndalimit të kërkuetit - veprimet e ndërmarra me qëllim dëbimin e tij sipas nenit 5(1)(f) - kishin mbetur të vlefshme për të gjithë periudhën e ndalimit të tij, edhe pas refuzimit të kërkesës së tij për azil, për shkak të mungesës të një perspektive reale të dëbimit të tij dhe dështimit të mundshëm të autoriteteve për të ndjekur procedurën me kujdesin e duhur.

Më tej, Gjykata vlerësoi nëse ndalimi ishte i ligjshëm sipas të drejtës së brendshme, pra nëse ishte “në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj” dhe nëse kishte garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit.

Ligji për emigracionin nuk vendoste kufizime kohore për ndalimet dhe kërkuesi ishte mbajtur i ndaluar për një periudhë të pakufizuar. Kështu, garancitë procedurale ishin vendimtare, megjithatë Gjykata kishte vendosur tashmë se, Z. Louled Massoud nuk kishte pasur asnjë mjet ligjor efektiv në dispozicion, për të kundërshtuar ligjshmërinë dhe kohëzgjatjen e ndalimit të tij. Ajo vazhdoi më tej duke konstatuar se sistemi ligjor maltez, nuk parashikonte një procedurë që të mund të shmangte ndalimet arbitrare në pritje të dëbimit.

Gjykata arriti në përfundimin se sistemi kombëtar dështoi në detyrimin e tij për të mbrojtur kërkuesin nga ndalimi arbitrar dhe ky ndalim nuk kishte qenë “i ligjshëm” për qëllimet e nenit 5.

Rrjedhimisht, Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 5(1) të Konventës.

#### Në lidhje me nenin 5(2)

Gjykata vendosi mos pranimin e pretendimeve të kërkuesit sipas nenin 5(2), për arsye të mosrespektimit të afatit kohor prej gjashtë muajsh.

#### Në lidhje me nenin 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 12,000 euro në lidhje me dëmin jo material.

### **3. Koment**

Ky është një vendim shumë i rëndësishëm për sa i përket ligjshmërisë së ndalimit të azilkërkuesve dhe shqyrtimit të masave të ndalimit në nivel kombëtar.

Gjykata shqyrtoi së pari pretendimet e kërkuesit sipas nenit 5(4) të Konventës, i cili parashikon se “Çdo person, të cilit i është hequr liria [...], ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirim, në qoftë se burgimi është i paligjshëm”. Gjykata i analizoi një nga një të gjitha kundërshtimet e Qeverisë Malteze për sa i përket ekzistencës së mjeteve ligjore efektive për shqyrtimin e ligjshmërisë së ndalimit të kërkuesit. Gjykata u shpreh se këto mjete ligjore ose kishin objekt të kufizuar, për qëllimet e nenit 5 (1) të Konventës - si në rastin e mjetit ligjor të parashikuar nga neni 409A i Kodit Penal - ose nuk ofronin një zgjidhje të shpejtë apo ishin të komplikuar për të bërë një shqyrtim brenda një afati të shkurtër në bazë të nenit 5 (4) - siç ishte rasti i ankesës para Bordit të Ankesave për Migracionin dhe ankimi kushtetues. Duke iu referuar gjetjeve të saj të mëparshme, në lidhje me rastet e Maltës<sup>119</sup>, Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 5 (4) të Konventës.

Më pas, Gjykata mori në shqyrtim çështjen e ligjshmërisë së ndalimit të Z. Louled Massoud, si azilkërkues, në bazë të nenit 5 (1) të Konventës. Gjykata

119 Shih *Sabour Ben Ali k. Maltës*, vendim i datës 29 qershor 2000, nr. 35892/97, dhe *Kadem k. Maltës*, vendim i datës 9 janar të vitit 2003, nr. 55263/00.

konstatoi se, pasi shleu dënimin dhe u lirua, kërkuesi u ndalua përsëri në pritje të përgjigjes të kërkesës së tij për azil. Gjykata arriti në përfundimin se mbajtja në paraburgim e një azilkërkuesi për më shumë se 18 muaj, ndërkohë që kërkesa e tij për azil dhe kundërshtimi i refuzimit të azilit, ishin rrëzuar të dyja, dhe nuk kishte asnjë perspektivë që kërkuesi të largohej, nuk mund të justifikohet për qëllimet e nenit 5 (1) (f) të Konventës. Gjykata vuri në dukje se periudha e ndalimit të kërkuesit në këtë rast kishte qenë më e shkurtër se në raste të tjera që ajo kishte gjykuar<sup>120</sup>, megjithatë ajo vendosi se autoritetet malteze nuk kishin marrë hapat e duhura për lirim të kërkuesit, pasi kishin marrë vesh se ishte i pamundur dëbimi i tij në Algjeri<sup>121</sup>. Kështu, ky vendim e bën të qartë se, ndalimi “në një procedurë dëbimi” mund të justifikohet vetëm për atë kohë sa ekziston një mundësi realiste për dëbimin e personit. Kur bëhet e qartë se dëbimi ishte i pamundur për arsye të ndryshme, ndalimi nuk është më në përputhje me nenin 5(1)(f)<sup>122</sup>.

120 Iu referua vendimit në çështjen *Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim [Dhoma e Madhe] i 15 nëntorit 1996, nr. 22414/93, gjithashtu i përfshirë në këtë kapitull, dhe *Raza k. Bullgarisë*, vendim i 11 shkurtit 2010, nr. 31465/08.

121 Krahaso me vendimin në çështjen *Ali k. Zvicrës*, i 5 gushtit 1998, nr. 24881/94, ku u vendos se kishte pasur shkelje dhe me *Eid k. Italisë*, vendim i 22 janarit 2002, nr. 53490/99, ku e njëjta periudhë prej 18 muajsh nuk u konsiderua në shkelje të nenit 5 (1) të Konventës.

122 Shih gjithashtu vendimin e GJDBE-së, të 15 shkurtit 2016, C-601/15, *J.N. k. Staatssecretaris van Veiligheid en Justitie*, ku Gjykata e Luksemburgu përsëriti se Direktiva për Kushtet e Pritjes nuk e shpërfill nivelin e mbrojtjes të garantuar nga neni 5(1)(f) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili lejon arrestimin e një personi, ndaj të cilit është duke u kryer një procedurë dëbimi.

## Neni 6 - E drejta për një proces të rregullt

*Në mungesë të garancive diplomatike, kthimi i një refugjat në Jordani përbën mohim flagrant të drejtësisë*

### **VENDIM NË ÇËSHTJEN OMAR OTHMAN (ABU QATADA) kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesa nr. 8139/09)

**17 janar 2012**

#### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Omar Othman (Abu Qatada), ishte shtetas jordanez. Ai arriti në Mbretërinë e Bashkuar në shtator të vitit 1993 dhe paraqiti një kërkesë për azil, duke pretenduar në mënyrë të veçantë se kishte qenë i burgosur dhe ishte torturuar nga autoritetet jordaneze në vitin 1988 dhe ndërmjet viteve 1990-1991. Atij iu dha statusi i refugjatit në vitin 1994.

Në tetor të vitit 2002 ai u arrestua në bazë të ligjit Kundër Terrorizmit, Krimin dhe Sigurisë. Në mars 2005 ligji u shfuqizua, kërkuesi u lirua me kusht dhe ndaj tij u dha një urdhër kontrolli sipas ligjit për Parandalimin e Terrorizmit. Ndërkohë që shqyrtimi i ankesës së tij kundër urdhrin të kontrollit ishte ende në pritje, në gusht të vitit 2005, Sekretari i Shtetit njoftoi kërkuesin për dëbimin e tij në Jordani.

Z. Othman u ankua kundër vendimit të dëbimit. Për shkak se ishte dënuar në mungesë në Jordani për përfshirje në dy komplete terroriste në vitet 1999 dhe 2000, Z. Othman pretendoi se, nëse kthehej do të rigjykohej, duke rrezikuar kështu të torturohej, të qëndronte në paraburgim gjatë dhe t'i nënshtrohej një gjykimi të parregullt, pasi provat kundër tij ishin marrë duke torturuar të pandehurit e tjerë në proces.

Komisioni Special i Apelimit për Emigrantët i Mbretërisë së Bashkuar (KSPE) hodhi poshtë ankesën e tij dhe vendosi, në veçanti se, Z. Othman nuk rrezikon-te të torturohej apo keqtrajtohej pasi kishte një marrëveshje të negociuar mes Mbretërisë së Bashkuar dhe Jordanisë e vitit 2005.

Në këtë aspekt, Memorandumi i Mirëkuptimit (MiM) përcaktonte një sërë garancish të detajuara, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të cilat duhet të plotësoheshin kur një individ transferohej nga një

shtet tek tjetri. Gjithashtu, KSPE vendosi se rigjykimi nuk do të në mohonte plotësisht të drejtën e tij për një gjykim të rregullt.

Gjykata e Apelit e pranoi pjesërisht ankesën e Z. Othman. Ajo konstatoi se ekzistonte rreziku i përdorimit të dëshmimeve të marra me anë të torturës kundër tij, në qoftë se kthehej në Jordani, dhe se kjo do të shkelte ndalimin ndërkombëtar mbi torturën, duke rezultuar në një mohim flagrant të drejtësisë, në shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Më 18 shkurt 2009, Dhoma e Lordëve mbështeti gjetjet e KSPE-së. Ata vërejtën se garancitë diplomatike do ta mbronin Z. Othman nga aktet e torturës. Gjithashtu, ata vendosën se, edhe në rast se do të përdoreshin provat e marra nëpërmjet torturës në procesin penal kundër tij në Jordani, kjo nuk nënkuptonte një mohim flagrant të drejtësisë.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi pretendoi se, nëse dëbohej në Jordani, rrezikonte t'i nënshtrohej torturës dhe keqtrajtimit dhe një mohimi flagrant të drejtësisë, për shkak, ndër të tjera, të pranimit të dëshmimeve të marra nëpërmjet torturës. Kërkuesi u mbështet në nenet 3, 5, 6 dhe 13.

Kërkesa u paraqit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut më 11 shkurt 2009. Më 19 shkurt 2009 Gjykata urdhëroi vendosjen e një mase të përkohshme, sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës, ku i kërkonte Mbretërisë së Bashkuar pezullimin e vendimit të dëbimit të kërkuesit në Jordani, deri në marrjen e një vendimi nga kjo Gjykatë.

### Në lidhje me nenin 3

Duke iu referuar jurisprudencës së saj të mirë-përcaktuar, Gjykata u shpreh se Z. Othman nuk mund të dëbohej në Jordani, nëse ekzistonte rreziku real që ai të torturohej apo t'i nënshtrohej trajtimit çnjerëzor ose poshtërues.

Raportet e organeve të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të të drejtave të njeriut dëshmonin se tortura në Jordani ishte “e përhapur dhe e përsëritur”, veçanërisht kundër të dyshuarve si terroristë islamikë dhe se gjykatat apo organe të tjera në Jordani nuk garantonin mbrojtje kundër këtyre akteve.

Si islamik i një profili të lartë, Z. Othman i përkiste një kategorie të të burgo-



surve në rrezik real keqtrajtimi, madje ai pretendonte se kishte qenë objekt i torturës në kohën që jetonte në Jordani.

Kështu, Gjykata duhet të vendoste nëse garancitë diplomatike të qeverisë jordaneze, të marra nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, kishin qenë të mjaftueshme për t'i garantuar mbrojtje Z. Othman.

Gjykata vendosi se, Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet dy qeverive ishte specifik dhe gjithëpërfshirës. Garancitë diplomatike ishin dhënë në mirëbesim nga Qeveria jordaneze, marrëdhëniet e së cilës me Mbretërinë e Bashkuar kishte qenë gjithmonë shumë të mira. Garancitë ishin miratuar në nivelet më të larta të qeverisë, mbështetur edhe nga vetë Mbreti. Duke marrë parasysh profilin e lartë të Z. Othman, autoritetet jordaneze do të vepronin me kujdes për të siguruar që ai të trajtohej siç duhej dhe përveç kësaj, çdo keqtrajtım do të kishte pasoja të rënda për marrëdhëniet e Jordanisë me Mbretërinë e Bashkuar. Së fundmi, në përputhje me MiM, kërkuesi do të vizitohej rregullisht nga një organizatë e pavarur e të drejtave të njeriut në Jordani, Qendra Adaleh, e cila do të monitoronte respektimin e garancive diplomatike dhe do të kishte akses të plotë tek Z. Othman gjatë qëndrimit në burg.

Si përfundim, Gjykata vendosi se, kthimi i kërkuesit në Jordani nuk do të shkelte nenin 3, pasi ai nuk rrezikonte të keqtrajtohej.

### Në lidhje me nenin 13

Gjykata vërejtı se procedurat e KSPE-së përmbushnin kërkesat e nenit 13, prandaj vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 13.

### Në lidhje me nenin 5

Më parë, Gjykata duhej të përcaktonte nëse neni 5 ishte i zbatueshëm në rastet e dëbimit. Ajo u shpreh se, nëse neni 6 mund të zbatohet në raste të tilla - dhe për këtë arsye një kërkues mund të mbështetet tek ky nen për të parandaluar dëbimin e tij në një shtet, ku rrezikonte të përballej me burgim, pas një gjykimi haptazi të padrejtë - edhe neni 5 mund të zbatohet për të parandaluar dëbimin në një shtet ku kërkuesi ishte dënuar me burg pas një gjykimi të padrejtë. Prandaj, Gjykata u shpreh se neni 5 gjente zbatim në një rast dëbimi e për rrjedhojë, një Shtet Kontraktues që dëbonte një kërkues në një shtet ku rrezikonte realisht të mos i respektohej e drejta për liri dhe siguri, do të shkelte detyrimet sipas kësaj dispozite. Megjithatë, duhej zbatuar një prag i lartë.

Gjykata konstatoi se Jordania, qartësisht kishte për qëllim të hapte procedurat në gjykatë kundër Z. Othman dhe sipas së drejtës së brendshme jordaneze duhet ta bënte këtë brenda 50 ditëve nga ndalimi i tij. Gjykata u shpreh se, periudha 50 ditore e ndalimit nuk mund të thuhej se shkelte në mënyrë flagrante kërkesat kohore sipas nenit 5 dhe, si pasojë, nuk do të kishte shkelje të nenit 5, nëse kërkuesi dëbohej në Jordani.

### Në lidhje me nenin 6

Në jurisprudencën e Gjykatës është përcaktuar se një vendim dëbimi ose ekstradimi, kur personi ishte përballur ose rrezikonte të përballej me një mohim flagrant të drejtësisë në vendin pritës, mund të ngrinte, në raste shumë përjashtimore, një çështje në bazë të nenit 6. Termi “mohim flagrant i drejtësisë” ishte bërë sinonim i një proces që ishte haptazi në kundërshtim me dispozitat e nenit 6 dhe parimet e mishëruara në të.

Në rastin konkret, Gjykata vërejti se një mohim flagrant i drejtësisë, siç pretendonte kërkuesi, nuk përfshinte thjesht parregullsitë apo mungesën e masave mbrojtëse në procedurat e gjykimit. Në fakt, duhej të kishte një shkelje të parimeve kryesore të gjykimit të drejtë, në mënyrë të tillë që të ishin aq thelbësore sa të bënin nul ose shkatërronin vetë thelbin e së drejtës së garantuar nga neni 6.

Në këtë drejtim, Gjykata u shpreh se, përdorimi i provave të marra nëpërmjet akteve të torturës gjatë një procesi penal, do të përbënte mohim flagrant të drejtësisë, në shkelje të nenit 6. Aktet e torturës dhe përdorimi i provave të marra nëpërmjet ushtrimit të torturës, ishin të ndaluara sipas së drejtës ndërkombëtare. Pranimi, nga një gjykatë penale, i provave të marrë nëpërmjet ushtrimit të torturës do të thoshte të legjitimohej ushtrimi i torturës tek dëshmitarët dhe të dyshuarit. Për më tepër, provat të marra nga ushtrimi i torturës konsideroheshin të pabesueshme, pasi një person që torturohet pranon gjithçka vetëm që të mos torturohet më.

Gjykata vërejti se aktet e torturës ishin të përhapura në Jordani, siç ishte edhe përdorimi i provave të marra nëpërmjet torturës nga gjykatat jordaneze. Për më tepër, Gjykata, në lidhje me dy akuzat për terrorizëm kundër Z. Othman, konstatoi se provat e përfshirjes së tij ishin marrë nga njëri prej të bashkë-akuzuarve të tjerë në të njëjtin proces nëpërmjet ushtrimit të torturës. Kur dy të pandehurit e tjerë u gjykuan, gjykatat jordaneze nuk kishin ndërmarrë asnjë veprim në lidhje me ankesat e tyre për ushtrim të torturës. Gjykata u shpreh se ishte shumë e mundshme që në rigjykimin e Z. Othman do të prano-

heshin prova inkriminuese të marra nëpërmjet ushtrimit të torturës dhe ato mund të ishin me rëndësi të konsiderueshme, në mos vendimtare.

Në mungesë të një garancie diplomatike nga qeveria jordaneze se nuk do të përdroreshin prova të marra nëpërmjet torturës kundër Z. Othman, Gjykata, arriti në përfundimin se dëbimi i tij në Jordani për t'u rigjykuar do të përbente një mohim flagrant të drejtësisë, në shkelje të nenit 6.

### Në lidhje me nenin 41

Kërkuesi nuk parashtroi pretendime për shpërblim të drejtë.

### **3. Koment**

Ky ishte një rast i një profili shumë të lartë, duke qenë kërkuesi ishte një person i akuzuar për disa akte terrorizmi. Rasti është raportuar gjerësisht në media dhe diskutuar në detaje në Parlamentin Britanik.

Ky vendim është i rëndësishëm për dy arsye.

Së pari, Gjykata duhet të vendoste nëse garancitë e veçanta diplomatike të dhëna nga qeveria Jordaneze qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar ishin të mjaftueshme për të shmangur rrezikun e trajtimit në kundërshtim me nenin 3 në rastin e kërkuesit, ndërkohë që raportet e organizatave ndërkombëtare sugjeronin se aktet e torturës ishin një praktikë e përhapur në Jordani. Për këtë qëllim, Gjykata analizoi kushtet e Memorandumit të Mirëkuptimit, i nënshkruar nga dy qeveritë respektive. Gjykata konstatoi se Memorandumi ishte specifik dhe gjithëpërfshirës, garancitë ishin dhënë në frymën e mirëbesimit dhe autoritetet më të larta jordaneze e kishin miratuar këtë angazhimin. Në këtë kuadër, Gjykata e konsideroi të rëndësishëm faktin që, një OJQ e pavarur do vizitonte dhe të monitoronte respektimin e termave të garancive diplomatike në lidhje me kërkuesin. Për këtë arsye, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte asnjë rrezik keqtrajtimi për kërkuesin nëse kthehej në Jordani.

Së dyti, për herë të parë, Gjykata e Strasburgut vendosi që dëbimi i një personi do të shkelte nenin 6 të Konventës, pasi ai mund të ishte viktimë e mohimit flagrant të drejtësisë në Jordani. Gjykata theksoi se termi “mohim flagrant i drejtësisë” ishte sinonim i procesit që ishte haptazi në kundërshtim me parashikimet e nenit 6 ose parimet e mishëruara në të. E tillë ishte, sipas Gjykatës, situata e kërkuesit, ku provat kundër Z. Othman për përfshirjen e tij në kom-

plote terroriste, ishin marrë duke torturuar një nga të pandehurit e tjerë në të njëjtin proces. Fakti se përdorimi i torturës ishte i përhapur në Jordani dhe provat e nxjerra nëpërmjet torturës pranoheshin nga gjykatat jordaneze, e bënë Gjykatën të arrinte në përfundimin se kërkuesi do të përballej me një rrezik të ngjashëm gjatë rigjyimit të tij pas kthimit dhe për këtë arsye ajo vendosi se kërkuesi mund të ishte viktimë e mohimit flagrant të drejtësisë. Ky është një shembull i përsosur i interpretimit të të drejtave të Konventës si të drejta efektive dhe praktike dhe jo thjesht teorike. Nëse Gjykata do të vendoste ndryshe, do të thoshte të pranonte praktikën e torturës dhe përdorimin e saj në gjykimet penale.

### Neni 13 – E drejta për një ankim efektiv

*Një personi që për herë të parë kërkonte azil nuk iu vë në dispozicion një mjet ligjor efektiv në procedurën e përshpejtuar të shqyrtimit të çështjes së tij*

#### **Vendimi në çështjen I.M. kundër FRANCËS**

(Kërkesa nr. 9152/09)

**2 shkurt 2012**

#### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, një shtetas sudanez, kishte lindur në vitin 1976 dhe jeton në Francë. Në maj të vitit 2008 ai u arrestua nga policia sudaneze dhe kaloi tetë ditë në paraburgim. Më pas qëndroi dy muaj nën mbikëqyrjen e autoriteteve, tek të cilët ishte i detyruar të paraqitej çdo javë për t'u marrë në pyetje. Gjatë këtyre seancave të marrjes në pyetje ndaj tij ishte ushtruar edhe dhunë. Në dhjetor të vitit 2008, ai udhëtoi për në Spanjë me qëllim kalimin e kufirit për në Francë, me një vizë të falsifikuar franceze.

Kërkuesi u arrestua në Francë për “kalim të paligjshëm” të kufirit, “duke përdorur dokumente të falsifikuara”. Ai u dënua me një muaj burgim në bazë të legjislacionit për të huajt.

Sipas kërkuesit, ai bëri dy kërkesa për azil, edhe në paraburgim edhe kur po vuante dënimin në burg. Asnjëra kërkesë nuk u regjistrua.

Më 7 janar 2009 prefekti lokal urdhëroi largimin e kërkuesit. Ky u përpoq ta kundërshtonte këtë vendim, por nuk mori asnjë ndihmë nga dikush që fliste arabisht dhe mundi të komunikonte vetëm disa momente me avokatin e caktuar kryesisht para apelimit të tij më 12 janar 2009, apelim i cili u refuzua. Më 16 janar 2009 ai u arrestua dhe u mbajt në një qendër për emigrantët që prisnin të dëboheshin.

Më 19 janar ai bëri një kërkesë për azil me ndihmën e organizatës joqeveritare (OJQ) CIMADE. Më 22 janar kërkesa e tij për azil u regjistrua nga Zyra Franceze për Mbrojtjen e Refugjatëve dhe Personave pa Shtetësi (ZFMR) sipas procedurës së “përshpejtuar”, për shkak se ishte bërë pas nxjerrjes së urdhrin të dëbimit. Kërkesa duhej bërë në frëngjisht dhe brenda pesë ditëve dhe jo siç ishte normalisht, brenda 20 ditëve, por megjithatë kërkuesi duhej të paraqiste të njëjtat dokumente si aplikantët që ndiqnin procedurën normale. Më 30 janar 2009 kërkuesi zhvilloi me një agjent të shërbimeve sociale të ZFMR interv-

istën në lidhje me kërkesën për azil, e cila zgjati 30 minuta, por kërkesa e tij u refuzua më 31 janar 2009 dhe procesverbali i intervistës për azil nuk i ishte bashkangjitur vendimit të refuzimit.

Kërkuesi apeloj. Megjithatë, në shkurt të vitit 2009, para se ankesa e tij të dëgjohej, ai u dërgua nga autoritetet franceze pranë Konsullatës Sudaneze për të marrë dokumentet e udhëtimit për dëbimin e tij.

Më 16 shkurt 2009, kërkuesi iu drejtua Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, duke kërkuar pezullimin e ekzekutimit të urdhrin të dëbimit të tij, sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës. Gjykata e pranoi kërkesën e tij dhe urdhëroi mosdëbimin e kërkuesit, sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës, deri në përfundimin e procedimeve para saj.

Më 19 shkurt 2011, Tribunali Kombëtar për Azilin, i dha kërkuesit statusin e refugjatit. Ndërkohë, ai mori një vërtetim vendbanimi nga komuna e tij e origjinës në Darfur dhe një raport mjekësor të lëshuar nga një psikiatër që deklaronte se ai kishte qenë subjekt i dhunës.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi pretendoi se zbatimi i vendimit të autoriteteve franceze për dëbimin e tij në Sudan, do ta ekspozonte atë ndaj rrezikut të trajtimit në kundërshtim me nenin 3.

Duke u bazuar në nenin 13, i marrë së bashku me nenin 3, ai parashtroi se nuk kishte pasur asnjë mjet efektiv ligjor në dispozicion të tij në Francë, duke qenë se kërkesa e tij për azil ishte trajtuar sipas procedurës së përshtetur.

### Në lidhje me nenin 3

Gjykata refuzoi pretendimet e kërkuesit në bazë të kësaj dispozite, pasi ai nuk rrezikonte më të dëbohej.

### Në lidhje me nenin 13

Gjykata përsëriti se, në rastet e azilit dhe emigracionit, ajo kufizohej veten në verifikimin nëse procedurat e brendshme ishin efektive dhe nëse respektoheshin të drejtat e njeriut. Mjetet ligjore përcaktohen nga secili Shtet sipas vlerësimit të tyre; garancitë e nevojshme kundër dëbimit arbitrar mund të jep-

en edhe nga bashkimi i disa mjeteve ligjore, të parashikuara nga e drejta e brendshme, duke përbushur kështu kërkesat e nenit 13 edhe nëse nuk ka një mjet ligjor të vetëm që ta bëjë këtë.

### *Procedura para ZFMR dhe Tribunalit Kombëtar të Azilit*

Gjykata vërejt se kërkuesi nuk kishte pasur mundësi të raportonte personalisht në prefekturë siç kërkohej nga ligji francez dhe se raportet e policisë tregonin se ai kishte tentuar të aplikonte për azil, ndërkohë që ishte në gjendje arresti.

Lidhur me këtë, autoritetet kishin deklaruar se kërkesa për azil, e parashtruar nga kërkuesi ndërkohë që ishte i ndaluar në qendrën për emigrantët në pritje të dëbimit, bazohej në «një mashtrim të qëllimshëm» dhe përbënte «abuzim me procedurën e azilit», vetëm sepse ishte paraqitur pas lëshimit të urdhrin të dëbimit. Ishte për këtë arsye dhe jo për rrethanat e rastit të kërkuesit, që kërkesa e tij ishte regjistruar për shqyrtim sipas procedurës së përsheptuar.

Gjykata pranoi se procedurat e përsheptuara të azilit mund të lehtësonin proceduarën për kërkesat e azilit që ishin në mënyrë të qartë të paarsyeshme ose të pabazuara. Ri-shqyrtimi i një kërkesë për azil sipas procedurës së përsheptuar nuk privonte qytetarët e huaj, të ndaluar në qendrat e pritjes, nga shqyrtimi i hollësishëm i pretendimeve të tyre, nëse kërkesa e tyre e parë ishte shqyrtuar sipas procedurës normale, por kjo s'mund të ndodhte për kërkesat për azil që shqyrtoheshin për herë të parë, siç ishte rasti i kërkuesit.

Nëse kërkesa e tij për masë të ndërmjetme nuk do ishte pranuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në kohën e duhur, shqyrtimi i kërkesës së tij për azil nga ZFMR, sipas procedurës së përsheptuar, do të ishte shqyrtimi i vetëm i themelit të kërkesës së tij për azil, para dëbimit.

Sipas procedurës së përsheptuar, afati për paraqitjen e kërkesës reduktohej nga 21 në 5 ditë. Kjo periudhë e shkurtër e kufizonte kërkuesin, duke qenë se duhej të paraqiste kërkesën në frëngjisht, të përbushte të njëjtat kërkesa si aplikimet sipas procedurë normale dhe të paraqiste dokumente mbështetëse. Pamundësia e kërkuesit për të siguruar informacionin e nevojshëm çoi në refuzimin e kërkesës së tij.

### *Ankimi në Gjykatën Administrative*

Ankimi në gjykatën administrative kundër urdhrin të dëbimit, i cili kishte efekt

të plotë pezullues, teorikisht e bënte të mundur shqyrtimin efektiv të rreziqeve të pretenduara nga kërkuesi, me të cilat do të përballej nëse kthehej në Sudan. Megjithatë, ai kishte vetëm 48 orë për të përgatitur kërkesën e tij, krahasuar me dy muajt e lejuar në procedurë të rregullt.

Ai kishte mundur të paraqiste kërkesën e tij vetëm në formë të shkruar në gjuhën arabe, të cilën një avokat i caktuar kryesisht, të cilin ai e kishte takuar shkurtimisht para seancës, e kishte lexuar pa pasur mundësinë për të shtuar ndonjë provë. Mungesa e provave bindëse kishte çuar në refuzimin e kërkesës.

Kërkuesi u kritikua edhe se nuk kishte paraqitur më parë një kërkesë për azil, megjithatë, duke qenë se ishte i ndaluar, e kishte pasur të pamundur plotësimin e këtyre formaliteteve, duke përfshirë edhe paraqitjen personalisht në prefekturë.

Kështu, Gjykata vërejti se mjetet e brendshme ligjore kishin qenë në dispozicion në teori, por aksesit i tyre në praktikë kishte qenë i kufizuar. Ankimi i kërkuesit në gjykatën administrative ishte ndikuar negativisht nga kushtet në të cilat atij i ishte dashur ta përgatiste atë dhe ndihma e pamjaftueshme ligjore dhe gjuhësore. Për më tepër, intervista me ZFMR kishte qenë e shkurtër, vetëm 30 minuta, pavarësisht faktit se çështja ishte komplekse dhe kërkesa për azil paraqitej për herë të parë.

Ankimi i kërkuesit nuk kishte efekt pezullues nëse zbatohet procedura e përshpejtuar. Dëbimi i tij ishte penguar vetëm nga zbatimi i nenit 39 të Rregullores së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Kështu, për Gjykatën ishte e qartë se nëse nuk do kishte qenë ndërhyrja e saj, kërkuesi do të ishte dëbuar në Sudan, pa një shqyrtim të kujdesshëm të pretendimeve të tij, siç kërkohet nga Konventa.

Në përfundim Gjykata vendosi se kërkuesi nuk ka pasur një mjet ligjor efektiv në praktikë në kundërshtim me detyrimin sipas 13 i marrë së bashku me nenin 3.

### Në lidhje me nenin 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 4,746.25 euro për kostot dhe shpenzimet.

### **3. Koment**

Në vendimin e saj në çështjen e *I.M. k. Francës*, Gjykata theksoi se efektiviteti



i një mjeti ankimor “varet nga cilësia, shpejtësia dhe efekti i tij pezullues, duke marrë parasysh në veçanti rëndësinë që Gjykata i jep nenit 3 dhe dëmit të pariparueshëm që mund të shkaktohet nëse rreziku i torturës apo keqtrajtimit bëhet realitet”. Në konstatimin e të metave në procedurën e përshpejtuar, Gjykata theksoi se kërkuesi nuk kishte pasur, në praktikë, mjetet ankimore në dispozicion dhe arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të së drejtës për zgjidhje ligjore efektive. Ndër elementet kryesore të procedurës, që çuan Gjykatën të marrë këtë vendim, ishin koha e shkurtër e intervistës, mungesa e ndihmës ligjore dhe gjuhësore, por më e rëndësishmja mungesa e efektit pezullues. Në vitin 2011, një e katërta e të gjitha kërkesave për azil në Francë ishin shqyrtuar në bazë të kësaj procedure të përshpejtuar. Mungesa e një mjeti ankimor me efekt pezullues në Tribunalin Kombëtar të Azilit, për sa i përket kërkesave për azil të shqyrtuara sipas procedurës së përshpejtuar, kishte vënë mijëra njerëz në rrezik. Komiteti i Kombeve të Bashkuara kundër Torturës ka deklaruar se nuk ishte i bindur nëse procedura e përshpejtuar ofronte masa mbrojtëse kundër dëbimit, kur ekzistonte rreziku i torturës.

Interesant është fakti se në vendimin I.M. nuk bëhej asnjë referencë në të drejtën e BE-së edhe pse Direktiva e Procedurave të Azilit ishte e zbatueshme në rastin e kërkuesit.

*Transferimi i personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare nga Spanja në Marok, ku mund të përballeshin me rrezikun e trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues*

## **VENDIMI NË ÇËSHTJEN A.C. DHE TË TJERË kundër SPANJËS**

(Kërkesa nr. 6528/11)

**22 prill 2014**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit ishin tridhjetë persona me origjinë nga Sahrawi, të cilët kërkonin mbrojtje ndërkombëtare. Më 10 tetor 2010, kërkuesit ngritën tenda në kampin Gdeim Izik, në territorin e Saharasë Perëndimore, në shenjë proteste ndaj kushteve të tyre të jetesës, mënjanimit të tyre dhe kërkonin punë dhe strehim të përshtatshëm. Sipas autoriteteve marokene, kampingu ishte i paligjshëm dhe i paautorizuar.

Më 8 nëntor 2010, kur forcat e sigurisë marokene ndërhyjnë me forcë për të shpërbërë kampin, shpërthyen përleshjet. Njëmbëdhjetë anëtarë të forcave të sigurisë dhe dy Sahrawis u vranë dhe kërkuesit u larguan nga kampi. Ata arritën me anije të improvizuara në bregdetin e ishujve Kanare ndërmjet janarit 2011 dhe gushtit 2012. Disa ditë më vonë ata paraqitën kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare (azil), të cilat u refuzuan, pasi u shqyrtuan dhe u rishqyrtuan nga Ministri spanjoll i Punëve të Brendshme. Ministri urdhëroi gjithashtu dëbimin e tyre.

Më 21 janar 2011, kërkuesit iu drejtuan gjykatës për shqyrtimin e vendimeve të Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe kërkuan gjithashtu pezullimin e ekzekutimit të urdhrave të dëbimit. Më 27 janar 2011, *Audiencia Nacional* urdhëroi autoritetet administrative të pezullonin përkohësisht dëbimin e kërkuesve në fjalë deri përfundimin e shqyrtimit të pretendimeve të tyre për rreziqet që u kanoseshin në rast se ktheheshin në vendin e tyre të origjinës.

Ndërmjet 28 janarit 2011 dhe 1 tetorit të 2012, kërkuesit paraqitën tridhjetë kërkesa në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut për vendosjen e masave të përkohshme sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës. Ata parashtuan se gjatë arrestimit dhe prishjes së kampit të tyre, ata ishin keqtrajtuar nga autoritetet marokene, për shkak të origjinës së tyre Sahrawi. Gjykata e urdhëroi qeverinë spanjolle të mos dëbonte kërkuesit deri sa të përfundonte procedura para saj. Pasi kërkesat e tyre për rishikim gjyqësor u hodhën poshtë, kërkuesit

u ankuan për çështje të ligjit në Gjykatën e Lartë. Në kohën e vendimit, Gjykata nuk kishte asnjë informacion të mëtejshëm nga palët mbi rezultatin e këtyre ankesave.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u bazuar në nenin 13 (e drejta për ankim efektiv), i marrë në lidhje me nenet 2 (e drejta për jetën) dhe 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues), kërkuesit pretenduan se nuk kishin pasur mundësi të mjaftueshme për të paraqitur, në gjykatat kombëtare, argumentet e tyre në lidhje me rreziqet që u kanoseshin nëse ktheheshin në Marok.

### Në lidhje me nenin 13 i marrë së bashku me nenet 2 dhe 3

Gjykata përsëriti se koncepti i një mjete ligjor efektiv nënkuptonte mundësinë e pezullimit të zbatimit të një urdhri largimi, kur personi që do të dëbohej rrezikonte të keqtrajtohej, torturohej dhe, aq më tepër, rrezikonte jetën, në shkelje të nenit 2. Në rastin konkret, Gjykata nuk e pa të nevojshme të përcaktonte nëse dëbimi i kërkuesve, mund të cenonte nenet 2 dhe 3. Ishte detyrim i vetë autoriteteve spanjolle të shqyrtonte ankesat e kërkuesve dhe të vlerësonte rreziqet me të cilat do të përballeshin në vendin e tyre të origjinës. Shqetësimi i Gjykatës ishte nëse ekzistonin masa mbrojtëse efektive kundër dëbimit arbitrar të kërkuesve, duke pasur parasysh se ankesat e tyre mbi themelin, në kohën e vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ishin ende në pritje në gjykatat spanjolle.

Gjykata vërejti se kërkuesit i kishin përdorur mjetet ligjore në dispozicion në sistemin spanjoll, në lidhje me ankesat e tyre sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës; ata kishin kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, e cila u ishte refuzuar pasi ishte shqyrtuar dhe rishqyrtuar nga Ministri i Punëve të Brendshme. Duke qenë se procedurat e mbrojtjes ndërkombëtare në vetvete nuk kishin efekt pezullues, kërkuesit më vonë kishin kërkuar pezullimin e ekzekutimit të urdhrave të dëbimit të tyre. Me sa dukej, dhe pa paragjykuar vlerësimin e themelit nga gjykatat spanjolle, frika e kërkuesve nga keqtrajtimi, nëse ktheheshin në vendin e tyre të origjinës, nuk dukej e paarsyeshme. Megjithatë, një ditë pas vendimit të pezullimit të procedurës për dëbimin e trembëdhjetë kërkuesve të parë, *Audiencia Nacional* kishte refuzuar kërkesat e tyre për pezullimin e ekzekutimit.

Kërkesat nga shtatëmbëdhjetë kërkuesve të tjerë, gjithashtu, u hodhën posh-

të shumë shpejt, pasi autoritetet administrative ishin urdhëruar të pezullonin përkohësisht procedurën e dëbimit. *Audiencia Nacional* theksoi në mënyrë të veçantë se, argumentet e paraqitura nga kërkuesit nuk mjaftonin për të konkluduar se kishte një emergjencë të veçantë që mund të justifikonte pezullimin e të gjitha masave për largimin e tyre nga territori spanjoll. Megjithatë, për shkak të natyrës të përsheptuar të procedurës, kërkuesit nuk kishin pasur mundësi të jepnin shpjegime të mëtejshme për këto pika. Kjo ishte edhe më rëndë për kërkuesit pasi, duke qenë se kërkesat e tyre për mbrojtje ndërkombëtare nuk kishin vetë efekt pezullues, procedurat para *Audiencia Nacional* ishin mjete i tyre i vetëm ligjor që mund t'u siguronte pezullimin e ekzekutimit të dëbimit të tyre.

Gjykata është e ndërgjegjshme se Shtetet të cilat përballeshin me një numër të madh azilkërkuesish, duhej të merrnin masat e nevojshme për të përbaluar çështje gjyqësore të tilla si dhe për rrezikun që këto raste të bllokonin sistemin. Megjithatë, ashtu si neni 6 i Konventës, edhe neni 13 vendoste mbi Shteteve Kontraktuese detyrimin e organizimit të sistemeve të tyre gjyqësore në mënyrë të tillë që të mundësojnë përmbushjen e detyrimeve sipas Konventës. Kjo kërkesë nuk duhet sidoqoftë të cenojë efikasitetin e masave mbrojtëse themelore procedurale, të parashikuara në nenin 13, për mbrojtjen e kërkuesve kundër dëbimit arbitrar në vendin e tyre të origjinës.

Për më tepër, duke qenë se kërkesa për shqyrtim gjyqësor nuk kishte efekt pezullues, zbatimi i nenit 39 të Rregullores së Gjykatës ishte mjete i vetëm ligjor që kërkuesit të mund të përdornin me qëllim pezullimin e procedurës për dëbimin e tyre. Pra, nëse Gjykata nuk do të ndërhynte, kërkuesit do të ktheheshin në vendin e origjinës, pa një shqyrtim të plotë dhe të shpejtë të kërkesave të tyre për mbrojtje ndërkombëtare. Prandaj, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 13, i marrë së bashku me nenet 2 dhe 3.

### Në lidhje me nenin 46

Gjykata vuri në dukje se shkelja e nenit 13 të Konventës kishte ardhur si rezultat i mungesës së efektit jo pezullues të procedurave gjyqësore në lidhje me kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare të kërkuesve. Ajo më tej theksoi se këto kërkesa ishin ende në pritje në kohën e vendimit të Gjykatës, edhe pse grupi i parë i kërkuesve kishte aplikuar për azil që kur kishin arritur në Spanjë, në janar të vitit 2011. Në këtë kontekst, Gjykata konstatoi se Shteti i paditur ishte i detyruar t'u garantonte kërkuesve, nga pikëpamja ligjore dhe materiale, qëndrimin brenda territorit të Spanjës, në pritje të një vendimi përfundimtar nga

ana e autoriteteve vendore në lidhje me kërkesat e tyre për mbrojtje ndërkombëtare.

### 3. Koment

Rëndësia e këtij vendimi nuk qëndron tek vendosja e një standardi të ri apo të panjohur ligjor, të pa përdorur më parë nga Gjykata. Përkundrazi, ky vendim konfirmoi çfarë ka deklaruar Gjykata në shumë prej vendimeve në çështjet e saj të mëparshme, si në *Čonka k. Belgjikës*<sup>123</sup> ose *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*<sup>124</sup>, se mjetet ankimore për kundërshtimin e urdhrin të dëbimit të një azilkërkuesi në vendin e destinacionit, duhet të ketë efekt pezullues.

Gjykata gjithmonë i kishte kushtuar vëmendje të veçantë kësaj çështje. Arsyeja e parë mbështetet sigurisht në pakthyeshmërinë e situatës në rastin e dëbimit. Nëse ankesa nuk ka efekt pezullues, kjo ankesë dhe madje edhe një kërkesë eventuale në GJEDNJ nuk do të kishte asnjë efekt, nëse azilkërkuesi ndërkohë do të ishte dëbuar. Kështu, ankuesi do të gjendej jashtë mbrojtjes së Konventës dhe gjykatave kombëtare dhe ndërkombëtare që zbatonin të drejtat e Konventës. Kjo ishte edhe logjika e funksionimit të nenit 39 të Rregullores së Gjykatës, e cila në rast dëbimesh të cilat paraqesin rrezik potencial për kërkuesit, urdhëron autoritetet kombëtare për të ndaluar dëbimin deri sa Gjykata të ketë mundësinë e një vlerësimi gjyqësor të detajuar të këtij rreziku.

Arsyeja e dytë mbështetet në të drejtat e mbrojtura në shqyrtim. Kjo arsye është natyrisht e lidhur me atë natyrën e pakthyeshme të dëmit që mund të shkaktohej, sidomos në rastet ku kërkuesi rrezikonte t'i shkeleshin të drejtat sipas nenit 2 ose 3 të Konventës, Gjykata i kushton vëmendje të veçantë analizës së kujdesshme të këtij rreziku dhe rishqyrtimit në nivel kombëtar. Aq e rëndësishme është për Gjykatën mundësia e pezullimit të ekzekutimeve të tilla, sa ka insistuar që të zbatohet edhe në rastet kur rreziqe të tilla mund të ekzistojnë në Shtetet Anëtare të Konventës dhe madje edhe të Bashkimit Evropian<sup>125</sup>.

Rasti në shqyrtim e nënvizon rëndësinë e efektit pezullues të mjetit ankimor. Gjykata, në fakt, për shkak të mungesës së këtij efekti pezullues, jo vetëm që vendosi shkëlqje të nenit 13 të Konventës, të marrë në lidhje me nenet 2 dhe

123 *Čonka k. Belgjikës*, vendim i 5 shkurtit 2002, nr. 51564/99.

124 *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*, vendim [Dhoma e Madhe] i 21 janarit 2011, nr. 30696/09, i përfshirë gjithashtu në këtë kapitull.

125 Shih *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë* dhe komentet e kësaj çështje në këtë kapitull.

3, por urdhëroi autoritetet spanjolle për marrjen e masave specifike në bazë të nenit 46 të Konventës, me qëllimi garantimin e qëndrimit të kërkuesve në territorin spanjoll, derisa të shqyrtoheshin kërkesat e tyre për azil nga juridiksioni i brendshëm. Ky është një mesazh i fuqishëm për të gjitha vendet, ku ankesat kundër refuzimit të kërkesave për azil nuk gëzojnë një efekt të qartë dhe të ekzekutueshëm pezullues.

## **Neni 4 i Protokollit Nr. 4 – Ndalimi i dëbimit kolektiv**

*Kthimi i emigrantëve në Libi pa shqyrtuar çështjen e tyre, i ekspozonte ata ndaj rrezikut të keqtrajtimit dhe përbënte dëbim kolektiv*

### **VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN HIRSI JAMAA DHE TË TJERË kundër ITALISË**

(Kërkesa nr. 27765/09)

**23 shkurt 2012**

#### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit ishin 11 somalez dhe 13 shtetas nga Eritrea.

Ata ishin pjesë e një grupi me rreth 200 persona, të cilët ishin larguar nga Libia në vitin 2009 për në Itali, me tre anije. Më 6 maj 2009, kur anijet ishin 35 milje në jug të Lampedusa (Agrigento), brenda juridiksionit të kontrollit detar dhe të shpëtimit të Maltës, ata ishin kapur nga autoritetet doganore italiane dhe rojet bregdetare. Pasagjerët u transferuan në anijet ushtarake italiane dhe u dërguan në Tripoli. Kërkuesit deklaruan se gjatë udhëtimit autoritetet italiane nuk i kishin bërë me dije se për ku ishin nisur dhe as nuk kishin kontrolluar identitetet e tyre. Pas një udhëtimi 10 orësh arritën në Tripoli, ku u dorëzuan tek autoritetet libiane.

Në një konferencë shtypi, në 7 maj 2009, Ministri italian i Punëve të Brendshme deklaroi se lokalizimi i anijeve në det të hapur dhe kthimi i emigrantëve në Libi ka qenë në përputhje me marrëveshjet bilaterale me Libinë që kishin hyrë në fuqi më 4 shkurt 2009, duke shënuar një pikë të rëndësishme kthese në luftën kundër emigracionit të paligjshëm.

Kjo politikë dekurajonte bandat kriminale, të përfshira në kontrabandimin dhe trafikimin e njerëzve, ndihmonte në shpëtimin e jetëve në det dhe reduktonte ndjeshëm ardhjen e emigrantëve klandestinë në bregdetin italian. Gjatë vitit 2009 Italia kreu nëntë operacione në det të hapur për të kapur emigrantë klandestinë, në përputhje me marrëveshjet dypalëshe të lidhura me Libinë. Më 26 shkurt 2011 Ministri i Mbrojtjes italian deklaroi se marrëveshjet dypalëshe me Libinë u pezulluan pas ngjarjeve në Libi.

Sipas informacione të dorëzuara në Gjykatë nga përfaqësuesit e kërkuesve, në kohën e gjyqimit, dy prej kërkuesve kishin vdekur në rrethana të panjohu-

ra. Ndërmjet qershorit dhe tetorit 2009, katërbëdhjetë prej kërkuesve u ishte dhënë statusi i refugjatit nga zyra e Komisionerit të Lartë të OKB për Refugjatët (ZKLLKBR) në Tripoli.

Pas revolucionit në Libi, në shkurt të vitit 2011, kontakti ndërmjet kërkuesve dhe përfaqësuesve të tyre u vështirësua. Në atë kohë, avokatët ishin në kontakt me gjashtë nga kërkuesit, katër prej të cilëve jetonin në Benin, Maltë dhe Zvicër dhe disa prej të cilëve ishin ende në pritje të përgjigjes së kërkesës së tyre për mbrojtje ndërkombëtare. Njëri prej kërkuesve ishte në një kamp refugjatësh në Tunizi dhe planifikonte të kthehej në Itali. Në qershor të vitit 2011 njëri nga kërkuesit mori statusin e refugjatit në Itali, pasi ishte kthyer atje në mënyrë klandestine.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u bazuar në nenin 3, kërkuesit pretenduan se vendimi i autoriteteve italiane për t'i kthyer në Libi i kishte ekspozuar ndaj rrezikut të keqtrajtimit atje, si dhe rrezikut të keqtrajtimit në vendet e origjinës (Somali dhe Eritrea), nëse vendosej kthimi i tyre në këto vende.

Gjithashtu, ata pretenduan se ndaj tyre ishte zbatuar dëbimi kolektiv, i ndaluar nga neni 4 i Protokollit nr. 4. Së fundmi, bazuar në nenin 13, ata u ankuan se nuk kishin pasur asnjë mjet ligjor efektiv në dispozicion në Itali, kundër shkeljeve të pretenduara të nenit 3 dhe nenit 4 të Protokollit nr. 4.

### Në lidhje me nenin 1

Gjykata përsëriti parimin e të drejtës ndërkombëtare, sanksionuar në Kodin Detar Italian, se një anije që lundron në det të hapur ishte subjekt i juridiksionit ekskluziv të shtetit, flamurin e të cilit ajo mbante. Gjykata nuk mund ta pranonte përshkrimin që i bëri qeveria italiane operacionit si një “operacion shpëtimi në det të hapur» apo pretendimin se kishte ushtruar kontroll gjoja minimal mbi kërkuesit. Ngjarjet kishin ndodhur tërësisht në bordin e anijeve të forcave të armatosura italiane, ekipet e së cilës përbëheshin vetëm nga personeli ushtarak italian. Në periudhën midis hipjes në anijet italiane dhe dorëzimit tek autoritetet libiane, kërkuesin kishin qenë, në mënyrë të vazhdueshme dhe ekskluzivisht, nën kontrollin e autoriteteve italiane, *de jure* dhe *de facto*. Rrjedhimisht, në përputhje me rrethanat në fjalë, ngjarjet që kishin çuar në shkeljet e pretenduara, binin brenda juridiksionit të Italisë në kuptimin e nenit 1.



## Në lidhje me nenin 3

### *Rreziku i keqtrajtimit në Libi*

Gjykata ishte në dijeni të presionit me të cilin Shtetet po përballeshin si pasojë e rritjes së fluksit të emigrantëve, i cili ishte një fenomen veçanërisht kompleks kur ardhjet e emigrantëve ishin nga deti, por megjithatë kjo nuk i përjashtonte Shtetet nga detyrimi i tyre për të mos kthyer personat të cilët rrezikojnë t'i nënshtrohen trajtimit të ndaluar sipas nenit 3 në vendin pritës. Duke vënë në dukje se situata në Libi ishte përkeqësuar pas prillit të 2010, Gjykata vendosi të kufizojë shqyrtimin e çështjes në gjendjen që mbizotëronte në Libi në atë kohë. Ajo vuri në dukje se konkluzionet shqetësuese të organizatave të shumta, në lidhje me trajtimin e emigrantëve klandestine, ishin konfirmuar nga një raport i Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT) i vitit 2010.

Emigrantët e parregullt dhe azilkërkuesit, ndërmjet të cilëve nuk bëhej asnjë dallim, arrestoheshin në mënyrë sistematike dhe mbaheshin të ndaluar në kushte të përshkruara si jonjerëzore nga vëzhguesit, të cilët kishin raportuar, ndër të tjera, raste të torturës.

Emigrantët klandestinë rrezikonin në mënyrë të vazhdueshme të ktheheshin në vendet e tyre të origjinës dhe, nëse arrinin të rifitonin lirinë, jetonin në kushte veçanërisht të pasigurta dhe të ekspozuar ndaj akteve raciste. Italia nuk mund t'i shmangej përgjegjësisë së saj sipas Konventës, duke iu referuar detyrimeve të saj të mëvonshme që rridhnin nga marrëveshjet dypalëshe me Libinë. Më tej, Gjykata vuri në dukje, se zyra e ZKLKBR-së në Tripoli nuk njihej nga qeveria libiane. Kjo situatë, në atë kohë, ishte e njohur dhe lehtësisht e verifikueshme. Prandaj, Gjykata konkludoi se kur kërkuesit ishin transferuar, autoritetet italiane kishin dijeni ose duhej të kishin dijeni se kërkuesin rrezikonin të trajtoheshin në shkelje të Konventës.

Për më tepër, fakti se kërkuesit nuk kishin kërkuar azil shprehimisht, nuk e përjashtonte Italinë nga përgjegjësia e saj. Gjykata përsëriti detyrimet e Shteteve, që rridhnin nga e drejta ndërkombëtare, duke përfshirë edhe "*parimin e moskthimit*" sanksionuar edhe në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.

Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet italiane, pavarësisht se kishin dijeni të plotë të fakteve, duke transferuar kërkuesit në Libi, i kishin ekspozuar ata ndaj trajtimit, në shkelje të Konventës. Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 3.

### *Rreziku i keqtrajtimit në vendin e origjinës të kërkuesve*

Largimi i indirekt i një të huaji nuk bënte përgjegjës Shtetin që e largonte, mjafton që ky Shtet të sigurohej se vendi ndërmjetës ofronte garanci të mjaftueshme kundër kthimit arbitrar, veçanërisht kur ky Shtet nuk ishte palë në Konventë. Në rastin në fjalë, Gjykata duhet të përcaktonte nëse këto garanci ishin dhënë.

Të gjitha informacionet që posedonte Gjykata, tregonin, *prima facie*, se gjendja e pasigurisë ishte e përhapur në Somali dhe në Eritrea; individët i nënshtroheshin akteve të dhunës dhe mbaheshin të ndaluar në kushte çnjerëzore, thjesht sepse ishin larguar nga vendi në mënyrë të pa ligjshme. Për këtë arsye, kërkuesit pretenduan se riadhesimi i tyre do të shkelte nenin 3 të Konventës. Gjykata vërejti se Libia nuk e kishte ratifikuar Konventën e Gjenevës dhe vuri në dukje mungesën e çdo forme të procedurës së azilit dhe mbrojtjes së refugjatëve në vend. Kështu, Gjykata nuk mund të pranonte argumentin e Qeverisë se aktivitetet e ZKLB-së në Tripoli përfaqësonin një garanci kundër riadhesimit arbitrar të kërkuesve. Për më tepër, Human Rights Watch dhe ZKLB-ja kishin denoncuar disa raste të kthimit të detyruar të azilkërkuesve dhe refugjatëve në vende me rrezik të lartë. Fakti që disa nga kërkuesit kishin marrë statusin e refugjatit në Libi, jo vetëm që nuk garantonte sigurinë e tyre por, përkundrazi, rriste vulnerabilitetin e tyre.

Gjykata arriti në përfundimin se, kur kishin bërë transferimin e kërkuesve në Libi, autoritetet italiane kishin pasur dijeni ose duhet të kishin dijeni se nuk kishte garanci të mjaftueshme që i mbronin ata nga rreziku i dëbimit në mënyrë arbitrare në vendet e tyre të origjinës. Kështu, transferimi shkelte nenin 3.

### Në lidhje me nenin 4 të Protokollit nr. 4

Gjykata vuri re se, deri në momentin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, ajo kishte konstatuar vetëm një herë shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 4, dhe konkretisht në rastin *Čonka k. Belgjikës*<sup>126</sup>. Në rastin konkret transferimi i kërkuesve në Libi ishte kryer pa shqyrtuar secilin rast individualisht. Autoritetet italiane, nuk kishin kryer asnjë procedurë për identifikimin e kërkuesve, por thjesht i kishin marrë kërkuesit në bordin e anijes së tyre për t'i zbarkuar në Libi. Gjykata arriti në përfundimin se dëbimi i kërkuesve ka qenë i një natyre kolektive, në shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 4.

126 *Čonka k. Belgjikës*, vendim i 5 shkurtit 2002, nr. 51564/99.

### Në lidhje me nenin 13, i marrë në lidhje me nenin 3 dhe nenin 4 të Protokollit nr. 4

Qeveria italiane pranoi se nuk kishte qenë e mundur vlerësimi i rrethanat personale të kërkuësve në bordin e anijeve ushtarake. Kërkuësit pretenduan se, personeli ushtarak i anijes nuk i kishte dhënë asnjë informacion se për ku ishin nisur, duke i bërë të besonin se ishin nisur për në Itali dhe as i kishin informuar në lidhje me procedurën që duhet të ndiqnin për të mos u kthyer në Libi. Ky version i ngjarjeve, edhe pse kundërshtohet nga Qeveria, ishte vërtetuar nga një sërë dëshmish të mbledhura nga ZKLKBR, KPT-së dhe Human Rights Watch. Kështu, kërkuësit e kishin pasur të pamundur për të paraqitur ankesat e tyre, në bazë të nenit 3 të Konventës dhe të nenit 4 të Protokollit nr. 4, tek një autoritet kompetent, i cili të shqyrtonte plotësisht dhe rigorozisht këto ankesa, para se të dëboheshin. Edhe në qoftë se ekzistonte një mjet ankimor në bazë të ligjit penal që kërkuësit të mund ta përdornin në praktikë kundër personelit ushtarak në bordin e anijeve, ky nuk përmbushte kriterin e efektit pezullues. Gjykata përsëriti detyrimin e Shteteve, sipas nenit 13, për vënien në dispozicion të një mjeti ankimor me efekt pezullues të një mase të marrë, kur kjo masë ishte në kundërshtim me Konventën dhe kishte efekte potencialisht të pariparueshme. Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 13, i marrë në lidhje me nenin 3 dhe nenit 4 të Protokollit nr. 4.

### Në lidhje me nenin 41

Gjykata vendosi që Italia t'i paguante secilit kërkuës 15,000 euro në lidhje me dëmin jo material dhe 1,575.74 euro të gjithë kërkuësve së bashku, në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

### **3. Koment**

Gjykata kishte vendosur tashmë, dy vjet më parë, në çështjen *Medvedyev dhe të Tjerë k. Francës*<sup>127</sup> se personat e ndaluar në bordin e një anije që lundronte në det të hapur, e lokalizuar nga autoritet franceze gjatë një operacioni policor dhe që më pas ishte vënë nën drejtimin e autoritetet franceze, konsideroheshin në "juridiksionin" e Francës. Një konstatim i ngjashëm u bë edhe në këtë rast ku emigrantët, të cilët lundronin në det të hapur, u morën në bordin e një anije italiane dhe u kthyen në Libi. Kishte prova të mjaftueshme për keqtrajtimin e azilkërkuësve në Libi, edhe para revolucionit dhe të një rreziku të vërtetë

127 *Medvedyev dhe të Tjerë k. Francës*, vendim [Dhoma e Madhe] i 29 marsit 2010, nr. 3394/03.

dëbimi nga Libia në vendet e tyre të origjinës. Kjo çoi Gjykatën të vendoste se kishte shkelje të nenit 3.

Kjo ishte hera e parë që neni 4 i Protokollit nr. 4, u aplikua për “kthime pas” të kryera jashtë territorit të një Shteti. Pasi Gjykata përcaktoi se kërkuesit ishin brenda juridiksionit të Italisë, ishte e lehtë arritja e përfundimit se neni 4 i Protokollit nr. 4 gjente zbatim. Shkelja e kësaj dispozite varet nga natyra kolektive e dëbimit ose refuzimit dhe mungesa e vlerësimit në mënyrë individuale të gjendjes së tyre, e jo (si në rastin e nenit 3) të rreziqeve ndaj të cilave ekspozohen kërkuesit. Kishte qenë jashtëzakonisht e vështirë për avokatët për të kontaktuar klientët e tyre dhe Gjykata ishte e shqetësuar pasi ata nuk mund të pretendonin se vepronin sipas udhëzimeve të klientëve.

Ky vendim ka rëndësi të veçantë për ata Shtete të cilat ndodhen në kufijtë jugore dhe juglindorë të Bashkimit Evropian. Në rastet kur rreziqet në rast kthimi janë gjerësisht njohura, kthimi në atë Shtet është i ndaluar. Kthimi i një personi tek një shtet ndërmjetës, i cili më pas mund ta kthejë personin në fjalë në vendin i tij të origjinës, përbën shkelje të nenit 3. Tashmë, Konventa zbatohet në mënyrë të qartë edhe në operacionet shtetërore të kontrollit të emigracionit kudo që ndodhin, madje edhe në det të hapur.

Mendimi paralel i Gjyqtarit Pinto de Albuquerque tërhoqi një interes të konsiderueshëm pasi në të pohohej se *“nëse një person është në rrezik për t’iu nënshtruar torturës në vendin e tij dhe kërkon azil në ambasadën e një shteti palë në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ai duhet të pajiset me vizë për të hyrë në territorin e atij shteti, në mënyrë që të mundësohet fillimi i procedurës së azilit”*

*Dëbimi kolektiv i emigrantëve afganë nga Italia në Greqi dhe mohimi i së drejtës për të përdorur procedurën e azilit në të dy vendet*

## **VENDIM NË ÇËSHTJEN SHARIFI DHE TË TJERË kundër ITALISË DHE GREQISË**

(Kërkesa nr. 16643/09)

**21 tetor 2014**

### **1. Faktet kryesore**

Rasti si fillim kishte të bënte me 35 kërkues me shtetësi të ndryshme, duke përfshirë afganë, sudanezë dhe eritrean. Kërkuesit deklaruan se, në data të ndryshme ndërmjet viteve 2007 dhe 2008, kishin hyrë në territorin grek nga vendet e tyre të cilat ishin të përfshira në konflikte të armatosura me pasoja në popullsinë civile. Ndërmjet janarit 2008 dhe shkurtit 2009, ata u nisën ilegalisht nga porti i Patras dhe mbërritën në Itali, në portet e Barit, Ankonës dhe Venecias, ku policia kufitare i lokalizoi menjëherë dhe i ktheu përsëri në Greqi. Më tej, kërkuesit pretenduan se në të dy këto vende, ndaj tyre ishte ushtruar dhunë nga ana e policisë dhe ekuipazhit të anijes. Ata nuk u lejuan të kërkonin azil as në Itali dhe as në Greqi.

Në lidhje me Italinë, kërkuesve nuk iu ofrua ndihmë ligjore dhe gjuhësore dhe as u informuan për të drejtat e tyre. Ata gjithashtu nuk morën asnjë letër zyrtare të përkthyer në lidhje me kthimin e tyre në Greqi. Përkundrazi, pasi zbankuan në Itali, ata u hipën menjëherë në anije dhe u kthyen në Greqi. Në Greqi, kërkuesit u ndaluan sapo arritën dhe ndaj tyre u lëshuan urdhra dëbimi. Më pas ata u vendosën në një kamp të improvizuar pranë Patras, ku kushtet e pritjes përcaktoheshin si çnjerëzore dhe poshtëruese, ku aksesit në tualete pothuajse mungonte komplet ose ishte shumë i kufizuar, gjithashtu kishte mungesa në ushqim dhe ndihmë mjekësore.

Për shkak të gjendjes së varfërisë dhe mjerimit absolut, kërkuesit i kërkuan Gjykatës, zbatimin e masës së përkohshme sipas nenit 39 të Rregullores, sidomos pas informacionit të paraqitur në Gjykatë, për dëbimin e disa shtetasve afgane fillimisht në Turqi e prej aty në Afganistan. Kërkesa e tyre u pranua.

Pas evakuimit dhe shkatërrimit të kampit të improvizuar në Patras nga ana e policisë, disa nga prej kërkuesve ishin arrestuar dhe ishin kthyer në Turqi, Shqipëri ose ishin vendosur në burgjet greke. Në mesin e tyre kishte edhe kërkues, ndaj të cilëve Gjykata kishte urdhëruar masat e përkohshme dhe rr-

jedhimisht dëbimi i tyre ishte pezulluar.

Gjatë qëndrimit në Greqi, kërkuessit pretenduan se nuk kishin pasur mundësi të kontaktonin një avokat ose përkthyes dhe se ata nuk kishin pasur akses në procedurat e azilit ose në një procedurë të shkallës së parë që, sipas së drejtës greke, kishte kompetenca për të dëgjuar ankesat e tyre.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkesa u paraqit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut më 25 mars 2009. Edhe pse fillimisht ishin 35 kërkuess që aplikuan para Gjykatës, vetëm katër prej tyre mundën të mbanin kontakte të rregullta me përfaqësuesit e tyre ligjorë e për rrjedhojë vendimi i Gjykatës kishte të bënte vetëm me këta katër kërkuess.

Kërkuessit pretenduan se kishin hyrë në territorin italian në mënyrë të paligjshme dhe ishin kthyer menjëherë në Greqi, nga frika e dëbimit më pas në vendet e tyre të origjinës, ku do të përballeshin me rrezikun serioz ndaj jetës, rrezikut të torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtëruess, në shkelje të nenit 2 dhe nenit 3 të Konventës.

Gjithashtu, ata u ankuan për mungesën e aksesit në gjykatat vendore, në kundërshtim me nenin 13 të Konventës.

Duke u bazuar në nenin 4 të Protokollit nr. 4, ata argumentuan se kishin qenë subjekt i dëbimit kolektiv pa dallim nga autoritetet italiane, çka përbënte një dëbim indirekt në Afganistan.

Së fundmi, kërkuessit pretenduan se u ishte mohuar e drejta për të paraqitur çështjen e tyre para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, për shkak të pamundësisë për të kontaktuar një përkthyes dhe një avokat gjatë identifikimit dhe dëbimit të tyre nga Italia, në shkelje të nenit 34 të Konventës.

### Në lidhje me nenin 13, i marrë së bashku me nenin 3, në lidhje me Greqinë

Gjykata vendosi t'i shqyrtojë në bazë të nenit 13, i marrë së bashku me nenin 3, pretendimet e kërkuessve në lidhje me kthimin e tyre të mundshëm në Afganistan dhe mungesës së aksesit në procedurën e azilit.

Në shqyrtimin e situatës në aspektin e marrjes së ndihmës së nevojshme për

të pasur akses në procedurat e azilit, Gjykata vuri në dukje se problemet (që rridhnin nga barrierat gjuhësore, mungesa e përkthyesve, mungesa e ndihmës ligjore dhe vonesat e tepërta në marrjen e një vendimi) ishin rezultat i vështirësive në menaxhimin e fluksit të madh të emigrantëve, me të cilin ishte përballur Greqia vitet e fundit.

Në rastin në fjalë, u theksua, ndër të tjera, se broshura që iu shpërnda kërkuesve “të identifikuar”, përmbante informacione që ishin thelbësore për kundërshtimin e vendimeve të dëbimit të tyre dhe ishte në arabisht, edhe pse ata ishin shtetas afganë dhe jo domosdoshmërisht e zotëronin atë gjuhë. Gjithashtu, Gjykata vuri në dukje se azilkërkuesit kishin qëndruar në Greqi në kampin e mbipopulluar të Patras, në një gjendje varfërie dhe mjerimi absolut, konstatim ky i cili duhej marrë në konsideratë në vlerësimin nëse kërkuesit kishin mundësi konkrete për marrjen e ndihmës ose informacionit të nevojshëm.

Përsa i përket frikës së kthimit në Afganistan, ekzistonte rreziku i kthimit direkt apo indirekt i kërkuesve në vendin e tyre. Kështu, ata kishin një interes specifik për të pasur mundësi të mbështeteshin tek e drejta për një mjet ligjor efektiv, i sanksionuar në nenin 13.

Rrjedhimisht, Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 13, i marrë në lidhje me nenin 3 të Konventës.

Në lidhje me nenet 3, 13, 34 dhe nenin 4 të Protokollit nr. 4, në lidhje me Italinë

### *Dëbimi kolektiv*

Ndërhyrjet e palëve të treta dhe raportet nga burime të ndryshme ndërkombëtare, të cilat nënvizonin praktikën e zakonshme italiane në portet e Detit Adriatik, të kthimit pa dallim dhe të menjëhershëm në Greqi të emigrantëve, duke i privuar ata nga çdo e drejtë dhe garanci materiale dhe procedurale, u morën parasysh gjatë shqyrtimi i çështjes në fjalë. Gjykata vërejti se e njëjta praktikë ishte zbatuar edhe në situatën e kërkuesve.

Për më tepër, qeveria italiane deklaroi se, sipas sistemit të Dublinit, Greqia ishte vendi i vetëm që kishte juridiksion në lidhje me kërkesat për azil të kërkuesve, duke qenë se ishte vendi i hyrjes së parë në Bashkimin Evropian. Megjithatë, sipas Gjykatës, për të përcaktuar nëse Greqia ishte me të vërtetë vendi i vetëm kompetent lidhur me kërkesat për azil, autoritetet italiane duhet të kishin shqyrtuar situatën e çdo kërkuesi dhe jo t'i dëbonin të gjithë në mënyrë

arbitrare. Siç Gjykata kishte deklaruar edhe në vendimet e saj të mëparshme në *Hirsi Jamaa dhe të tjerët k. Italisë*<sup>128</sup> dhe *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*<sup>129</sup>, sistemi i Dublinit (i cili duhej zbatuar në pajtim me Konventën), nuk mund të përdorej për të justifikuar dëbimet kolektive dhe pa dallim të azilkërkuesve potencial.

Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 4, duke pasur parasysh se masat e marra ndaj kërkuesve në portin e Ankonës, përbënin dëbim kolektiv dhe pa dallim.

### *Rreziku i kthimit në mënyrë arbitrare në Afganistan*

Në shqyrtimin e përgjegjësisë së Italisë si pasojë e dëbimit të kërkuesve në Greqi, Gjykata zbatoi të njëjtat konstatime që kishte bërë në vendimin e saj në rastin *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*. Me kthimin e kërkuesve në Greqi, Italia kishte dështuar në shqyrtimin e situatave individuale të kërkuesve dhe në sigurimin, në kuadër të sistemit të Dublinit, e garancive të nevojshme nga vendi i destinacionit, në zbatim të dispozitave të saj për azil, për të parandaluar dëbimin e tyre në vendin e origjinës pa një vlerësim paraprak të rreziqeve me të cilat mund të përballëshin. Për shkak të mungesës së aksesit në procedurat e azilit dhe rrezikut të dëbimit në Afganistan, ku kërkuesit rrezikonin t'i nënshtrroheshin keqtrajtimit, Gjykata u shpreh se ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës.

### *Aksesi në procedurat e azilit ose çdo mjeti tjetër ankimor në portin e Ankonës*

Duke marrë në konsideratë konkluzionet e saj të mëparshme në këtë rast, Gjykata konkludoi se pretendimet e kërkuesve ishin të justifikuar, pasi kishte pasur një lidhje të qartë ndërmjet dëbimit të tyre kolektiv dhe faktit se ishin penguar të kërkonin azil, apo të kishin akses në ndonjë mjet tjetër të brendshëm ligjor që plotësonte kushtet e nenit 13. Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 13, i marrë së bashku me nenin 3 dhe nenin 4 të Protokollit nr. 4.

### Nene të tjera

Duke pasur parasysh konkluzionet e saj në lidhje me nenin 13, i marrë së bashku me nenin 3 të Konventës dhe në lidhje me nenin 4 të Protokollit nr. 4, Gjyka-

128 *Hirsi Jamaa dhe të tjerët k. Italisë*, vendim [Dhoma e Madhe] i 23 shkurtit 2012, nr. 27765/09, i përfshirë në këtë kapitull.

129 *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*, vendim [Dhoma e Madhe] i 21 janarit 2011, nr. 30696/09, i përfshirë gjithashtu në këtë kapitull.



ta arriti në përfundimin se nuk kishte asnjë arsye për të shqyrtuar pretendimet e kërkuësve në lidhje me nenin 34 të Konventës.

### Në lidhje me nenin 41

Gjykata vendosi se Greqia duhet t'i paguante Reza Karimi, Yasir Zaidi, Muzamil Azimi dhe Najeeb Heidi, së bashku, 5,000 euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

### **3. Koment**

Ky rast është në një farë mase një kombinim i situatave me të cilat Gjykata u përball në Dhomë të Madhe, në çështjen *M.S.S. k. Greqisë dhe Belgjikës dhe Hirsi Jamaa dhe të tjerët k. Italisë*. Ajo trajton transferimin në bazë të sistemit të Dublinit, nga një Shtet Anëtar i BE-së në një tjetër, si në rastin e *M.S.S.*, por autoritetet italiane, krahasuar me veprimet e autoriteteve Belgjike, proceduan me transferimin e menjëhershëm, duke mos i lejuar kërkuësit të ngrinin pretendime për rreziqet e mundshme që do të hasnin në Greqi.

Kjo është arsyeja pse Gjykata konsideron që edhe dëbimet nga një Shtet Anëtar i BE-së, siç ishte Italia, edhe në rastet kur bazohet në sistemin e Dublinit, në një Shtet tjetër Anëtar të BE-së, siç ishte Greqia në këtë rast, nëse nuk ishte në gjendje të ofronte garancitë e nevojshme procedurale kundër dëbimeve arbitrare mund të përbëjnë shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 4 të Konventës. Prandaj mund të thuhet se ky vendim e shtrin zbatimin e *parimit të moskthimit* edhe në rastet e transferimit bazuar në sistemin e Dublinit. Edhe pse sistemi i Dublinit është i bazuar në supozimin që Shtetet Anëtare të BE-së respektojnë *parimin e moskthimit* dhe konsiderohen vende të sigurta, Gjykata përsëriti se sistemi i Dublinit nuk justifikon aspak dëbimin kolektiv dhe pa dallim dhe se sistemi i Dublinit duhet të zbatohet në përputhje me Konventën. Prandaj, Gjykata kërkon një vlerësim individual të rrethanave të çdo azilkërkuësi, edhe në rastin e transferimeve në bazë të Rregullores së Dublinit nga një Shtet Anëtar i BE-së në një tjetër<sup>130</sup>. Bazuar në këtë përfundim, Gjykata vendosi se mënyrë sesi Italia i kishte transferuar kërkuësit nga porti i Ankonës, cenonte të drejtat e tyre në bazë të nenit 4 të Protokollit nr. 4 të Konventës.

130 Shih nenin 5 të "Rregullores (BE) nr. 604/2013 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 qershor 2013, për kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin e Shtetit Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, parashtruar në një nga Shtetet Anëtare, nga një shtetas i vendeve të treta ose një person pa shtetësi (e ndryshuar)", Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian L (180/31).

Gjykata përsëriti konkluzionet e saj, në rastin e *M.S.S. k. Greqisë dhe Belgjikës* në lidhje me aksesin në procedurat e azilit, si në Greqi dhe në Itali, sipas nenit 13, i marrë së bashku me nenin 3 të Konventës. Në funksion të këtij konstatimi, Gjykata gjithashtu konstatoi shkelje nga ana Italia të nenit 3 të Konventës, në lidhje me rrezikun e dëbimit arbitrar në Greqi e më pas në Afganistan.

*Dëbimi dhe riatdhesimi në Tunizi i emigrantëve të parregullt, të cilët kishin arritur në brigjet italiane në shtator të vitit 2011*

## **VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN KHLAIFIA DHE TË TJERË kundër ITALISË**

(Kërkesë nr. 16483/12)

**15 dhjetor 2016**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit, Saber Ben Mohamed Ben Ali Khlaifia, Fakhreddine Ben Brahim Ben Mustapha Tabal dhe Mohamed Ben Habib Ben Jaber Sfar, janë shtetas tunizianë, të lindur në vitin 1983, 1987 dhe 1988 respektivisht. Të gjithë jetojnë në Tunizi.

Më 16 dhe 17 shtator 2011 ata u larguan nga Tunizia me anije të improvizuara drejt bregdetit italian. Anijet e tyre u ndaluan nga autoritetet italiane, dhe u shoqëruan për në ishullin Lampedusa. Më pas u transferuan në Qendrën e Pritjes dhe të Ndihmës së Parë ("QPNP") në ishullin Lampedusa, ku autoritetet proceduan me identifikimin e tyre. Kërkuesit pohuan se Qendra ishte e mbi-populluar, me higjenë të papranueshme, hapësirë joadekuate për të fjetur dhe se nuk kishin kontakt me personat jashtë për shkak të mbikëqyrjes së vazhdueshme policore.

Pas një revolte të personave të ndaluar në këtë qendër, më 20 shtator, QPNP-ja pësoi dëmtime nga zjarri dhe u shkatërrua pjesërisht. Kërkuesit u transferuan në një park sportiv për të kaluar natën, ku mundën të shmangnin forcat e zbatimit të ligjit që i mbikëqyrnin dhe arritën në fshatin Lampedusa. Më pas u bashkuan në një demonstratë me pothuajse 1,800 emigrantë të tjerë. Pasi u ndaluan nga policia, kërkuesit fillimisht u shoqëruan në qendrën e pritjes e më pas në aeroportin e Lampedusës, nga ku u dërguan për në Palermo më 22 shtator 2011. Në Palermo kërkuesit qëndruan për disa ditë në dy anije të ankoruara në portin e qytetit. Kërkuesi i parë qëndroi në bordin e anijes *Vincent*, së bashku me rreth 190 persona të tjerë, ndërsa kërkuesi i dytë dhe i tretë qëndruan në bordin e anijes *Audace*, me rreth 150 të tjerë.

Më 27 dhe 29 shtator 2011 kërkuesit u dëbuan në Tunizi. Para se të largoheshin ata u intervistuan nga konsulli tunizian, i cili sipas kërkuesve thjesht regjistroi të dhënat e tyre të gjendjes civile.

Gjithashtu, kërkuesit pohuan se gjatë qëndrimit të tyre në Itali ata nuk ishin pajisur në asnjë moment me ndonjë dokument. Në përgjigje të pretendimeve të kërkuesve, Qeveria, paraqiti tre urdhëra për refuzim të hyrjes të datës 27 dhe 29 shtator 2011, që ishin lëshuar në lidhje me kërkuesit. Këto urdhëra, të cilat ishin pothuajse identikë, shoqëroheshin secili me nga një shënim njoftimi me të njëjtin shkrim dore ku thuhej “personi refuzoi të nënshkruante ose të merrte një kopje”. Me arritje e tyre në aeroportin e Tunizis, kërkuesit u liruan.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Më 1 shtator 2015, një Dhomë e Gjykatës konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 5 paragrafi (1), (2) dhe (4) të Konventës dhe shkelje të nenit 3 të Konventës në lidhje me kushtet e ndalimit në QPNP, por nuk konstatoi shkelje të nenit 3 në lidhje me kushtet e ndalimi në bordin e anijeve. Gjithashtu ajo vërejti se kishte pasur shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 4, të nenit 13 të marrë në lidhje me nenin 3 të Konventës dhe nenit 4 të Protokollit nr. 4. Me kërkesë të Qeverisë, çështja iu referua Dhomës së Madhe sipas nenit 43.

Kërkuesit pretendonin se mbyllja e tyre fillimisht në një qendër pritjeje për emigrantët e paligjshëm dhe më pas në dy anije cenonte nenet 3 dhe 5 të Konventës. Gjithashtu, ata argumentuan se kishin qenë subjekt i dëbimit kolektiv dhe se kuadri ligjor italian nuk parashikonte asnjë mjet efektiv për të kundërshtuar shkeljen e të drejtave të tyre themelore.

### Neni 5(1)

Në kundërshtim me argumentin e qeverisë, Gjykata u shpreh se marrëveshja dypalëshe midis Italisë dhe Tunizisë e prillit 2011 nuk mund të konsiderohej se përbënte një bazë ligjore për ndalimin e kërkuesve në QPNP, duke pasur parasysh se marrëveshja nuk ishte bërë publike e për rrjedhojë ishte e paaksesueshme për kërkuesit, të cilët nuk mund të kishin parashikuar pasojat e zbatimit të saj. Përveç kësaj, kërkuesit nuk kishin gëzuar as garancitë themelore të *habeas corpus* siç është kërkesa që çdo kufizim i lirisë personale duhet të bazohet në një vendim të arsyetuar të një autoriteti gjyqësor dhe se çdo masë e përkohshme e ndërmarrë nga një autoritet policor duhet më pas të aprovohet nga një vendim i autoritetit gjyqësor. Në rastin në fjalë, nuk kishte asnjë autoritet gjyqësor apo administrativ që të aprovonte me një vendim ndalimin e kërkuesve.

Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata konstatoi se heqja e lirisë së kërkuesve nuk mund të konsiderohej “e ligjshme” në kuptim të nenit 5 (1), pasi nuk respektonte parimin e përgjithshëm të sigurisë juridike dhe nuk ishte në përputhje me qëllimin e mbrojtjes së individit kundër arbitraritetit. Rrjedhimisht, ka pasur shkelje të nenit 5 (1) të Konventës.

#### Neni 5(2)

Gjykata vuri në dukje, duke u nisur nga konstatimi i saj sipas nenit 5 (1) se ndalimi i kërkuesve nuk kishte bazë ligjore të qartë dhe të aksesueshme në të drejtën italiane, autoritetet nuk mund t'i kishin njoftuar kërkuesit për arsyet ligjore të ndalimit të tyre apo t'i informonin lidhur me mundësinë për të kundërshtuar arsyet e ndalimit përpara një gjykate. Rrjedhimisht, konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 5 (2).

#### Neni 5(4)

Duke pasur parasysh konstatimin e saj sipas nenit 5(2) se, arsyet ligjore për ndalimin e kërkuesve në QPNP dhe në anije nuk u ishin njoftuar atyre, Gjykata arriti në përfundimin se e drejta e kërkuesve për të kundërshtuar ndalimin e tyre ishte zhveshur nga efektiviteti i saj. Kështu, kishte pasur shkelje të nenit 5 (4).

#### Neni 3

Sa i përket kushteve të ndalimit të kërkuesve në QPNP të Lampedusas, Gjykata konstatoi se liria e lëvizjes që ata gëzonin në atë qendër, duhet ta kishte lehtësuar pjesërisht apo në një masë të konsiderueshme kufizimin e shkaktuar nga fakti se kapaciteti maksimal i qendrës ishte tejkaluar. Ajo pranoi se kjo qendër nuk ishte e përshtatshme për qëndrime disa ditore dhe autoritetet italiane kishin detyrimin për t'i transferuar të ndaluarit në vende të përshtatshme. Megjithatë, duke marrë parasysh se QPNP-ja ishte djegur vetëm dy apo tre ditë pas mbërritjes së kërkuesve, nuk mund të supozohej se autoritetet italiane kishin qenë joaktive ose neglizhente apo që emigrantët duhej të ishin transferuar në më pak se dy deri në tre ditë. Për më tepër, Gjykata vuri në dukje se kërkuesit nuk pretendonin të ishin keqtrajtuar qëllimisht nga autoritetet gjatë qëndrimit në QPNP, apo se ushqimi dhe uji ishte i pamjaftueshëm, apo klima në atë kohë kishte ndikuar negativisht kur atyre u ishte dashur të flinin jashtë. Për më tepër kërkuesit nuk përfshihehin në asnjë nga kategoritë e personave vulnerabël. Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykata konstatoi se trajtimi për

të cilin kërkuesit ankoheshin nuk e kalonte nivelin e ashpërsisë që kërkohet nga neni 3 i Konventës.

Sa i përket kushteve të qëndrimit në të dyja anijet, Gjykata hodhi poshtë pretendimet e kërkuesve për keqtrajtim pasi ato ishin të pa mbështetura në raporte që vërtetonin ekzistencën e shenjave apo pasojave të tjera të keqtrajtimin të pretenduar, apo në dëshmi të personave të tjerë që të vërtetonin faktet e pretenduara prej tyre. Përkundrazi, qeveria i paraqiti Gjykatës një vendim gjyqësor të datës 1 qershor 2012 që kundërshtonte pretendimet e kërkuesve në lidhje me gjykatësin e hetimeve paraprake të Palermos. Lidhur me këtë, kërkuesit nuk kishin ofruar dëshmi që të bindnin Gjykatën për të vënë në pikëpyetje paanësinë e gjyqtarit të lartpërmendur. Rrjedhimisht Gjykata vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 3.

#### Neni 4 i Protokollit nr. 4

Gjykata theksoi se neni 4 i Protokollit nr. 4 nuk garantonte të drejtën për një intervistë individuale në të gjitha rrethanat. Kërkesat e kësaj dispozite mund të plotësohen kur çdo i huaj ka një mundësi objektive dhe efektive për të paraqitur argumente kundër dëbimit të tij ose të saj.

Në rastin në fjalë, Gjykata konstatoi se kërkuesit kishin patur mundësinë të njoftonin autoritetet për arsyet se pse duhet të qëndronin në Itali apo pse nuk duhet të ktheheshin në Tunizi, gjatë dy procedurave të identifikimit që u ishin nënshtruar, ose në cdo kohë tjetër gjatë kohës që qëndruan në Itali. Për më tepër, natyra relativisht e thjeshtë dhe e standardizuar e urdhrave të refuzimit të hyrjes mund të shpjegohet me faktin se kërkuesit nuk kishin dokumente të vlefshme udhëtimi dhe nuk kishin pretenduar se i frikësoheshin keqtrajtimin në rast të kthimit të tyre apo nëse kishte pengesa të tjera ligjore për dëbimin e tyre. Kështu, dëbimi i njëkohshëm i tre kërkuesve nuk përbënte dëbim “kolektiv” por ishte rezultat i një serie urdhërash individual të refuzimit të hyrjes. Rrjedhimisht, Gjykata u shpreh se nuk kishte pasur shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 4.

#### Neni 13 i marrë së bashku me nenin 3

Gjykata vërejti se nuk ishte paraqitur para saj asnjë dëshmi për eksitencën e mjeteve ligjore në dispozicion të kërkuesve për tu ankuar në lidhje me kushtet në të cilat ishin mbajtur të ndaluar. Kundërshtimi i urdhrave të refuzimit të hyrjes tek Drejtësia e Paqes së Agrigendos shërbente vetëm për të kundërshtu-

ar ligjshmërinë e dëbimit së tyre. Për më tepër, këto urdhra u lëshuan vetëm në fund të periudhës së ndalimit. Rrjedhimisht, Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 13 i marrë së bashku me nenin 3 të Konventës.

#### Neni 13 i marrë së bashku me nenin 4 të Protokollit nr. 4

Gjykata vuri në dukje se në urdhrat për refuzimin e hyrjes citohej shprehimisht mundësia e personave për të apeluar kundër tyre tek Drejtësia e Paqes të Agrigento. Në këtë kontekst, gjyqtari mund të shqyrtojë çfarëdo ankese lidhur me mos marrjen parasysh të situatës personale të emigrantit e për rrjedhojë për natyrën “kolektive” të dëbimit. Për sa i përket mungesës së efektit pezullues të mjetit ankimor të sipërpërmendur, Gjykata vlerësoi se kjo nuk përbënte në vetvete shkelje të nenit 13 të Konventës, kur, si në rastin konkret, kërkuesit nuk pretendonin se ekzistonte një rrezik real i shkeljes së të drejtave të garantuara me nenet 2 ose 3 në vendin e destinacionit. Prandaj, nuk kishte pasur shkelje të nenit 13 të Konventës, i marrë së bashku me nenin 4 të Protokollit nr. 4.

#### Neni 41

Gjykata vendosi që secilit prej kërkuesve ti akordohej një shumë prej 2,500 euro për dëmin jomaterial dhe 15,000 euro të treve së bashku për kostot dhe shpenzimet.

### **3. Komentete**

Ky vendim ka të bëjë me kthimin në Tunizi të emigrantëve tunizianë që vijnë masivisht nga deti. Rëndësia e tij është e qartë, pasi vendet përgjatë kufijve të Bashkimit Evropian janë përballur me një fluks masiv të emigrantëve që vijnë nga deti dhe Italia është një ndër këto vende. Prandaj, ndikimi më i rëndësishëm i këtij vendimi ka të bëjë me nenin 4 të Protokollit nr. 4 të Konventës, ndalimin e dëbimit kolektiv të të huajve. Dhoma e Madhe bëri dallimin ndërmjet situatës së kërkuesve në këtë rast me atë të kërkuesve në rastet *Çonka kundër Belgjikës*<sup>131</sup>, *Hirsi Jamaa dhe të tjerët kundër Italisë*<sup>132</sup> dhe *Sharifi dhe të tjerët kundër Italisë dhe Greqisë*<sup>133</sup>. Për tri arsye kryesore, Dhoma e Madhe, në ndryshim nga vendimi i mëparshëm i Dhomës, nuk gjeti shkelje të nenit 4 të Protokollit Nr. 4.

131 *Çonka k. Belgjikës*, vendim i 5 shkurtit 2002, nr. 51564/99.

132 *Hirsi Jamaa dhe të tjerë k. Italisë*, vendim [DHM] i 23 shkurtit 2012, nr. 27765/09, i përfshirë gjithashtu në këtë seksion.

133 *Sharifi dhe të tjerë k. Italisë dhe Greqisë*, vendim i 21 tetorit 2013, nr.16643/09, i përfshirë gjithashtu në këtë seksion.

Së pari, kërkuesit ishin identifikuar personalisht dy herë nga autoritetet italiane. Së dyti, urdhrat e largimit, përkundër faktit se të gjithë kishin një format standard, ishin individuale. Dhe së treti, fakti që kërkuesit u dëbuan në të njëjtën kohë me persona të tjerë nuk do të thoshte se vendimet për deportimet e tyre nuk ishin individuale. Në vendimin e saj, Dhoma e Madhe pohoi se neni 4 i Protokollit nr. 4 nuk garantonte të drejtën për një intervistë individuale në të gjitha rrethanat. Kërkesat e këtij nenin konsideroheshin të përmbushura kur çdo i huaj kishte një mundësi reale dhe efektive për t'u ankuar ndaj dëbimit të tij dhe ky ankim të shqyrtohej në mënyrë adekuate nga autoritetet e shtetit të paditur.

Reagimet ndaj këtij vendimi ishin të menjëhershme. Në përgjithësi, kritikët e kanë konsideruar këtë vendim si një hap prapa krahasuar me jurisprudencën e mëparshme.<sup>134</sup> Në një koment të botuar në revisten franceze të të drejtave të njeriut *La Revue des droits de l'homme*, vendimi u konsiderua si “*përmirësim i gënjeshtërt në lidhje me të drejtat e emigrantëve në dyert e Europës*”.<sup>135</sup> Në pritje të komenteve dhe kritikave të mëtejshme, mund të thuhet se vendimi ka njëfarë merite pasi kërkon të qartësoj të drejtat procedurale të azilkërkuesve sipas nenit 4 të Protokollit nr.4, edhe pse i kufizon ato në mënyrë të konsiderueshme.

Vendimi është gjithashtu i rëndësishëm për sa i përket interpretimit të nenit 5 të Konventës. Gjykata konstatoi se në rastin e kërkuesve ishin shkelur disa paragrafë të këtij neni. Veçanërisht, ajo vërejtë që, marrëveshja dypalëshe e vitit 2011 ndërmjet Italisë dhe Tunizisë, nuk mund të konsiderohet bazë ligjore për ndalimin e kërkuesve, në kuptimin që i jep neni 5 (1) i Konventës, pasi marrëveshja nuk ishte e aksesueshme për ta. Përveç kësaj, Gjykata konstatoi se ndalimi *de facto* i kërkuesve pa ndonjë vendim zyrtar i kishte privuar ata nga mbrojtja kushtetuese e *habeas corpus* e për rrjedhojë nuk mund të konsiderohej në përputhje me qëllimin e nenit 5, edhe në kushtet e një situatë alarmante migrimi.

Mesazhi i Gjykatës në këtë vendim të saj, në lidhje me të dyja këto nene, por edhe në lidhje me nenin 3 dhe 13 të Konventës, është vërtet shumë i rëndësishëm, veçanërisht në lidhje me marrëveshjet dypalëshe të lidhura me

134 Shih Vëzhguesit e Strasburgut, Denise Venturi “Vendimi i Dhomës së Madhe në çështjen Khlaifia dhe të tjerë k Italisë: një hap para, një hap mbrrapa?” ose Marion Tissier : « Dëbimi kolektiv i emigrantëve: Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së kufizon rreptësisht garancitë procedurale të të huajve » 7 mars 2017, *Journal d'actualité des droits européens*.

135 Foegle (Jean-Philippe), “Un renforcement en trompe-l'œil des droits des migrants retenus aux portes de l'Europe”, *La Revue des droits de l'homme, Actualités Droits-Libertés*, 2017, <http://revdh.revues.org/2904>



vendet e jugut dhe lindjes të Mesdheut për sa i përket ndalimit ose reduktimit të flukseve migratore. Marrëveshja BE-Turqi është njëra prej tyre dhe do të ishte interesante të shikonim një çështje që do të paraqitej para Gjykatës në lidhje me atë marrëveshje.<sup>136</sup>

-----  
136 Shih gjithashtu Urdhërat e Gjykatës së Përgjithshme (të Bashkimit Evropian) në rastet T-192/16, T-193/16 dhe T-257/16 NF, NG dhe NM kundër Këshillit Europian, në të cilin Gjykata e Përgjithshme e BE-së deklaroi se i mungon juridiksioni për të dëgjuar dhe vendosur në lidhje me pretendimet e ngritura nga tre azilkërkues kundër marrëveshjes BE-Turqi, e cila kërkon të zgjidhë krizën e migracionit.

# Përmbledhje dhe Komente të Vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian

**Rregullorja e Këshillit nr. 343/2003 e 18 shkurtit 2003 (Rregullorja Dublin II)**

*Një azilkërkues nuk mund të transferohet në Shtetin Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së tij, në qoftë se ekziston një rrezik real që ai të trajtohej në mënyrë çnjerëzore dhe poshtëruese*

**VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN N.S. kundër SEKRETARIT TË SHTETIT PËR DEPARTAMENTIN E PUNËVE TË BRENDSHME DHE M.E. DHE TË TJERË kundër KOMISIONERIT PËR REFUGJATËT DHE MINISTRIT TË DREJTËSISË, BARAZISË DHE REFORMËS LIGJORE**

(Çështjet nr. C-411/10 dhe C-493/10)

**21 dhjetor 2011**

## 1. Faktet kryesore

Këto dy raste burojnë nga ky kërkesa për vendime paraprake, respektivisht, nga Gjykata e Apelit e Anglisë dhe Uellsit dhe Gjykata e Lartë e Irlandës, në lidhje me interpretimin e Rregullores (KE) nr. 343/2003 të 18 shkurtit 2003 (Rregullorja Dublin II). Rregullorja Dublin II vendos kriteret e përdorura për të përcaktuar Shtetin Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për azil nga një shtetas i vendeve të treta. Kur një shtetas i një vendi të tretë kërkon azil në një Shtet Anëtar, që sipas kësaj Rregulloreje nuk konsiderohet shteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së tij, atëherë Rregullorja parashikon një procedurë për transferimin e azilkërkuesit në Shtetin Anëtar përgjegjës.

Rasti i parë kishte të bënte me një shtetas afgan i cili kishte udhëtuar përmes Greqisë për të arritur në Mbretërinë e Bashkuar, ku kishte kërkuar azil në 12 janar 2009. Ai pretendoi se, pas mbërritjes në Greqi ishte arrestuar dhe dëbuar më pas në Turqi, ku ishte mbajtur i ndaluar për dy muaj të tjerë. Kërkuesi ishte arratisur nga paraburgimi në Turqi dhe kishte udhëtuar drejt Mbretërisë së Bashkuar.

Rasti i dytë kishte të bënte me pesë persona nga Afganistani, Irani dhe Algjeria, të cilët nuk kishin asnjë lidhje me njeri-tjetrin. Ata kishin udhëtuar gjithashtu nëpërmjet Greqisë dhe pasi kishin mbërritur në Irlandë kishin kërkuar azil. Ata ishin arrestuar në Greqi për hyrje të paligjshme.

Autoritetet britanike dhe irlandeze vlerësuan, në bazë të Rregullores Dublin II, se Shteti Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për azil të kërkuarve në fjalë ishte Greqia. Ndaj kërkuarve u nxorën urdhrat e transferimit për në Greqi. Të gjithë kërkuarët kundërshtuan transferimin e tyre në Greqi dhe pretenduan se autoritetet britanike dhe irlandeze duhet të pranonin përgjegjësinë për shqyrtimin e kërkesës së tyre për azil sipas nenit 3 (2) të Rregullores së Dublinit, i cili lejon një Shtet Anëtar që nuk ishte Shteti përgjegjës Anëtar sipas Kreut III, si derogim, të shqyrtonte një kërkesë për azil nga një shtetas i një vendi të tretë. Ata kërkuar shqyrtim gjyqësor të vendimit për transferimin e tyre në Greqi. Në rastin e parë, Gjykata e Lartë e Anglisë dhe Uellsit hodhi poshtë kërkesën, por kërkuar i apeloi në Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit e Anglisë dhe Gjykata e Lartë e Irlandës iu drejtuan GJDBE-së për vendime paraprake në lidhje me interpretimin e nenit 3 (2).

## 2. Pyetjet e paraqitura nga gjykatat kombëtare

Së pari Gjykata e Apelit e Anglisë dhe Uellsit i kërkoj GJDBE-së nëse shqyrtimi i një kërkesë për azil sipas nenit 3 (2) të Rregullores Dublin II binte brenda fushëveprimit të së drejtës së BE-së, çka do të nënkuptonte se Karta e të Drejtave Themelore do të ishte e zbatueshme<sup>137</sup>.

Së dyti, të dyja gjykatat kombëtare i kërkuar GJDBE-së, nëse, nën dritën e kushteve të këqija të azilit në Greqi dhe trajtimit të azilkërkuarve, Shtetet Anëtare kanë detyrimin për të kontrolluar, para transferimit të azilkërkuarve, nëse Shteti Anëtar përgjegjës sipas Rregullores Dublin II (në këtë rast Greqia) respekton plotësisht të drejtat themelore. Gjykatat kombëtare gjithashtu e pyetën GJDBE-në nëse ishin të detyruara të merrnin përgjegjësi për shqyrtimin vetë të kërkesës, sipas nenit 3 (2) të Rregullores Dublin II, nëse konstatojnë se Shteti Anëtar përgjegjës nuk i respekton të drejtat themelore.

## 3. Vendimi i GJDBE-së

Së pari, GJDBE-ja vendosi se kur një Shtet Anëtar vendos të ushtrojë diskre-

137 Karta e të Drejtave Themelore zbatohet vetëm për Shtetet Anëtare gjatë zbatimit të së drejtës së BE-së.

cionin e tij, për të shqyrtuar një kërkesë për azil, në bazë të nenit 3 (2) të Rregullores Dublin II, ai ishte duke zbatuar të drejtën e BE-së. Kështu, Karta e të Drejtave Themelore zbatohet dhe Shtetet Anëtare duhet të respektojnë të drejtat dhe parimet e parashikuara prej saj.

Së dyti, GJDBE-ja kujton se Sistemi i Përbashkët Evropian i Azilit (SPEA) është ndërtuar mbi parimin e besimit të ndërsjellë ndërmjet Shteteve Anëtare dhe se të gjitha Shtetet Anëtare duhet të respektojnë të drejtat themelore, përfshirë të drejtat në bazë të Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe ato të KEDNJ-së. Qëllimi i Rregullores Dublin II ishte përshpejtimi i përpunimit të kërkesave për azil duke identifikuar dhe garantuar një Shtet Anëtar përgjegjës dhe duke shmanhur kështu «sorollatjen e azilkërkuesve». GJDBE-ja pranoi se sistemi mund të përjetonte probleme të mëdha operative të cilat mund të çonin në trajtimin e azilkërkuesve në kundërshtim me të drejtat e tyre themelore. Megjithatë, jo çdo shkelje e të drejtave themelore të një azilkërkuesi nga një Shtet Anëtar përgjegjës apo çdo shkelje e vogël e legjislacionit dytësor të azilit, mund të prekë situatën ligjore të Shteteve të tjera Anëtare sipas kësaj Rregulloreje.

Megjithatë, GJDBE-ja deklaroi se “nëse ka arsye serioze për të besuar se ka të meta sistemore në procedurën e azilit dhe kushtet e pritjes të azilkërkuesve në Shtetin Anëtar përgjegjës, të cilat mund të rezultojnë në trajtim çnjerëzor ose poshtërues të tyre në territorin e atij Shteti, sipas nenit 4 të Kartës, transferimi do të ishte në kundërshtim me këtë dispozitë”<sup>138</sup>. Për këtë arsye, e drejta e BE-së e përjashton prezumimin absolut se Shteti Anëtar i përcaktuar nga Rregullorja, si shteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për azil, respekton të drejtat themelore të BE-së. Shtetet Anëtare duhet të përdorin instrumentet në dispozicion të tyre, përfshirë edhe raportet e OJQ-ve ndërkombëtare, ZKLBKBR-së dhe Komisionit, për të vlerësuar nëse një azilkërkues rrezikonte t'i cenoheshin të drejtat e tij themelore, nëse transferoheshin në Shtetin Anëtar përgjegjës sipas Rregullores.

Përsa i përket pyetjes nëse Shteti Anëtar që bën transferimin e azilkërkuesve duhet të marrë përgjegjësinë sipas nenit 3(2) të Rregullores, nëse konstaton se azilkërkuesit do të ishin në rrezik, GJDBE-ja u shpreh se Shteti Anëtar transferues duhet të shqyrtojë kriteret e tjera të përcaktuara në Kreun III të Rregullores për të përcaktuar nëse një tjetër Shtet Anëtar mund të identifikohet si shteti përgjegjës për të shqyrtuar kërkesën për azil. Megjithatë, në qoftë se të drejtat themelore të azilkërkuesit ishin shkelur tashmë, Shteti Anëtar

138 Shih pg. 86.

transferues nuk duhet të përdorë një procedurë e cila do të marrë shumë kohë të paarsyeshme për të përcaktuar Shtetin Anëtar përgjegjës për kërkesën për azil. Nëse është e nevojshme, Shteti Anëtar, i cili është përcaktuar përgjegjës duhet të shqyrtojë vetë kërkesën në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 3 (2) të Rregullores.

#### 4. Koment

Në çështjet e bashkuara *N.S.* dhe *M.E.*, GJDBE-ja vlerësoi nëse neni 4 i Kartës së BE për të Drejtat Themelore, i cili korrespondon me nenin 3 të KEDNJ-së, do të cenohet nëse azilkërkuesit do të transferoheshin në Greqi në bazë të Rregullores Dublin II. Gjatë kohës që GJDBE-ja po shqyrtonte çështjet, GJEDNJ-ja kishte vendosur tashmë se, kushtet e pritjes dhe të tjera të azilkërkuesve në Greqi, në atë kohë, shkelnin nenin 3 të KEDNJ-së<sup>139</sup>. Kështu, GJDBE-ja duhej të merrte një vendim mbi parimin.

GJDBE-ja e bëri të qartë se, prezumimi që azilkërkuesit do të trajtoheshin në një mënyrë që ishte në përputhje me të drejtat themelore të njeriut, i cili përbënte bazën e SPEA-s, duhej konsideruar i hedhur poshtë “nëse ka arsye serioze për të besuar se ekzistonin të meta sistemore në procedurën e azilit dhe kushtet e pritjes së azilkërkuesve në Shtetin Anëtar përgjegjës”. Prandaj, Shtetet Anëtare nuk duhet t’i transferojnë azilkërkuesit në Shtetin Anëtar përgjegjës, në zbatim të Rregullores së Dublinit, kur ata nuk mund të mos jenë në dijeni se, ekzistenca e “mangësive sistemore” në procedurat e azilit dhe në kushtet e pritjes së azilkërkuesve në atë Shtet Anëtar, krijojnë baza thelbësore për të besuar se azilkërkuesi do të përballej me rrezikun real të trajtimit çnjerëzor ose poshtërues, në kuptim të dispozitës përkatëse të Kartës së të Drejtave Themelore. Në raste të tilla, Shteti Anëtar transferues është i detyruar që të vazhdojë të shqyrtonte kriteret e përcaktuara në Rregulloren Dublin II, për të vendosur nëse një Shtet tjetër Anëtar është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për azil. Nëse është e nevojshme, Shteti Anëtar ku azilkërkuesi është i pranishëm, duhet ta shqyrtojë vetë kërkesën për të shmangur që procedura e Dublinit të zgjasë për një kohë të paarsyeshme.

Ky vendim u pasua nga raste të tjera që kishin të bënin me situatën në Greqi<sup>140</sup>,

139 *M.S.S. k. Belgjikë dhe Greqi*, vendim [Dhoma e Madhe] i 21 janarit 2011, nr. 30696/09, i përfshirë në kapitullin për jurispru-  
dencën e GJEDNJ-së.

140 *C528/11, Zuheyr Frayeh Halaf k. Darzhavna agentsia za bezhantsite pri Ministerskia savet*, vendim i 30 majit 2013; *C-4/11, Bundesrepublik Deutschland k. Kaveh Puid*, vendim [Dhoma e Madhe] i 14 nëntorit 2013, i përfshirë në këtë kapitull, dhe

të cilat trajtohen më vonë në këtë kapitull dhe mesa duket e kanë frymëzuar ligjvënësin e BE-së të hartojë Rregulloren Dublin III.

Për më tepër, GJEDNJ-ja, pas këtij vendimi, theksoi në vendimin e saj në çështjen *Tarakhel*<sup>141</sup> se, vlerësimi individual i rrethanave në një situatë të tillë duhet të kryhet në funksion të situatës së përgjithshme të kushteve dhe procedurave të pritjes për azilkërkuesit dhe situatës specifike të azilkërkuesit në fjalë.

---

C-394/12, *Shamso Abdullahi k. Bundesasylamt*, vendim [Dhoma e Madhe] i 10 dhjetorit 2013, gjithashtu i përfshirë në këtë kapitull.

141 *Tarakhel k. Zvicrës*, vendim [Dhoma e Madhe] i 4 nëntorit 2014, nr. 29217/12, i përfshirë në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

*Përcaktimi i Shtetit Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për azil nga një i mitur i pashoqëruar dhe që nuk ka asnjë anëtar të familjes në BE*

## **VENDIMI NË ÇËSHTJEN MA, BT DHE DA kundër SEKRETARIT TË SHTETIT PËR DEPARTAMENTIN E PUNËVE TË BRENDSHME**

(Çështja nr. C-648/11)

**6 qershor 2013**

### **1. Faktet kryesore**

Ky rast u referua në GJDBE për vendim paraprak nga Gjykata e Apelit e Anglisë dhe Uellsit për interpretimin e paragrafit të dytë të nenit 6 të Rregullores (KE) nr. 343/2003, të datës 18 shkurt 2003 (Rregullorja Dublin II). Kur azilkërkuesi është një i mitur i pashoqëruar, Rregullorja parashikon se Shteti Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së tij, është Shteti, ku një anëtar i familjes së tij qëndron ligjërisht, me kushtin që kjo të jetë në interesin më të mirë të të miturit. Në mungesë të një anëtari të familjes, Shteti Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës është ai ku i mituri ka paraqitur kërkesën për azil.

Dy të mitur nga Eritrea (MA dhe BT) dhe një i mitur shtetas irakian (DPA) kërkuan azil në Mbretërinë e Bashkuar. Asnjë anëtar i familjeve të tyre nuk ishte ligjërisht i pranishëm në ndonjë Shtet tjetër Anëtar të BE-së. Autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar deklaruan se të miturit kishin paraqitur tashmë kërkesë për azil në Shtetet e tjera Anëtare: në Itali (MA dhe BT) dhe në Holandë (DA). Për këtë arsye, autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar kërkuan nga autoritetet italiane dhe holandeze për të marrë përgjegjësinë për këta azilkërkues dhe këto autoritete pranuan.

Kërkuesit iu drejtuan Gjykatës së Lartë të Drejtësisë të Anglisë dhe Uellsit për të kundërshtuar ligjshmërinë e transferimit të tyre. Para se të procedonin me transferimin e MA dhe DA, por pasi ishte transferuar BT, autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar vendosën shqyrtimin e kërkesave për azil sipas "klauzolës së sovranitetit" të parashikuar nga Rregullorja, sipas të cilës çdo Shtet Anëtar mund të shqyrtojë një kërkesë për azil paraqitur nga një shtetas i vendeve të treta, edhe në qoftë se një shqyrtim i tillë nuk ishte përgjegjësia e tij, sipas kritereve të përcaktuara në këtë Rregullore. Si pasojë BT, i cili tashmë ishte transferuar në Itali, mund të kthehej në Mbretërinë e Bashkuar.

Tre rastet u shqyrtuan së bashku në Gjykatën e Lartë të Drejtësisë të Anglisë dhe Uellsit. Më 21 dhjetor 2010, kjo gjykatë hodhi poshtë pretendimet dhe u

shpreh se, në bazë të paragrafit të dytë të nenit 6 të Rregullores nr. 343/2003, të miturit e pashoqëruar që kërkojnë azil dhe që nuk kanë anëtar të familjes ligjërisht të pranishëm në territorin e një prej Shteteve Anëtare, duhet të transferohen në Shtetin Anëtar ku paraqitur bërë kërkesën e parë për azil.

MA, BT dhe DA apeluan kundër këtij vendimi në Gjykatën e Apelit të Anglisë dhe Uellsit (Seksioni civil).

## **2. Pyetjet e paraqitura nga gjykata kombëtare**

Gjykata e Apelit e Anglisë dhe Uellsit pyeti GJDBE-n nëse paragrafi i dytë i nenit 6 të Rregullores nr. 343/2003 duhej interpretuar se, kur një i mitur, i pashoqëruar dhe që nuk kishte asnjë anëtar të familjes së tij të pranishëm ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar, kishte paraqitur kërkesë për azil në më shumë se një Shtet Anëtar, Shteti Anëtar përgjegjës ishte ai ku i mituri kishte paraqitur kërkesën e tij të parë, apo interpretohej se Shteti Anëtar përgjegjës ishte ai ku i mituri ishte i pranishëm dhe kishte paraqitur kërkesën e tij më të fundit për azil.

## **3. Vendimi i GJDBE-së**

Në vendimin e saj, GJDBE-ja deklaroi se, kur një i mitur, i pashoqëruar dhe që nuk kishte asnjë anëtar të familjes së tij të pranishëm ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar, ka aplikuar për azil në më shumë se një Shtet Anëtar, Shteti Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës ishte ai ku i mituri ishte i pranishëm pasi kishte depozituar një kërkesë atje.

Ky konkluzion rrjedh, ndër të tjera, nga konteksti dhe objektivi i nenit 6 të Rregullores nr. 343/2003, i cili përqendrohet veçanërisht tek të miturit e pashoqëruar, si dhe në dritën e objektivit kryesor të Rregullores nr. 343/2003, konkretisht garantimin e një qasje efektive në vlerësimin e statusit të refugjatit të një azilkërkuesi. Kështu, duke qenë se miturit e pashoqëruar përbëjnë një kategori personash veçanërisht vulnerabël, është e rëndësishme që të mos merrej më shumë kohë seç ishte e nevojshme për përcaktimin e Shtetit Anëtar përgjegjës, që do të thotë se, si rregull, të miturit e pashoqëruar nuk duhet të transferohen në një tjetër Shtet Anëtar. Këto përfundime mbështeteshin nga detyrimi i respektimit të të drejtave themelore të BE-së, duke përfshirë të drejtën që interesi më i mirë i fëmijës të jetë konsiderata mbizotëruese në të gjitha masat që kanë të bëjnë me fëmijët, qofshin ato të autoriteteve publike apo të institucioneve private



Duke marrë në konsideratë interesin më të mirë të fëmijës, në rrethana të tilla si ato që lidhen me situatën e kërkuesve në procedurat kryesore, Shteti Anëtar në të cilin i mituri ishte i pranishëm dhe kishte paraqitur kërkesën për azil atje, përcaktohet si përgjegjës për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Prandaj, bazuar në interesin më të mirë të të miturve të pashoqëruar, është e rëndësishme të mos zgjaten së tepërmi procedurat për përcaktimin e Shtetit Anëtar përgjegjës, si dhe të garantohen procedura të shpejta për përcaktimin e statusit të refugjatit për këta të mitur.

Gjykata shtoi se, një interpretim i tillë nuk nënkuptonte se një i mitur i pashoqëruar, kërkesa e të cilit për azil është refuzuar në thelb nga një Shtet Anëtar, mund të detyrojë më pas një tjetër Shtet Anëtar për të shqyrtuar një kërkesë tjetër për azil. Kjo bëhet e qartë nga neni 25 i Direktivës së Këshillit nr. 2005/85, i cili parashikon se Shtetet Anëtare nuk janë të detyruara të shqyrtojnë një kërkesë për azil, kur kërkesa konsiderohet e papranueshme, pasi personi ka paraqitur një kërkesë të njëjtë për azil dhe është marrë një vendim përfundimtar në lidhje me të.

#### 4. Koment

Vendimi për rastin e *MA, BT dhe DA* është, deri tani, i vetmi rast që ngriti para GJDBE-së pyetje në lidhje me regjimin juridik të të miturve të pashoqëruar sipas Rregullores Dublin II (Rregullorja nr. 343/2003). Ky vendim theksoi origjinalitetin e këtij regjimi, i cili rezulton nga fakti se kriteri i zbatueshëm për të miturit e pashoqëruar është i pari në hierarkinë e kriterëve të përcaktuara në këtë Rregullore.

Rregullorja nr. 343/2003 përmban kriterë për të përcaktuar Shtetin Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për azil. Ky vendim sqaron cili është Shteti përgjegjës në rastin e një të mituri të pashoqëruar dhe që nuk ka asnjë anëtar të familjes në një shtet të BE-së.

Rasti kishte të bënte me fëmijë veçanërisht vulnerabël, të cilët pretendonin azil në Mbretërinë e Bashkuar, pasi kishin kërkuar më parë azil në vende të tjera në BE. Fëmijët nuk kishin anëtarë të familjes së tyre askund në Evropë. Për interpretimin e nenit 6(2) të Rregullores, e cila ishte e paqartë në këtë pikë, GJDBE-ja analizoi formulimin dhe kontekstin e saj, si dhe objektivat e ndjekura nga Rregullorja. Gjykata interpretoi, në veçanti, nenin 6(2) në dritën e nenit 24 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, i cili parashikon se “Në të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me fëmijë, qofshin ato të autoriteteve

publike apo të institucioneve private, konsideratë primare duhet të jenë interesat më të larta të fëmijës”, duke ndjekur kështu jurisprudencën ekzistuese në fusha të tjera, në lidhje me interesin më të mirë të fëmijës<sup>142</sup>.

Sipas GJDBE-së, nuk ishin në interesin më të mirë të fëmijës udhëtimet e panevojshme dhe Shteti Anëtar ku ndodhej i mituri ishte, në parim, përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së tij. Me fjalë të tjera, një Shtet Anëtar nuk mund thjesht ta transferojë të miturin në Shtetin ku ai ka paraqitur kërkesën e parë për azil, por është vetë përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës dhe duhet të informojë për këtë Shtetin Anëtar ku ishte dorëzuar kërkesa e parë.

Për më tepër, në përgjigje të një argumenti të paraqitur nga Qeveria e Holandës, GJDBE-ja vuri në dukje se një i mitur i pashoqëruar, kërkesa e të cilit për azil refuzohet në thelb në një Shtet Anëtar, nuk mund të detyrojë një tjetër Shtet Anëtar për të shqyrtuar kërkesën për azil.

-----  
142 C-400/10, *J. McB k. L.E.*, vendim i 5 tetorit 2010.

*Përcaktimi i Shtetit Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për azil nga një shtetas i vendeve të treta*

## **VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND kundër KAVEH PUID**

(Çështja nr. C-4/11)

**14 nëntor 2013**

### **1. Faktet kryesore**

Ky rast u referua në GJDBE për vendim paraprak nga Gjykata e Lartë Administrative e Hessen (Gjermani) për interpretimin e Rregullores (KE) nr. 343/2003 e 18 shkurtit 2003 (Rregullorja Dublin II). Ai ka të bëjë, ndër të tjera, me nenin 3 (2) të Rregullores, i cili, përjashtimisht, lejon një Shtet Anëtar që nuk është Shteti përgjegjës Anëtar sipas Kapitullit III, për të shqyrtuar kërkesën për azil të një shtetasi nga një vend i tretë.

Z. Puid ishte një shtetas iranian, i lindur në vitin 1979. Ai udhëtoi për në Greqi nga Teherani më 20 tetor të vitit 2007 dhe vazhdoi, katër ditë më vonë, për në Gjermani, ku kërkoi azil. Ai u arrestua dhe kërkesa e tij për azil nuk u pranua, për shkak se ai kishte kaluar transit përmes Greqisë, të cilën autoritetet gjermane e konsideronin Shtetin Anëtar përgjegjës për të shqyrtuar kërkesën e tij sipas Rregullores Dublin II. Prandaj, Z. Puid u transferua në Greqi. Ai ngriti padi para një gjykate administrative gjermane, e cila e rrëzoi vendimin. Gjykata Administrative vendosi se, për shkak të kushteve të këqija të pritjes dhe procedurat për azilkërkuesit në Greqi, Gjermania duhet të shqyrtonte kërkesën e tij, në bazë të nenit 3 (2) të Rregullores.

Autoritetet gjermane u ankuan në Gjykatën e Lartë Administrative të Hessen. Gjykata e Lartë Administrative e Hessen vendosi t'i parashtrojë katër pyetje GJDBE-së.

Ndërkohë, Gjermania kishte shqyrtuar kërkesën e Z. Puid dhe i dha atij statusin e refugjatit më 18 maj 2011. Gjykata e Lartë Administrative vlerësoi se vendimi paraprak nga GJDBE-ja ishte ende i rëndësishëm pasi Z. Puid mund të kërkonte kompensim.

### **2. Pyetjet e paraqitura nga gjykata kombëtare**

Gjykata e Lartë Administrative tërhoqi tri nga katër pyetje që kishte parash-

truar, pasi ishin trajtuar nga GJDBE-ja në një rast tjetër, konkretisht *N. S. dhe të Tjerë*<sup>143</sup>. Kështu pyetja e vetme që i paraqiti Gjykata e Lartë Administrative GJDBE-së ishte nëse azilkërkuesi kishte një të drejtë personale të zbatueshme, bazuar në nenin 3(2) të Rregullores, për të detyruar një Shtet Anëtar të shqyrtonte kërkesën e tij për azil, nëse situata në Shtetin Anëtar përgjegjës sipas kriterëve të përcaktuara në Kapitulli III (në këtë rast Greqia) përbën kërcënim për të drejtat themelore të azilkërkuesit.

### 3. Vendimi i GJDBE-së

Kapitulli III i Rregullores përmban kritere, të cilat kanë hierarki ndërmjet tyre, për përcaktimin e Shtetit Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për azil. GJDBE-ja ka deklaruar se neni 3(2) i Rregullores lejon shmangien nga rregulli sipas së cilit, një kërkesë për azil mund të shqyrtohet vetëm nga Shteti Anëtar përgjegjës sipas kriteret që gjenden në Kapitullin III, duke lejuar një tjetër Shtet Anëtar për të shqyrtuar një kërkesë, edhe në qoftë se nuk është përgjegjësia e tij sipas Kapitullit III.

GJDBE-ja vendosi se një Shtet Anëtar nuk mund të transferojë një azilkërkues tek Shtetit Anëtar përgjegjës sipas Kapitullit III “kur nuk mund të mos jetë në dijeni se mangësitë sistemore në procedurat e azilit dhe në kushtet e pritjes së azilkërkuesve në atë Shtet Anëtar, përbëjnë arsye serioze për të besuar se azilkërkuesi do të përballej me rrezikun reale i trajtimit çnjerëzor ose poshtërues, sipas kuptimit të nenit 4 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian»<sup>144</sup>. I takonte gjykatës kombëtare për të vendosur nëse ekzistonin këto mangësi sistematike në Greqi, në kohën e transferimit të Z. Puid. GJDBE-ja vuri në dukje se, Shteti Anëtar, i cili përcakton se cili është Shteti përgjegjës ka të drejtë të zbatojë nenin 3(2) të Rregullores në një situatë të tillë, por nuk i detyruar për ta bërë këtë.

Nëse një Shtet Anëtar konstaton ekzistencën e këtyre të metave sistemore dhe për rrjedhojë nuk mund ta transferojë azilkërkuesin atje, siç përcaktohet në Kapitullin III, Shteti Anëtar duhet të vazhdojë të vlerësojë kriteret e tjera të parashikuara në këtë kapitull, për të parë nëse një nga këto kritere identifikon një tjetër Shtet Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për

143 C411/10 dhe C493/10, *N.S. k. Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme dhe M.E. dhe të Tjerë k. Komisionerit për Refugjatët dhe Ministrin të Drejtësisë, Barazisë dhe Reformës Ligjore*, vendim [Dhoma e Madhe] i 21 dhjetorit 2011, shih komentet e veçanta të përfshirë në këtë kapitull.

144 Parag. 30.

azil. Sipas nenit 13 të Rregullores, në qoftë se nuk mund të identifikohet një Shtet Anëtar përgjegjës “Shteti i parë Anëtar, në të cilit është dorëzuar kërkesa për azil është përgjegjës për shqyrtimin e saj». GJDBE-ja ka shtuar se procedura për përcaktimin e Shtetit anëtar Përgjegjës nuk duhet të zgjasë në mënyrë të paarsyeshme dhe të përkeqësojë situatën, në shkelje të të drejtat themelore të azilkërkuësit. Nëse është e nevojshme, Shteti Anëtar i cili duhet të përcaktojë Shtetin Anëtar përgjegjës duhet ta shqyrtojë vetë kërkesën në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 3(2) të Rregullores.

#### 4. Koment

Në këtë çështje, GJDBE-ja zhvilloi më tej disa aspekte të vendimit në çështjen *N.S.*.

GJDBE-ja vendosi se një Shtet Anëtar, i cili është i ndaluar të transferojë një azilkërkuës, sipas Rregullores Dublin II, në një Shtet ku azilkërkuësi rrezikon për të keqtrajtohet, nuk është i detyruar, në parim, të marrë përsipër përgjegjësinë për shqyrtimin e kërkesës për azil. Në këto rrethana (kur transferimi është i pamundur për shkak të mangësive sistemore në Shtetin Anëtar përgjegjës), siç GJDBE-ja deklaroi në vendimin *N.S.*, dhe përsëriti në vendimin në fjalë, procedura e zakonshme është zbatimi hierarkik i kriterëve që gjenden në kapitullin III të Rregullores Dublin II, që përcaktojnë Shtetin Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për azil. Sipas këtyre kriterëve, përgjegjësia i atribuohet Shteteve Anëtare në rendin e mëposhtëm të përparësisë: kur azilkërkuësi është i mitur i pashoqëruar, Shteti Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës do të jetë ai Shtet ku i mituri ka një anëtar i familjes së tij, i cili qëndron atje në mënyrën ligjore, me kushtin që kjo të jetë në interesin më të mirë të të miturit. Në mungesë të një anëtari të familjes, Shteti Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës do të jetë ai ku i mituri ka paraqitur kërkesën e tij për azil (neni 6); Shteti Anëtar në të cilin azilkërkuësi ka një anëtar të familjes kërkesa e të cilit për azil është duke u shqyrtuar ose ka marrë statusin e refugjatit (neni 7 dhe 8); Shteti Anëtar që e ka pajisur azilkërkuësin me një dokument qëndrimi apo vizë (neni 9); Shteti Anëtar kufiri i të cilit është kaluar ilegalisht nga azilkërkuësi (neni 10); Shteti Anëtar ku një shtetas i vendeve të treta ka hyrë në mënyrë të ligjshme dhe ku detyrimi për të pasur një vizë është hequr (neni 11); Shteti Anëtar në të cilin kërkesa për azil është bërë në zonën ndërkombëtare të transitit të aeroportit (neni 12); në situatat ku asnjë prej kriterëve të mësipërme nuk gjen zbatim, Shteti i parë Anëtar ku kërkesa për azil është paraqitur (neni 13).

Kështu, Shteti Anëtar i cili ka për qëllim të transferojë azilkërkuësin në një

vend tjetër duhet të vazhdojë të shqyrtojë këto kriteret të përcaktimit të përgjegjësisë për të parë nëse një Shtet Anëtar tjetër mund të bëhet përgjegjës. Në qoftë se asnjë Shtet tjetër nuk mund të identifikohet si përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës, Shteti Anëtar ku azilkërkuesi gjendet duhet të marrë përgjegjësinë e shqyrtimit të kërkesës. Ky Shtet Anëtar duhet të marrë përgjegjësinë edhe në rast se procesi i përcaktimit të përgjegjësisë zgjat «për një kohë të paarsyeshme». Rrjedhimisht, edhe pse një Shtet Anëtar ka gjithmonë *mundësinë* për të zbatuar nenin 3(2) të Rregullores Dublin II, ndalimi i transferimit të azilkërkuesit nuk sjell detyrimin për të zbatuar nenin 3(2) të Rregullores Dublin II, përveçse në këto rrethana shumë specifike.

Në vendimin e saj të mëvonshëm në çështjen *Abdullahi*<sup>145</sup>, Gjykata vendosi për aspekte edhe më të detajuara.

-----  
145 C-394/12, *Shamsa Abdullahi k. Bundesasylamt*, vendim[Dhoma e Madhe] i 10 dhjetorit 2013, shih komentet që gjendet më vete në këtë kapitull.

*Objekti i shqyrtimit gjyqësor në përcaktimin e përgjegjesisë për shqyrtimin e një kërkesë për azil*

## **VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN SHAMSO ABDULLAHI kundër BUNDESASYLAMT**

(Çështja nr. C-394/12)

**10 dhjetor 2013**

### **1. Faktet kryesore**

Ky rast u referua në GJDBE për vendim paraprak nga Asylgerichtshof (Austri) në lidhje me interpretimin e paragrafit të dytë të nenit 19 të Rregullores (KE) nr. 343/2003, të 18 shkurtit 2003 (Rregullorja Dublin II), e cila parashikon se vendimi për mos shqyrtimin e një kërkesë dhe për transferimin e azilkërkueses në Shtetin Anëtar përgjegjës mund të apelohej ose të kërkohet rishqyrtim.

Znj. Abdullahi, 22 vjeç, ishte shtetase somaleze. Në vitin 2011, ajo u largua nga vendi i saj dhe shkoi në Siri. Ajo udhëtoi nëpër Turqi dhe hyri në Greqi në mënyrë të paligjshme. Me ndihmën e kontrabandistëve arriti në Austri nëpërmjet ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Serbisë dhe Hungarisë. Znj. Abdullahi u arrestua në Austri, në afërsi të kufirit hungarez dhe më 29 gusht 2011 paraqiti një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare pranë Bundesasylamt, autoriteti kompetent. Bundesasylamt kërkoi nga Hungaria të merrte përgjegjësinë e shqyrtimit të kërkesës së Znj. Abdullahi, në përputhje me nenin 10(1) të Rregullores nr. 343/2003 dhe Hungaria pranoi.

Me vendim të datës 30 shtator 2011, Bundesasylamt refuzoi kërkesën për azil Znj. Abdullahi si të papranueshme dhe urdhëroi largimin e saj në Hungari. Ajo apeloj kundër këtij vendimi, duke pretenduar, veçanërisht se situata e azilit në Hungari nuk ishte në pajtim me kërkesat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila ndalon torturën dhe trajtimin çnjerëzor dhe poshtëruës. Në janar të vitit 2012 Bundesasylamt hodhi poshtë edhe një herë kërkesën për azil Znj. Abdullahi si të papranueshme dhe vendosi kështu transferimin e saj në Hungari, me arsyetimin se transferimi në Hungari nuk do të cenonte të drejtat e saj sipas nenit 3 të KEDNJ-së .

Më tej, Znj. Abdullahi apeloj në Asylgerichtshof, por këtë herë pretendoi se Shteti Anëtar përgjegjës për kërkesën e saj për azil ishte Greqia dhe jo Hungaria. Megjithatë, ajo argumentoi se, duke qenë se Greqia nuk i respektonte të drejtat e njeriut në disa aspekte, ajo nuk mund të dërgohej atje e për rrjed-

hojë ishte detyrimi i autoriteteve austriake për të përfunduar shqyrtimin e kërkesës së saj për azil. Më 14 shkurt 2012, Asylgerichtshof deklaroi se ankesa ishte e pabazuar, duke u shprehur se, në përputhje me nenin 10 (1) të Rregullores nr. 343/2003, Hungaria ishte Shteti Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës e saj për azil.

Znj. Abdullahi iu drejtua Verfassungsgerichtshof (Gjykatës Kushtetuese Austriake), e cila më 27 qershor 2012 e rrëzoi vendimin e Asylgerichtshof me arsyetimin se gjykata duhet t'i drejtohej GJDBE-së për një vendim paraparak.

## **2. Pyetjet e paraqitura nga gjykata kombëtare**

Duke pasur parasysh sa më sipër, Asylgerichtshof vendosi të pezullojë procedurën dhe i paraqiti GJDBE-së, ndër të tjera, pyetjen nëse neni 19(2) i Rregullores nr. 343/2003 duhet të interpretohet se i detyron Shtetet Anëtare për t'i garantuar një azilkërkuesi të drejtën që, në ankimin kundër vendimit të transferimit sipas nenit 19(1) të kësaj Rregulloreje, të kërkojë rishikimin e përcaktimit të Shtetit Anëtar përgjegjës, pasi ky i fundit ka rënë dakord për të marrë përgjegjësinë për azilkërkuesin, me arsyetimin se kriteret e përcaktuara në Kapitullin III të kësaj Rregulloreje nuk janë zbatuar korrektësisht.

## **3. Vendimi i GJDBE-së**

GJDBE vendosi se ishte e nevojshme të përcaktohej se në çfarë mase dispozitat në Kapitullin III të Rregullores nr. 343/2003 u japin azilkërkuesve të drejta, të cilat gjykatat kombëtare kanë detyrimin t'i mbrojnë. Ajo vuri në dukje se Rregullorja parashikon një ankim të vetëm, në bazë të nenit 19(2) dhe se ajo duhet të lexohet në dritën e skemës së saj të përgjithshme, të objektivave dhe kontekstit të saj dhe në veçanti evoluimin e saj në lidhje me sistemin në të cilin bën pjesë. GJDBE-ja iu referua parimit të besimit reciprok në Sistemin e Përbashkët Evropian të Azilit, i cili është arsyeja pse Rregullorja është themeluar në mënyrë që të racionalizojë trajtimin e kërkesave për azil si dhe të rrisë sigurinë ligjore e kështu të shmangë zgjedhjen e juridiksionit më të favorshëm, duke qenë objektivi kryesor i të gjitha këtyre masave për të përshpejtuar trajtimin e kërkesave në interes të azilkërkuesve dhe të Shteteve Anëtare pjesëmarrëse.

GJDBE vlerësoi, si të rëndësishëm në këtë kontekst, elementë të ndryshëm të Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit, veçanërisht harmonizimin e rregullave të azilit brenda BE-së, ekzistencën e “klauzolës së sovranitetit” (neni 3(2) i Rregullores nr. 343/2003) ose mundësinë, për Shtetet Anëtare, për të përcaktu-



ar, me marrëveshje dypalëshe, rregullimet administrative në lidhje me detajet praktike të zbatimit të Rregullores nr. 343/2003.

GJED theksoi objektivin kryesor të Rregullores nr. 343/2003, një metodë të qartë dhe të realizueshme për përcaktimin e shpejtë të Shtetit Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për azil, në mënyrë që të garantonin një qasje efektive në procedurat për përcaktimin e statusit të refugjatit dhe jo të rrezikonin përmbushjen e objektivit për shqyrtimin e shpejtë të kërkesave për azil.

Në rastin konkret, Shteti Anëtar, në të cilin ishte paraqitur kërkesa për azil e Znj. Abdullahi vendosi mos shqyrtimin e kësaj kërkesë dhe transferimin e saj në një tjetër Shtet Anëtar, i cili ra dakord për të marrë përgjegjësinë për Znj. Abdullahi, në bazë të nenit 10(1) të Rregullores nr. 343/2003, si Shteti Anëtar i hyrjes së parë në territorin e BE-së. GJDBE vendosi se në një situatë të tillë, në të cilën Shteti Anëtar bie dakord të marrë përgjegjësinë për azilkërkuesin dhe duke pasur parasysh parimin e besimit reciprok në SPEA-n dhe objektivin e marrjes së masave për të përsheptuar trajtimin e kërkesave, e vetmja mënyrë në të cilën azilkërkuesi mund të kundërshtonte zbatimin e këtij kriteri ishte duke pretenduar mangësi sistemore në procedurat e azilit dhe në kushtet e pritjes të azilkërkuesve në atë Shtet Anëtar. Megjithatë, GJDBE-ja vuri në dukje se, dokumentet e paraqitura para saj, nuk tregonin se ky ishte rasti i Hungarisë.

Prandaj, GJDBE-ja vendosi se neni 19(2) duhet të interpretohet se thotë që, në rrethanat ku një Shtet Anëtar ka rënë dakord për të marrë përgjegjësinë për një azilkërkues në bazë të kriterit të përcaktuar në nenin 10(1) të kësaj Rregulloreje - si Shteti Anëtar i hyrjes së parë të azilkërkuesit në Bashkimin Evropian - e vetmja mënyrë në të cilën azilkërkuesi mund të kundërshtojë zbatimin e këtij kriteri është duke pretenduar ekzistencën e mangësive sistemore në procedurën e azilit dhe në kushtet e pritjes së azilkërkuesve në atë Shtet Anëtar, çka përbën arsye serioze për të besuar se azilkërkuesi do të përballet me rrezikun real të trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës sipas kuptimit të nenit 4 të Kartës.

#### **4. Koment**

Çështja *Abdullahi* është një prej vendimeve më të rëndësishme në të cilin GJDBE-ja u shpreh në lidhje me mosmarrëveshje që kanë të bëjnë me përcaktimin e Shtetit Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për azil.

Në sqarimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë për shqyrtimin

e kërkesës për azil në dritën e nenit 10 (1) të Rregullores Dublin II, GJDBE-ja vendosi se mundësitë e azilkërkuesit për të kundërshtuar një vendim për transferimin e tij sipas Rregullores Dublin II ishin të kufizuara pasi një Shtet Anëtar ka rënë dakord për të marrë përgjegjësinë e shqyrtimit të kërkesës së tij për azil. Ky vendim mund të përmbysë vetëm kur kishte mangësi sistemore në procedurën e azilit dhe kushtet e pritjes së tij në atë Shtet Anëtar. Pajtueshmëria e regjimit të Dublinit me të drejtat e njeriut është diskutuar edhe më parë në N.S.<sup>146</sup>, ku GJDBE-ja bëri dallimin midis shkeljeve të rënda të të drejtave themelore, të cilat do cenonin nenit 4 të Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore (ekuivalentin e nenit 3 të KEDNJ-së) dhe shkeljeve të vogla të rregullave të BE-së apo rregullave ndërkombëtare për refugjatët, të cilat nuk detyrojnë Shtetet Anëtare për të mos zbatuar rregullat e Dublinit. Në vendimin *Abdullahi*, GJDBE-ja vendosi se, kur dy Shtete Anëtare bien dakord se cili prej tyre ishte Shteti Anëtar i hyrjes së parë të autorizuar, azilkërkuesi mund ta kundërshtojë atë vendim vetëm duke “pretenduar mangësi sistemore në procedurat e azilit dhe në kushtet e pritjes së azilkërkuesve” në Shtetin Anëtar i cili u konsiderua përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për azil.

Ky formulim kufizues, i lexuar fjalë për fjalë, mund të interpretohet se bindesh me vendimin e GJEDNJ-së rastin *Tarakhel*<sup>147</sup>, ku ajo theksoi se vlerësimi individual i rrethanave në një situatë të tillë duhet të kryhet në funksion të situatës së përgjithshme të procedurave të azilit dhe kushteve të pritjes për azilkërkuesit dhe situatës specifike të azilkërkuesit në fjalë. Megjithatë, ky lexim duhet të vihet në perspektivë, duke pasur parasysh faktin se vendimi në rastin *Abdullahi* nuk u fokusua në dallimin ndërmjet shkeljeve individuale dhe mangësive sistematike. Për më tepër, në një fushë të ngjashme, GJDBE-ja ka marrë kohët e fundit në konsideratë jo vetëm mangësitë sistematike, por edhe shkeljet individuale<sup>148</sup>.

GJDBE-ja është shprehur në lidhje me identifikimin e Shtetit Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për azil edhe në çështjet *K*<sup>149</sup>, *MA*, *BT* dhe

146 C-411/10 dhe C-493/10 C, N.S. k. Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme dhe M.E. dhe të tjerë k. Komisionerit për Refugjatët dhe Ministrit të Drejtësisë, Barazisë dhe Reformës Ligjore, vendim [Dhoma e Madhe] i 21 dhjetor 2011, shih komentet e veçantë të rastit të parashikuar në këtë kapitull.

147 *Tarakhel* k. Zvicrës, vendim [Dhoma e Madhe] i 4 nëntorit 2014, nr. 29217/12, përfshirë në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

148 C-404/15 dhe C-659/15, Pål Aranyosi and Robert Căldăraru k. Generalstaatsanwaltschaft Bremen, vendim [Dhoma e Madhe] i 5 prillit 2016.

149 C-245/11, K k. Bundesasylamt, vendim [Dhoma e Madhe] i 6 nëntorit 2012.

*DA*<sup>150</sup>, *N.S.*<sup>151</sup>, dhe *Puid*<sup>152</sup>. Vlen të përmendet se të gjitha këto vendime u bazuan në Rregulloren nr. 343/2003 (Rregullorja Dublin II), e cila atëherë ishte zëvendësuar me Rregulloren nr. 604/2013 (Rregullorja Dublin III). Rregullorja Dublin III, e cila zgjeroi në mënyrë të konsiderueshme të drejtat procedurale të azilkërkuesve në sistemin e Dublinit, vlen për kërkesat e paraqitura nga Shtete nga 1 janari 2014 e tutje. E drejta e re për ankim efektiv sipas nenin 27 mund të lexohet se u garanton azilkërkuesve një të drejtë mjaft të gjerë për të kundërshtuar elementet faktike dhe juridike të një vendimi transferimi.

-----  
150 C-648/11, *MA, BT dhe DA k. Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme*, vendim i 6 qershorit 2013, shih komentet e veçanta të përfshira në këtë kapitull.

151 C411/10 dhe C493/10, *N.S k. Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme dhe M.E. dhe të tjerë k. Komisionerit për Refugjatët dhe Ministrit të Drejtësisë, Barazisë dhe Reformës Ligjore*, vendim [Dhoma e Madhe] i 21 dhjetorit 2011, përfshirë në këtë kapitull.

152 C-4/11, *Bundesrepublik Deutschland k. Kaveh Puid*, vendim [Dhoma e Madhe] i 14 nëntorit 2013, shih komentet e veçanta të përfshira në këtë kapitull.

**Direktiva e Këshillit nr. 2004/83/EC e 29 prillit 2004 (Direktiva e Kualifikimit)**

*Standardet minimale për përcaktimin e kritereve të kualifikimit për statusin e mbrojtjes plotësuese*

**VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN MEKI ELGAFAJI DHE  
NOOR ELGAFAJI kundër STAATSSECRETARIS VAN JUSTITIE**

(Çështja nr. C-465/07)

**17 shkurt 2009**

### **1. Faktet kryesore**

Ky rast u referua në GJDBE për vendim paraprak nga Raad van State (Këshilli i Shtetit i Holandës) në lidhje me interpretimin e nenit 15(c) të Direktivës së Këshillit 2004/83/EC të 29 prillit 2004 (Direktiva e Kualifikimit ose DK). Direktiva e Kualifikimit garanton “mbrojtje plotësuese” për ata që nuk kualifikohen si refugjatë, por që do të përballen me një dëmtim serioz nëse kthehen në vendin e tyre të origjinës ose në vendin e banimit të përhershëm. Neni 15 përcakton se «dëmtimi i rëndë konsiston në (a) dënimin me vdekje apo ekzekutimin; ose (b) torturën apo trajtimin ose dënimin çnjerëzor ose poshtërues; dhe (c) kërcënimin serioz dhe individual për jetën apo personin, për shkak të dhunës pa dallim në situata konflikti të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm “.

Në 13 dhjetor 2006, Z. dhe Znj. Elgafaji, shtetas irakianë, aplikuan për leje të përkohshme qëndrimi në Holandë, duke deklaruar se do të përballeshin me dëmtim serioz nëse ktheheshin në Irak. Ata u mbështetën në rrethanat e tyre personale, konkretisht tek fakti se Z. Elgafaji kishte punuar për një firmë britanike për t'u garantuar sigurinë dhe transportin e personelit ndërmjet aeroportit dhe “zonës së gjelbër”<sup>153</sup>. Xhaxhai i tij, i cili ishte kishte punuar për të njëjtin punëdhënës në Irak ishte vrarë nga milicia. Z. dhe Znj. Elgafaji kishin marrë një kërcënim me vdekje nëpërmjet një letre të varur në derën e shtëpisë së tyre në Irak. Ministri i Emigracionit dhe Integritimit refuzoi kërkesën e tyre me argumentim se ata nuk kishin dëshmuar për një rrezik real dhe një kërcënim serioz dhe individual. Ministri pohoi se standardi i provës që kërkohej në bazë të nenit 15(c) të Direktivës ishte i njëjtë me atë të nenit 15(b), domethënë se rrethanat duhet të jenë individuale.

Z. dhe Znj. Elgafaji kërkuan rrëzimin e vendimit të Ministrit para Gjykatës së

-----  
153 Zona Ndërkombëtare e Bagdadit.

Qarkut në Hagë. Gjykata e Qarkut vendosi se neni 15(c) nuk kërkon të njëjtën shkallë të individualizimit, si neni 15 (b). “Kështu, ekzistenca e një kërcënim serioz dhe individual të personave që kërkojnë mbrojtje mund të provohet më lehtë në bazë të nenit 15(c) të Direktivës sesa sipas nenit 15(b)”<sup>154</sup>. Në apel, Raad van State vendosi t’ia referojë pyetjen mbi interpretimin e nenit 15(c) GJDBE-së.

## 2. Pyetjet e paraqitura nga gjykatat kombëtare

1. A ofron neni 15(c) mbrojtje plotësuese kundrejt mbrojtjes së ofruar nga neni 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, siç është interpretuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut?

2. Nëse neni 15(c) ofron mbrojtje plotësuese kundrejt mbrojtjes së ofruar nga neni 3 i KEDNJ-së, cilat janë kriteret për të përcaktuar nëse një person, i cili plotëson kushtet për të përfituar mbrojtje plotësuese, është në rrezik të dëmtimit serioz dhe individual?

## 3. Vendimi i GJDBE-së

GJDBE-ja vendosi se neni 15(b) i Direktivës korrespondon me nenin 3 të KEDNJ-së dhe se neni 15(c) ka fushën e vet të zbatimit dhe një kuptim të pavarur nga neni 3 i KEDNJ-së. Ndryshe nga neni 15 (a) dhe (b), sipas së cilëve kërkuesi përfiton mbrojtje plotësuese nëse është i ekspozuar në mënyrë specifike ndaj rrezikut të një lloji të veçantë, neni 15 (c) mbulon një rrezik më të përgjithshëm dëmtimi në lidhje me rrethanat e kërkuesit dhe gjendjen e përgjithshme në vend. GJDBE-ja sqaroi se “fjala ‘individual’ [në nenin 15 (c)] duhet të kuptohet se përfshin edhe dëmtimin që i shkaktohet një personi pavarësisht identitetit të tij, kur shkalla e dhunës së përgjithshme që karakterizon konfliktin e armatosur [...] arrin një nivel të tillë të lartë që përbën arsye serioze për të besuar se një person nëse kthehet në vendin përkatës [...] do të përballet me rrezikun real i të qenit subjekt i kërcënimit serioz të cilit i referohet neni 15(c) i Direktivës, vetëm për shkak të pranisë së tij në territorin e atij vendi apo rajoni”<sup>155</sup>. GJDBE-ja vëren, në përputhje me paragrafin 26 të preambulës së Direktivës së Kualifikimit, se konstatimi i një rreziku që lidhet me situatën e përgjithshme në vend mund të jetë i mjaftueshëm për të përmbushur kushtet e përcaktuara në nenin 15(c) vetëm në rrethana të jashtëzakonshme kur ka një shkallë të lartë të rrezikut.

154 Parag. 22.

155 Parag. 35.

Ndërsa faktorët, e mbledhur së bashku, luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e nenit 15 (c), kuadri i përgjithshëm i mbrojtjes plotësuese dhe vetë neni 15, kërkon që ky nen të interpretohet duke iu referuar ngushtësisht rrezikut individual. Rrjedhimisht, GJDBE-ja deklaroi se “sa më shumë kërkuesi të tregojë se është i prekur në mënyrë të veçantë, për shkak të faktorëve që lidhen me rrethanat e tij personale, aq më i ulët është niveli i kërkuar i dhunës pa dallim për të përfituar mbrojtje plotësuese”<sup>156</sup>.

GJDBE-ja iu përgjigj pyetjes së Raad van State duke deklaruar se që një kërkues të përfitojë mbrojtje shtesë nuk është e nevojshme, në bazë të nenit 15 (c), të paraqesë prova që ai është në shënjestër në mënyrë specifike për shkak të rrethanave të tij personale. Në rrethana të jashtëzakonshme, kushtet e nenit 15 (c) mund të plotësohen, nëse autoritetet përkatëse apo gjykatat e Shtetit Anëtar ku kërkesa për mbrojtje plotësuese është bërë, konstatojnë se shkalla e dhunës së përgjithshme që karakterizon konfliktin e armatosur “arrin një nivel të tillë të lartë që përbën arsye serioze për të besuar se një civil, nëse kthehej në atë vend ose, sipas rastit, në rajonin përkatës, do të përballej me rrezikun real të të qenit objekt i këtij kërcënimi, vetëm për shkak të pranisë së tij në territorin e atij vendi apo rajoni «.

#### 4. Koment

*Elgafaji* është vendimi i parë në lidhje me thelbin e Direktivës së Kualifikimit të 2004 dhe, më konkretisht, në lidhje me mbrojtjen plotësuese sipas nenit 15(c). GJDBE-ja theksoi dallimin ndërmjet llojeve të ndryshme të dëmtimeve të përmendura në nenin 15 të Direktivës së Kualifikimit, duke nënvizuar, ndër të tjera, lidhjet e tyre përkatëse me nenin 3 të KEDNJ-së dhe të nuancës së zbatimit të kushtit të rrezikut individual.

Në veçanti, GJDBE-ja vendosi se “kërcënim serioz dhe individual”, në nenin 15(c) nuk do të thotë se kërkuesi është “individualisht në shënjestër” për shkak të faktorëve të veçantë të rrethanave të tij. Përkundrazi, dispozita ka si kriter dhunën e përgjithshme me intensitet të mjaftueshëm, e cila si e tillë, sjell kërcënimin individual për të gjithë personat që ndodhen në zonën e prekur. Ky kërcënim mund të shtrihet në të gjithë vendin, por mund të jetë i kufizuar edhe në një “rajon”. Këto fakte përcaktohen nga ekzekutivi dhe gjyqësori në Shtetet Anëtare.

-----  
156 Parag. 39

Më e rëndësishmja, GJDBE-ja konsideroi se interpretimi i saj i nenit 15(c) të Direktivës Kualifikimit ishte plotësisht në përputhje me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja, përfshirë praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me nenin 3 të KEDNJ-së. GJDBE-ja tërhoqi vëmendjen në mënyrë të veçantë në vendimin e GJEDNJ-në në çështjen *NA. k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>157</sup>.

Megjithatë, vendimi *Elgafaji* nuk ofroi përgjigje për të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me zbatimin e mbrojtjes plotësuese. GJDBE-ja i zhvilloi në rastet e mëvonshme, detajet në lidhje me mbrojtjen plotësuese.

Kështu, vendimi *Diakite*, interpretoi konceptin e “konfliktit të brendshëm të armatosur” në nenin 15 (c) të Direktivës së Kualifikimit<sup>158</sup>.

Në dy vendime të fundit, GJDBE-ja sqaroi fushëveprimin e mbrojtjes ndërkombëtare në rastet kur kërkuesi vuan nga sëmundje të rënda. Kështu, rastet *M’Bodj* dhe *Abdida*, sqaruan konceptin e “dëmtimit serioz” në nenin 15(b) të Direktivës së Kualifikimit, i cili përfshin torturën apo trajtimin çnjerëzor dhe poshtërues të një kërkuesi në vendin e origjinës.<sup>159</sup> Këto vendime treguan se një vlerësim i mbrojtjes, bazuar në kushte mjekësore, nuk mund të bjerë në fushëveprimin e «dëmtimit serioz», siç përcaktohet në nenin 15 të Direktivës së Kualifikimit, përveç nëse kishin të bënin me veprime të qëllimshme, çka shpjegonte mungesën e aksesit në kujdesin shëndetësor.

157 *NA. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 17 korrikut 2008, nr. 25904/07, 17 korrik 2008, i përfshirë në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

158 C-285/12, *Aboubacar Diakité k. Commissaire général aux réfugiés et aux apatrides*, vendim i 30 janarit 2014, shih komentet e veçanta të përfshira në këtë kapitull.

159 C-542/13, *Mohamed M’Bodj k. État Belge*, vendim [Dhoma e Madhe] i 18 dhjetorit 2014, dhe C-562/13, *Centre public d’action sociale d’Ottignies-Louvain-la-Neuve k. Moussa Abdida*, vendim [Dhoma e Madhe] i 18 Dhjetorit 2014, shih komentet e veçanta të përfshira në këtë kapitull.

*Kushtet e heqjes së statusit të refugjatit***VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN AYDIN SALAHADIN  
ABDULLA DHE TË TJERË kundër BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND**

(Çështjet nr. C-175/08, C-176/08, C-178/08 dhe C-179/08)

**2 mars 2010****1. Faktet kryesore**

Ky rast u referua në GJDBE për vendim paraprak nga Bundesverwaltungsgericht (Gjykata Federale Administrative e Gjermanisë) në lidhje me interpretimin e nenit 11 të Direktivës së Këshillit 2004/83/EC e 29 prillit 2004 (Direktiva e Kualifikimit). Neni 11 i Direktivës së Kualifikimit lejon heqjen e statusit të refugjatit, në funksion të klauzolave për heqjen e statusit sipas nenit 1C të Konventës së Gjenevës të 1951.

Pesë shtetas irakenë kishin përfutur statusin e refugjatit në Gjermani në vitet 2001 dhe 2002 dhe ishin kundërshtarë të partisë së Sadam Huseinit. Në vitin 2005, atyre iu hoq statusi i refugjatit për shkak të ndryshimit të rrethanave në Irak. Ata i kundërshtuan vendimet para gjykatave përkatëse administrative të cilat vendosën në favor të tyre, por vendimet u rrëzuan në apel. Ankuesit apeluan mbi çështje të ligjit në Gjykatën Federale Administrative.

**2. Pyetjet e paraqitura nga gjykata kombëtare**

Gjykata Federale Administrative i paraqiti GJDBE-së pyetje në lidhje me interpretimin e nenit 11 të Direktivës së Kualifikimit dhe konkretisht mbi heqjen e statusit të refugjatit dhe ndryshimit të rrethanave. Ajo kërkoi, ndër të tjera, nëse neni 11 (e) duhet të interpretohet se statusi i refugjatit hiqet, nëse rrethanat mbi të cilat refugjati mbështeste frikën e persekutimit nuk ekzistonin më. Gjykata pyeti më tej sesi ndikon humbja e statusit të refugjatit në sistemet e tjera të mbrojtjes dhe në cilat kushtet autoritetet duhet të verifikojnë rrethana të tjera të cilat mund të jenë shkak për frikë të arsyeshme ndaj persekutimit.

**3. Vendimi i GJDBE-së**

Së pari, GJDBE-ja theksoi se ishte e qartë nga preambula e Direktivës së Kualifikimit se kjo Direktivë ishte miratuar për të udhëzuar autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare në zbatimin e Konventës së Gjenevës të vitit 1951, e cila përbënte bazën e mbrojtjes ndërkombëtare të refugjatëve dhe se Direktiva



duhej interpretuar në dritën e kësaj Konvente. Gjithashtu, DK-ja duhej interpretuar në mënyrë të tillë që të respektonte të drejtat dhe parimet themelore të përfshira në Kartën e të Drejtave Themelore.

Neni 11(1)(e) i Direktivës së Kualifikimit parashikon se një person nuk konsiderohet më refugjat në qoftë se rrethanat, në bazë të së cilave ai kishte marrë statusin e refugjatit, nuk ekzistojnë më. Në këtë rast, personi nuk kualifikohej më për statusin e refugjatit. GJDBE-ja vendosi se, për qëllimet e nenit 11 të Direktivës së Kualifikimit, kjo do të thoshte që rrethanat në vendin e tretë në fjalë kishin pësuar një ndryshim të rëndësishëm dhe jo të përkohshëm dhe arsyet e frikës nuk ekzistojnë më dhe as ndonjë arsye tjetër për frikë persekutimi. Ishte e detyrueshme për Shtetet që të vlerësonin situatën individuale të refugjatit dhe të verifikonin ekzistencën e një sistemi efektiv ligjor në vendin në fjalë, ku aktet e persekutimit hetoheshin, ndiqeshin penalisht dhe dënoheshin. Kjo mbrojtje duhet të ishte në dispozicion të personit në fjalë. Neni 7(1) i Direktivës së Kualifikimit nuk përjashton edhe mbrojtjen nga organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë forca shumëkombëshe ushtarake të pranishme në territorin e vendit në fjalë.

GJDBE-ja vuri në dukje se heqja e statusit të refugjatit nuk e pengon personin të kërkojë mbrojtje plotësuese në bazë të Direktivës së Kualifikimit nëse përmushen të gjitha kërkesat e nevojshme sipas nenit 4 të Direktivës. Mbrojtja plotësuese u jepet personave që nuk kualifikohen si refugjatë, por që rrezikojnë të vuajnë dëmtime serioze nëse kthehen në vendin e tyre të origjinës ose të vendbanimit. Neni 15 përcakton se dëmtimi i rëndë konsiston në «dënimin me vdekje apo ekzekutim; torturën ose trajtimin apo dënimin çnjerëzor ose poshtërues të personin në vendin e origjinës; dhe kërcënimin serioz e individual për jetën e personit apo të civilëve, për shkak të dhunës pa dallim në situatat e një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm»<sup>160</sup>.

Në qoftë se rrethanat në bazë të të cilave personi kishte marrë statusin e refugjatit, pushonin së ekzistuari dhe autoritetet kompetente verifikonin se nuk ekzistonte asnjë rrethanë tjetër që mund të përbënte bazën e frikës nga persekutimi ose të përbënte bazën për dhënien e një mbrojtje tjetër, standardi i probabilitetit që do të përdoret për vlerësimin e rrezikut të personi në fjalë është i njëjtë me atë të përdorur për vlerësimin e rrezikut për dhënien e sta-

160 Në lidhje me mbrojtjen plotësuese shih komentet e çështjeve të parashikuara në këtë kapitull, si C-465/07, *Meki Elgafaji dhe Noor Elgafaji k. Staatssecretaris van Justitie*, vendim [Dhoma e Madhe] i 17 shkurtit 2009, dhe C-542/13, *Mohamed M'Bodj k. État belge*, vendim [Dhoma e Madhe] i 18 dhjetorit 2014.

tusit të refugjatit. Megjithatë, GJDBE-ja nënvizoi se, edhe pse ky standard nuk ndryshon, një person i cili, pasi ka jetuar për disa vite jashtë vendit të tij të origjinës si refugjat, mbështetet në rrethana të tjera për të arsyetuar frikën nga persekutimi, normalisht nuk ka të njëjtat mundësi për vlerësimin e rrezikut ndaj të cilit mund të ekspozohet nëse kthehet në vendin e tij të origjinës, si një azilkërkues i cili sapo ishte larguar nga vendi i tij i origjinës.

Së fundmi, GJDBE-ja deklaroi se, kur autoritetet kompetente planifikonin të hiqnin statusin e refugjatit sipas nenit 11(1)(e) të Direktivës së Kualifikimit, neni 4(4)<sup>161</sup> të Direktivës mund të zbatohet në atë fazë vetëm, nëse arsyeja e frikës nga persekutimi ishte e ndryshme nga ajo e pranuar kur kishte marrë statusin e refugjatit dhe vetëm nëse shkak i ri ka lidhje me aktet apo kërcënimet e mëparshme të persekutimit.

#### 4. Koment

Neni 11 (1)(e) i Direktivës së Kualifikimit njihet zakonisht si klauzola e “rrethave pushuese” dhe është i bazuar në nenin 1 (c)(5) të Konventës së Gjenevës të 1951. Në këtë rast, GJDBE-ja ka shpjeguar për herë të parë marrëdhënien ndërmjet Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe Direktivës së Kualifikimit. Kështu, edhe pse GJDBE-ja nuk ka juridiksion për të interpretuar në mënyrë të drejtpërdrejtë Konventën e Refugjatëve dhe Protokollin e saj, të cilat nuk janë pjesë e së drejtës së BE-së, në situata të caktuara, kur vendos në lidhje me interpretimin ose vlefshmërinë e një dispozite të së drejtës së BE-së, asaj i duhet t’i interpretojë këto traktate.

Në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe Direktivës së Kualifikimit, GJDBE-ja e ka zhvilluar qëndrimin e saj në rastet e mëvonshme, konkretisht në çështjet *Abdel Karim El Kott*<sup>162</sup>, *Qurbani*<sup>163</sup> dhe *Alo e Osso*<sup>164</sup>.

161 Neni 4(4) i Direktivës Kualifikimit parashikon se fakti që “një aplikant kishte qenë tashmë objekt persekutimi ose dëmtimi serioz apo ishte kërcënuar me persekutim apo dëmtim, është një tregues serioz i frikës së bazuar të aplikantit nga persekutimi ose rreziku real i dëmtimit serioz, përveç rasteve kur ka arsye të mjaftueshme për të besuar se persekutimi apo dëmtimi i rëndë nuk do të përsëritet”. Kjo dispozitë zbatohet zakonisht kur vlerësohet dhënia e statusit të refugjatit.

162 C-364/11, *Mostafa Abed El Karem El Kott dhe të Tjerë k. Bevándorlási és Állampolgársági Hivatal*, vendim [Dhoma e Madhe] i 19 dhjetorit 2012.

163 C-481/13, *Mohammad Ferooz Qurbani k. Staatsanwaltschaft Würzburg*, vendim i 17 korrikut 2014.

164 C-443/14 dhe C-444/14, *Kreis Warendorf k. Ibrahim Alo dhe Amira Osso k. Region Hannover*, vendim [Dhoma e Madhe] i 1 marsit 2016.

Në rastin *Qurbani*, GJDBE-ja vendosi se nuk kishte juridiksion për të interpretuar nenin 31 të Konventës së Gjenevës të vitit 1951, në një situatë si ajo në atë çështje. Z. Qurbani u largua nga Afganistani me ndihmën e një trafikanti qeniesh njerëzore dhe arriti në Gjermani me aeroplan nga Greqia, duke kaluar nëpër Iran dhe Turqi. Pasi u arrestua, menjëherë sapo mbërriti, për hyrje të paautorizuar dhe përdorim të një pasaporte të falsifikuar pakistaneze, ai kërkoi azil. Rasti në fjalë, ndër të tjera, ka të bëjë me zbatimin e nenit 31 të Konventës së Gjenevës të vitit 1951, i cili përjashton azilkërkuesit “të cilët vijnë direkt nga një territor ku jeta apo liria e tyre kërcënohej” nga penalizimi për hyrje të parregullt, “me kusht që të paraqiten pa vonesë tek autoritetet dhe të kenë arsye të forta për hyrjen apo prezencës e tyre të paligjshme”. GJDBE-ja vendosi se nuk kishte juridiksion për t’iu përgjigjur pyetjeve të referuara për interpretime duke qenë se vendimet e saj paraprahe “kanë të bëjnë vetëm me rregullat të cilat janë pjesë e së drejtës së BE-së”. Prandaj, ajo arriti në përfundimin se, edhe pse GJDBE-ja kishte juridiksion për të interpretuar një konventë ndërkombëtare midis Shteteve Anëtare dhe vendeve jo-anëtare, kur BE-ja kishte marrë kompetencat e ushtruara më parë nga Shtetet Anëtare në fushat e mbuluara nga kjo konventë, kjo zgjidhje nuk mund të zbatohet për nenin 31 të Konventës së Gjenevës të vitit 1951, për shkak se Shtetet Anëtare “kishin mbajtur disa kompetenca [...] në lidhje me objektin e nenit 31”. Për më tepër, “neni 31 [...] nuk ishte bërë pjesë e ndonjë akti legjislativ të BE-së”, që nënkupton se GJDBE-ja nuk mund të ketë kompetencë në interpretimin uniform të dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat janë bërë pjesë e së drejtës kombëtare dhe të BE-së. Së fundmi, edhe pse neni 14(6) i Direktivës së Kualifikimit i referohet nenit 31 të Konventës së Gjenevës të vitit 1951, GJDBE-ja e bëri të qartë se kërkesa për një vendim paraprak nuk sugjeron se ky nen është relevant për rastin në procedurat kryesore.

Nga ana tjetër, në vendimin e saj të fundit në rastin *Alo dhe Osso*, GJDBE-ja forcoi ndërvarësinë interpretuese ndërmjet Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe Direktivës së Kualifikimit duke iu referuar të parës në rastet që përfshinin përfituesit e mbrojtjes plotësuese. Kjo çështje është konsideruar si “revolucionare”. Në këtë rast, GJDBE-ja iu përgjigj pyetjes nëse ishte në përputhje me Direktivën e Kualifikimit kufizimi i lirisë së lëvizjes brenda vendit pritës (Gjermanisë) të personave që gëzonin mbrojtje plotësuese, nëpërmjet përfitimit të sigurimeve shoqërore. GJDBE-ja përsëriti deklaratat e mëparshme në lidhje me nevojën për të siguruar përputhshmëri me Konventën e Gjenevës të vitit 1951 dhe një zbatim të plotë dhe gjithëpërfshirës të kësaj Konvente. Përveç kësaj, GJDBE-ja vendosi se, duke qenë se neni 33 i Direktivës së Kualifikimit nuk lejon në mënyrë specifike dallimin në trajtim ndërmjet refugjatëve dhe per-

sonave që gëzojnë mbrojtje plotësuese dhe duke qenë se neni 26 i Konventës së Gjenevës i vitit 1951 mbi lirinë e lëvizjes së refugjatëve përfshin të drejtën e tyre për të zgjedhur vendbanimin e tyre, e njëjta e drejtë duhet të zbatohet sa i përket nenit 33 të Direktivës së Kualifikimit.

*Përjashtimi nga dhënia e statusit të refugjatit nëse personi është individualisht përgjegjës për aktet e kryera nga një organizatë nëpërmjet metodave terroriste*

**VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN BUNDESREPUBLIK  
DEUTSCHLAND kundër B AND D**  
(Çështjet nr. C-57/09 dhe C-101/09)  
**9 nëntor 2010**

### 1. Faktet kryesore

Ky rast u referua në GJDBE për vendim paraprak nga Bundesverwaltungsgericht në lidhje me interpretimin e nenit 12(2)(b) dhe (c) dhe nenit 3 të Direktivës së Këshillit 2004/83/EC të 29 prillit 2004 (Direktiva e Kualifikimit). Direktiva e Kualifikimit parashikon, ndër të tjera, përjashtimin e një personi nga dhënia e statusit të refugjatit kur ka arsye serioze për të besuar se ai ka kryer një “krim të rëndë jopolitik” ose është fajtor “për veprime në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara”. Ajo gjithashtu i lejon Shtetet Anëtare për të zbatuar standarde më të favorshme për përcaktimin e kritereve të kualifikimit si refugjat.

B, shtetas turk me origjinë kurde, kishte mbështetur luftën e armatosur guerile të udhëhequr nga Partia/Fronti Revolucionar Çlirimtar Popullor (DHKP/C). Në vitin 2002, ai hyri në Gjermani, ku kërkoi azil. Më 14 shtator 2004, Bundesamt für Migration und Flüchtlinge hodhi poshtë pretendimin e B-së për azil si të pabazuar dhe vendosi se nuk ishin plotësuar kushtet për njohjen e statusit të refugjatit, pasi ai kishte kryer një krim të rëndë jopolitik. Në qershor të vitit 2006, Verwaltungsgericht Gelsenkirchen rrëzoi vendimin e Bundesamt dhe urdhëroi dhënien e azilit për B-në. Bundesamt apeloj kundër këtij vendimi para Bundesverwaltungsgericht.

D, shtetas turk me origjinë kurde, banonte në Gjermani që nga maji i vitit 2001, kur mori statusin e refugjatit. Në mbështetje të kërkesës së tij, ai kishte deklaruar se kishte qenë një luftëtar gueril dhe zyrtar i lartë në Partinë Punëtore të Kurdistanit (PKK). Në vitin 2004 Bundesamt revokoi vendimin për dhënien e statusit të refugjatit D-së, duke vendosur se kishte arsye serioze për të besuar

se ai kishte kryer një krim të rëndë jopolitik jashtë Gjermanisë dhe se kishte qenë fajtor për akte në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara. Në vitin 2005, Verwaltungsgericht Gelsenkirchen rrëzoi vendimin e revokimit. Bundesamt apeloj këtë vendim.

## **2. Pyetjet e paraqitura nga gjykata kombëtare**

Bundesverwaltungsgericht i pezulloi të dy procedurat dhe kërkoi nga GJDBE-ja një vendim paraprak në lidhje me pyetjen nëse, kur personi në fjalë ka qenë një anëtar i një organizate e cila, për shkak të përfshirjes së saj në akte terroriste, është në listën e BE-së ku renditen grupet e përfshirë në akte terroriste dhe ka mbështetur në mënyrë aktive luftën e armatosur të zhvilluar nga ajo organizatë – dhe ndoshta ka pasur edhe një pozicion të rëndësishëm brenda kësaj organizate - është një rast i “krimeve të rënda jo-politike” ose “akteve në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara” sipas kuptimit të neni 12 (2)(b) dhe (c) të Direktivës 2004/83. Më tej ajo pyeti nëse përjashtimi nga statusi i refugjatit kushtëzohet nga fakti nëse personi në fjalë vazhdon të përfaqësojë një rrezik për Shtetin Anëtar pritës, ose nga një test proporcionaliteti që ndërmerret në lidhje me rastin konkret. Së fundmi, Bundesverwaltungsgericht pyeti GJDBE-ja nëse ishte në përputhje me Direktivën 2004/83, për qëllimet e neni 3 të kësaj Direktive, që një Shtet Anëtar t'i njohë një personi, të përjashtuar nga e drejta për të përfituar statusin e refugjatit në përputhje me nenin 12(2), të drejtën e azilit sipas ligjit të saj kushtetues.

## **3. Vendimi i GJDBE-së**

GJDBE-ja vendosi se aktet terroriste konsiderohen krime të rënda jo-politike sipas kuptimit të neni 12(2)(b) të Direktivës 2004/83 dhe autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare mund të zbatojnë nenin 12 (2)(c) të Direktivës 2004/83 për një person i cili, në rrjedhën e anëtarësisë së tij në një organizatë që është në listën e Aneksit për Qëndrimin e Përbashkët të 2001/931, ka qenë i përfshirë në akte terroriste me një dimension ndërkombëtar.

GJDBE-ja vlerësoi se përjashtimi i një personi, i cili ka qenë anëtar i një organizate që përdor metoda terroriste, nga statusi i refugjatit, është i kushtëzuar nga vlerësimi individual i fakteve të veçanta dhe autoriteti kompetent duhet të përcaktojë nëse ka arsye serioze për të konsideruar se, në kuadër të aktiviteteve të tij pranë kësaj organizate, ai person ka kryer një krim të rëndë jopolitik, ose është fajtor për vepra në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara, sipas kuptimit të Direktivës së Kualifikimit.

Më tej GJDBE-ja vërejtë pikë së pari, se neni 12(2)(b) dhe (c) i Direktivës 2004/83 duhet të interpretohet se anëtarësimi i një personi në një organizatë të tillë nuk mund të sjellë automatikisht përjashtimin e tij nga e drejta për të marrë statusin e refugjatit. GJDBE-ja vendosi se përfshirja e një organizatë në listën e BE-së të grupeve dhe subjekteve të përfshira në aktet terroriste, mundëson përcaktimin e natyrës terroriste të grupit, në të cilin personi në fjalë kishte qenë anëtar. Së dyti, sipas GJDBE-së, pjesëmarrja në veprimtaritë e një grupi terrorist nuk sjell, në vetvete, zbatimin automatik të klauzolave përjashtimit të përcaktuara në Direktivë, të cilat presupozojnë një hetim të plotë të të gjitha rrethanave të çdo rasti individual.

Para se të vendoset zbatimi i klauzolave përjashtuese, GJDBE-ja vendosi se autoriteti kompetent duhet të kenë mundësi për të përcaktuar përgjegjësinë individuale të personit në fjalë për aktet e kryera nga organizata ku ai ishte anëtar. Për këtë qëllim, autoriteti kompetent duhet, ndër të tjera, të vlerësojë rolin e vërtetë që luan personi i interesuar në kryerjen e akteve terroriste; pozitën e tij brenda organizatës; shkallën e informacioneve që kishte, ose presupozohet të kishte rreth aktiviteteve të saj; ndonjë presion ndaj të cilit ishte i ekspozuar; ose faktorë të tjerë që kishin ndikuar në sjelljen e tij.

Në qoftë se vlerësimi tregon se personi në fjalë ka një pozicion të rëndësishëm në një organizatë e cila përdor metoda terroriste, si në rastin e D-së, mund të merret me mend se ky person ka përgjegjësi individuale për aktet e kryera nga kjo organizatë gjatë periudhës përkatëse. Megjithatë, është përsëri e nevojshme të shqyrtohen të gjitha rrethanat përkatëse para se të merret një vendim për përjashtimin e atij personi nga marrja e statusit të refugjatit.

GJDBE-ja më tej deklaroi se klauzolat e përjashtimit u miratuan me qëllim përjashtimin nga marrja e statusit refugjat të personave të cilët nuk e meritonin mbrojtjen që statusi u jepte dhe parandalimin e dhënies së këtij statusi personave që kanë kryer disa krime të rënda dhe kërkojnë t'i shmangen përgjegjësisë penale. Prandaj, nuk është në përputhje me këtë objektiv të dyfishtë përjashtimi nga statusi i refugjatit sipas nenit 12 (2)(b) dhe (c) i Direktivës 2004/83 për shkak të ekzistencës së një rreziku aktual ndaj Shtetit Anëtar pritës. Në të njëjtën mënyrë, kur autoriteti kompetent ka vlerësuar tashmë seriozitetin e akteve të kryera nga personi në fjalë dhe përgjegjësinë individuale të tij, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e akteve dhe situatën e atij personi, nuk mund të kërkohej, në qoftë se konstatohet se neni 12(2) zbatohet, të ndërmerret një vlerësim të proporcionalitetit, duke nënkuptuar se ky përbën një vlerësim të ri të nivelit të seriozitetit të akteve të kryera.

Së fundmi, sipas GJDBE-ja neni 3 i Direktivës 2004/83 nënkuptonte se Shtetet Anëtare mund t'i njohin një personi, i cili përjashtohet nga statusi i refugjatit në përputhje me një nga klauzolat e përjashtimit të përcaktuara në këtë Direktivë, të drejtën e azilit sipas të drejtës së tyre të brendshme, për aq sa bëhet një dallim i qartë ndërmjet mbrojtjes kombëtare dhe mbrojtjes si refugjat sipas Direktivës së Kualifikimit.

#### 4. Koment

Në vendimin *D dhe B* GJDBE-ja për herë të parë shprehet në lidhje me klauzolat për përjashtimin nga statusi i refugjatit të Direktivës 2004/83 (Direktiva e Kualifikimit) dhe mbetet, deri më tani, vendimi më i rëndësishëm në këtë drejtim.

Në mënyrë të veçantë, ky vendim sqaron elemente të rëndësishme në lidhje me mundësinë për të aplikuar këto klauzola ndaj anëtarëve të një organizate terroriste dhe metodën që duhet të ndjekur për këtë qëllim. Në këtë drejtim, GJDBE-ja ka theksuar ndarjen midis Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit dhe disa normave të së drejtës ndërkombëtare. Vlen të përmendet se ky lloj arsytimi është përsëritur më pas në vendimin *Diakite*<sup>165</sup>.

Përjashtimi nga statusi i refugjatit i një personi, i cili kishte qenë anëtar i një organizate e cila përdorte metoda terroriste, kushtëzohet nga një vlerësim individual i fakteve të veçanta. Kështu, fakti që një person ka qenë anëtar i një organizate, si dhe ka mbështetur në mënyrë aktive luftën e armatosur të zhvilluar nga ajo organizatë nuk përbën automatikisht një arsye serioze për të konsideruar se ka kryer “një krim të rëndë jopolitik” ose “akte në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara”. Për këtë arsye, përgjegjësia individuale duhej të vlerësohet në dritën e kriterëve objektive dhe subjektive dhe duhet të bëhet një vlerësim për rolin e vërtetë që personi ka luajtur në kryerjen e akteve në fjalë; pozitën e tij brenda organizatës; shkallën e informacioneve që kishte, ose që presupozohej të kishte rreth aktiviteteve të saj; ndonjë presion ndaj të cilit ishte i ekspozuar; ose faktorë të tjerë që kishin ndikuar në sjelljen e tij.

Për më tepër, përjashtimi nga statusi i refugjatit sipas nenit 12(2)(b) dhe (c) i Direktivës së Kualifikimit nuk është i kushtëzuar nga fakti nëse personi në

165 C-285/12, *Aboubacar Diakité k. Commissaire général aux réfugiés et aux apatrides*, vendim i 30 janarit 2014, shih komentet e veçanta të përfshira në këtë kapitull.

fjalë përfaqëson një rrezik aktual për Shtetin Anëtar pritës dhe nuk është i kushtëzuar as nga vlerësimi i proporcionalitetit në lidhje me atë rast të veçantë.

Vendimi *B dhe D* ishte gjithashtu rasti i parë ku GJDBE-ja u shpreh në lidhje me nenin 3 të Direktivës së Kualifikimit, i cili i lejon Shtetet Anëtare për të miratuar apo mbajtur standarde më të favorshme në përcaktimin e kriterëve të kualifikimit për statusin e refugjatit apo mbrojtjen plotësuese dhe për përcaktimin se çfarë përmban mbrojtja ndërkombëtare. Lidhur me këtë, ai u pasua nga vendimi *M'Bodj*<sup>166</sup>.

-----  
166 C-542/13, *M'Bodj k. État belge*, vendim [Dhoma e Madhe] i 18 dhjetorit 2014, shih komentet e veçanta të përfshira në këtë kapitull.



*Kur persekutimi është mjaft serioz, statusi i refugjatit duhet të jepet*

## **VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND kundër Y DHE Z**

(Çështjet nr. C-71/11 dhe C-99/11)

**5 shtator 2012**

### **1. Faktet kryesore**

Ky rast u referua në GJDBE për vendim paraprak nga Bundesverwaltungsgericht (Gjermani) në lidhje me interpretimin e neneve 2(c) dhe 9(1)(a) të Direktivës së Këshillit 2004/83/EC e 29 prillit 2004 (Direktiva e Kualifikimit). Sipas Direktivës së Kualifikimit, Shtetet Anëtare duhet, në parim, t'u japin statusin e refugjatit shtetasve të vendeve të treta që kanë frikë nga persekutimi në vendin e tyre të origjinës për shkak të racës, fesë, kombësisë, mendimit politik, ose anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror, ndodhen jashtë vendit shtetësinë e të cilit kanë dhe nuk kanë mundësi ose nuk dëshirojnë për shkak të një frike të tillë, të përfitojnë nga mbrojtja e atij vendi. Një veprim mund të konsiderohet si persekutim, ndër të tjera, në qoftë se është mjaft serioz nga natyra ose përsëritja sa përbën shkelje të rëndë të të drejtave themelore të njeriut.

Përkatesisht në janar të vitit 2004 dhe në gusht të vitit 2003, Y dhe Z hynë në Gjermani dhe kërkuan azil. Ata pretenduan ishin detyruan të largoheshin nga Pakistani për shkak të anëtarësisë së tyre në komunitetin mysliman Ahmedija, një lëvizje reformiste islamike. Në veçanti, Y deklaroi se në disa raste ishte rrahur në fshatin e tij nga një grup njerëzish dhe se e kishin goditur me gurë në vendin e lutjes së komunitetit të tij. Ky grup njerëzish e kishte kërcënuar me vdekje dhe e kishte denoncuar në polici për fyerje të Profetit Muhamed. Z pohoi se ishte keqtrajtuar dhe burgosur për shkak të besimit të tij fetar. Në të vërtetë, Kodi Penal pakistanez parashikonte që anëtarët e komunitetit fetar Ahmedija mund të dënoheshin me burg deri në tre vjet ose me gjobë, nëse deklarorin se ishin myslimanë, e përshkruanin fenë e tyre si islame dhe predikonin ose propagandonin tek të tjerët besimin e tyre. Kodi parashikonte gjithashtu se çdo person i cili njolloste emrin e Profetit Muhamed mund të dënohej me vdekje ose burgim të përjetshëm dhe me gjobë.

Bundesamt, më 4 maj dhe 8 korrik 2004, vendosi refuzimin e kërkesave për azil të Y dhe Z si të pabaza. Të dy kërkuesit kundërshtuan vendimin e Bundesamt. Në rastin e Y gjykata kombëtare vërejti se përmbushte kërkesat për ndalimin

e dëbimit të tij në Pakistan, ndërsa ankimi i Z u rrëzua pasi nuk plotësonte kërkesën e frikës së mirë bazuar nga persekutimi.

Më 13 nëntor 2008, Sächsisches Oberverwaltungsgericht la në fuqi vendimin në lidhje me Y ndërsa në lidhje me Z u shpreh se në fakt plotësonte kriteret për të marrë statusin e refugjatit, prandaj u ndalua dëbimi i tij. Gjykata vërejtí se, në rast kthimi në Pakistan, të dy kërkuessit, si ahmedinë aktivë, nuk mund të vazhdonin të praktikonin fenë e tyre në publik pa u ekspozuar ndaj rrezikut të persekutimit, një faktor i cili duhej të merrej parasysh në çdo procedurë e azilit për të përcaktuar nëse duhej dhënë statusi i refugjatit.

Bundesamt dhe Bundesbeauftragter paraqitën një ankesë mbi një çështje të ligjit në Bundesverwaltungsgericht (Gjykata Administrative Federale), duke argumentuar se gjykata e apelit e kishte interpretuar në mënyrë shumë të zgjeruar fushëveprimin e Direktivës së Kualifikimit.

## **2. Pyetjet e paraqitura nga gjykata kombëtare**

Bundesverwaltungsgericht pezulloi procedurën dhe i kërkoí GJDBE-së të shprehej nëse neni 9(1)(a) i Direktivës së Kualifikimit duhej interpretuar se konsideronte çdo ndërhyrje në të drejtën e lirisë fetare “akt persekutimi” sipas kuptimit të kësaj dispozite dhe nëse duhej bërë dallimi ndërmjet “elementëve kryesore” të lirisë fetare dhe manifestimit të saj të jashtëm. GJDBE-ja u pyet gjithashtu nëse neni 2(c) i Direktivës së Kualifikimit duhet të interpretohet se nënkupton që frika e kërkuessit nga persekutimi është e mirë bazuar, kur personi mund të shmangë ekspozimin ndaj persekutimit në vendin e tij të origjinës duke mos u përfshirë në praktika të caktuara fetare .

## **3. Vendimi i GJDBE-së**

Së pari, GJDBE-ja vendosi se liria e fesë është një nga themelet e një shoqërie demokratike dhe është një e drejtë themelore e njeriut. Megjithatë, ajo u shpreh se jo çdo ndërhyrje në këtë të drejtë përbën një akt persekutimi që i detyron autoritetet kompetente të japin statusin e refugjatit.

Përkundrazi, neni 9(1) i Direktivës së Kualifikimit kërkon një “shkelje të rëndë” të lirisë fetare që ka një efekt të rëndësishëm tek personi në fjalë në mënyrë që të konsiderohet si akt persekutimi. Për këtë arsye, kufizimet në ushtrimin e së drejtës për lirinë e fesë të cilat mbulohen nga neni 52(1) të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian nuk mund të konsiderohen si akte persekutimi.

Së dyti, për përcaktimin, në mënyrë të veçantë, se cilat akte mund të konsiderohen akte persekutimi sipas kuptimit të nenit 9(1) (a) të Direktivës së Kualifikimit, GJDBE-ja vuri në dukje se ishte e panevojshme bërja e dallimit ndërmjet veprimeve që ndërhyjnë në “elementët kryesorë (*forum internum*)” të së drejtës themelore të lirisë së fesë, të cilat nuk përfshijnë veprimtaritë fetare në publik (*forum externum*), nga aktet të cilat nuk prekin ‘elementët kryesorë’. Gjithashtu, ajo vuri në dukje se aktet të cilat mund të përbëjnë “shkelje të rënda” sipas kuptimit të nenit 9(1)(a) të Direktivës së Kualifikimit përfshijnë akte të cilat ndërhyjnë në lirinë e kërkuesit jo vetëm për të praktikuar besimin e tij në rrethin privat, por edhe për ta shfaqur atë publikisht. Për këtë arsye, nuk është e rëndësishme natyra publike apo private, ose kolektive apo individuale, e shfaqjes dhe praktikimit të fesë në përcaktimin nëse një shkelje e së drejtës së lirisë së fesë duhet të konsiderohet si persekutim, por ashpërsia e masave dhe sanksioneve të zbatuara ose që mund të zbatohen ndaj personit në fjalë.

Në këtë kontekst, GJDBE-ja vendosi se një shkelje e së drejtës së lirisë së fesë mund të përbëjë akt persekutimi, kur, për shkak të ushtrimit të kësaj lirie në vendin e tij të origjinës, azilkërkuesi rrezikon realisht, ndër të tjera, të ndiqet penalisht apo t’i nënshtrohet ndëshkimit çnjerëzor ose poshtëruës nga njëri prej aktorëve të përmendur në nenin 6 të Direktivës së Kualifikimit. GJDBE-ja vërejtë se kur pjesëmarrja në praktikën e faljes, qoftë vetë ose me të tjerët, mund të shkaktojë një rrezik të tillë, shkelja e të drejtës për lirinë e fesë mund të jetë mjaft serioze.

Më tej, GJDBE-ja konstatoi se në vlerësimin e një rreziku të tillë, autoritetet kompetente duhet të marrin në konsideratë një numër faktorësh, objektivë dhe subjektivë. Rrethana subjektive se respektimi i një praktike të caktuar fetare në publik, i cili është subjekt i kufizimeve në fjalë, është i një rëndësie të veçantë për personin në fjalë në mënyrë që të ruajë identitetin e tij fetar, është një faktor i rëndësishëm që duhet të merret parasysh në përcaktimin e nivelit të rrezikut ndaj të cilit do të ekspozohet kërkuesi në vendin e tij të origjinës për shkak të fesë së tij, edhe nëse respektimi i një praktike të tillë fetare nuk përbën një element thelbësor të besimit të komunitetit fetar në fjalë. Në të vërtetë, në bazë të GJDBE-së mbrojtja nga persekutimi për arsye fetare, shtrihet qoftë tek format e sjelljes individuale qoftë tek ato në bashkësi, të cilat personi në fjalë i konsideron të nevojshme për të - konkretisht ato ‘të bazuara në [...] një besim fetar’ - dhe ato të parashikuara nga doktrina fetare - d.m.th. ato ‘të kërkuara nga një besim fetar’.

Së fundmi, për sa i përket interpretimit të nenit 2 (c) të Direktivës së Kualifi-

kimit, GJDBE-ja vendosi se, kur konstatohet se, nëse pas kthimit në vendin e tij të origjinës, praktikimi i fesë nga personi në fjalë do e ekspozonte atë ndaj rrezikut real të persekutimit, atij duhet t'i jepej statusi i refugjatit. Ajo vendosi se, në vlerësimin e një kërkesë për azil mbi baza individuale, autoritetet kombëtare nuk mund të presin që azilkërkuesi të heqë dorë nga manifestimi ose praktikimi i akteve të caktuara fetare.

#### 4. Koment

Vendimi *Y dhe Z* është kyç për sa i përket nocionit të “aktit të persekutimit” në kuptimin e nenit 9 të Direktivës së Kualifikimit, ku GJDBE-ja sqaroi se si duhet kuptuar lidhja midis këtij nocioni dhe shkeljes së të drejtave të njeriut. Gjithashtu, ky vendim përfshiu elemente të rëndësishme në objektin e mbrojtjes kundër persekutimit mbi baza fetare<sup>167</sup>.

GJDBE-ja shpjegoi, pikë së pari, se vetëm disa forma të rënda të ndërhyrjes në të drejtën për lirinë e fesë dhe jo çdo ndërhyrje, mund të përbëjë akt persekutimi që detyron autoritetet kompetente për të dhënë statusin e refugjatit. Prandaj, kufizimet në ushtrimin e kësaj të drejte, të cilat janë të mbuluara nga neni 52 (1) të Kartës, nuk mund të konsiderohen si akte persekutimi. Për më tepër, edhe shkelja e së drejtës përbën akt persekutimi vetëm nëse është mjaft serioze dhe ka një efekt të rëndësishëm tek personi në fjalë.

GJDBE-ja sqaroi gjithashtu se aktet që mund të përbëjnë një shkelje të rëndë përfshijnë akte të rënda të cilat ndërhyjnë në lirinë e një personi jo vetëm për të praktikuar besimin e tij në rrethe private, por edhe për ta manifestuar publikisht. Për këtë arsye, nuk është e rëndësishme natyra publike apo private, ose kolektive apo individuale, e shfaqjes dhe praktikimit të fesë në përcaktimin nëse një shkelje e së drejtës së lirisë së fesë duhet të konsiderohet si persekutim, por ashpërsia e masave dhe sanksioneve të zbatuara ose që mund të zbatohen ndaj personit në fjalë. Në këtë kontekst, GJDBE-ja vendosi se një shkelje e së drejtës së lirisë së fesë mund të përbëjë akt persekutimi, kur, për shkak të ushtrimit të kësaj lirie në vendin e tij të origjinës, azilkërkuesi rrezikon realisht, ndër të tjera, të ndiqet penalisht apo t'i nënshtrohet ndëshkimit çnjerëzor ose poshtërues nga njëri prej aktorëve të përmendur në nenin 6 të Direktivës së Kualifikimit. Më tej, GJDBE-ja konstatoi se në vlerësimin e një rreziku të tillë, autoritetet kompetente duhet të marrin në konsideratë një numër faktorësh,

167 Shih komentet në vendim e Gjykatës Administrative Federale Gjermane, 20 shkurt 2013, *BVerwG, 10 C 23.12*, i përfshirë në kapitullin për jurisprudencën e gjykatave kombëtare.

objektivë dhe subjektivë. Rrethana subjektive se respektimi i një praktike të caktuar fetare në publik, i cili është subjekt i kufizimeve në fjalë, është i një rëndësie të veçantë për personin në fjalë në mënyrë që të ruajë identitetin e tij fetar, është një faktor i rëndësishëm që duhet të merret parasysh në përcaktimin e nivelit të rrezikut ndaj të cilit do të ekspozohet kërkuesi në vendin e tij të origjinës për shkak të fesë së tij, edhe nëse respektimi i një praktike të tillë fetare nuk përbën një element thelbësor të besimit të komunitetit fetar në fjalë.

Së fundmi, GJDBE-ja vendosi se, kur autoritetet kompetente vërejnë se, nëse pas kthimit në vendin e tij të origjinës, praktikimi i fesë nga personi në fjalë do e ekspozonte atë ndaj rrezikut real të persekutimit, atij duhet t'i jepej statusi i refugjatit. Ajo vendosi se, në vlerësimin e një kërkesë për azil mbi baza individuale, autoritetet kombëtare nuk mund të presin që azilkërkuesi të heqë dorë nga manifestimi ose praktikimi i akteve të caktuara fetare.

Disa nga parimet e përcaktuara në këtë vendim u zbatuan më pas në një lloj tjetër persekutimi në çështjen *X, Y dhe Z*<sup>168</sup>.

---

168 C-199/12 deri C-201/12, *Minister voor Immigratie en Asiel k. X dhe Y dhe Z k. Minister voor Immigratie en Asiel*, vendim i 7 nëntorit 2013, shih komentet e veçanta, të përfshira në këtë kapitull.

*Azilkërkuesit homoseksual përbëjnë një grup të veçantë shoqëror që mund të persekutohen për shkak të orientimit të tyre seksual*

## **VENDIMI NË ÇËSHTJEN MINISTER VOOR IMMIGRATIE EN ASIEL kundër X DHE Y DHE Z kundër MINISTER VOOR IMMIGRATIE EN ASIEL**

(Çështjet nr. C-199/12 deri C-201/12)

**7 nëntor 2013**

### **1. Faktet kryesore**

Ky rast u referua në GJDBE për vendim paraprak nga Raad van State (Holandë) në lidhje me interpretimin e nenit 9(1)(a) të Direktivës së Këshillit 2004/83/EC të 29 prillit 2004 (Direktiva e Kualifikimit), e lexuar në lidhje me nenin 9(2)(c) dhe nenin 10(1)(d) të saj. Në bazë të Direktivës së Kualifikimit, çdo person i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit për arsye të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të tij të shtetësisë dhe nuk ka mundësi ose nuk dëshiron për shkak të një frike të tillë, të përfitojë nga mbrojtja e atij vendi, mund të kërkojë statusin e refugjatit. Një akt mund të konsiderohet si akt persekutimi nëse është mjaft i rëndë nga natyra ose përsëritja sa përbën shkelje të rëndë të të drejtave themelore të njeriut, ose nëse përbën një tërësi masash të ndryshme, duke përfshirë edhe shkeljet e të drejtave të njeriut, të cilat janë aq të rënda, sa ndikojnë tek një individ në mënyrë të ngjashme me shkeljet e rënda të të drejtave themelore të njeriut.

X, Y dhe Z, shtetas të Sierra Leones, Ugandës dhe Senegalit, aplikuan për leje qëndrimi për një periudhë të caktuar (azil) në Holandë, përkatësisht në vitet 2009, 2011 dhe 2010, duke pretenduar se kishin një frikë të bazuar së nëse ktheheshin në vendet e tyre të shtetësisë do të persekutoheshin për shkak të orientimit të tyre seksual. Në të vërtetë, aktet homoseksuale ishin vepër penale në tri këto vende dhe dënoheshin me gjobë të rëndë deri në burgim të përjetshëm, në raste të caktuara.

Ministri, nëpërmjet dekreteve të 18 marsit 2010, 10 majit 2011 dhe 12 janarit 2011, u refuzoi X, Y dhe Z dhënien e lejes së qëndrimit për një periudhë të caktuar (azilin). Sipas Ministrit, edhe pse orientimi seksual i azilkërkuesve ishte i besueshëm, ata nuk i kishin provuar, në standardin e kërkuar ligjor, faktet dhe rrethanat në të cilat mbështeteshin dhe kishin dështuar të dëshmonin se kishin një frikë të mirë bazuar që nëse ktheheshin në vendet e tyre përkatëse të origjinës mund të persekutoheshin për shkak të përkatësisë së tyre në një grup të caktuar shoqëror.

Pas refuzimit të kërkesës së tyre për leje qëndrimi, X dhe Z apeluan, ndërsa Y depozitoi një kërkesë për masë të përkohshme para Rechtbank's-Gravenhage. Gjykata kombëtare pranoi ankimin e X dhe kërkesën e Y, duke deklaruar, në veçanti, se Ministri nuk kishte dhënë arsye të mjaftueshme në të dy këto raste, nëse, duke pasur parasysh veçanërisht penalizimin e akteve homoseksuale në vendet e origjinës, frika nga persekutimi i X dhe Y për shkak të homoseksualitetit të tyre, ishte e mirë bazuar. Rechtbank's-Gravenhage rrëzoi ankimin e Z, me argumentin se nga dokumentacioni i parashtruar nga Z nuk tregohet se në Senegal homoseksualët përndiqeshin në mënyrë sistematike.

Ministri apeloj në Raad van State të dy vendimet që rrëzonin vendimet e tij për refuzimin e dhënies së lejes së qëndrimit X dhe Y. Z iu drejtua së njëjtës gjykatë për të kundërshtuar vendimin që rrëzonte ankimin e tij kundër vendimit të Ministrit për refuzimin e kërkesës së tij.

## **2. Pyetjet e paraqitura nga gjykata kombëtare**

Raad van State pezulloi procedurën dhe pyeti GJDBE-së nëse neni 10(1)(d) i Direktivës së Kualifikimit mund të interpretohej se, për qëllime të vlerësimit të arsyeve të persekutimit në të cilat mbështeteshin azilkërkuesit për marrjen e statusit të refugjatit, i konsideronte homoseksualët anëtarë të një grupi të caktuar shoqëror. Në këtë rast, Raad van State pyeti Gjykatën nëse mund të pretendohet nga shtetasit e huaj me orientim homoseksual që ta fshihnin orientimin e tyre seksual në vendin e tyre të origjinës me qëllim që të shmangnin persekutimin. Për më tepër, si duhej ta vlerësonin autoritetet kombëtare se çfarë përbënte një akt persekutimi kundër homoseksualitetit në këtë kontekst dhe nëse sanksionimi si vepër penale e dënueshme me burgim, në vendin e tyre të origjinës, përbënte akt persekutimi.

## **3. Vendimi i GJDBE-së**

Neni 10(1) i Direktivës së Kualifikimit jep përkufizimin e grupit të veçantë shoqëror, anëtarësimi tek i cili mund të çojë në një frikë të vërtetë nga persekutimi. Kështu, një grup konsiderohet një "grup i veçantë shoqëror", kur pjesëtarët e tij kanë një karakteristikë të lindur të përbashkët, një histori të njëjtë që nuk mund të ndryshohet, ndajnë të njëjtin besim ose karakteristikë, që është aq thelbësor për identitetin apo ndërgjegjen e tyre sa nuk duhet të detyrohen të heqin dorë dhe kur grupi ka një identitet të veçantë në Shtetin përkatës, sepse perceptohet si i ndryshëm nga shoqëria përreth.

GJDBE-ja vërejt, para së gjithash, se është e gjithë pranuar se orientimi seksual i një personi është një karakteristikë aq thelbësore për identitetin e tij se ai nuk duhet të detyrohet të heqë dorë prej saj. Rrjedhimisht, ajo pranon se ekzistenca e ligjeve penale që shënjestrojnë në mënyrë specifike homoseksualët mbështet përfundimin se ata perceptohen si të ndryshëm nga shoqëria përreth, duke formuar kështu një grup të veçantë shoqëror. Prandaj, neni 10(1)(d) i Direktivës së Kualifikimit duhet të interpretohet se nënkupton që ekzistenca e ligjeve penale, si në rastet në fjalë, të cilat kanë në shënjestër në mënyrë specifike homoseksualët, mbështet konstatimin se këta persona duhet të konsiderohen një grup i veçantë shoqëror.

Megjithatë, në mënyrë që shkelja e të drejtave themelore të përbëjë akt persekutimi, ajo duhet të jetë mjaft e rëndë dhe për rrjedhojë jo të gjitha shkeljet e të drejtave themelore të një azilkërkuesi homoseksual domosdoshmërisht arrijnë një nivel të tillë rëndësie. Në këtë kontekst, thjesht ekzistenca e legjislacionit që kriminalizon homoseksualizmin nuk mund të konsiderohet si një akt që cenon azilkërkuesin në një mënyrë të tillë sa të arrijë nivelin e nevojshëm të rëndësisë për t'u konsideruar një akt persekutimi, sipas kuptimit të nenit 9(1) të Direktivës së Kualifikimit. Megjithatë, parashikimi i dënimit me burgim për homoseksualizmin mund të përbëjë një akt persekutimi në vetvete, me kusht që në realitet të zbatohet.

Në këto rrethana, kur një aplikant mbështet kërkesën e tij për azil tek ekzistenca e legjislacionit që kriminalizon aktet homoseksuale në vendin e tij të origjinës, autoritetet kombëtare duhet të ndërmarrin një shqyrtim të të gjitha fakteve relevante në vendin e origjinës, duke përfshirë ligjet e atij vendi dhe rregulloret si dhe mënyrën sesi zbatoheshin. Nëpërmjet këtij shqyrtimi, autoritetet duhet të përcaktojnë, në mënyrë të veçantë, nëse dënimi me burgim i parashikuar nga legjislacioni në vendin e origjinës së azilkërkuesit zbatohet në praktikë.

Së fundmi, GJDBE-ja duhet të përcaktonte nëse ishte e arsyeshme të pretendohet që azilkërkuesit ta fshihnin homoseksualitetin e tyre në vendin e origjinës ose të vetëpërmbaheshin në deklarinimin e këtij fakti, për të shmangur persekutimin dhe nëse kjo vetëpërmbytje duhet të ishte më e madhe se në rastin e një personi heteroseksual. Lidhur me këtë, GJDBE-ja vërejt se t'i kërkoje anëtarëve të një grupi shoqëror që kishin të njëjtin orientim seksual ta fshihnin atë, binte në kundërshtim me pranimin e orientimit seksual si një karakteristikë themelore për identitetin e një personi, nga i cili nuk mund të hiqnin dorë. Prandaj, nuk mund të pretendohet nga azilkërkuesit që ta fshihnin homo-



seksualitetin e tyre në vendin e tyre të origjinës, në mënyrë që të shmangnin persekutimin.

Lidhur me vetëpërbajtjen që një person duhet të ushtrojë, në sistemin e parashikuar nga Direktiva e Kualifikimit, kur vlerësohet nëse azilkërkuesi ka një frikë të mirë bazuar persekutimi, autoritetet kompetente duhet të verifikojnë nëse rrethanat e verifikuara përbëjnë një kërcënim të tillë për personin në fjalë që sjell për rrjedhojë frikën e arsyeshme, në dritën e situatës së tij individuale, se do të persekutohet. Në vlerësimin e shkallës së rrezikut të veprimeve aktuale të persekutimit në një situatë të veçantë, GJDBE-ja vendosi se fakti që aplikanti mund të shmangë këtë rrezik, duke ushtruar vetëpërbajtje më të madhe se një heteroseksual, nuk duhet të merret parasysh në këtë drejtim. Për këto arsye, personit në fjalë duhet t'i jepet statusi i refugjatit, kur vërtetohet se kthimi i tij në vendin e origjinës, do ta ekspozonte atë ndaj rrezikut real të persekutimit për shkak të homoseksualitetit të tij, sipas kuptimit të nenit 9 (1).

#### 4. Koment

Në vendimin *X, Y dhe Z*, GJDBE-ja u shpreh për herë të parë për një temë të ndjeshme dhe aktuale në fushën e azilit: mbrojtjen e personave ndaj sanksioneve penale për shkak të orientimit të tyre seksual. GJDBE-së iu kërkua t'u jepte përgjigje tri pyetjeve.

Lidhur me pyetjen nëse shtetasit e huaj me orientim homoseksual formonin një “grup të veçantë shoqëror” në kuptimin e Direktivës së Kualifikimit, GJDBE-ja vendosi se në këtë rast ishin përmbushur të dy kushtet e listuara në Direktivë: orientimi seksual i një personi është një karakteristikë themelore për identitetin e tij, si dhe ekzistenca e ligjeve që kriminalizonin homoseksualitetin mbështesnin konstatimin se komuniteti homoseksual perceptohej si i ndryshëm nga pjesa tjetër e shoqërisë në vendet përkatëse.

Përsa i përket pyetjes nëse dënimet penale të parashikuara për homoseksualitetin, nëse nuk zbatoheshin në praktikë, mund të konsideroheshin si akt persekutimi, GJDBE-ja iu përgjigj negativisht. Kjo mund të krahasohet me qëndrimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila ka vendosur në çështjet *Dudgeon k. Mbretërisë së Bashkuar*, *Norris k. Irlandës dhe Modinos k. Qipros*<sup>169</sup> se “thjesht ekzistenca e ligjeve të tilla shkel nenin 8”. GJDBE-ja vendosi

169 *Dudgeon k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 22 tetorit 1981, nr. 7525/76; *Norris k. Irlandës*, vendim i 26 tetorit 1988, nr. 10581/83; *Modinos k. Qipros*, vendim i 22 prillit 1993, nr. 15070/89.

se neni 9 i Direktivës së Kualifikimit thekson se aktet përkatëse që përbëjnë akte persekutimi duhet të jenë “mjaft të rënda” nga natyra ose përsëritja që të përbëjnë një «shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut» dhe sipas GJDBE-së, thjesht kriminalizimi i homoseksualitetit nuk arrin në këtë nivel rëndësie. Megjithatë, dënimi me burgim i akteve homoseksuale dhe zbatimi i këtij dënimi në praktikë në vendin e origjinës duhet të konsiderohet si ndëshkim jo proporcional dhe diskriminues në bazë të nenit 9(2)(c) dhe në këtë mënyrë, përbën një akt persekutimi.

Së fundmi, GJDBE-ja vendosi se nuk mund të pretendohet në mënyrë të arsyeshme që azilkërkuesit të “fshihnin homoseksualitetin e tyre në vendin e origjinës, ose të vetëpërmbaheshin në shprehjen e tij». Lidhur me këtë, GJDBE-ja iu referua për analogji vendimit të saj në rastin Y dhe Z<sup>170</sup>, ku vendosi që mundësia e mos ushtrimit të praktikës fetare nga azilkërkuesit, me qëllim shmangien e persekutimit, nuk duhet të merrej parasysh nga autoritetet në përcaktimin e rrezikut të persekutimit. Në mënyrë të ngjashme, GJDBE-ja deklaroi se «fakti që azilkërkuesi mund të shmangë rrezikun duke ushtruar vetëpërmbytje më të madhe se një heteroseksual në shprehjen e orientimit të tij seksual nuk duhet të merret parasysh”.

Gjithashtu, duhet përmendur se vendimi X, Y dhe Z fokusohet në përkufizimin e persekutimit, ndërsa pyetjet në lidhje me vlerësimin e fakteve të orientimit seksual u trajtuan më vonë në vendimin e A, B dhe C<sup>171</sup>.

170 C-71/11 dhe C-99/11, *Bundesrepublik Deutschland k. Y dhe Z*, vendim [Dhoma e Madhe] i 5 shtatorit 2012, i përfshirë në këtë kapitull.

171 C-148/13 deri C-150/13, *A, B dhe C k. Staatssecretarías van Veiligheid en Justitie*, vendim [Dhoma e Madhe] i 2 dhjetorit 2014, i përfshirë në këtë kapitull.

*Interpretimi i “konfliktit të brendshëm të armatosur” në kontekstin e mbrojtjes ndërkombëtare*

## **VENDIMI NË ÇËSHTJEN ABOUBACAR DIAKITÉ kundër COMMISSAIRE GÉNÉRAL AUX RÉFUGIÉS ET AUX APATRIDES**

(Çështja nr. C-285/12)

**30 janar 2014**

### **1. Faktet kryesore**

Ky rast u referua në GJDBE për vendim paraprak nga Këshillit i Shtetit (Belgjikë) në lidhje me interpretimin e nenit 15(c) të Direktivës së Këshillit 2004/83/EC të 29 prillit 2004. Direktiva e mbron jo vetëm personat të cilët mund të kualifikohen për njohjen e statusit refugjat, por edhe ata që kualifikohen për mbrojtjen plotësuese. Një shtetas i vendit të tretë kualifikohet për të marrë mbrojtje plotësuese, kur ka arsye serioze për të besuar se, kthimi në vendin e tij të origjinës ose në vendbanimin e mëparshëm, do e vendose përballë rrezikut real të dëmtim serioz, siç përcaktohet në nenin 15 të Direktivës 2004/83. Dëmtimi i specifikuar në nenin 15(c) të Direktivës 2004/83 konsiston në “kërcënimin serioz e individual për jetën e personit apo të civilëve, për shkak të dhunës pa dallim në situatat e një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm”.

Rasti në fjalë ka të bëjë me një shtetas nga Guinea, Z. Diakite, i cili kërkoi mbrojtje ndërkombëtare nga Belgjika me 21 shkurt 2008, me pretendimin se kishte qenë viktimë e akteve të dhunës në Guinea pas pjesëmarrjes së tij në lëvizjet protestuese kundër regjimit në pushtet. Autoriteti kompetent kombëtar nuk pranoi t'i japë Z. Diakite statusin e refugjatit dhe as mbrojtjen plotësuese. Ky vendim i dyfishtë u la në fuqi nga Conseil du contentieux des étrangers (Bordi belg për azilin dhe emigracionin).

Më 15 korrik 2010, Z. Diakite bëri një kërkesë tjetër për azil tek autoritetet belge. Autoriteti kompetent kombëtar refuzoi edhe një herë dhënien e statusit refugjat Z. Diakite. Atij iu mohua edhe mbrojtja plotësuese, me argumentin se nuk ka një situatë dhune pa dallim apo “konflikt të brendshëm të armatosur” në Guine.

Z. Diakite u ankua kundër këtij vendimi para Conseil du contentieux des étrangers, i cili, në maj të vitit 2011, la në fuqi vendimin e autoritetit kompetent kombëtar që i refuzonte atij statusin e refugjatit dhe mbrojtjen plotësuese. Ky vendim u mbështet, ndër të tjera, në përkufizimin e “konfliktit të brendshëm të armatosur” të përcaktuar sipas së drejtës ndërkombëtare humanitare. Në ank-

esën e tij në Conseil d' État (Këshilli i Shtetit), Z. Diakite kundërshtoi vendimin e Conseil du contentieux des étrangers.

## 2. Pyetjet e paraqitura nga gjykata e brendshme

Këshilli i Shtetit vendosi të pezullojë procedurën dhe kërkoi një vendim paraprak nga GJDBE-ja në mënyrë që të sqarohej nëse interpretimi që do t'i jepej konceptit të “konfliktit të armatosur të brendshëm”, të përmendur në Direktivën 2004/83, duhet të ishte i pavarur nga përkufizimi që i bën e drejta ndërkombëtare humanitare dhe, nëse po, cilat kritere duhet të plotësohen për të vlerësuar ekzistencën e një konflikti i tillë për qëllimet e përcaktimit nëse një shtetas i një vendi të tretë ose një person pa shtetësi ka të drejtë të marrë mbrojtje plotësuese.

## 3. Vendimi i GJDBE-së

Për GJDBE-në, koncepti i “konfliktit të armatosur të brendshëm”, i përdorur në Direktivën 2004/83, është unik dhe nuk është reflektuar në mënyrë të drejtë-përdrejt në të drejtën ndërkombëtare humanitare, e cila pranon vetëm “konflikt të armatosur të një karakteri jo ndërkombëtar”. Ndërsa e drejta ndërkombëtare humanitare ka për qëllim, ndër të tjera, mbrojtjen e popullatës civile në një zonë konflikti, duke kufizuar sa më shumë efektet e luftës kundër personave dhe pronës, në ndryshim nga Direktiva 2004/83, ajo nuk garanton mbrojtje ndërkombëtare për civilët që ndodhen jashtë zonave të konflikti dhe territorit të palëve në konflikt. Si pasojë, përkufizimi i së drejtës ndërkombëtare humanitare për “konfliktin e armatosur” nuk identifikon situatat, në të cilat mbrojtja ndërkombëtar është e nevojshme dhe duhet të jepet nga autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare.

Prandaj, GJDBE-ja vuri në dukje se e drejta ndërkombëtare humanitare dhe regjimi i mbrojtjes plotësuese e parashikuar nga Direktiva 2004/83 ndjekin qëllime të ndryshme dhe krijojnë mekanizma mjaft të dallueshëm mbrojtjeje.

Si pasojë, GJDBE-ja deklaroi se objekti i frazës “konflikt i brendshëm i armatosur” duhet të përcaktohet duke marrë parasysh kuptimin e saj të zakonshëm në gjuhën e përditshme, ku ajo i referohet një situatë në të cilën forcat e armatosura në një shtet përballen me një ose më shumë grupe të armatosura ose kur dy ose më shumë grupe të armatosura përballen me njëri-tjetrin. GJDBE-ja më tej rikujtoi se, në kuadër të sistemit të parashikuar në Direktivën 2004/83, ekzistenca e një konflikti të armatosur mund të jetë shkak për

dhënien e mbrojtjes plotësuese vetëm kur shkalla e dhunës pa dallim arrin një nivel të tillë të lartë sa personi që kërkon mbrojtje plotësuese, do të përballet me rrezikun real të kërcënimit serioz dhe individual ndaj jetës apo personit të tij vetëm për shkak të pranisë së tij në territorin në fjalë. Prandaj, është e nevojshme, kur konsiderohet një kërkesë për mbrojtje plotësuese, kryerja e një vlerësimi të veçantë të intensitetit të konfliktit të armatosur në fjalë.

Duke pasur parasysh se mbrojtja plotësuese është modeluar për të plotësuar mbrojtjen që u ofrohet refugjatëve, të mishëruar në Konventën e Gjenevës të vitit 1951, me anë të identifikimit të personave që vërtetë kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe ofrimin atyre të një statusi të përshtatshëm, konstatimi se ka një konflikt të armatosur nuk duhet kushtëzuar me faktin nëse forcat e armatosura të përfshira në konflikt kanë një nivel të caktuar organizimi apo nga kohëzgjatja e konfliktit nëse ky konflikt, në të cilin janë të përfshira këto forcat e armatosura, ka sjellë si pasojë një nivel dhune që arrin pragun e përcaktuar nga neni 15(c) i Direktivës 2004/83.

Si pasojë, në ndërtimin e duhur të nenit 15(c) të Direktivës 2004/83, një konflikt i brendshëm i armatosur ekziston në qoftë se forcat e armatosura të një shteti përballen me një ose më shumë grupe të armatosura ose në qoftë se dy ose më shumë grupe të armatosura përballen me njëri-tjetrin. Nuk është e nevojshme që konflikti të kategorizohet si “konflikt i armatosur i një karakteri jo ndërkombëtar” sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare; as nuk është e nevojshme të kryhet, përveç vlerësimit të nivelit të dhunës në territorin në fjalë, një vlerësim i veçantë i intensitetit të konfliktit të armatosura, i nivelit të organizimit të forcave të armatosura të përfshira ose i kohëzgjatjes e konfliktit .

#### 4. Koment

Lloji i dëmit të cilit i referohet neni 15(c) i Direktivës së Kualifikimit kërkon një nivel të caktuar dhune në situatat e konfliktit të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm. Ndërsa në vendimin *Elgafaji*<sup>172</sup> GJDBE-ja shpjegoi elementë të rëndësishëm në lidhje me këtë nivel të dhunës, në vendimin *Diakite* sqaroi konceptin e “konfliktit të armatosur ndërkombëtar”, në nenin 15(c) të Direktivës së Kualifikimit.

Para këtij vendimi, ka pasur një debat të vazhdueshëm në qarqet akademike,

172 C-465/07, *Meki Elgafaji dhe Noor Elgafaji k. Staatssecretaris van Justitie*, vendim [Dhoma e Madhe] i 17 shkurtit 2009, shih komentet e veçanta të përfshira në këtë kapitull.

por edhe nga gjyqtarë kombëtarë, nëse ky koncept duhet të interpretohet duke iu referuar të drejtës ndërkombëtare humanitare (DNH). Pyetja për GJDBE-në ishte nëse duhej vendosur shenja e barazimit ndërmjet konceptit të “konfliktit të armatosur të brendshëm” të Direktivës së Kualifikimit dhe të konceptit të “konfliktit të armatosur jo-ndërkombëtar” të DNH-ja, për qëllime të interpretimit të së drejtës së BE-së dhe për pasojë për zbatimin e legjislacioneve kombëtare të Shteteve Anëtare në përputhje me të drejtën e BE-së.

GJDBE-ja vendosi se e drejta ndërkombëtare humanitare dhe Direktiva e Kualifikimit ndjekin qëllime të ndryshme dhe të krijojnë mekanizma të veçanta të mbrojtjes. E para siguron mbrojtje për popullsinë civile në një zonë konflikti duke kufizuar efektet e luftës, ndërsa kjo e fundit mbron civilë të caktuar që ndodhen jashtë zonës së konfliktit. Përkufizimi i konfliktit të armatosur në të drejtën ndërkombëtare humanitare nuk është projektuar për të identifikuar situatat në të cilat mbrojtja ndërkombëtare është e nevojshme. Prandaj, e drejta për mbrojtje plotësuese për shkak të “konfliktit të armatosur të brendshëm” nuk mund të jetë subjekt i kushteve të drejtës ndërkombëtare humanitare.

Në dritën e kësaj, GJDBE-ja theksoi se “konflikt i armatosur i brendshëm” duhet të kuptohet në mënyrë të pavarur, kryesisht për shkak të dallimeve të konsiderueshme ndërmjet të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit (SPEA). Kështu, GJDBE-ja vendosi se përkufizimi i «konfliktit të brendshëm të armatosur» duhet të marrë kuptimin e zakonshëm që ai ka në gjuhën e përditshme: grupet e armatosura që konfliktohen me njëri-tjetrin ose me forcat e armatosura shtetërore dhe jo si përcaktohen në bazë të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

Sipas Direktivës së Kualifikimit, vetëm konfliktet e armatosura të brendshme në vendin e origjinës së personit, përbëjnë “arsye serioze” për të besuar se nëse ai kthehet atje do të përballet me “rrezikun real” të të qenit subjekt i “një kërcënimi serioz dhe individual” për jetën e tij. Prandaj, duke pasur parasysh këtë kriter, GJDBE-ja vendosi se ishte e panevojshme vendosja e kushteve shtesë në lidhje me intensitetin, nivelin e organizimit dhe kohëzgjatjen e konfliktit përkatës. Kushte të tilla nuk i shërbenin qëllimit të Direktivës së Kualifikimit për identifikimin e personave vërtetë në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

Rrjedhimisht, vendimi *Diakité* sqaroi qëllimin e mbrojtjes plotësuese dhe gjithashtu kontribuoi në përcaktimin e marrëdhënieve ndërmjet të drejtës ndërkombëtare dhe SPEA.

*Vlerësimi i besueshmërisë së një kërkesë për azil të bazuar në orientimin seksual*

**VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN A, B DHE C kundër  
STAATSSECRETARIAS VAN VEILIGHEID EN JUSTITIE**

(Çështjet nr. C-148/13 to C-150/13)

**2 dhjetor 2014**

**1. Faktet kryesore**

Ky rast u referua në GJDBE për vendim paraprak nga Raad van State (Këshilli i Shtetit holandez) në lidhje me interpretimin e nenit 4 të Direktivës së Këshillit 2004/83/EC të 29 prillit 2004 (Direktiva e Kualifikimit), e cila përcakton kushtet për vlerësimin e fakteve dhe rrethanave për kualifikimin e shtetasve të vendeve të treta ose të personave pa shtetësi si refugjatë ose si persona që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe të neneve 3 dhe 7 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian ('Karta'), për mbrojtjen e të drejtës së integritetit të personit dhe të drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare.

A, B dhe C, shtetas të vendeve të treta, kërkuan azil në Holandë, duke pretenduar se i frikësoheshin persekutimit në vendet e tyre përkatëse të origjinës për shkak, në veçanti, të homoseksualitetit të tyre. Autoritetet kompetente refuzuan kërkesat për azil për të tre azilkërkuesit, me argumentin se deklaratat e tyre në lidhje me homoseksualitetin nuk ishin të besueshme.

Të tre azilkërkuesit i kundërshtuan këto vendime. Raad van State u shpreh se verifikimi i pretendimit të persekutimit për shkak të orientimit seksual të azilkërkuese nuk është i ndryshëm nga verifikimi i arsyeve të tjera të persekutimit. Megjithatë, gjykata holandeze nuk ishte e sigurt nëse e drejta e BE-së vendoste kufizime në lidhje me verifikimin e orientimit seksual të azilkërkuesve. Raad van State vlerësoi se thjeshtë marrja në pyetje e një azilkërkuesi në lidhje me seksualitetin e tij, në një farë mase, shkel të drejtat e parashtruara në Kartë.

**2. Pyetjet e paraqitura nga gjykata kombëtare**

Raad van State vendosi pezullimin e procedurës dhe pyeti GJDBE-së nëse neni 4 i Direktivës 2004/83, i lexuar në dritën e Kartës - në veçanti nenet 3 dhe 7 të saj - duhet të interpretohet se vendos kufizime mbi autoritetet kompe-

tente kombëtare, nën mbikëqyrjen e gjykatave, në vlerësimin e fakteve dhe rrethanave lidhur me orientimin seksual të deklaruar të një azilkërkuesi, i cili kërkesën e tij për azil e mbështet tek frika nga persekutimi për shkak të tij orientimit seksual.

### 3. Vendimi i GJDBE-së

Në radhë të parë, GJDBE-ja vërejtë se deklarimi nga azilkërkuesi i orientimit të tij seksual është vetëm pika e fillimit në procesin e vlerësimit të kërkesës për azil dhe mund, në rrethana të caktuara, të kërkojë verifikim. Më tej, sipas GJDBE-së, kërkesat azil që bazohen në frikën nga persekutimi për shkak të orientimit seksual të azilkërkuesit mund të jenë subjekt i një procesi vlerësimi të parashikuar në nenin 4 të Direktivës 2004/83, në të njëjtën mënyrë si kërkesat për azil të bazuara në arsye të tjera persekutimi.

Megjithatë, metodat e përdorura nga autoritetet kompetente për të vlerësuar deklaratat dhe dëshmitë e azilkërkuesit, në mbështetje të kërkesës së tij, duhet të jenë në përputhje me të drejtën e BE-së dhe në veçanti të drejtat themelore të garantuara nga Karta. Për rrjedhojë, është detyrim i autoriteteve kompetente kombëtare për të përshtatur metodat e tyre të vlerësimit të deklaratave dhe dëshmimeve të tjera me karakteristikat specifike të secilës kategori të kërkesës për azil, në respektim të të drejtave të garantuara nga Karta.

Për më tepër, vlerësimi duhet të bëhet mbi baza individuale, duke pasur parasysh situatën dhe rrethanat personale të azilkërkuesit, për të përcaktuar nëse aktet ndaj të cilave kërkuesi është ekspozuar ose mund të ekspozohet do të përbënin akt persekutim ose dëmtim serioz.

Për sa i përket metodave të vlerësimit të deklaratave dhe dëshmimeve në secilin prej rasteve në procedurë kryesore, GJDBE-ja u dha autoriteteve kombëtare udhëzimet e mëposhtme.

Së pari, pyetjet e bazuar në nocione të stereotipizuara mund të jenë një element i dobishëm në dispozicion të autoriteteve kompetente, por vlerësimi i një kërkesë për azil në bazë vetëm të nocioneve të stereotipizuara lidhur me homoseksualët, të tilla si njohjen e organizatave për mbrojtjen e të drejtave të homoseksualëve dhe detaje rreth tyre, nuk i jep mundësi autoriteteve për të marrë parasysh situatën dhe rrethanat personale të azilkërkuesit në fjalë. Prandaj, paaftësia e tij për t'iu përgjigjur pyetjeve të tilla nuk është, në vetvete, një arsye e mjaftueshme për të konkluduar se azilkërkuesi nuk është i besueshëm.



Së dyti, autoritetet kombëtare kanë të drejtë të marrin në intervistë azilkërkuesin me qëllim vërtetimin e fakteve në lidhje me orientimin e deklaruar seksual të tij, por pyetjet në lidhje me detaje të praktikave të tij seksuale janë në kundërshtim me të drejtat themelore të garantuara nga Karta dhe, në veçanti, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare.

Së treti, për sa i përket mundësisë së lejimit nga autoriteteve kombëtare, siç disa azilkërkues propozojnë, që të kryhen akte homoseksuale, nënshtrimi ndaj “testeve” të mundshme në mënyrë që të demonstrojnë homoseksualitetin e tyre apo edhe paraqitjen e dëshmimeve të tilla si filmime të akteve intime, GJDBE-ja e bëri të qartë se, përveç faktit që prova të tilla nuk do të kenë vlerë dëshmuese, për nga natyra e tyre, ato cenojnë dinjitetin njerëzor, respektimi i të cilit është i garantuar nga Karta. Për më tepër, autorizimi ose lejimi i këtyre lloj provave do të ketë efektin e nxitjes së azilkërkuesve të tjerë që të ofrojnë të njëjtën gjë dhe do të çonte, *de facto*, në detyrimin e azilkërkuesve për paraqitjen e provave të tilla.

Së katërti, duke pasur parasysh natyrën e ndjeshme të informacionit në lidhje me identitetin personal të një personi dhe, në veçanti, seksualitetin e tij, përfundimi se azilkërkuesi nuk ishte i besueshëm nuk mund të arrihet vetëm në bazë faktit që, duke pasur parasysh heshtjen e tij në lidhje me zbulimin e disa aspekte intime të jetës së tij, nuk e ka deklaruar homoseksualitetin e tij që në fillim kur paraqiti arsyet e persekutimit të tij.

Në këto baza, GJDBE-ja vendosi se neni 4(3)(c) i Direktivës 2004/83 duhet të interpretohet se ndalon që deklaratat e azilkërkuesit, kërkesa e të cilit bazohet në frikën nga persekutimi për shkak të orientimit të tij seksual dhe dokumentet e provat e tjera të dorëzuara në mbështetje të kërkesës së tij, të jenë subjekt i vlerësimit nga autoritetet kombëtare nëpërmjet pyetjeve që bazohen vetëm mbi nocionet stereotipe në lidhje me homoseksualët. Neni 4 i Direktivës 2004/83, i lexuar në dritën e nenit 7 të Kartës, duhet interpretuar se ndalon, në kontekstin e këtij vlerësimi, autoritetet kompetente kombëtare të pyesin azilkërkuesit për detaje të praktikave të tyre seksuale.

Neni 4 i Direktivës 2004/83, i lexuar në dritën e nenit 1 të Kartës, duhet të interpretohet se ndalon, në kontekstin e këtij vlerësimi, pranimin nga ana e këtyre autoriteteve të provave që do të shkelin dinjitetin njerëzor, me qëllim të verifikimit të homoseksualitetit të azilkërkuesve. Së fundmi, neni 4(3) i Direktivës 2004/83 duhet të interpretohet se ndalon, në kontekstin e këtij vlerësimi, autoritetet kompetente kombëtare të konkludojnë se deklaratat e azilkërkuesit

nuk janë të besueshme thjesht për shkak se të faktit se ai nuk ka deklaruar orientimin e tij seksual që në fillim kur paraqiti arsyet e persekutimit të tij.

#### 4. Koment

Në vendimin *X, Y dhe Z*<sup>173</sup>, GJDBE-ja vendosi se, në rrethana të caktuara, homoseksualët duhet të konsiderohen grup i veçantë shoqëror, në kuptimin e nenit 10 të Direktivës 2004/83 dhe se disa lloje kriminalizimi të akteve homoseksuale mund të përbëjnë një akt persekutimi në bazë të nenit 9 të së njëjtës Direktivë. Ndërsa GJDBE-ja, në atë vendim të parë, përcaktoi elementët e rëndësishëm të interpretimit të nocioneve kyçe të së drejtës së azilit në kontekstin e kriminalizimit të akteve homoseksuale, ajo nuk u shpreh për metodën që duhet të ndiqet për të vlerësuar kërkesën për azil të bazuar në frikën e persekutimit për shkak të orientimit seksual dhe në veçanti nëse azilkërkuesi i takon grupit të persekutuar.

Kjo pyetje specifike dhe sensitive iu referua GJDBE-së nga rastet *A, B dhe C*, në një kontekst ku gjykata kombëtare kishte dyshime për ligjshmërinë e metodës së ndjekur nga autoritetet kompetente kombëtare. Në vendimin e saj, GJDBE, për herë të parë, interpretoi në thellësi, rregullat e parashikuara nga neni 4 i Direktivës 2004/83 në lidhje me vlerësimin e fakteve dhe rrethanave dhe theksoi kufizimin që vendos ky nen dhe Karta kundrejt metodave që autoritete mund të përdorin për këtë qëllim.

Në thelb, GJDBE-ja vendosi se edhe pse vetë-identifikimi i identitetit seksual është një pikë fillimi, Shtetet Anëtare mund t'ia nënshtrojnë këtë vetë-identifikim një procedure vlerësimi, në përputhje me nenin 4 të Direktivës së Kualifikimit 2004 (të përditësuar aktualisht nga Direktiva e ndryshuar më 2011). Megjithatë, këto vlerësime nuk duhet të shkelin të drejtat e garantuara nga Karta, veçanërisht të drejtën e respektimit të dinjitetit njerëzor (neni 1) dhe të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 7). Prandaj, ndërkohë që “vlerësimi duhet të marrë parasysh situatën dhe rrethanat personale të azilkërkuesit”, GJDBE-ja e bëri të qartë se vlerësimi nuk mund të bazohet vetëm në stereotipe - të tilla si njohja e organizatave të homoseksualëve apo e mënyrës së sjelljes së homoseksualëve. Për më tepër, disa metoda duhet të përjashtohen në këtë vlerësim: (a) pyetje mbi praktikat seksuale pasi kjo do të shkelte të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 7 i

173 C-199/12 deri C-201/12, *Minister voor Immigratie en Asiel k. X dhe Y dhe Z k. Minister voor Immigratie en Asiel*, vendim i 7 nëntorit 2013, shih komentet e veçanta të përfshira në këtë kapitull.

Kartës); (b) testet për të treguar identitetin seksual kanë vlerë të vogël dhe do të shkelnin dinjitetin njerëzor (neni 1 i Kartës); dhe (c) përfundimet negative të bazuara në vonesën e deklaramit të identitetit seksual që në fillim (mbështetja në këtë fakt do të shkelte edhe nenin 4 të Direktivës së Kualifikimit dhe nenin 13 të Direktivës mbi Procedurat e Azilit, për shkak të vulnerabilitetit të azilkërkuesve homoseksualë).

*Ofrimi i mbrojtjes për shtetasit e vendeve të treta që vuajnë nga sëmundje të rënda*

**VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN MOHAMED M'BODJ  
kundër ÉTAT BELGE**  
(Çështja nr. C-542/13)  
**18 dhjetor 2014**

**1. Faktet kryesore**

Ky rast u referua në GJDBE për vendim paraprak nga Cour constitutionnelle (Gjykata Kushtetuese në Belgjikë) në lidhje me interpretimin e neneve 28 dhe 29 të Direktivës së Këshillit 2004/83/EC e 29 prillit 2004 (Direktiva e Kualifikimit). Neni 28 i Direktivës së Kualifikimit, i cili rregullon asistencën sociale, parashikon që Shtetet Anëtare duhet t'u garantojnë personave që gëzojnë mbrojtjen nga statusi i refugjatit ose mbrojtjen plotësuese, ndihmën e nevojshme sociale që u japin edhe shtetasve të tyre. Neni 29 i kësaj Direktive rregullon kujdesin shëndetësor, duke u garantuar personave të lartpërmendur akses në sistemin e kujdesit shëndetësor sipas të njëjtave kushte me ato për shtetasit e Shtetit Anëtar që ka u dhënë statusin e refugjatit ose mbrojtjen plotësuese.

Z. M'Bodj, shtetas mauritanëz, arriti në Belgjikë në vitin 2006. Ai kërkoi azil dhe, më pas, leje qëndrimi për arsye mjekësore. Të dy kërkesat iu refuzuan dhe ai ngriti një sërë ankimesh por të gjitha të pasuksesshme. Më 27 maj 2008, Z. M'Bodj bëri një kërkesë të mëtejshme për leje qëndrimi për arsye mjekësore, me argumentin se vuante efektet e një sulmi agresor, viktimë e së cilit kishte qenë në Belgjikë.

Në prill të vitit 2009 Z. M'Bodj kërkoi pa sukses ndihmë financiare si i papunë. Ai kundërshtoi vendimin për refuzimin e kërkesës së tij para gjykatës së punës së Liezhit. Ndërkohë, më 17 maj 2010, Z. M'Bodj iu dha leje qëndrimi pa afat në Belgjikë për shkak të gjendjes së tij shëndetësore.

Me vendimin e 8 nëntorit të vitit 2012, gjykata e punës së Liezhit i kërkoi Gjykatës Kushtetuese një vendim paraprak në lidhje me legjitimitetin kushtetues të nenit 4 të Ligjit të datës 27 shkurt 1987, i cili nuk lejonte dhënien e ndihmave financiare për personat me aftësi të kufizuara që qëndronin në Belgjikë për arsye mjekësore, pra që gëzonin mbrojtjen ndërkombëtare sipas Direktivës së Kualifikimit, ndërsa lejonte pagesën e shtesave të tilla për refugjatët, të cilët, sipas kësaj gjykate, gëzojnë të njëjtat mbrojtje ndërkombëtare.

## 2. Pyetjet e paraqitura nga gjykata kombëtare

Gjykata Kushtetuese vendosi pezullimin e procedurës dhe pyeti GJDBE-ja nëse nenet 28 dhe 29 të Direktivës 2004/83, të lexuar në lidhje me nenet 2(e), 3, 15 dhe 18 të saj, duhet të interpretohen se detyrojnë Shtetet Anëtare për dhënien e ndihmës sociale dhe përfitimin nga skema e kujdesit shëndetësor për shtetasit e një vendi të tretë, të cilët kanë leje qëndrimi në territorin e atij Shteti Anëtar në bazë të legjislacionit kombëtar - si rasti në fjalë në procedurën kryesore – që u mundëson këtyre shtetasve të huaj, të cilët vuajnë nga një sëmundje që i rrezikon realisht jetën dhe integritetin fizik ose trajtim çnjerëzor apo poshtërues, të banojnë në Shtetin Anëtar, kur nuk ka asnjë trajtim të për-shtatshëm në vendin e tyre të origjinës ose në vendin e tretë ku kishin banuar më parë. Gjithashtu, gjykata referuese pyeti edhe nëse, detyrimi pozitiv i vendosur mbi Shtetet Anëtare për të marrë në konsideratë situatën e veçantë të personave në nevojë, si ata me aftësi të kufizuara, nënkupton që personat vulnerabël duhet të marrin ndihmat e parashikuara nga ligji i 27 shkurtit 1987.

## 3. Vendimi i GJDBE-së

Në vlerësimin e saj, GJDBE-ja theksoi se Belgjika është e detyruar, në pajtim me nenet 28 dhe 29 të Direktivës 2004/83, t'u akordojë përfitimet e mbuluara nga këto dispozita, shtetasve të vendeve të treta që janë të pajisur me leje qëndrimi në Belgjikë në bazë të legjislacionit kombëtar në fjalë vetëm nëse leja për të qëndruar përfshinte edhe dhënien e statusit të mbrojtjes plotësuese.

GJDBE-ja vuri në dukje se ekzistenca e dëmtimeve serioze të përcaktuara në nenin 15 të Direktivës 2004/83 përbën kusht që duhet të përmbushet që një person të kualifikohet për mbrojtje plotësuese, kur, në përputhje me nenin 2(e) të kësaj Direktive, ka arsye thelbësore për të besuar se aplikanti përballet me rrezikun real të një dëmtimi të tillë, në qoftë se kthehet në vendin e origjinës. Rreziqet me të cilat përballet një shtetas i një vendi të tretë për shkak të përkeqësimit të gjendjes së tij shëndetësore, i cili nuk ka ardhur si rezultat i mos ofrimit qëllimisht të kujdesit shëndetësor, nuk mbulohen nga neni 15(a) dhe (c) të Direktivës 2004/83, pasi dëmtimi serioz i përcaktuar nga këto dispozita përfshijnë respektivisht, dënimin me vdekje apo ekzekutimin dhe kërcënimin serioz e individual për jetën e personit apo të civilëve, për shkak të dhunës pa dallim në situatat e një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm. Neni 15(b) i Direktivës 2004/83, gjithashtu nuk zbatohet, pasi ai garanton mbrojtje plotësuese vetëm për shtetasit e vendeve të treta të cilët i janë nënshtruar torturës ose trajtimit çnjerëzor ose poshtërues në vendet e

tyre të origjinës. Në të vërtetë, në dritën e nenit 6 të Direktivës së Kualifikimit, dëmtimet serioze duhet të shkaktohen nga një palë e tretë, pra nuk mund të jenë thjesht rezultat i mangësive të përgjithshme në sistemin shëndetësor të vendit të origjinës. Sipas GJDBE-së, nga disa paragrafë të preambulës del se rreziku i përkeqësimit të shëndetit të një shtetasi të vendit të tretë, që vuan nga një sëmundje e rëndë si pasojë e mungesës së trajtimit të duhur në vendin e tij të origjinës, nuk është, në parim, i mjaftueshëm për akordimin e mbrojtjes ndërkombëtare dhe se fusha e kësaj mbrojtje nuk shtrihet për personat që kanë leje qëndrimi të akorduar në mënyrë diskrecionare nga Shtetet Anëtare për arsye humanitare.

Për më tepër, GJDBE-ja pohoi se, ndërsa jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, transferimin e një personi i cili vuan nga një sëmundje e rëndë në një vend ku kujdesi mjekësor është në nivele më të ulëta, e konsideron shkelje të nenit 3 në raste shumë të jashtëzakonshme<sup>174</sup>, kjo nuk do të thotë se ky person duhet të pajiset me leje qëndrimi në një Shtet Anëtar nëpërmjet mbrojtjes plotësuese në bazë të Direktivës së Kualifikimit.

Më tej, GJDBE-ja vendosi se neni 3 i Direktivës së Kualifikimit, i cili lejon Shtetet Anëtare që të miratojnë, ndër të tjera, standarde më të favorshme për personat që kualifikohen për mbrojtje plotësuese, nuk zbatohet edhe për legjislativat kombëtare që mbrojnë shtetasit e vendeve të treta për arsye mjekësore. Përrjashtimi i parashikuar në nenin 3 të Direktivës 2004/83, i ndalon Shtetet Anëtare të miratojnë apo mbajnë në fuqi dispozita që i japin statusin e mbrojtjes plotësuese të parashikuar në këtë Direktivë, një shtetasi të një vendi të tretë që vuan nga një sëmundje e rëndë, me arsyetimin se ekziston rreziku që shëndeti i këtij personi të përkeqësohet si rezultat i faktit se mungon trajtimi adekuat në vendin e tij të origjinës, pasi këto dispozita nuk janë në përputhje me Direktivën.

GJDBE-ja e bazoi këtë konstatim në faktin se do të ishte në kundërshtim me skemën e përgjithshme dhe objektivat e Direktivës 2004/83 dhënia e statusit të refugjatit dhe statusit të mbrojtjes plotësuese shtetasve të vendeve të treta në situata të cilat nuk kanë lidhje me arsyet për të cilat jepet mbrojtja ndërkombëtare. Pra, legjislativoni i përmendur nga shteti belg nuk mund të konsiderohet, për qëllimet e nenit 3 të Direktivës 2004/83, se miraton një standard më të favorshëm për përcaktimin e kritereve të përfitimit të mbrojtjes plotë-

174 *N. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim [Dhoma e Madhe] i 27 majit 2008, nr. 26565/05, i përfshirë në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

suese. Shtetasit e vendeve të treta të cilët kanë leje qëndrimi, në bazë të një legjislacioni të tillë, nuk ishin, pra, persona me status të mbrojtjes plotësuese, ndaj të cilëve mund të zbatohen nenet 28 dhe 29 të kësaj Direktive, konkretisht dhënia e ndihmës sociale dhe kujdesi shëndetësor.

Si përfundim, GJDBE-ja vendosi se nenet 28 dhe 29 të Direktivës 2004/83, lexuar së bashku me nenet 2 (e), 3, 15, dhe 18 të kësaj Direktive, duhet të interpretohen se nuk i kërkojnë një Shteti Anëtar të japë ndihma sociale dhe shëndetësore të cilat janë të parashikuara për një shtetas të një vendi të tretë të cilit i është dhënë leje qëndrimi në territorin e atij Shteti Anëtar në bazë të legjislacionit kombëtar - si ajo në fjalë në procedimin kryesor - që lejon një shtetas i huaj që vuan nga një sëmundje që përbën një rrezik real për jetën e tij ose integritetin fizik ose një rrezik real të trajtimit çnjerëzor apo poshtërues të banojë në atë Shtet Anëtar, kur nuk ka asnjë trajtim të përshtatshëm në vendin e huaj të origjinës së tij ose në vendin e tretë në të cilin ai ka banuar më parë, përveç nëse një shtetas i huaj i tillë është i privuar qëllimisht nga kujdesit shëndetësor në atë vend.

#### 4. Koment

Sipas Direktivës së Kualifikimit, mbrojtja plotësuese duhet të jepet nëse kërkuesi mund të përballet me një nga tre situatat e mëposhtme: (a) “dënimin me vdekje ose ekzekutimin”; (b) “torturën ose trajtimin apo ndëshkimin çnjerëzor ose poshtërues të kërkuesit në vendin e origjinës”; ose (c) “kërcënimin serioz e individual për jetën e personit apo të civilëve, për shkak të dhunës pa dallim në situatat e një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm”. GJDBE-ja e ka interpretuar të arsyen e tretë në vendimet e saj *Elgafaji*<sup>175</sup> dhe *Diakité*<sup>176</sup>.

Në vendimin *Elgafaji*, GJDBE-ja theksoi lidhjen ndërmjet nenit 15(b) të Direktivës 2004/83 dhe nenit 3 të KEDNJ-së. Megjithatë, kjo lidhje nuk do të thotë se këto nene kanë tërësisht të njëjtën fushë zbatimi. Në dy vendime të fundit, *M’Boj dhe Abdida*<sup>177</sup>, GJDBE-ja sqaroi objektin e mbrojtjes ndërkombëtare në rastet kur kërkuesit vuanin nga sëmundje të rënda.

175 C-465/07, *Meki Elgafaji dhe Noor Elgafaji k. Staatssecretaris van Justitie*, vendim [Dhoma e Madhe] i 17 shkurtit 2009, i përfshirë në këtë kapitull.

176 C-285/12, *Aboubacar Diakité k. Commissaire général aux réfugiés et aux apatrides*, vendim i 30 janarit 2014, i përfshirë në këtë kapitull.

177 C-562/13, *Centre public d’action sociale d’Ottignies-Louvain-La-Neuve k. Moussa Abdida*, vendim [Dhoma e Madhe] i 18 dhjetorit 2014, shih komentet e veçanta të përfshira në këtë kapitull.

Rasti aktual *M'Bodj* sqaroi konceptin e “dëmtimit serioz” në nenin 15(b) të Direktivës së Kualifikimit, i cili përfshin torturën apo trajtimin çnjerëzor dhe poshtëruës të një kërkuesi në vendin e origjinës.

Z. M'Bodj argumentoi se arsyeja e dytë zbatohet, mbi bazën e interpretimit të nenit 3 të KEDNJ-së nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, i cili ndalon po njësoj “torturën ose trajtimin ose dënimin çnjerëzor ose poshtëruës”, që do të thotë se, në raste të jashtëzakonshme, ndalohet kthimi i personave në vendin e tyre të origjinës, nëse atje rrezikojnë jetën për shkak të trajtimit mjekësor të papërshtatshëm.

Megjithatë, GJDBE-ja i hodhi poshtë këto argumente. Sipas saj, duke qenë se Direktiva e Kualifikimit specifikonte aktivitetet e veçanta të personit si burime të persekutimit ose dëmtimit serioz, kjo formë e “dëmtimit serioz” duhet të jetë rezultat i “një formë sjelljeje në emër të një pale të tretë”, pra “nuk mund të jetë, thjesht rezultat i mangësive të përgjithshme në sistemin shëndetësor të vendit të origjinës”. Ajo bëri një përjashtim për rastet kur personit në fjalë i është mohuar qëllimisht kujdesi shëndetësor. Në këtë rast ai do të përfitonte nga mbrojtja plotësuese. Për këtë arsye, vetëm se GJEDNJ-ja e ndalon sipas nenit 3 të KEDNJ-së dëbimin e personave, si në situatën e Z. M'Bodj, në vendin e origjinës, nuk do të thotë se ata kualifikoheshin domosdoshmërisht për përfitimin e mbrojtjes plotësuese në bazë të Direktivës.

Megjithatë, përjashtimi i arsyes mjekësore nga fusha e zbatimit të Direktivës së Kualifikimit nuk do të thotë se jurisprudenca e GJEDNJ-së mbi nenin 3 të KEDNJ-së nuk respektohet në të drejtën e BE-së, ashtu siç është treguar edhe në vendimin, e dhënë në të njëjtën ditë nga GJDBE-ja, në lidhje me Direktivën 2008/115 (Direktiva e Kthimit) në çështjen *Abdida*.

Për më tepër, vendimi *M'Bodj* plotëson vendimet *B dhe D*<sup>178</sup> duke konfirmuar se, në përputhje me nenin 3 të Direktivës 2004/83 (Direktiva e Kualifikimit), Shtetet Anëtare lejohen të zgjerojnë objektin e mbrojtjes ndërkombëtare, por vetëm brenda disa kufijve të caktuar.

178 C-57/09 dhe C-101/09, *Bundesrepublik Deutschland k. B dhe D*, vendim [Dhoma e Madhe] i 9 nëntorit 2010, shih komentet e veçanta të përfshira në këtë kapitull.



*Kushtet e marrjes së statusit të refugjatit në BE  
nga një shtetas i vendeve të treta*

## **VENDIMI NË ÇËSHTJEN ANDRE LAWRENCE SHEPHERD kundër BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND**

(Çështja nr. C-472/13)

**26 shkurt 2015**

### **1. Faktet kryesore**

Ky rast u referua në GJDBE për vendim paraprak nga Gjykata Administrative e Mynihut në lidhje me interpretimin e Direktivës së Këshillit 2004/83/EC e 29 prillit 2004 (Direktiva e Kualifikimit). Sipas Direktivës së Kualifikimit, një shtetas i vendeve të treta që ka një frikë të mirë bazuar të persekutimit për arsye të racës, fesë, kombësisë, mendimit politik ose anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror mundet, në kushte të caktuara, të marrë statusin e refugjatit. Direktiva përcakton, ndër të tjera, faktorët që mbështesin konstatimin se aktet përbëjnë akte persekutimi. Sipas nenit 9(2)(e) të Direktivës së Kualifikimit, një akt persekutimi mund të marrë formën e “ndjekjes penale ose dënimit për refuzimin për të kryer shërbimin ushtarak në një konflikt, ku kryerja e shërbimit ushtarak do të përfshinte krime ose akte që janë objekt i klauzolave të përjashtimit të përcaktuara në nenin 12(2)”. Kjo klauzolë përjashtimi i referohet, në veçanti, krimeve kundër paqes, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe akteve në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

Kërkuesi, Z. Shepherd, ishte shtetas amerikan. Në vitin 2003, ai u rekrutua në shërbimin ushtarak amerikan. Midis 2004 dhe 2005, punoi si teknik helikopterësh në Irak. Nga shkurti 2005, ai shërbeu në bazën ushtarake në Gjermani.

Më 1 prill 2007, Z. Shepherd iu kërkua të kthehej në Irak. Menjëherë pas kësaj, ai u largua nga shërbimi ushtarak me bindjen se lufta në Irak ishte e paligjshme dhe si pasojë rezultonte në kryerjen e krimeve të luftës. Më pas ai kërkoi azil në Gjermani duke pretenduar se, si pasojë e dezertimit të tij, rrezikonte të ndiqej penalisht në SHBA. Kërkesa për azil u refuzua nga Zyra Federale Gjermane për Emigracionin dhe Refugjatët.

Z. Shepherd kërkoi nga Gjykata Administrative e Mynihut rrëzimin e vendimit të refuzimit të kërkesës së tij për azil dhe të urdhëronte dhënien e azilit për të.

## 2. Pyetjet e paraqitura nga gjykata kombëtare

Gjykata Administrative iu drejtua GJDBE-së për një vendim paraprak në lidhje me interpretimin e nenit 9(2)(e) të Direktivës së Kualifikimit (2004/83). Pyetjet e parashtruara kishin të bënin me kriteret specifike të cilat vinin në zbatim nenin 9(2)(e), si, ndër të tjera: kryerja e drejtpërdrejtë e shërbimit ushtarak dhe akteve jashtë veprimeve luftarake; probabiliteti i ndodhjes së krimeve; ndjekja penale në Gjykatën Penale Ndërkombëtare (GJPN) dhe së fundi ajo e pyeti nëse dënimi me burg dhe izolimi nga shoqëria për dezertim mund të përbëjë në vet-vete një akt persekutimi sipas nenit 9(2)(b) ose (c) të Direktivës.

## 3. Vendim i GJDBE-së

GJDBE ka theksuar se qëllimi i Direktivës së Kualifikimit është identifikimi i personave të cilët kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Si rrjedhojë, GJDBE-ja u shpreh se mbrojtja e dhënë sipas nenit 9(2)(e) mbulon të gjithë personelin ushtarak. Kështu, ajo përfshin personelin mbështetës dhe të logjistikës. Megjithatë, neni 9(2)(e) zbatohet vetëm për ata individë aktivitetet e të cilëve, të tilla si mbështetja teknike, do të “çonin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe logjikisht të mundshme” në pjesëmarrje në krime lufte.

Më e rëndësishmja, mbrojtja sipas nenit 9 (2) (e) zbatohet vetëm në situatat ku ekziston mundësia e kryerjes së akteve që bien në fushëveprimin e nenit 12(2) të Direktivës së Kualifikimit, të tilla si krimet kundër paqes, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit. Autoritetet kombëtare janë përgjegjëse për vlerësimin e rrethanave të mëparshme dhe aktuale që mund të dëshmojnë për përfshirjen ose mundësinë e përfshirjes së forcave ushtarake në kryerjen e akteve të tilla. Megjithatë, është përgjegjësia e kërkuesit, për të “dëshmuar me besueshmëri të mjaftueshme” se njësi e tij ushtarake do të kishte qenë e përfshirë në kryerjen e këtyre akteve.

Në mënyrë domethënëse, situata e persekutimit, ndaj së cilës ofron mbrojtje neni 9(2)(e), i referohet vetëm refuzimit të kërkuesit për të kryer shërbimin ushtarak. Në rastin e Z. Shepherd, Gjykata theksoi se ai jo vetëm u ishte bashkuar vullnetarisht forcave të armatosura në kohën që ato ishin të angazhuar në konfliktin në Irak, por edhe pas kryerjes së një shërbimi në atë vend, u ishte ribashkuar këtyre forcave. GJDBE-ja deklaroi se nëse kërkuesi nuk shfrytëzoi procedurën për kundërshtimin e shërbimit ushtarak për shkak të ndërgjegjes, çdo mbrojtje sipas nenit 9(2)(e) përjashtohet, përveç nëse ai mund të demonstroi se një procedurë e tillë nuk ka ekzistuar për situatën e tij të veçantë .

Së fundi, GJDBE theksoi se dënimi me burg mund të konsiderohet akt persekutimi sipas nenit 9(2)(b) dhe (c) vetëm nëse është aq i tepruar dhe diskriminues sa të «shkojë përtej asaj që është e nevojshme, që Shteti në fjalë të ushtrojë të drejtën e tij legjitime për pasur një forcë të armatosur». Është detyrë e autoriteteve kombëtare ta bëjnë këtë vlerësim. Në rastin konkret të Z. Shepherd, GJDBE-ja u shpreh se asnjë nga dokumentet e përfshira në dosjen e paraqitur, nuk sugjeron se burgimi i mundshëm i kërkuesit do tejkalonte të drejtat legjitime të Shtetit për të mbajtur një forcë të armatosur.

#### 4. Koment

Në rastin *Shepherd*, GJDBE-së i dha përgjigje pyetjeve të detajuara dhe sensitive në lidhje me një aspekt të veçantë të akteve të persekutimit, të renditura në nenin 9 të Direktivës së Kualifikimit, përkatësisht, ndjekjen penale apo dënimin për refuzimin e kryerjes së shërbimit ushtarak, kur argumentohet se kryerja e shërbimit ushtarak do përfshinte kërkuesin në kryerjen e krimeve të luftës.

Në vendimin e saj, GJDBE-ja solli elementë të rëndësishëm, të nevojshëm për të përcaktuar objektin e këtij koncepti, duke sqaruar, sidomos, nocionin e “refuzimit për të kryer shërbimin ushtarak” dhe llojin e lidhjes që kërkohet ndërmjet aktivitetit të kërkuesit dhe kryerjes së krimeve të luftës.

GJDBE-ja vuri në dukje se Direktiva e Kualifikimit përcakton si një akt persekutimi ndjekjen ose dënimin për refuzimin e kryerjes së shërbimit ushtarak në një konflikt, kur kryerja e shërbimit ushtarak do të përfshinte kryerjen e krimeve të luftës. Ajo shpjegoi se qëllimi i Direktivës është që të identifikohen personat të cilët kanë me të vërtetë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Prandaj, neni 9(2)(e) përfshin “të gjithë personelin ushtarak, përfshirë edhe stafin logjistik apo mbështetës”. Megjithatë, GJDBE-ja vuri në dukje se që të gjente zbatim neni 9(2)(e) duhet të ekzistonte një situatë konflikti dhe ndërsa pjesëmarrja jo direkte në krimet e luftës (p.sh. kur personi ofron mbështetje logjistike) nuk e përjashton kërkuesin nga mbrojtja e nenit 9(2)(e), dispozita shtrihet në detyrat individuale të cilat mund të çojnë “në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe logjikisht të mundshme” në pjesëmarrjen në akte të tilla. Kështu, GJDBE-ja konstatoi se anëtarët e forcave ushtarake që bëhen pjesë e një konflikti në mënyrë të tërthortë munden, në situata të caktuara, të përfitojnë nga mbrojtja ndërkombëtare, pas dezertimit. Edhe pse nuk është kusht që të jenë kryer krime lufte në mënyrë që një azilkërkues të kualifikohet për të marrë mbrojtje, është e nevojshme të vërtetohet se ekziston një mundësi e madhe që të kryhen krime

lufte dhe se detyrat e tij lidhen mjaftueshëm me krimet e luftës.

Megjithatë, GJDBE-ja theksoi se ishte e pamundur që një ushtar të përfshihej në krime lufte, nëse ndërhyrja ushtarake ishte e legjitimuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së ose nga një konsensus ndërkombëtar dhe nëse legjislacioni i brendshëm ndiqte penalisht, në mënyrë efektive, krimet e luftës. Prandaj, azilkërkuesi ishte i detyruar “të provonte, në mënyrë të besueshme, se njësia e tij kryente operacionet që i ishin ngarkuar [...] në mënyrë të tillë që përbënin akte të cilave u referohej ajo dispozitë”.

Më tej, GJDBE-ja theksoi se aktet e persekutimit të kundërshtuara mund dhe duhej të rezultonin vetëm nga refuzimi i azilkërkuesit për të kryer shërbimin ushtarak, me kushtin që refuzimi të ishte mjete i vetëm që kishte ai për të shmangur pjesëmarrjen në krime lufte.

Së fundmi, duke pasur parasysh se dënimi me burg, izolimi nga shoqëria dhe lirimi pa nderime për shkak të dezertimit ushtarak mund të përbëjnë aktet persekutimi sipas nenit 9(2)(b) dhe (c), kur autoritetet kompetente kombëtare konsiderojnë se nuk është vërtetuar se shërbimi ushtarak do të përfshinte kryerjen e krimeve të luftës, GJDBE-ja vuri në dukje se “ishte e nevojshme të merrej në konsideratë nëse akte të tilla shkojnë përtej asaj që është e nevojshme që Shteti në fjalë të ushtrojë të drejtën e tij legjitime për të mbajtur një forcë të armatosur”. Kështu, dënimi me burg pesë vjet për dezertim ushtarak në Shtetet e Bashkuara, nuk konsiderohet disproporcional apo diskriminues sa të përbëjë një akt persekutimi.

**Direktiva e Këshillit nr. 2008/115/EC e datës 16 dhjetor 2008  
(Direktiva e Kthimit)**

*Periudha maksimale e ndalimit prej 18 muajsh në bazë të Direktivës së Kthimit  
nuk mund të tejkalohet*

**VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN SAID SHAMILOVICH  
KADZOEV (HUCHBAROV)**

(Çështja nr. C-357/09 PPU)

**30 nëntor 2009**

### **1. Faktet kryesore**

Ky rast ishte një kërkesë urgjente për një vendim paraprak nga Administrativen sad Sofia-grad (Bullgari) në lidhje me interpretimin e nenit 15(4), (5) dhe (6) të Direktivës 2008/115/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 16 dhjetorit 2008 (Direktiva e Kthimit). Neni 15 i Direktivës së Kthimit përbën bazën për ndalimin e shtetasve të vendeve të treta që janë në proces kthimi në vendin e tyre të origjinës. Ndalimi mund të vendoset vetëm në qoftë se ekziston rreziku i arratisjes së personit, ose ai pengon kthimin. Neni 15 parashikon që periudha e ndalimit nuk mund të jetë më shumë se 18 muaj dhe se personi në fjalë duhet të lirohet menjëherë nëse nuk ekziston më një mundësi e arsyeshme për kthimin e tij.

Z. Kadzoev u arrestua në Bullgari më 21 tetor 2006. Ai u arrestua, në bazë të ligjit të brendshëm, dhe autoritetet bullgare urdhëruan kthimin e tij në Çeçeni. Ai pohoi se ishte një shtetas rus që vinte nga Çeçenia. Autoritetet ruse nuk i njohën dokumentet e tij si dëshmi e shtetësisë ruse. Ndërkohë që mbahej i ndaluar, Z. Kadzoev kërkoi disa herë marrjen e statusit të refugjatit. Kërkesat iu refuzuan. Gjithashtu, kërkesat e tij për rishikim gjyqësor u hodhën poshtë.

Autoritetet bullgare u përpoqën të gjenin një vend të tretë të sigurt<sup>179</sup> që mund

179 Koncepti i "vendit të tretë të sigurt" nuk duhet të ngatërrohet me nocionin e "vendit të sigurt të origjinës". Ky i fundit i referohet një vendi, qytetarët e të cilit nuk persekutohen, ndërsa i pari i referohet një vend tranzitor i cili konsiderohet i sigurt për ofrimin e mbrojtjes ndërkombëtare. Koncepti "vendi i tretë i sigurt" është përcaktuar në nenin 27 të Direktivës mbi Procedurat e Azilit (Direktiva e Këshillit 2005/85/EC e 1 dhjetorit 2005 për Standardet Minimale të Procedurave në Shtetet Anëtare për Dhënien dhe Heqjen e Statusit të Refugjatit, e ndryshuar nga Direktiva 2013/ 32/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013 për Procedurat e Përbashkëta për Dhënien dhe Heqjen e Mbrojtjes Ndërkombëtare (e ndryshuar)). Sipas konceptit "vendi i tretë i sigurt", Shtetet Anëtare mund të transferojnë kërkuesin në një vend të tretë

të priste Z. Kadzoev, por vendet, të cilave autoritetet bullgare iu drejtuan lidhur me këtë, refuzuan. Ndërkohë, ai u mbajt i ndaluar për 34 muaj.

## 2. Pyetjet e paraqitura nga gjykata kombëtare

Administrativen sad Sofia-grad i bëri një kërkesë urgjente për një vendim paraprak GJDBE-së në lidhje me pyetjen nëse periudha maksimale e ndalimit prej 18 muajsh, e parashikuar në nenin 15, zbatohet për një person në një situatë si ajo e Z. Kadzoev.

## 3. Vendimi i GJDBE-së

GJDBE-ja vendosi se periudha e përgjithshme e ndalimit për qëllimet e kthimit të një shtetasi të një vendi të tretë nuk mund të kalojë 18 muaj, siç parashikohet në nenin 15 të Direktivës së Kthimit, edhe nëse periudha e ndalimit ka filluar para se rregullat e Direktivës të bëheshin të zbatueshme në të drejtën kombëtare.

GJDBE-ja sqaroi se periudha e ndalimit të një personi, në bazë të një vendimi të marrë në përputhje me të drejtën kombëtare dhe të BE-së për azilin, nuk është e njëjtë me ndalimin sipas nenit 15 të Direktivës së Kthimit. Në këtë rast, i takonte gjykatës kombëtare për të vendosur nëse shqyrtimi i kërkesës për azil të Z. Kadzoev ishte bazuar ose jo në rregullat e mëparshme kombëtare për kthimin e tij. Nëse ishte për qëllimin e kthimit të tij, periudha e ndalimit duhet të llogaritet në bazë të periudhës maksimale të ndalimit sipas nenit 15 të Direktivës së Kthimit.

Periudha gjatë së cilës ekzekutimi i një urdhri dëbimi është pezulluar, për shkak të shqyrtimit gjyqësor të kërkuar nga personi i interesuar, llogaritet në bazë të periudhës maksimale të ndalimit. Për më tepër, GJDBE-ja e bëri të qartë se, nëse nuk kishte një mundësi të arsyeshme për kthimin e personit, atëherë ai duhej liruar, në përputhje me nenin 15(4).

me të cilin ai ka një lidhje dhe që do të ishte e arsyeshme që ai të shkonte atje si dhe ku ekziston mundësia për të kërkuar statusin e refugjatit e nëse ai kualifikohet për të marrë këtë status, të mund të marrë mbrojtje në përputhje me Konventën e Gjenevës të vitit 1951. Në vendin e tretë ku do të transferohet, kërkuesi nuk duhet të rrezikojë të persekutohet, të kthehet ose të trajtohet në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së. Në bazë të këtij prezumimi, Shtetet Anëtare mund të vendosin të konsiderojnë kërkesën për azil, si haptazi të pabazuar apo të papranueshme, në përputhje me Direktivën për Procedurat e Azilit.

Së fundmi, GJDBE-ja vendosi se në bazë të nenit 15, periudha maksimale e ndalimit prej 18 muajsh, nuk mund të tejkalohet edhe në qoftë se personi në fjalë “nuk kishte dokumente të vlefshme, sjellja e tij ishte agresive, nuk kishte mundësi financiare për të mbajtur veten e tij dhe nuk merrte mbështetje nga Shteti Anëtar për strehim ose nevoja të tjera”. GJDBE-ja vuri në dukje se Direktiva e Kthimit nuk mund të jetë baza ligjore për ndalimin e një personi për arsye të rendit dhe sigurisë publike.

#### 4. Koment

Rasti *Kadzoev* ishte rasti i parë paraqitur në GJDBE në lidhje me Direktivën e Kthimit. Vendimi përqendrohet në interpretimin e nenit 15 të Direktivës së Kthimit, dispozita që autorizon ndalimin nga ana e Shteteve Anëtare, në kontekstin e procedurave të dëbimit, të shtetasve të vendeve të treta të cilët qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në territorin e tyre.

Në lidhje me pyetjen nëse, kur përcakton nëse ka mbaruar periudha maksimale e ndalimit, Shteti Anëtar duhet të përfshijë periudhën e ndalimit para se Direktiva e Kthimit të transpozohet dhe të bëhet e zbatueshme, GJDBE-ja vendosi se nëse nuk llogaritet periudha para-Direktivës, personat, siç ishte rasti i Z. Kadzoev, do të mbaheshin të ndaluar më shumë se periudha maksimale, çka nuk është në përputhje me objektivat e Direktivës.

Vendimi sqaron se si duhet të zbatohet Direktiva e Kthimit gjatë periudhës tranzitore, kur vazhdonte të zbatohet një procedurë kthimi në bazë të ligjit të kombëtar paraparak. Lidhur me këtë, ky vendim u pasua nga vendimi *Filew dhe Osmani*<sup>180</sup>. Në këtë rast, GJDBE-ja vendosi se neni 11(2) i Direktivës së Kthimit përjashtoi dënimin penal për shkeljen e ndalimit të hyrjes dhe qëndrimit, kur një ndalim i tillë ishte dhënë pesë vjet para datës ose të ri-hyrjes në territorin e një Shteti Anëtar të shtetasit të një vendi të tretë ose të hyrjes në fuqi të legjislacionit kombëtar që transponon Direktivën, përveç nëse ky person përbën një kërcënim serioz për rendin dhe sigurinë publike dhe sigurinë kombëtare.

Për më tepër, GJDBE-ja theksoi dallimin ndërmjet ndalimit të bazuar në Direktivën e Kthimit dhe ndalimit në bazë të Direktivës së Kushteve të Pritjes<sup>181</sup>. Konkretisht, ndalimi me qëllim kthimin e personit rregullohet nga Direktiva e

180 C-297/12, *Gjoko Filew and Adnan Osmani*, vendim i 19 shtatorit 2013.

181 Direktiva 2003/9 / EC e 27 janarit 2003 që përcakton standardet minimale për pritjen e azilërkuesve (Direktiva e Pritjes)

Kthimit, ndërsa ndalimi i azilkërkuesve rregullohet nga Direktiva mbi Kushtet e Pritjes dhe Direktiva mbi Procedurat e Azilit<sup>182</sup>. Nëse llogaritet apo jo periudha e ndalimit në pritje të shqyrtimit të kërkesës së azilit, varet sipas cilës Direktivës është ndaluar azilkërkuesi. Nëse nuk merret asnjë vendim për shndërrimin e qëllimit të ndalimit të Z. Kadzoev nga “në pritje të kthimit” në “në pritje të përgjigjes për kërkesën për azil”, atëherë periudha e ndalimit do të llogaritet në bazë të periudhës maksimale për ndalimin në pritje të kthimit në bazë të Direktivës së Kthimit.

Në përcaktimin e ekzistencës së një “mundësie të arsyeshme kthimi”, sipas nenit 15(4) të Direktivës së Kthimit, duhet pasur parasysh nëse kthimi mund të realizohet brenda periudhës maksimale të ndalimit të përcaktuar nga kjo Direktivë. Kur arrihet periudha maksimale, neni 15(4) është i pazbatueshëm dhe personi duhet të lirohet menjëherë.

Për sa i përket pyetjes nëse një person duhet të lirohet kur periudha maksimale është tejkaluar edhe nëse ai nuk është në posedim të dokumenteve të vlefshme, sjellja e tij është agresive, nuk ka mundësi financiare për të mbajtur veten e tij dhe nuk merr mbështetje nga Shteti Anëtar për strehim ose nevoja të tjera, GJDBE-ja vuri në dukje se neni 15(6) nuk e lejon tejkalimin e periudhës maksimale të ndalimit në asnjë rrethanë, përfshirë kur rrezikohet rendi dhe siguria publike

Në lidhje me ndalimin e azilkërkuesve, mund të përmendim edhe vendimin në rastin e fundit N.<sup>183</sup>, në të cilën gjykata kombëtare vuri në pikëpyetje vlefshmërinë e Direktivës mbi Kushtet e Pritjes, sipas të cilës një azilkërkues mund të ndalohet për arsye të mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe rendit publik. Gjykata vendosi në N. se nuk kishte baza për zbatimin e masës së ndalimit për arsye të sigurisë kombëtare dhe rendit publik, fushëveprimi i së cilës është i kufizuar rreptësisht në plotësimin e kërkesave të proporcionalitetit.

182 Direktiva e Këshillit 2005/85/EC e 1 dhjetorit 2005 mbi Standardet Minimale të Procedurave në Shtetet Anëtare për Dhënien dhe Heqjen e Statusit të Refugjatit (Direktiva për Procedurat e Azilit).

183 C-601/15, J.N. k. *Staatssecretaris van Veiligheid en Justitie*, vendim [Dhoma e Madhe] i 15 shkurtit 2016.



*Nevoja e ekzistencës së një efekti pezullues të vendimit të kthimit të shtetasit nigerian i cili vuante nga një sëmundje e rëndë*

**VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN CENTRE PUBLIC  
D'ACTION SOCIALE D'OTTIGNIES-LOUVAIN-LA-NEUVE  
kundër MOUSSA ABDIDA**

(Çështja nr. C-562/13)

**18 dhjetor 2014**

**1. Faktet kryesore**

Ky rast u referua në GJDBE për vendim paraprak nga Cour du travail (Gjykata e Punës) e Brukselit (Belgjikë) në lidhje me interpretimin e Direktivës së Këshillit 2003/9/ EC të 27 janarit 2003 që përcakton standardet minimale për pritjen e azilkërkuesve, të Direktivës së Këshillit 2004/83/EC të 29 prillit 2004 mbi standardet minimale për kualifikimin dhe statusin e shtetasve të vendeve të treta ose të personave pa shtetësi si refugjatë ose si persona që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë, të Direktivës së Këshillit 2005/85/EC të 1 dhjetorit 2005 mbi standardet minimale të procedurave në Shtetet Anëtare për dhënien dhe heqjen e statusit të refugjatit, si dhe nenet 1 deri në 4, 19(2), 20, 21 dhe 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian ('Kartës').

Z. Abdida, shtetas nigerian i cili vuante nga një sëmundje e rëndë, aplikoi në Belgjikë për leje qëndrimi për arsye mjekësore. Në qershor të vitit 2011, aplikimi Z. Abdida u refuzua me arsyetimin se vendi i tij i origjinës kishte kushte të përshtatshme mjekësore për ofrimin e kujdesit shëndetësor për personat që vuanin nga sëmundje si ajo e Z. Abdida. Kështu autoritetet belge urdhëruan largimin e tij nga Belgjika.

Më 7 korrik 2011, Z. Abdida u ankua kundër këtij vendimi para Conseil du Contentieux des Étrangers (Këshillit të Mosmarrëveshjeve të të Huajve). Gjatë procedurës gjyqësore, Z. Abdida nuk kishte në dispozicion një mjet ligjor me efekt pezullues dhe gjithashtu i ishte hequr ndihma sociale dhe kujdesi mjekësor nga CPAS (Centres Publics d'Action Sociale – Qendra Publike për Mbështetjen Sociale). Më pas, Z. Abdida kundërshtoi vendimin e heqjes së ndihmës sociale në Tribunalin e punës të Nivelles, e cila mbështeti pretendimet e tij dhe urdhëroi CPAS t'i paguajë Z. Abdida ndihmën sociale.

Më 7 tetor 2011, CPAS parashtroi një ankesë kundër këtij vendimi para Cour du

travail de Bruxelles. Kjo gjykatë deklaroi se, sipas rregullave përkatëse kombëtare, nuk kishte mjete ligjore në dispozicion të Z. Abdida për pezullimin e vendimit të refuzimit të lejes së tij të qëndrimit dhe se, në pritje të vendimit për ankesën e tij, ai nuk kishte të drejtë për asnjë formë të ndihmës sociale përveç ndihmës mjekësore urgjente.

## 2. Pyetjet e paraqitura nga gjykata kombëtare

Cour du Travail de Bruxelles pezulloi procedurën dhe pyeti GJDBE-në nëse Direktivat 2003/9, 2004/83 dhe 2005/85, të marra në lidhje me nenet 1 deri 4, 19(2), 20, 21 dhe 47 të Kartës, interpretohen se një Shtet Anëtar, autoritetet kompetente të të cilit kanë refuzuar kërkesën e një shtetasi të një vendi të tretë për leje qëndrimi në atë Shtet Anëtar sipas legjislacionit kombëtar, i cili parashikon dhënien e lejes së qëndrimit një shtetasi të huaj i cili vuan nga një sëmundje e rëndë që rrezikon jetën ose integritetin fizik e tij ose të trajtohet në mënyrë çnjerëzore apo poshtëruese, për shkak të mos-ofrimit të një trajtimi të përshtatshëm mjekësor në vendin e tij të origjinës ose në vendin e tretë ku ai ka banuar më parë, dhe kanë urdhëruar largimin e tij nga territori i atij Shteti Anëtar, si në rastin në fjalë, duhet të vërë në dispozicion një mjet ligjor efektiv me efekt pezullues në lidhje me këtë vendim dhe duhet të sigurojë plotësimin e nevojave themelore të shtetasit të vendit të tretë në pritje të vendimit mbi ankesën e tij ndaj refuzimit të dhënies së lejes së qëndrimit.

## 3. Vendimi i GJDBE-së

GJDBE-ja përsëriti se një kërkesë në bazë të legjislacionit kombëtar për leje qëndrimi për shkak të një sëmundjeje të rëndë, e shoqëruar me mungesën e trajtimit në vendin e origjinës, nuk përbën një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në kuptimin e nenit 2(g) të Direktivës së Kualifikimit. Megjithatë, rasti në fjalë ngrinte çështje në bazë të Direktivës së Kthimit 2008/115, të 16 dhjetorit 2008, duke pasur parasysh se ndaj Z. Abdida ishte marrë një vendim që deklaronte qëndrimin e tij si të paligjshëm dhe urdhëronte kthimin e tij.

Në lidhje me efektin pezullues të ankimit kundër vendimit të kthimit, GJDBE-ja iu referua nenit 13(1) të Direktivës së Kthimit, i cili parashikon se një shtetasi të një vendit të tretë duhet t'i vihet në dispozicion një mjet ligjor efektiv për të apeluar kundër vendimit që urdhëron kthimin e tij. Neni 13(2) i kësaj Direktive parashikon se autoriteti i autorizuar për të gjykuar një ankim të tillë, mund të pezullojë përkohësisht zbatimin e vendimit të kthimit që kundërshtohet, duke lënë kështu të kuptohet se Direktiva e Kthimit nuk kërkon që mjeti ligjor i para-

shikuar në nenin 13(1) të ketë patjetër efekt pezullues. Megjithatë, karakteristikat e një mjeti të tillë duhet të përcaktohen në përputhje me nenin 47 të Kartës, e cila përbën një ripohim të parimit të mbrojtjes gjyqësore efektive.

Duke pasur parasysh jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut<sup>184</sup>, GJDBE-ja vendosi se në raste shumë të veçanta, kthimi i një shtetasi të një vendi të tretë, të sëmurë rëndë, në një vend ku ai nuk mund të marrë një trajtim mjekësorë të përshtatshëm, mund të cenojë parimin e *moskthimit* dhe kështu të shkelet detyrimi sipas nenit 5 të Direktivës së Kthimit. Këto raste shumë përjashtimore, karakterizohen nga serioziteti dhe natyra e pariparueshme e dëmit që mund të shkaktohet nga largimi i këtij personi në një vend në të cilin ekziston një rrezik serioz që ai t'i nënshtrohet trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës.

Duke pasur parasysh se kthimi i një personi mund të çojë në dëmtim serioz dhe të pariparueshëm të atij personi, GJDBE-ja deklaroi se “një shtetas i një vendi të tretë duhet të jetë në gjendje të mbrojë veten e tij, në rrethana të tilla, nëpërmjet një mjeti ligjor me efekt pezullues, me qëllim që të sigurojë mos-ekzekutimin e vendimit të kthimit derisa autoriteti kompetent të ketë mundësinë për të shqyrtuar pretendimin për shkeljen e parimit të moskthimit të parashikuar nga Direktiva e Kthimit dhe nga Karta”. GJDBE-ja vendosi se kjo zgjidhje është mbështetur nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së sipas nenit 13 të KEDNJ-së, i marrë në lidhje me nenin 3 të KEDNJ-së<sup>185</sup>, e cila është e rëndësishme për të interpretuar nenin 47 të Kartës.

Rrjedhimisht, GJDBE-ja vendosi se nenet 5 dhe 13 të Direktivës së Kthimit duhet të interpretohen se e ndalojnë legjislacionin kombëtar i cili nuk parashikon një mjet ligjor me efekt pezullues në lidhje me një vendim kthimi, zbatimi i të cilit mund ta vërë një shtetas të një shteti të tretë përballë rrezikut të përkeqësimit të rëndë dhe të pakthyeshëm të gjendjes shëndetësore.

Përsa i përket parashikimit të plotësimit të nevojave themelore të një shtetasi të një vendi të tretë, si rasti në procedurën kryesore, neni 14 i Direktivës së Kthimit parashikon marrjen e disa masave mbrojtëse në pritje të ekzekutimit të vendimit të kthimit.

184 Shih *N. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim [Dhoma e Madhe] i 27 majit 2008, nr. 26565/05, i përfshirë në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

185 Shih *Hirsi Jaama dhe të Tjerë k. Italisë*, vendim [Dhoma e Madhe] i 23 shkurtit 2012, nr. 27765/09, i përfshirë në kapitullin për jurisprudencën e GJEDNJ-së.

Në rastin konkret, Shteti Anëtar në fjalë ishte i detyruar, në përputhje me nenin 14(1)(b) të Direktivës së Kthimit, të parashikonte, për aq sa ishte e mundur, plotësimin e nevojave bazë të shtetasit të një vendi të tretë i cili vuante nga një sëmundje e rëndë ku ai nuk mundet vetë t'i plotësojë këto nevoja. Detyrimi për të siguruar kujdesin shëndetësor të urgjencës dhe trajtimin thelbësor të sëmundjes mundet, në një situatë të tillë, të bëhet i pakuptimtë nëse nuk ka një detyrim për t'u kujdesur për nevojat themelore të shtetasit të vendit të tretë.

Rrjedhimisht, GJDBE-ja vendosi se neni 14(1)(b) i Direktivës së Kthimit duhet të interpretohet se ndalon legjislacionin kombëtar i cili nuk parashikon, për sa është e mundur, detyrimin e plotësimin të nevojave themelore të një shtetasi të një vendi të tretë që vuan nga një sëmundje e rëndë, duke i siguruar atij kujdesin shëndetësor emergjent dhe trajtimin thelbësor të sëmundjes, gjatë periudhës në të cilën autoritetet e Shtetit Anëtar në fjalë duhet të pezullojë ekzekutimin e vendimit të kthimit të tij, pas depozitimit të ankimit kundër një vendimit që urdhëron kthimin e tij.

#### 4. Koment

Vendimi në rastin *Abdida* ka një lidhje indirekte me të drejtën e azilit. Vendimi konfirmoi qëndrimin GJDBE-së në rastin *M'Bodj*<sup>186</sup>, i publikuar në të njëjtën ditë, se vlerësimi i mbrojtjes së nevojshme për arsye mjekësore nuk mundet, si i tillë, të përfshihet në fushëveprimin e nocionit të “dëmtimit serioz”, siç përcaktohet në nenin 15 të Direktivës së Kualifikimit, përveç nëse mungesa e kujdesit shëndetësor është e qëllimshme.

Kështu, rasti *Abdida* sugjeron se në disa raste, ata që nuk kualifikohen për të përfituar mbrojtjen plotësuese ose statusin e refugjatit, megjithatë, nuk mund të kthehen në zbatim të Direktivës së Kthimit të BE-së. Së pari, GJDBE-së vendosi se, ndërsa Direktiva e Kthimit nuk kërkon që mjeti ligjor që kundërshton vendimin e largimit, të ketë efekt pezullues, ishte e nevojshme të merrej në konsideratë ndikimi i nenit 19(2) të Kartës e të Drejtave e BE-së, e cila ndalon kthimin në Shtete ku personi në fjalë do të përballlej me një rrezik serioz të trajtimit çnjerëzor ose poshtërues. Kjo duhej interpretuar në dritën e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në lidhje me nenin 3 të KEDNJ-së, e cila ndalon kthimin për “arsye shëndetësore” në raste të jashtëzakonshme<sup>187</sup>. Prandaj, në raste të

186 C-542/13, *Mohamed M'Bodj k. État belge*, vendim [Dhoma e Madhe] i 18 dhjetorit 2014, shih komentet e veçanta të përfshira në këtë kapitull.

187 *N. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim [Dhoma e Madhe] i 27 majit 2008, nr. 26565/05, i përfshirë në kapitullin për jurispru-

tilla të jashtëzakonshme, kthimi i një shtetasi të një vendi të tretë që vuan nga një sëmundje e rëndë, në një vend në të cilin nuk ofrohet trajtimi i përshtatshëm mjekësor “do të shkelte parimin e *moskthimit*” për arsye mjekësore dhe për rrjedhojë do të shkelte nenin 5 të Direktivës së Kthimit. Ky ndalim i kthimit në këto kushte, ka efektin tjetër, që mjeti ligjor që kundërshton largimin nga Shteti Anëtar, duhej të ketë efekt pezullues, pavarësisht formulimit të Direktivës që e bën fakultativ një parashikimin të tillë, sepse në të kundërt, Z. Abdida mund të pësonte një dëm të pariparueshëm, nëse kthehej në vendin e tij të origjinës përpara se të vendosej apeli i tij. Kështu, GJDBE-ja vendosi se legjislati kombëtar, i cili nuk parashikonte një mjet ankimor me efekte pezulluese kundër vendimit të kthimit dhe që mund ta ekspozonte ankuesin ndaj rrezikut serioz të përkeqësimit të rëndë dhe të pakthyeshëm të gjendjes së tij shëndetësore, ndalohej të zbatohet.

Së dyti, GJDBE-ja u shpreh gjithashtu edhe për të drejtat sociale të kërkuesit. GJDBE-ja vendosi se kur kërkesa ngre këto çështje dhe është paraqitur një ankim, Shteti Anëtar duhej t’i siguronte, në bazë të nenit 14(1)(b) të Direktivës së Kthimit “plotësimin e nevojave themelore një shtetasi të një vendi të tretë i cili vuante nga një sëmundje e rëndë, kur ai nuk mundej t’i plotësonte vetë”. Megjithatë, GJDBE arriti në përfundimin se u takonte “Shteteve Anëtare për të përcaktuar mënyrën sesi do të bëhej ky plotësim i nevojave themelore të një shtetasi të një vendi të tretë”.

Kufizimet e fushës së zbatimit të detyrimeve të përshkruara në vendimin *Abdida* u trajtuan më pas nga Gjykata edhe në vendimin Tall<sup>188</sup>.

-----  
dencën e GJEDNJ-së.

188 C-239/14, *Abdoulaye Amadou Tall k. Centre public d'action sociale de Huy*, vendimi i 17 dhjetorit 2015. Shih diskutimin e këtij vendimi tek komentet e vendimit holandez në Seksionin e Juridiksionit Administrativ të Këshillit të Shtetit (ABRVs), 201112955/1 / V4, 29 qershor 2012, në kapitullin për jurisprudencën e gjykatave kombëtare.

# Përmbledhje dhe komente të vendimeve të gjykatave kombëtare

**Cenimi i lirisë fetare si akt persekutimi**  
**Direktiva e Këshillit nr. 2004/83/EC e 29 prillit 2004**  
**(Direktiva e Kualifikimit), neni 9(1)**

*Ndalimi, në forma të caktuara, i praktikimit të fesë mund të përbëjë një akt të rëndë persekutimi sipas kuptimit të nenit 9(1) të Direktivës së Kualifikimit, pavarësisht nëse anëtari i fesë përkatëse do të jetë aktiv në praktikimin e fesë së tij apo do të tërhiqet për shkak të frikës nga persekutimi.*

**Gjermani: Gjykata Administrative Federale**  
**(BVerwG), 20 shkurt 2013, 10 C 23.12**

## 1. Faktet kryesore

Azilkërkuesi, i cili ka lindur në vitin 1979, është anëtar i komunitetit fetar Ahmadija në Pakistan. Ai udhëtoi në Gjermani në vitin 2000 dhe aplikoi për azil. Kërkesa u refuzua me arsyetimin se pretendimet e tij nuk ishin të besueshme. Për më tepër, Gjykata Administrative vendosi se nuk kishte prova që vërtetonin persekutimin në masë të anëtarëve të komunitetit fetar Ahmadija në Pakistan.

Pas disa kërkesash të pasuksesshme të mëvonshme, azilkërkuesi paraqiti një kërkesë tjetër për azil në vitin 2008 duke deklaruar se situata ligjore ka ndryshuar në favor të tij në sajë të zbatimit të Direktivës së Kualifikimit (2004/83/EC).<sup>189</sup> Konkretisht, ai argumentoi se neni 10(1)(b) i Direktivës 2004/83/EC tani e konsideronte fenë si arsye për persekutim, në mënyrë të tillë që të mbrohej edhe praktikimi i fesë në publik. Gjykata Administrative pranoi kërkesën e tij dhe detyroi autoritetet t'i njihnin atij statusin e refugjatit.

Gjykata e Lartë Administrative Baden-Württemberg konfirmoi vendimin e Gjykatës Administrative më 13 dhjetor 2011, duke argumentuar se Direktiva e Kualifikimit 2004/83/EC e ndryshoi objektin e mbrojtjes së lirisë së fesë në të

189 Shih n 1.

drejtën e refugjatëve, krahasuar me dispozitat që aplikoheshin më parë. Ajo vendosi se, në bazë të standardeve të Direktivës, azilkërkuesi ishte kërcënuar me përndjekje në Pakistan, duke qenë se komuniteti fetar Ahmadija ishte objekt i kufizimeve serioze në ushtrimin e fesë së tyre, konkretisht nga kufizimet nga legjislacioni penal dhe dhunës së ushtruar nga ekstremistë fetarë, pa pasur mbrojtje efektive kundër abuzimeve të tilla nga forcat policore.

Autoritetet kërkuar në Gjykatën Federale Administrative rishqyrtimin e çështjes. Në maj të vitit 2012, Gjykata Federale Administrative pezulloi procesin derisa GJDBE-ja të vendoste lidhur me kërkesat për një vendim paraprak për pyetje të ndryshme për sa i përket interpretimit të nenit 9 (1) (a) dhe nenit 2 (c) të Direktivës së Kualifikimit të 2004/83/EC. GJDBE-ja iu përgjigj pyetjeve të përmendura në një vendim të datës 5 shtator 2012 (bashkimi i çështjeve C-71/11 dhe C-99/11).<sup>190</sup>

## 2. Vendimi i Gjykatës

Në vendimin e saj të datës 5 shtator 2012 (*Bundesrepublik Deutschland k. Y dhe Z, C-71/11 and C-99/11*), GJDBE-ja përcaktoi në cilat rrethana cenimi i lirisë fetare mund të konsiderohet akt persekutimi sipas nenit 9 (1) (a) i Direktivës së Kualifikimit.

GJDBE-ja e sheh të drejtën e lirisë së fesë të sanksionuar në nenin 10 (1) të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (KDTHBE), si një e drejtë themelore e njeriut dhe një nga themelet e një shoqërie demokratike e që korrespondon me nenin 9 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Sipas GJDBE, cenimi i të drejtës për liri fetare mund të jetë aq i rëndë sa të trajtohet në të njëjtën mënyrë si rastet të cilave u referohet neni 15 (2) i KEDNJ-së, e që neni 9(1)(a) i Direktivës së Kualifikimit iu referohet si udhëzues për përcaktimin se cilat akte mund të konsiderohen akte persekutimi. Megjithatë, jo çdo ndërhyrje në të drejtën e lirisë fetare e garantuar nga neni 10 (1) i Kartës përbën një akt persekutimi sipas kuptimit të nenit 9 (1) të Direktivës.

Para së gjithash, cenimi i kësaj lirie nuk duhet të bjerë në fushëveprimin e kufizimeve të parashikuara me ligj të së drejtës për të ushtruar të drejtat themelore, në kuptim të nenit 52 (1) të Kartës. Për më tepër, duhet të jetë një shkelje e rëndë e të drejtave që sjell pasoja të rënda për personin në fjalë. Sipas

190 Shih vendimin e GJDBE në çështjet e bashkuara C-71/11 dhe C-99/11, *Bundesrepublik Deutschland k. Y dhe Z* (5 shtator 2012) në seksionin e jurisprudencës së GJDBE-së.

nenit 9(1)(a) të Direktivës, kjo presupozon se aktet që cenojnë këtë liri duhet të jenë në të njëjtin nivel me cenimin e të drejtave themelore të njeriut të paderogueshme në bazë të nenit 15 (2) të KEDNJ-së (e drejta për jetën (neni 2 KEDNJ-së, me përjashtim të rasteve kur personi vdes si pasojë e akteve të ligjshme të luftës) ndalimi i torturës (neni 3 i KEDNJ-së), ndalimi i skllavërisë dhe i punës të detyruar (neni 4, paragrafi 1 i KEDNJ-së) dhe nuk ka dënim pa ligj (neni 7 i KEDNJ-së)).

Sipas praktikës gjyqësore të GJDBE-së, aktet të cilat mund të përbëjnë shkelje të rëndë të lirisë fetare në këtë kuptim nuk përfshijnë vetëm akte që cenojnë rëndë lirinë e aplikantit për të praktikuar besimin e tij privatisht, por edhe aktet të cilat kufizojnë lirinë e tij për ta shprehur besimi i tij në një kontekst publik. Si pasojë, GJDBE-ja nuk e konsideron në pajtim me përkufizimin e gjerë që i jep neni 10 (1) (b) i Direktivës së Kualifikimit lirisë së fesë, bërjen e dallimit ndërmjet rëndësisë së një akti bazuar në faktin nëse akti ndërhyr në fushat kryesore të ushtrimit të fesë privatisht (*forum internum*) apo në një zonë më të gjerë të aktiviteteve fetare në publik (*forum externum*).

Gjykata Federale Administrative aprovoi këtë interpretim dhe vendosi se aktet të cilat mund të konsiderohen se përbëjnë akte persekutimi, duhet të identifikohen në bazë të natyrës së represionit që shkaktonin mbi individin në fjalë dhe pasojat e tij.

Rrjedhimisht Gjykata Federale Administrative, vendosi se:

“Shkelja e të drejtës për lirinë e fesë mund të përbëjë persekutim sipas kuptimit të nenit 9 (1) (a) të Direktivës së Kualifikimit kur një azilkërkuar, si rezultat i ushtrimit të kësaj lirie në vendin e tij të origjinës, mund të përballet me një rrezik real, ndër të tjera, të ndiqet penalisht apo t’u nënshtrohet dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese nga njëri prej aktorëve të përmendur në nenin 6 të Direktivës.”

Në vijim, Gjykata Federale Administrative vërejtj se:

“Një cenim i rëndë i lirisë së fesë sipas nenit 9 (1) të Direktivës nuk presupozon që, pas kthimit në vendin e tij të origjinës, i huaji e ushtron në fakt fenë e tij, në një mënyrë që e ekspozon atë ndaj kërcënimit të persekutimit. Përkundrazi, frenimi nga ushtrimi i besimit fetar për shkak të presionit nga kërcënimi i persekutimit, mund të arrijë në nivelin e persekutimit.”



Për më tepër, thjesht ndalimi i pjesëmarrjes në adhurimin fetar në publik mund të përbëjë një akt të rëndë sipas kuptimit të nenit 9 (1) (a) të Direktivës, dhe për rrjedhojë akt persekutimi, ku një shkelje e këtij ndalimi sjell një rrezik real të zbatimit të sanksioneve dhe të pasojave të përmendura atje.

Në vijim, edhe GJDBE edhe Gjykata Federale Administrative konfirmuan se respektimi i një praktike të caktuar fetare duhet të jetë veçanërisht i rëndësishëm për ruajtjen e identitetit fetar të aplikantit, edhe nëse ndjekja e një praktike të tillë fetare nuk është me rëndësi themelore për komunitetin fetar në fjalë. Faktori vendimtar është se si jeton besimtari jashtë besimit të tij, dhe nëse praktika fetare, për shkak të së cilës ndodh persekutimi, është e domosdoshme për aplikantin personalisht sipas kuptimit të tij për fenë e tij. Faktori vendimtar për sa i përket ashpërsisë të cenimit të identitetit fetar është intensiteti i presionit mbi vendimin vullnetar të individit nëse ai duhet ta praktikojë besimin e tij në një mënyrë që ai mendon se është e detyrueshme për të, apo duhet të mos e praktikojë për shkak të kërcënimit të zbatimit të sanksioneve. Fakti që ai e konsideron praktikën e ndaluar fetare të besimit të tij, si të detyrueshme për të në një mënyrë që të ruajë identitetin e tij fetar, duhet të provohet nga azilkërkuesi para gjykatës.

Gjykata Federale Administrative vendosi se pyetja thelbësore është nëse, në dritën e këtyre rrethanave, mundet që frika e persekutimit mund t'i ngjallet një personi të arsyeshëm dhe të matur në situatën e personit në fjalë:

“Në rastin konkret, pyetja thelbësore është nëse azilkërkuesi mundet, me të drejtë dhe në mënyrë të justifikueshme, të frikësohet nga kërcënimi, krejt i mundshëm, i cenimit të rëndë të interesave të tij të ligjshme, veçanërisht rrezikut të shkakimit të dëmin kundrejt jetës së tij, gjymtyrëve ose lirisë, ndjekjes penale, trajtimit ose dënimi çnjerëzor ose poshtëruës, për shkak të një aktiviteti fetar publik në Pakistan, që ka rëndësi të veçantë për të ruajtur identitetin e tij fetar.”

Gjykata Federale Administrative vuri në dukje se, Gjykata e Lartë Administrative kishte vendosur me të drejtë që thjesht anëtarësimi në komunitetin Ahmadija, nuk i vendoste shtetasit pakistanez në rrezik persekutimi në vendin e tyre që të ishte përcaktuese për të drejtën e azilit. Persekutimi drejtohet vetëm kundrejt ‘predikuesve Ahmadinë’ të cilët ‘po ashtu dëshironin të praktikonin besimin e tyre në publik në vendin e tyre’. Megjithatë, Gjykata Federale Administrative u shpreh se standardet e aplikueshme për persekutimin e një grupi nuk bazohen tërësisht në përcaktimin e probabilitetit të persekutimit

kundër 'predikuesve Ahmadinë', pasi një shqyrtim i krahasueshëm i numrit të akteve të përndjekjes që kanë ndodhur në raport me numrin e përgjithshëm të Ahmadinëve në Pakistan (rreth 4 milion), ose predikuesve Ahmadinë (500,000 - 600,000), mund të mos marrë në konsideratë një numër potencialisht të madh anëtarësh të besimit që nuk e praktikojnë fenë e tyre në publik nga frika e persekutimit. Kështu, duke qenë se rreziku i persekutimit varet nga sjellja vullnetare e individit - ndalimi i praktikimit të besimit publik - prognoza e rrezikut duhet të bazohet në grupin e anëtarëve të besimit që e praktikojnë atë në publik, pavarësisht nga ndalimet.

Në këtë rast, GjFA-ja konkludoi se duhet përcaktuar sa Ahmadinë praktikojnë besimin e tyre në një mënyrë të ndaluar sipas së drejtës penale dhe sa ndikon persekutimi tek anëtarët e këtij grupi. Në qoftë se, në bazë të një prognozë të tillë, rezulton një rrezik real persekutimi ndaj grupit të anëtarëve të besimit që e praktikojnë atë në publik në një mënyrë të ndaluar, mbi këtë bazë mund të nxirret përfundimi që i gjithë grupi i Ahmadinëve, për të cilët këto praktika publike të fesë përbëjnë një element themelor të identitetit të tyre fetar dhe në këtë kuptim janë të nevojshme, janë gjithashtu të prekur nga kufizimet e lirisë së tyre fetare në mënyrë të tillë që mund të mbahet parasysh në të drejtën e refugjatëve.

Për shkak të mungesës së gjetjeve të mjaftueshme faktike nga Gjykata e Lartë Administrative në lidhje me probabilitetin e persekutimit të aplikantit në rast të kthimit të tij në Pakistan, Gjykata Federale Administrative nuk mundi të marrë një vendim përfundimtar mbi këtë çështje.

Rasti iu kthye përsëri për gjykim Gjykatës së Lartë Administrative, për të marrë një vendim të ri në bazë të parimeve të vendosura nga Gjykata Federale Administrative.

### 3. Koment

Efekti i vendimit të GJDBE-së në *Bundesrepublik Deutschland k. Y dhe Z* dhe vendimi i mëvonshëm i Gjykatës Federale Administrative Gjermane është se shumë rrallë mund të jetë e mjaftueshme që t'i jepet statusi i refugjatit një personi i cili pretendon se ka frikën e persekutimit për shkak të besimit të tij fetar, vetëm duke treguar që në vendin e tij të origjinës ka ligje që diskriminojnë fenë e tij. Është gjithashtu e nevojshme të tregohet se ato ligje përcaktojnë dënime penale të cilat kanë shumë të ngjarë të zbatohen në praktikë. Së dyti, nuk është e mjaftueshme që personi të tregojë se nuk do të jenë në gjendje të

ushtrojë lirinë e tij fetare në vendin e tij për shkak të diskriminimit fetar; duhet të tregojë gjithashtu se ushtrimi i një lirie të tillë është e një rëndësie themelore për identitetin e tij fetar<sup>191</sup>.

---

191 Shih C-71/11 dhe C-99/11, *Bundesrepublik Deutschland k. Y dhe Z*, vendim [Dhoma e Madhe] i 5 shtatorit 2012, i përfshirë në kapitullin për jurisprudencën e GJBE-së, paragrafi 70.

**Persekutimi nga persona që nuk mbajnë detyra shtetërore  
Direktiva e Këshillit nr. 2004/83/EC e 29 prillit 2004 (Direktiva e Kualifikimit),  
neni 7 dhe Konventa e Refugjatëve e 1951 neni 1A (2)**

*Në rastet kur një aplikant ka frikën e persekutimit nga persona që nuk mbajnë detyra shtetërore, Shteti, shtetësinë e të cilit aplikanti mban, është i detyruar t'i ofrojë mbrojtje, në qoftë se ka një sistem të mjeteve të brendshme mbrojtëse për zbulimin, ndjekjen dhe dënimin e akteve të tilla dhe ka një aftësi dhe gatishmëri për ta vënë në lëvizje këtë sistem.*

**Mbretëri e Bashkuar: Horvath k. Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme [2000] UKHL 37**

**6 korrik 2000**

## **1. Fakte kryesore**

Aplikanti, shtetas sllovak, i përkiste komunitetit minoritar rom. Romët, të cilët ishin të shpërndarë në të gjithë vendin, përbënin rreth 10 për qind të popullsisë së Sllovakisë. Në fshatin nga vinte aplikanti ata ishin një pakicë e vogël. Ai dhe familja e tij për shkak të faktit që i përkisnin komunitetit rom, ishin përballur me keqtrajttime nga kokërruarit. Të njëjtën gjë përjetonin dhe romët e tjerë në lagjen e tij. Ai u largua për në Britaninë e Madhe dhe kërkoi azil. Aplikanti pohoi se kishte frikë se nëse ai dhe familja e tij ktheheshin në Sllovaki do të sulmoheshin përsëri nga kokërruarit dhe për më tepër nuk do merrnin mbrojtje nga policia. Tribunali i Apelit të Emigracionit vendosi se, ndërsa ai kishte një frikë mirëbazuar të dhunës nga kokërruarit, kjo nuk përbënte persekutim, pasi aplikanti nuk kishte mundur të tregonte se nuk ishte mundësi, ose për shkak të frikës nga persekutimi, nuk ishte i gatshëm të kërkonte mbrojtjen nga shteti.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Çështjet në diskutim në procesin në apel para Dhomës së Lordëve<sup>192</sup> kishin të bënin me interpretimin e duhur të nenit 1A (2) të Konventës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve, e ndryshuar nga Protokollin e vitit 1967 (Konventa për Refugjatët). Pretendimi i aplikantit për marrjen e statusit të refugjatit bazohej në pamjaftueshmërinë e mbrojtjes të

-----  
192 Në pajtim me pjesën 3 të Ligjit mbi Reformën Kushtetuese, i vitit 2005, u krijua Gjykata e Lartë e cila mori funksionet gjyqësore të Dhomës së Lordëve që nga 1 tetori 2009.

shtetit kundër persekutimit nga persona që nuk mbajnë funksione shtetërore dhe jo mbi frikën e bazuar të persekutimit nga vetë shteti ose nga organet ose agjentët e shtetit. Kërkesa e tij bazohej në frikën e tij ndaj dhunës së ushtruar nga kokërruarit, të cilët nuk ishin funksionarë të shtetit dhe dështimin e shtetit për t'i siguruar atij mbrojtjen e nevojshme kundër këtyre akteve.

Me unanimitet, të pesë gjyqtarët (Lordët e Gjykatës) rrëzuan ankesën e aplikantit me argumentin se ky i fundit mund t'i kishte kërkuar shtetit mbrojtje nga personat që nuk ushtronin funksione shtetërore të cilët kishin keqtrajtuar atë.

U vendos se një nga qëllimet e Konventës për Refugjatët ishte sigurimi i mbrojtjes plotësuese për ata që i frikësoheshin dëmtimit në vendin e tyre. Kur frika drejtohet kundrejt personave të cilët nuk janë të veshur me pushtet shtetëror, garantimi i mbrojtjes së refugjatit nga shteti është vendimtar dhe nëse një mbrojtje e tillë nuk është në dispozicion, atëherë shteti pranues detyrohet t'i ofrojë mbrojtje plotësuese. Ka disa formula për përcaktimin e nivelit të mbrojtjes që duhet t'i ofrohet personit në rastin kur frika e tij drejtohet kundrejt personave që nuk mbajnë poste shtetërore.

Kështu, Lordët vendosën se:

“Detyrimi parësor për të ofruar mbrojtje i takon Shtetit mëmë. Është detyra e tij të krijojë dhe të zbatojë një sistem të mbrojtjes kundër persekutimit të shtetasve të saj. Në qoftë se ky sistem nuk ekziston, atëherë detyrohet komuniteti ndërkombëtar të sigurojë mbrojtjen plotësuese. Por zbatimi i parimit të mbrojtjes plotësuese qëndron mbi supozimin se, ashtu si mbrojtja plotësuese nuk mund të garantojë një mbrojtje të plotë kundër sulmeve të izoluara dhe rastësore, kështu edhe mbrojtja e plotë kundër sulmeve të tilla nuk mund të pretendohet që garantohej në shtetin mëmë. Për rrjedhojë, standardi i zbatueshëm nuk është eliminimi i të gjitha rreziqeve që do të çojë kështu në garantimin e mbrojtjes në shtetin mëmë. Krejt ndryshe, standardi është praktik dhe lidhet me vlerësimin e duhur që një shtet ka ndaj shtetasve të tij.”

Gjithashtu, për sa i përket vlerësimit të nivelit të mbrojtjes në shtetin e origjinës, Lordët u shprehën se:

“Shteti duhet ngrejë një sistem mbrojtjeje dhe mekanizma për zbulimin, ndjekjen dhe dënimin e veprimeve të cilat vijnë në kundërshtim me qëllimet që Konventa kërkon të mbrojë. Më e rëndësishmja është se duhet të ekzistojë mundë-

sia dhe gatishmëria për t'i vënë në lëvizje këto mekanizma sa herë lind nevoja. Por se ku saktësisht është vija që e ndan atë që është e përgjithshme, varet nga rrethanat e çdo rasti të veçantë.”

Për të qartësuar qëllimin e synuar, Dhoma e Lordëve u mbështet në formulimin e vendimit të Gjykatës së Apelit të Anglisë dhe Uellsit, ku deklarohet se:

“Në vendin në fjalë duhet të jetë në fuqi një ligj penal i cili dënon sulmet e dhunshme nga persekutorët në përpjesëtim me rëndësinë e veprave penale. Viktimat që i përkasin një grupi shoqëror nuk duhet të përjashtohen nga mbrojtja e ligjit. Agjencitë e zbatimit të ligjit, forcat policore dhe gjykatat, duhet të kenë vullnetin e arsyeshëm për të zbuluar, ndjekur penalisht dhe ndëshkuar shkelësit.”

Më tej, në lidhje me çështjen e mungesës së vullnetit të shtetit të origjinës për garantimin e mbrojtjes, Gjykata e Apelit theksonte se:

“Mungesa e efikasitetit dhe paaftësia nuk është e njëjtë me mungesën e vullnetit, në kuptimin që mund të ketë arsye bindëse të ndryshme se pse kriminelët nuk nxirren para drejtësisë dhe se korrupsioni, keqardhja apo dobësia e disa individëve të sistemit të drejtësisë nuk do të thotë që shteti nuk ka vullnet për të siguruar mbrojtje.”

Kështu, Dhoma e Lordëve arriti në përfundimin se duhen “prova bindëse që shteti i cili është në gjendje të garantojë mbrojtje nuk ka vullnetin ta ofrojë atë, veçanërisht në rastin e një shteti demokratik” Prandaj, ajo vërejt se “mjaftueshmëria e mbrojtjes së siguruar nga shteti nuk matet me ekzistencën e një rreziku real të abuzimit të të drejtave, por nga disponueshmëria e një sistemi të ngritur për mbrojtjen e qytetarit dhe një vullnet i arsyeshëm nga ana e shtetit për të përdorur atë.”

Rrjedhimisht, mjaftueshmëria e mbrojtjes shtetërore duhet të matet me “disponueshmërinë e një sistemi për mbrojtjen e qytetarit dhe një gatishmëri të arsyeshme nga ana e shtetit për të vepruar”.

Dhoma e Lordëve konkludoi se situata në Republikën e Sllovakisë nuk ishte e tillë që të shfaqeshin probleme si ato që mund të lindin në juridiksione të tjera, ku nuk kishte një autoritet efektiv shtetëror ose autoriteti shtetëror nuk ishte në gjendje të siguronte mbrojtje. U vërejt se institucionet shtetërore ishin efektive dhe operonin në Sllovaki dhe se shteti iu ofronte mbrojtje shtetasve

të tij në respektim të shtetit të së drejtës dhe ushtronte autoritetin e tij përmes forcave policore. Gjyqtarët pranuan se ka pasur dhunë për shkak të racës ndaj romëve nga kokërruarit, se policia nuk kishte kryer në të gjitha rastet hetimin e duhur dhe se ka pasur raste kur hetimi i tyre ka qenë shumë i ngadaltë. Megjithatë, Gjyqtarët gjithashtu kishin gjetur “prova se policia kishte ndërhyrë për të siguruar mbrojtje, kur u ishte kërkuar të vepronin dhe se dënime të ashpra ishin vendosur për krimet që ishin të motivuara për arsye raciale.” Prandaj, Dhoma e Lordëve u pajtua me përfundimin e Tribunalit që sulmet e dhunshme mbi romët ishin sulme të izoluara dhe rastësore nga banditë. Ankesa u hedh poshtë.

### 3. Koment

Vendimi në rastin *Horvath* ka pasur ndikim të konsiderueshëm në të drejtën ndërkombëtare dhe evropiane të refugjatëve dhe në përkufizimin e termit “refugjat” sipas nenit 1A (2) të Konventës për Refugjatët. Ai sqaron se, çështja nëse ekziston ose jo mbrojtje shtetërore është pjesë integrale e hetimit nëse dikush mund të tregojë se është «persekutuar». Gjithashtu ky vendim shpjegon se nuk mund pretendohet mbrojtje absolute nga asnjë shtet, përkundrazi duhet zbatuar një “standard praktik” për të vlerësuar nëse shteti është në “pamundësi apo nuk ka vullnet të përmbushë detyrimin e tij për krijimin dhe zbatimin e një sistemi për mbrojtjen nga persekutimi të shtetasve të tij”. Për të siguruar mbrojtje, një shtet duhet të ketë: “një sistem të brendshëm mbrojtje dhe mekanizma për zbulimin, ndjekjen dhe dënimin e akteve të cilat janë në kundërshtim me qëllimet e mbrojtura nga Konventa. Më e rëndësishmja është se shteti duhet të ketë aftësinë dhe vullnetin për t’i vënë në lëvizje ato mekanizma”.

Formulimi i nenit 7 të Direktivës së Kualifikimit (i cili përcakton se cilët subjekte mund të përbëjnë aktorë të mbrojtjes dhe në çfarë kushtesh mund të thuhet se këta aktorë garantojnë mbrojtje efektive), është modeluar bazuar së tepërmi në arsyetimin e përcaktuar në rastin *Horvath*. Paragrafi 27 i preambulës së Direktivës së Kualifikimit, e ndryshuar, shkon disi më tej kur parashikon se “kur shteti apo agjentët e tij janë ata që kryejnë akte persekutimi ose lëndimi serioz, supozohet se nuk ka mbrojtje efektive në dispozicion të azilkerkuesit”.

Rasti *Horvath* nuk duhet kuptuar që, nëse në vendin e origjinës të një personi ekziston një sistem ligjesh, që përgjithësisht u garanton mbrojtje qytetarëve të tij, personi nuk mund të marrë mbrojtje plotësuese edhe pse rrethanat e veçanta të tij e bëjnë të nevojshme një gjë të tillë. Krejt ndryshe, ky vendim përcakton në nivel të përgjithshëm se në çfarë konsiston mbrojtja. Siç u pohua

në rastin *Bonomova* në Gjykatën e Apelit<sup>193</sup>, *Horvath* “nuk përcaktoi nivelin e saktë ose standardin e mbrojtjes që një shtet duhet të sigurojë, kundrejt së cilit duhet të analizohen faktet e një rasti të veçantë». Për më tepër, Gjykata e Apelit në rastin *Bagdanavicius*<sup>194</sup> identifikoi një nga propozimet *post-Horvath* që duhet të aplikohen nga gjykatat, sipas të cilit: “pavarësisht ekzistencës së një sistemi mbrojtjeje në shtetin pritës, një person mund të ketë përsëri frikë të bazuar nga persekutimi në qoftë se ai mund të tregojë se autoritetet shtetërore janë në dijeni ose duhet të jenë në dijeni për rrethanat e veçanta të rastit të tij, por nuk duket se janë të gatshme t’i sigurojnë mbrojtjen plotësuese, kur rrethanat e tij të veçanta në mënyrë të arsyeshme e bëjnë të nevojshme...”. Për më tepër, duke u mbështetur në këtë vendim, në rastin e mëvonshëm *IM*<sup>195</sup>, Tribunali i Azilit dhe Emigracionit në Mbretërinë e Bashkuar arriti në përfundimin se:

“Një tjetër mënyrë e të kuptuarit të efektit të vendimeve të mësipërme është se: mbrojtja e një shteti duhet të jetë mjaft e gjerë për të mbuluar nevojat e zakonshme të qytetarëve të saj për mbrojtje. Mbrojtja mund të jetë ende e pamjaftueshme, për të parandaluar persekutimin në një rast të veçantë ose në një grup të veçantë rastesh, në qoftë se një individ (ose grup individësh) ka nevojë për mbrojtje të jashtëzakonshme. Megjithatë, identifikimi i nevojës së një personi (ose grup i caktuar personash) për “mbrojtje plotësuese” për shkak të rrethanave individuale të tij, ka një kufi të rëndësishëm. Siç theksohet në *Horvath*, mbrojtja është një standard praktik. Lord Clyde deklaroi se, “askush nuk ka të drejtën e një imuniteti të garantuar në mënyrë absolute. Kjo shkon përtej çdo pritshmërie realiste në praktikë”.

193 *Banomova k. SSHD* [2001] EWCA Civ. 807.

194 *Bagdanavicius k. Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme* (CA) [2005] EWCA Civ. 1605.

195 *IM (Mbrojtja e Mjaftueshme) Malawi k. Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme* [2007] UKAIT 00071.



**Mbrojtja plotësuese**  
**Direktiva e Këshillit nr. 2004/83/EC e 29 prillit 2004**  
**(Direktiva e Kualifikimit), neni 15(c)**

*Kushti i individualizimit të kërcënimit të jetës apo personit, për qëllimet e mbrojtjes plotësuese, është në përpjesëtim me shkallën e dhunës pa dallim, që karakterizon konfliktin e armatosur.*

**Francë: Conseil d'Etat, 3 korrik 2009, Ofpra c/ M.A., n° 320295**

### **1. Faktet kryesore**

Aplikanti, një shtetas nga Sri Lanka, depozitoi një kërkesë për azil në Zyren Franceze për Mbrojtjen e Refugjatëve dhe Personave pa Shtetësi (ZFMRPSH), e cila u refuzua. Në gjykimin në apel, më 27 qershor 2008, Gjykata Kombëtare mbi të drejtën e Azilit (Cour Nationale du Droit d'Asile - CNDA) vendosi t'i jepte azilkërkuessit mbrojtjen plotësuese. ZFMRPSH kërkoi rrezimin e këtij vendimi nga Këshilli i Shtetit.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Neni 15(c) i Direktivës së Kualifikimit<sup>196</sup> është transpozuar në legjislacionin francez me nenin L.712-1 c) CESEDA. Bazuar në nenin L.712-1 CESEDA, Këshilli i Shtetit vërejti se dhuna pa dallim, që sjell kërcënimin i cili përbën bazën e kërkesës për mbrojtje plotësuese, është pjesë e pandashme e konfliktit të armatosur dhe e karakterizon atë. Këshilli i Shtetit vlerësoi se në bazë të interpretimit të kësaj dispozite, si dhe, dispozitave të Direktivës së Kualifikimit, dhuna dhe situata e konfliktit të armatosur bashkëjetojnë në çdo aspekt në të njëjtën zonë gjeografike.

Për më tepër, Këshilli i Shtetit theksoi se, ekzistenca e një kërcënimi serioz, të drejtpërdrejtë dhe individual ndaj jetës apo personit, i cili ka kërkuar mbrojtje plotësuese, nuk kufizohet nga fakti se ai duhet të vërtetohet që është vënë në shënjestër për shkak të disa elementeve të cilat janë specifike për situatën e tij personale, për aq kohë sa shkalla e dhunës pa dallim që karakterizon konfliktin e armatosur arrin një nivel të tillë të lartë sa ka arsye serioze për të besuar se një civil, nëse kthehet në rajonin në fjalë, thjesht për shkak të prezencës së tij, do përballej me rrezikun real të këtyre kërcënimeve.

-----  
 196 Shih (n 163).

Në rastin konkret, Këshilli i Shtetit e vlerësoi vendimin e CNDA-së si të mirë argumentuar dhe vërejtë se ajo kishte kompetenca të plota për të konstatuar ekzistencën e një klime dhune pa dallim që vinte si rezultat i një situatë konflikti të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm në lindje të Sri Lankës, ku aplikanti kishte jetuar. Këshilli i Shtetit nuk e konsideroi të gabuar ligjër-isht deduksionin e ZFMRPSH-së se niveli i lartë i dhunës pa dallim që mbi-zotëronte në atë zonë, e vinte aplikantin në një situatë ku rrezikonte realisht të ishte objekti i kërcënimeve serioze, të drejtpërdrejta dhe individuale. Kështu, Këshilli i Shtetit, refuzoi apelimin e ZFMRPSH.

### 3. Koment

Neni 15 (c) i Direktivës së Kualifikimit parashikon një nga tre llojet e “dëmtimit serioz” që mund t’i shkaktohet personit, duke i dhënë të drejtën për të kërkuar mbrojtje plotësuese. Ai është përcaktuar si “kërcënimin serioz e individual për jetën e personit apo të civilëve, për shkak të dhunës pa dallim në situatat e një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm”. Kjo dispozitë përfaqëson një përpjekje për të kodifikuar praktikën e Shteteve Anëtare të BE-së për garantimin e një lloji mbrojtjeje plotësuese për personat që largohen nga rajonet e përfshira në konflikte të armatosura, të cilët nuk i plotësojnë kushtet për të gëzuar mbrojtjen si refugjatë. Megjithatë, duhet mbajtur parasysh se, vendimmarrësit brenda BE-së, kur shqyrtojnë rastet e personave që largohen nga rajonet e përfshira në konflikte të armatosura, duhet së pari të vlerësojnë nëse ata kualifikohen për të përfituar mbrojtjen si refugjatë sipas nenit 1A (2) të Konventës për Refugjatët. Vetëm nëse këta nuk përfitojnë nga mbrojtja që gëzojnë refugjatët, mund të vlerësohet nëse kualifikohen për të pasur mbrojtje plotësuese ose, në rastin e Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës që nuk janë anëtare të BE-së, mbrojtje kundër keqtrajtimit të ndaluar nga neni 3 KEDNJ-së.

Ky vendim i Këshillit të Shtetit francez tregon dy aspekte që kanë të bëjnë me nenin 15 (c), të hasura vazhdimisht në praktikën gjyqësore të gjykatave dhe tribunaleve kombëtare në Shtetet Anëtare të BE-së. Aspekti i parë ka të bëjë me faktin se, që një person të përfitojë nga mbrojtja që garanton kjo dispozitë, mund të mos jetë e nevojshme të vërtetojë se është ai objekti direkt i dhunës aktuale apo kërcënimit për ushtrim dhune. Nëse niveli i dhunës në rajonin përkatës është jashtëzakonisht i lartë, aplikanti mund të përfitojë nga kjo mbrojtje edhe vetëm nëse është thjesht një civil i cili vjen nga ai rajon. Së dyti, gjykata franceze u shpreh se merret në konsideratë situata e konfliktit të armatosur në rajonin ku banon aplikanti; që një person të gëzojë mbrojtjen në bazë të nenit 15 (c) nuk ishte e nevojshme të tregohet ekzistenca e një konflikti të armatosur

në të gjithë vendin në fjalë (në këtë rast, Sri Lanka në vitin 2009).

Në bazë të së drejtës së BE-së të gjitha gjykatat dhe tribunalet kombëtare janë të detyruara të respektojnë vendimet paraprake të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJDBE). Deri më tani, GJDBE-ja ka dhënë dy vendime në bazë të nenit 15 (c): çështjet C-465/07, *Elgafaji* dhe *Diakité*<sup>197</sup>. Këto raste dhe qasja korrekte ndaj nenit 15 (c) ka qenë objekt i materialit të përgatitur nga një grup gjyqtarësh evropianë në kuadër të Zyrës Evropiane për Mbështetjen e Azilit (ZEMA), (seria e Zhvillimit Profesional “Neni 15(c) i Direktivës së Kualifikimi (2011/95 / EU ): Një Analizë Gjyqësore”, dhjetor 2014). Duke qenë se kjo analizë merr për bazë edhe jurisprudencën përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në veçanti atë lidhur me nenin 3 të KEDNJ-së, është gjithashtu me rëndësi për vendet evropiane jashtë BE-së që janë palë të KEDNJ-së. Ky material gjendet falas në internet.

Që prej vendimit të GJDBE-së në *rastin Elgafaji*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka zhvilluar disa kriteret të ngjashme të mbrojtjes në bazë të nenit 3 të KEDNJ-së për personat që largohen nga vendet apo zonat të përfshira në konflikte të armatosura me një nivel të lartë dhune. Në çështjen *LM dhe të Tjerët kundër Rusisë*<sup>198</sup>, GJEDNJ-ja ka vendosur se, në kuadër të raportimeve të fundit për gjendjen e rënduar në Siri, kthimi i detyruar në atë vend do të ishte në kundërshtim me nenin 3.

197 Shih vendimin e GJDBE-së C-465/07, *Meki Elgafaji dhe Noor Elgafaju k. Staatssecretaris van Justitie*, vendim [Dhoma e Madhe] i 17 shkurtit 2009, dhe C-285/12, *Aboubacar Diakité k. Commissaire general aux refugies et aux apatrides*, vendim i 30 janarit 2014, të përfshira të dyja në kapitullin për jurisprudencën e GJDBE-së.

198 *L.M. dhe të Tjerë k. Rusisë*, vendim i 15 tetorit 2015, nr. 40081/14.

*Mbrojtja plotësuese sipas Direktivës së Kualifikimit e tejkalon mbrojtjen e ofruar sipas nenit 1A(2) të Konventës së Refugjatëve të 1951 dhe parashikon një sërë të drejtash dhe përfitimesh minimale përtej atyre të garantuara në nenin 3 të KEDNJ-së.*

**Francë: Cour Nationale du Droit d'Asile (CNDA), 2 shkurt 2015, M.A., n° 14017393, C Libi**  
**Mbrojtja plotësuese**

## 1. Faktet kryesore

Kërkuesi, shtetas libian, depozitoi një kërkesë për azil në ZFMRPSH, e cila u refuzua. Në apel, Gjykata Kombëtare mbi të drejtën e Azilit (Cour Nationale du Droit d'Asile - CNDA vendosi, më 2 shkurt 2015, t'i jepte aplikantit mbrojtje plotësuese.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Azilkërkuesi është një shtetas libian, i cili deklaronte se ishte anëtar i fisit Tawargha dhe vinte nga rajoni i Ajdabiya Al Wahat, që ndodhej njëqind kilometra nga Bengazi. Ai pretendoi se për shkak të faktit se ishte pjesëtar i këtij fisi, kishte qenë në shënjestër të revolucionarëve pasi dyshohej se kishte qenë bashkëpunëtor i forcave të armatosura të Mouammar Gadafit. Ai argumentoi se ishte burgosur dhe keqtrajtuar. Gjykata (CNDA) konstatoi se deklaratat e tij nuk kishin detaje të mjaftueshme dhe shumë prej tyre ishin kontradiktore duke vendosur si rrjedhojë se ai nuk kualifikohej për të marrë statusin e refugjatit sipas Konventës së Refugjatëve të 1951.

Megjithatë, gjykata (CNDA) më tej vlerësoi nëse aplikanti mund të përfitonte mbrojtje plotësuese sipas nenit 15 (c) duke iu referuar vendimit të GJDBE-së në çështjen C-465/07, *Elgafaji* [2009] ECR I-921 dhe në çështjen C-285/12, *Diakite*<sup>199</sup>. Vendimi i CNDA iu referua së shumti informacionit mbi vendin e origjinës: ai iu referua rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (2014, 2011), një raporti nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, një deklaratë nga ana e Komisionerit të Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët për kthimin në Libi të cilat pranonin se situata atje ishte e paqëndrueshme dhe

199 C-465/07, *Meki Elgafaji dhe Noor Elgafaju v. Staatssecretaris van Justitie*, vendim [Dhoma e Madhe] i 17 shkurtit 2009, dhe C-285/12, *Aboubacar Diakité k. Commissaire general aux refugies et aux apatrides*, vendim i 30 janarit 2014, të përfshira të dyja në kapitullin për jurisprudencën e GJDBE-së.

ishite përkeqësuar në vitin 2014, si dhe karakterizohej nga dhuna pa dallim si pasojë e një konflikti të brendshëm të armatosur ndërmjet forcave të armatosura libiane dhe grupeve të armatosura të tilla si Ansar al-Sheriatit, sidomos në lindje të Libisë dhe në veçanti në Bengazi. Rrjedhimisht, aplikanti do të përballej me një kërcënim real, me karakter serioz dhe individual nëse kthehej në vendin e tij.

### **3. Koment**

Ky vendim tregon mënyrën se si gjykatat dhe tribunalet kombëtare në Shtetet Anëtare të BE-së filluan ta zbatonin nenin 15 (c) në mënyrë të tillë që zgjeronte objektin e tij përtej mbrojtjes e ofruar sipas nenit 1A (2) të Konventës së Refugjatëve të vitit 1951, pasi i përshtatej më specifikisht situatave të konfliktit të armatosur. Gjithashtu, vendimi francez ilustron faktin se në vendet në të cilat ka një numër të madh zonash apo rajonesh të prekura nga nivele të konsiderueshme të konfliktit të armatosur, do të jetë më e vështirë për të vlerësuar ekzistencën e një alternative të mundshme për mbrojtje të brendshme. Një person, i cili ka të drejtë për mbrojtje plotësuese, përfiton statusin e të mbrojturit, i cili në bazë të Direktivës së Kualifikimit sjell një sërë të drejtash dhe përfitimesh minimale, ndryshe nga neni 3 i KEDNJ-së, i cili vetëm garanton masa mbrojtëse kundër kthimit por nuk i jep aplikantit një status.

*Në rastin e një konflikti i armatosur të lokalizuar, me qëllim përcaktimin nëse një aplikant është i ekspozuar ndaj një rreziku të konsiderueshëm dhe specifik që rrjedh nga një konflikt i armatosur, në vlerësimin nëse plotësohen kriteret për të përfituar mbrojtje plotësuese, autoritetet duhet t'i referohen vendndodhjes së synuar të shtetasit të huaj pas kthimit.*

**Gjermani: Gjykata Federale Administrative (BVerwG), 31 janar 2013, 10 C 15.12**

## 1. Faktet kryesore

Aplikanti është një shtetas afgan. Ai mbërriti në Gjermani në shkurt 2009. Në mars të vitit 2010 kërkesa e tij për azil u refuzua. Në përgjigje të kërkesës së tij, Gjykata Administrative konstatoi se plotësoheshin kushtet për të përfituar mbrojtje plotësuese. Autoritetet u ankuan kundër këtij vendimi.

Në vendimin e saj të datës 27 prill 2012, Gjykata e Lartë Administrative vendosi në favor të autoriteteve se kushtet për mbrojtje plotësuese nuk plotësoheshin në bazë të nenit 15 (c) të Direktivës së Kualifikimit<sup>200</sup>. Duke qenë se nuk kishte asnjë konflikt të armatosur në Afganistan të përhapur në mbarë vendin, kushti i ekzistencës së një rreziku individual do të konsiderohej i përmbushur vetëm nëse konflikti shtrihet në zonën ku aplikanti do të shkonte konkretisht pas kthimit të tij. Ky do të ishte vendi në të cilin ai kishte jetuar së fundmi apo ku ishte i mundur kthimi i tij. Në rastin e azilkërkuesit në fjalë, nuk do të ishte rajoni i vendlindjes së tij, Helmand, por Kabuli ku ai qëndroi para se të largohej nga Afganistani. Në Kabul nuk kishte më asnjë konflikt të brendshëm të armatosur. Me përjashtim të disa sulmeve masive, situata e sigurisë në Kabul konsiderohej relativisht e qëndrueshme në tërësi dhe në mënyrë të konsiderueshme më e qetë krahasuar me rreth dhjetë vite më parë.

Azilkërkuesi apeloj në Gjykatën Federale Administrative.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkesa e aplikantit për rishikim u pranua duke u konsideruar si e mirë argumentuar. Në verifikimin e kushteve për përfitimin e mbrojtjes plotësuese, Gjykata e Lartë Administrative nuk iu referua rajonit të origjinës së azilkërkuesit, por rrethanave në Kabul si zona e vetme e mundshme e dëbimit në këtë moment. Megjithatë, në përgjithësi, në vlerësimin nëse kthimi sjell apo

200 Shih (n 163).

jo rrezik për personin, Qeveria, ashtu si dhe Gjykata, duhet t'i referohet rajonit të origjinës së personit dhe jo një rajoni që mund të zgjedhë në mënyrë të arsyeshme një vëzhgues i largët, apo një rajoni në të cilën shtetasi i huaj në fjalë do të donte të shkonte parë nga një këndvështrim subjektiv. Shmangia nga ky rregull nuk mund të arsyetohet me pretendimin se azilkërkuesi do të ekspozohet ndaj një rreziku në rajonin e origjinës, rrezik ky, ndaj të cilit Direktiva e Kualifikimit ka për qëllim ta mbrojtë duke i ofruar mbrojtje plotësuese. Kjo mund të kuptohet edhe nga karakteri sistematik i ndalimit të dëbimeve sipas së drejtës së BE-së në dispozitat lidhur me mbrojtjen e brendshme (neni 8 i Direktivës Kualifikimit)<sup>201</sup>. Nëse për shkak të rreziqeve me të cilat mund të përballet shtetasi i huaj në rajonin e origjinës, mund të merret për referencë një rajon tjetër, duke respektuar gjithashtu kufizimet e nenit 8 të Direktivës së Kualifikimit. Koncepti i “zonës aktuale ku synohet kthimi”, nuk është pra një koncept thjesht empirik, sipas së cilit rajoni më i mundshëm ose subjektivisht i dëshirueshëm për t'u kthyer duhet të merret në konsideratë.

Mos marrja në konsideratë e rajonit të origjinës nuk mund të justifikohet me faktin se azilkërkuesi ka humbur lidhjen personale me rajonin e tij të origjinës, si rezultat i një konflikti të armatosur, në të cilin anëtarët e familjes janë vrarë ose janë larguar nga ai rajoni. Për aq sa rënia e peshës së lidhjeve subjektive të aplikuesit me rajonin e origjinës është e justifikuar në rrethana të cilat janë pasojë e drejtpërdrejtë e konfliktit të armatosur (p.sh. dëmtimi i infrastrukturës sociale dhe ekonomike, përkeqësimi i vazhdueshëm i situatës me furnizimet) dhe ngurrimi për t'u kthyer në rajonin e origjinës për shkak të kushteve të këqija të jetesës dhe mungesës së perspektivës për të ardhmen, këto aspekte konsiderohen të rëndësishme për qëllimet e mbrojtjes. Megjithatë, rajoni i origjinës nuk është, ose nuk është më pikë referimi, nëse azilkërkuesi tashmë ishte zhvendosur, pavarësisht rrethanave që mund ta kishin shtyrë për të marrë një vendim të tillë, në një rajon tjetër të vendit për të jetuar atje për një periudhë të pacaktuar, para largimit të tij. Pra, rajoni i origjinës nuk mund të merret si pikë referimi për shqyrtimin e mbrojtjes plotësuese, në rastin kur personi largohet vullnetarisht prej tij drejt një rajoni tjetër të vendit. Megjithatë, Gjykata Federale Administrative nuk mund të marrë një vendim përfundimtar në këtë drejtim dhe çështja duhet t'i kthehet përsëri për shqyrtim Gjykatës së Lartë Administrative.

Kërkesa e azilkërkuesit u pranua.

201 Ibid.

### 3. Koment

Ky vendim i Gjykatës Administrative Federale Gjermane thekson rëndësinë, në rastet në të cilat azilkërkuesit e bazojnë kërkesën e tyre për marrjen e statusit të refugjatit apo për mbrojtje plotësuese në Direktivën e Kualifikimit, e përcaktimit saktësisht të zonës së vendbanimit të tij. Në vendet e prekur nga konflikti i armatosur, situata mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme nga zona në zonë. Kështu konflikti i armatosur mund të jetë i përqendruar në disa zona por jo në disa të tjera, ose mund të kufizohet vetëm në një zonë të vendit. Në qoftë se personi është nga një zonë relativisht e sigurt, kryesisht e paprekur nga konflikti i armatosura, është e vështirë që kërkesa e tij të pranohet.

Për Gjykatën Federale Administrative Gjermane, testi i vendit që do të konsiderohet si zona e vendbanimit të një personi është në thelb një test faktik, i cili merr për bazë vendin ku është rritur personi. Në qoftë se ai është zhvendosur në një zonë tjetër para se të largohet nga Shteti, pa qenë i detyruar ta bëjë këtë për shkak të një konflikti të armatosur, vendbanimi i tij duhet të konsiderohet kjo zonë e re. Ky është një ilustrim i mirë i qasjes faktike të gjykatave dhe tribunaleve kryesore evropiane në çështje të tilla.

Edhe pse qeveria mund të argumentojë se një azilkërkues nuk është në rrezik pasi nëse kthehet në vendin e tij të banimit nuk do të përballë me një rrezik real dëmtimi të rëndë (sepse, për shembull, ai është një rajon ku nuk ka një konflikt të armatosur), gjithsesi është e nevojshme për një gjykatë ose tribunal (kur kundërshtohet gjyqësisht) të bindet se azilkërkuesi mund të ketë akses në zonën e banimit të tij. Në rastin konkret, zona që konsiderohej e sigurt ishte Kabuli, vendi ku ktheheshin nga Gjermania shtetasit e Afganistanit. Por vendbanimi i azilkërkuesit në rastin në fjalë (Helmand) nuk ishte një zonë e sigurt. Pra, ai mund të kthehej vetëm nëse pritej, në mënyrë të arsyeshme, që ai të qëndronte në Kabul (shih nenin 8 të Direktivës së Kualifikimit). Këto fakte nuk ishin konstatuar nga Gjykata e Lartë Administrative, prandaj çështja iu dërguar përsëri kësaj Gjykate.

Në bazë të së drejtës së BE-së të gjitha gjykatat dhe tribunalet kombëtare janë të detyruara të respektojnë vendimet paraprake të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJDBE). Deri më tani, GJDBE-ja ka dhënë dy vendime në bazë të nenit 15 (c): çështjet C-465/07, Elgafaji dhe Diakité<sup>202</sup>. Këto raste dhe

202 Shih vendimin e GJDBE-së C-465/07, Meki Elgafaji dhe Noor Elgafaju k. Staatssecretaris van Justitie, vendim [Dhoma e Madhe] i 17 shkurtit 2009, dhe C-285/12, Aboubacar Diakité k. Commissaire general aux refuges et aux apatrides, vendim i



qasja korrekte ndaj nenit 15 (c) ka qenë objekt i materialit të përgatitur nga një grup gjyqtarësh evropianë në kuadër të Zyrës Evropiane për Mbështetjen e Azilit (ZEMA), (seria e Zhvillimit Profesional “Neni 15(c) i Direktivës së Kualifikimi (2011/95 / EU ): Një Analizë Gjyqësore”, dhjetor 2014). Duke qenë se kjo analizë merr për bazë edhe jurisprudencën përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në veçanti atë lidhur me nenin 3 të KEDNJ-së, është gjithashtu me rëndësi për vendet evropiane jashtë BE-së që janë palë të KEDNJ-së. Ky material gjendet falas në internet.

---

30 janarit 2014, të përfshira të dyja në kapitullin për jurisprudencën e GJDBE-së.

## Alternativa e “mbrojtjes së brendshme”

### Direktiva e Këshillit nr. 2004/83/EC e 29 prillit 2004 (Direktiva e Kualifikimit), neni 8

*Vendimmarrësit, në vlerësimin nëse një personi mund t'i jepet mbrojtje e brendshme për të shmangur persekutimin, duhet të marrin në konsideratë edhe faktin nëse do të ishte e paarsyeshme ose tepër e ashpër të pretendohet që personi të zhvendoset në një pjesë tjetër të Shtetit të tyre.*

### Mbretëria e Bashkuar: Januzi k. Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme & të Tjerë [2006] UKHL 5 15 shkurt 2006

#### 1. Faktet kryesore

Të katër azilkërkuesve iu mohua statusi i refugjatit pasi një rajon i Shtetit të tyre konsiderohej i sigurt dhe nuk kishte baza për ekzistencën e frikës nga persekutimi si dhe nuk ishte e paarsyeshme apo shumë e vështirë për ta që të zhvendoseshin atje. Azilkërkuesi i parë, Z. Januzi, ishte një shqiptar i Kosovës nga Mitrovica, i cili ishte larguar si pasojë e spastrimi etnik serb. Ai u largua për në Mbretërinë e Bashkuar dhe kërkoi azil. Sekretari i Shtetit i ngarkuar me detyrën e vlerësimit të kërkesës për azil pohoi se aplikanti mund të zhvendosej për të jetuar në një qytet tjetër në Kosovë, në Prishtinë. Azilkërkuesi kundërshtoi, kryesisht për arsye mjekësore që lidheshin me përvojën e tij të persekutimit, duke pretenduar se do të ishte tepër e vështirë për të që të vendosej atje. Tre azilkërkuesit e tjerë, Z. Hamid, Z. Gaafar dhe Z. Mohammed, ishin të gjithë afrikanë me ngjyrë nga Darfuri, në Sudan, të cilët kishin vuajtur persekutimin apo rrezikonin të persekutoheshin nga grupet bandite arabe, të cilat qeveria e Khartoumit i inkurajonte, bashkëpunonte me to apo nuk i ndalonte. Kërkesat e tyre për njohje si refugjatë nuk u pranuan me arsyetimin se ata, në mënyrë të arsyeshme dhe pa vështirësi të tepërta, mund të vendoseshin në Khartum. Ata të gjithë i trembeshin trajtimit diskriminues e persekutimit në Khartum dhe pretenduan se zhvendosja e tyre atje do të ishte e paarsyeshmë dhe tepër e vështirë.

#### 2. Vendimi i Gjykatës

Dhoma e Lordëve e hodhi poshtë ankimin e Z. Januz dhe pranoi ankesat e tjera duke i kthyer për shqyrtim në Tribunalin e Azilit dhe Imigracionit me arsye-

timin se vendimi nuk ishte i mirë arsyetuar.

Dhoma e Lordëve mbajti qëndrimin vijues në lidhje me vlerësimin e zhvendosjes së azilkërkuesve brenda vendit: “vendimmarrësi, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse që kanë të bëjnë me azilkërkuesin dhe vendin e tij të origjinës, duhet të vendosë nëse është e arsyeshme të pritët nga ai të zhvendoset në një rajon tjetër të vendit apo kjo do të ishte tepër e vështirë për të “.

Pika kryesore të debatit kishin të bënin me standardet të cilat duhet të merreshin parasysh kur vlerësohej nëse azilkërkuesi mundej, në mënyrë të arsyeshme, të vendosej në një pjesë tjetër të vendit të tyre: konkretisht, nëse kushtet në zonën ku do të vendosej azilkërkuesi plotësonin normat themelore të të drejtave civile, politike dhe social-ekonomike; nëse kishte një standard ndërkombëtar poshtë të cilit do të ishte e paarsyeshme të pretendohet që aplikanti të jetonte atje; dhe nëse duhej bërë një krahasim ndërmjet standardeve në rajonin ku mendohej të dërgohej aplikanti dhe atij të origjinës.

Dhoma e Lordëve konstatoi se Konventa e vitit 1951 e Kombeve të Bashkuara në lidhje me Statusin e Refugjatëve, e ndryshuar nga Protokollin e vitit 1967 (Konventa për Refugjatët) nuk vendoste standarde në lidhje me rrethanat në të cilat zhvendosja e azilkërkuesit në një rajon tjetër të vendit të tij, të ndryshëm nga ai i origjinës, do të ishte e arsyeshme. Për këtë arsye u morën në analizë një gamë e gjerë burimesh të së drejtës ndërkombëtare.

Ajo vendosi se çështja nëse do të ishte tepër e vështirë për azilkërkuesin që të vendosej në një rajon tjetër të vendit të shtetësisë së tij, nuk do të gjykohej duke marrë parasysh nëse cilësia e jetës në vendin ku do të vendosej respektonte të drejtat themelore civile, politike dhe social-ekonomike të njeriut për arsyet e mëposhtme.

Së pari, nga Konventa për Refugjatët nuk mund të dilte një interpretim i tillë. Gjithashtu, kjo Konventë nuk ka për qëllim përcaktimin e të drejtave në vendin e kombësisë së azilkërkuesit, i cili mund të përbëjë një vend qëndrimi të sigurt nga persekutimi.

Së dyti, edhe pse në preambul Konventa për Refugjatët i referohet Kartës së Kombeve të Bashkuara të 1945 dhe Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, qëllimi i Konventës ka të bëjë me trajtimin e barabartë të refugjatëve në mënyrë që atyre t'u garantohet një mbrojtje efektive në vendin e strehimit. Përveç mbrojtjes nga persekutimi, Konventa nuk trajton nivelin e të drejtave

të njohura në vendin e kombësisë të aplikantit.

Së treti, neni 8 i Direktivës së Kualifikimit<sup>203</sup> nuk ka asnjë referencë për standardet ndërkombëtare dhe përmban vetëm një dispozitë ku parashikon se mbrojtja e brendshme mund t'i ofrohet një azilkërkuesi kur ai mund të zhvendosej në një rajon të vendit të tij, pa rrezikuar të persekutohej apo të vuante dëme të rënda dhe, në mënyrë të arsyeshme, mund të pretendohet që ai të zhvendosej atje. Gjithashtu, dispozita parashikonte se në momentin e marrjes së vendimit duhet të mbahen në konsideratë “rrethanat e përgjithshme që mbizotërojnë në atë pjesë të vendit dhe rrethanat personale të azilkërkuesit”.

Së katërti, nuk ka pasur, në asnjë rast, një praktikë ndërkombëtare apo mendim profesional dhe akademik të unifikuar, që të mund të themi që si rrjedhojë janë krijuar norma zakonore të së drejtës ndërkombëtare lidhur me këtë çështje.

Së fundmi, ajo theksoi se miratimi i një rregulli të tillë do të sillte pasoja të padëshiruara dhe jo normale të Konventës për Refugjatët. Si shembull mund të merret rasti i një individi i cili largohet për t'i shpëtuar persekutimit nga një vend që është shumë i varfër, me privime të jashtëzakonshme dhe ku të drejtat e njeriut respektohen në nivele shumë të ulëta. Nëse atij do t'i njihej statusi i refugjatit për shkak se rrethanat në zonën brenda vendit ku mund të vendosej ai përbënin thjesht “disavantazhe të të jetuarit në një vend të varfër dhe të prapambetur” (por jo aq të rënda sa të përbënin persekutim), atëherë ai rastësisht do të përfitonte nga Konventa e Refugjatëve për t'i shpëtuar privimit nga të drejtat e tij, situatë nga e cila vuanin të gjithë në vendin e tij.

Dhoma e Lordëve sugjeroi se Udhëzimet e ZKLBKBR-së mbi Mbrojtjen Ndërkombëtare (korrik 2003) mund të konsideroheshin si një pikë fillimi për të përcaktuar se çfarë përbënte zhvendosje të paarsyeshme ose padrejtësisht të ashpër brenda vendit. Udhëzimet i referohen respektimit të të drejtave themelore të njeriut, në veçanti të drejtave të paderogueshme, mbijetesës ekonomike, përfshirë çështje të aksesit në territor, mbrojtjen e burimeve, lidhjet familjare apo një rrjet social të sigurt, vështirësitë kulturore apo të tjera të parëndësishme, apo kushtet shumë të vështira dhe kur vlerësohet e dobishme të përqendrohet vëmendja në standardet ekzistuese në vendin e shtetësisë.

Kështu, u vendos që “fjalët ‘tepër të ashpra’ përcaktonin standardin që një zhvendosje e brendshme të konsiderohet si e paarsyeshme. Nëse paditësi mund

203 Shih n 1.

të bënte një jetë relativisht normale, duke parë në përgjithësi kushtet në vendin e tij të shtetësisë dhe në qoftë se ai mund të aksesonte zonat ku ka më pak konflikte armiqësore pa vështirësi apo mundim të madh, nuk do të ishte e paarsyeshme të pretendohet që ai të zhvendosej atje.”

Bazuar në këto parime, Dhoma e Lordëve arriti në përfundimin se situata në Kosovë ishte mjaft e qëndrueshme që zhvendosja diku tjetër brenda vendit të konsiderohej një alternative realiste për një person të etnisë shqiptare i cili ishte i ekspozuar ndaj persekutimit në një rajon ku etniteti i tij ishte në minorancë. Dhoma e Lordëve rrëzoi ankesën e Januzit.

Aplikantët sudanezë parashtruan një argument të dytë duke pretenduar se, për shkak se persekutimi vinte nga shteti, nuk ishte e mundur apo e arsyeshme zhvendosja e sigurt brenda vendit pasi presupozohej që shteti vepronte në të gjithë territorin e vendit. Megjithatë, një supozim i tillë është refuzuar pasi persekutimi mund të vijë nga një shumëllojshmëri njerëzish me shkallë të ndryshme afërsie apo llogaridhënie kundrejt vetë shtetit. Dhoma e Lordëve preferonte “të merrte parasysh të gjitha rrethanat relevante që kishin të bënin me paditësit dhe vendin e tij të origjinës” kur të analizonte mundësinë e zhvendosjes brenda vendit. U pranua se sa më e afërt të ishte lidhja e persekutorit me shtetin dhe sa më i madh ishte niveli i kontrollit të ushtruar nga shteti mbi persekutorin, aq më e madhe ishte mundësia që paditësi të rrezikonte të dëmtohej apo të ishte veçanërisht i pambrojtur në një pjesë tjetër të vendit.

Duke i konsideruar vendimet jo mjaftueshmërisht të arsyetura, Dhoma e Lordëve i pranoi tre ankesat e tjera dhe i ktheu për shqyrtim të mëtejshëm nga Tribunali i Azilit dhe Imigracionit.

### 3. Koment

Vendimi i Dhomës së Lordëve në çështjen *Januzi* përforcon ekzistencën e një pranimi të gjerë në të drejtën ndërkombëtare dhe evropiane të refugjatëve se një person nuk mund të konsiderohet refugjat sipas përkufizimit që i bën neni 1A (2) thjesht për shkak të ekzistencës së rrezikut real të persekutimit në rajonin ku ai banonte. Gjithashtu ai duhet të tregojë se nuk ekziston mundësia e arsyeshme e zhvendosjes së tij në një pjesë tjetër të vendit - tashmë Direktiva e Kualifikimit e quan alternativa e «mbrojtjes së brendshme». Në rastin e *Januzit*, Dhoma e Lordëve pohoi se, për të treguar se ekziston një alternativë e mundshme e zhvendosjes së personit në një rajon tjetër brenda atij shteti, duhet të vërtetohet se ai rajon është (a) i sigurt (pra nuk ka një rrezik real perse-

kutimi) dhe (b) që është e arsyeshme të pretendohet që personi të zhvendosej atje (që do të thotë se nuk do të ishte tepër e vështirë që personi të banonte atje).

Testi i arsyeshmërisë është kritikuar si shumë subjektiv në vetvete. Vendimi në rastin e *Januzit* e përshkroi testin si “shumë i përgjithshëm dhe linte jashtë vlerësimit shumë pak elementë përveç standardeve të mbrojtjes së të drejtave të azilkërkuarit në vendin ku kërkonte të merrte statusin e refugjatit”, edhe pse vendimi më i hershëm i Dhomës së Lordëve në rastin *AH(Sudan)* e përshkroi atë si “strikt”.

Neni 8 i Direktivës së Kualifikimit parashikon se, si pjesë të vlerësimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, Shtetet Anëtare mund të vërejnë që një aplikant nuk ka nevojë për mbrojtje ndërkombëtare në qoftë se në një pjesë të vendit të origjinës nuk ka asnjë frikë të mirë-bazuar persekutimi ose rrezik real të vuajtjes së një dëmi serioz dhe mund të pretendohet në mënyrë të arsyeshme që azilkërkuari të qëndrojë në atë pjesë të vendit. Në kuadër të nenit 8 të Direktivës së Kualifikimit (të ndryshuar) duket se standardet që do të zbatohen për të vendosur mbi arsyeshmërinë duhet të jenë standardet e të drejtave të njeriut, duke qenë se ato janë standardet e përdorura për të përcaktuar “aktet e persekutimit” në nenin 9 të kësaj Direktive. Megjithatë, në rastin *Januzi*, Lordët rekomanduan që vendimmarrësit t’u referohen Udhëzimeve të ZKLKBR-së mbi Mbrojtjen Ndërkombëtare nr. 4 “Zhvendosja e brendshme ose Alternativa e Zhvendosjes” në kontekstin e nenit 1A (2) të Konventës së vitit 1951 dhe/ose Protokollit të vitit 1967 lidhur me Statusin e Refugjatëve”, të cilat iu referohen “standardeve themelore të të drejtave të njeriut, duke përfshirë në mënyrë të veçantë të drejtat e paderogueshme” si kryesore, por jo të vetmet faktorë të rëndësishëm.

Është e rëndësishme të theksohet se neni 8 i Direktivës së Kualifikimit, e ndryshuar, ka shtuar kriteret që duhen përmbushur në mënyrë që një azilkërkuar të përfitojë nga mbrojtja e brendshme. Sipas nenit 8(1)(b), jo vetëm që zhvendosja e aplikantit në një rajon tjetër brenda vendit duhet të jetë (a) e sigurt dhe (b) e arsyeshme; por gjithashtu është e nevojshme të tregohet se azilkërkuari: c) ka akses në mjetet mbrojtëse; d) mundet ligjërisht dhe i sigurt të udhëtojë ose të lejohet të hyjë në atë pjesë të vendit; dhe e) mundet në mënyrë të arsyeshme të pretendohet që të zhvendoset atje.

## Viktimat e trafikimit si një grup i caktuar shoqëror

### Konventa e Refugjatëve e 1951, neni 1A (2) dhe Direktiva 2011/95/EU, 13 dhjetor 2011 (Direktiva e Kualifikimit - e ndryshuar), neni 10

*Viktimat e trafikimit kanë një të kaluar të njëjtë dhe identitet të veçantë, çka i bën ata të konsiderohen 'grup i caktuar shoqëror' sipas kuptimit që i jep Konventës së Refugjatëve të 1951.*

**Francë: Cour Nationale du Droit d'Asile, 24 mars 2015, n° 10012810**

#### 1. Faktet kryesore

Çështja ka të bëjë me një shtetase nigeriane nga shteti Edo e cila u detyrua të prostituonte pasi u trafikua në Francë. Më vonë, ajo raportoi në polici emrat e atyre të përfshirë në rrjetin e prostitucionit dhe aplikoi për azil. Azilkërkuesja kishte frikë se nëse kthehej, do të dyshohej për prostitucion, i cili ishte i jashtëligjshëm në Nigeri. Ajo më tej pohoi se do të izolohej nga rrjeti i saj social dhe familjar, pasi kishte shkelur kontratën sociale duke qenë se nuk kishte paguar borxhin për udhëtimin e saj në Evropë dhe se do të shihej si i mallkuar nga komuniteti sipas një ceremonie rituale në Nigeri, e cila vuloste përkatësinë e saj në rrjetin e trafikimit.

Zyra Franceze për Mbrojtjen e Refugjatëve dhe Personave pa Shtetësi (ZFM-RPSH) vendosi se, edhe pse viktimat e trafikimit nuk do të pranoheshin nga shoqëria nigeriane, duke pasur parasysh se shumica e femrave viktimat, vazhdonin të ishin prostituta edhe më vonë në Evropë, nuk ishte e mjaftueshme që të përbënin një grup të veçantë shoqëror në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara e vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve, e ndryshuar nga Protokollin e vitit 1967 (Konventa për Refugjatët) dhe Direktivën e Kualifikimit.<sup>204</sup> Për më tepër, ZFM-RPSH-ja vërejti se nuk kishte informacion që sugjeronte se viktimat e trafikimit bëheshin subjekt i persekutimit nëse ktheheshin në Nigeri dhe për pasojë nuk e pranoi kërkesën për azil të aplikantes.

Ky argument u hodh poshtë nga Gjykata Kombëtar mbi të Drejtën e Azilit (CNDA) në vendimin e datës 29 prill 2011. ZFM-RPSH apeloi kundër këtij vendimi në Këshillin e Shtetit. Këshilli i Shtetit e rrëzoi vendimin e CNDA-së, duke vendosur se kjo e fundit duhet të hetonte nëse, përtej rrjetit të prostitucionit nga

204 Shih n 1.

i cili ato rrezikoheshin, shoqëria ose institucionet që i rrethonin i perceptonin ish viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore si një grup që kishin një identitet të veçantë dhe që përbënin grup shoqëror brenda kuptimit të Konventës së Refugjatëve të 1951. Rasti u dërgua përsëri në CNDA për rishqyrtim.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Në pajtim me vendimin e Këshillit të Shtetit, CNDA, u përqendrua kryesisht në perceptimin e komunitetit ndaj viktimave të trafikimit në vlerësimin nëse përbënin një grup të veçantë shoqëror. CNDA shqyrtoi nenin 10 të Direktivës së Kualifikimit, të ndryshuar, (2011/95/EU) dhe vuri në dukje se një grup social përbëhet nga persona të cilët kanë një karakteristikë të përbashkët që prej lindjes ose të kaluar të përbashkët, që nuk mund të ndryshohet. Si rezultat i kësaj, shoqëria e percepton grupin sikur është ndryshe nga pjesa tjetër e shoqërisë. Gjithashtu, CNDA theksoi se femrat nga Nigeria i nënshtrohen një rituali të quajtur “juju”, gjatë të cilit u bëheshin shenja në trup dhe betoheshin për punën që do të bënin duke shënuar kështu hyrjen e tyre në rrjetin e trafikimit. Për më tepër, vitet e shfrytëzimit në Evropë, së bashku me kërcënimet që pasonin nëse ato përpiqeshin të largoheshin nga rrjeti, e bënë CNDA të vendoste se këto gra kanë një histori të përbashkët që nuk mund të ndryshohet.

Për më tepër, Gjykata vërejti se raportime të besueshme ndërkombëtare dokumentonin se kur femrat e reja nigeriane të cilat ktheheshin në shtëpi nga Evropa pa para, dyshoheshin menjëherë për prostitucion, çka perceptohej shumë keq nga komunitetet lokale. Ky perceptim çon në izolim social. CNDA vazhdoi duke konkluduar se viktimat femra të trafikimit të qenieve njerëzore nga shteti i Edos i bashkon një identitet i veçantë, të cilin ato nuk mund ta ndryshojnë e për rrjedhojë femra të tilla duhet të konsiderohen si një grup i veçantë shoqëror, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe evropiane. CNDA iu referua praktikës gjyqësore të Australisë, Kanadasë, Zelandës së Re dhe Britanisë së Madhe, të cilat i konsiderojnë viktimat e trafikimit grup i veçantë shoqëror.

Gjithashtu, CNDA diskutoi ‘borxhin’ që i detyrohej azilkërkesja një kulti shumë të respektuar në komunitet. Për shkak të denoncimit të rrjetit të trafikimit për prostitucion, kulti e kishte kërcënuar me integritetin e saj fizik si dhe me diskriminim nëse kthehej. Duke theksuar se aktorë të tillë janë shumë të fuqishëm dhe zbatojnë ligje zakonore në rajon, CNDA vuri në dukje mungesën e mjeteve mbrojtëse efektive administrative dhe gjyqësore, të cilat pengonin çdo hetim të vërtetë në lidhje me aktivitetet kriminale, të tilla si trafikimi. Disa



raporte lokale u cituan nga CNDA për të theksuar mungesën e ligjeve efektive kundër trafikimit, skllavërisë, ekzistencën e një sistemi gjyqësor të korruptuar në Nigeri si dhe zbatimin e zakoneve të “drejtësisë tradicionale” në shtetin e Edo.

Rrjedhimisht, për shkak të pjesëmarrjes të azilkërkueses në një grup të veçantë shoqëror dhe veprimeve të saj kundër rrjetit të trafikimit, CNDA rrëzoi vendimin e ZFMRPSH-së dhe i njohu aplikantes statusin e refugjatit.

Para CNDA, në vitin 2015, ZFMRPSH-ja pranoi ekzistencën e një grupi të veçantë shoqëror, por argumentoi se kërcënimet e pretenduara nuk përbënin persekutim pasi nuk arrinin pragun e ashpërsisë të kërkuar nga Konventa e Refugjatëve të vitit 1951. CNDA nuk e pranoi këtë argument. Duke iu referuar dispozitave të nenit 9 të Direktivës së Kualifikimit, ajo vlerësoi se viktimat e trafikimit përballen me një sërë veprimesh kundër tyre (hakmarrje, kërcënime, fyerje, izolim etj.), të cilat përbënin persekutim.

### 3. Koment

Në mënyrë që të kualifikohet si refugjat sipas nenit 1A (2) të Konventës së vitit 1951, një person duhet të tregojë një frikë të bazuar nga persekutimi për arsye të përcaktuara në Konventë (racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të veçantë shoqëror ose mendimit politik). Edhe në qoftë se një person mund të tregojë një frikë të bazuar nga persekutimi, atij nuk mund t’i njihet statusi i refugjatit nëse nuk është në gjendje të tregojë se kjo ishte për shkak të një ose më shumë prej këtyre pesë arsyeve të persekutimit. Testi “për arsye të” nuk është shumë kërkuar; është e mjaftueshme të ekzistojë një lidhje ndërmjet akteve të persekutimit dhe njërës ose disa nga arsyet. Zakonisht një vendimarrës nuk vendos nëse një azilkërkues ka apo jo një arsye sipas Konventës derisa ai të konstatojë që azilkërkuesi ka treguar një frikë të bazuar nga persekutimi.

Ky vendim i CNDA është në përputhje me praktikën e gjykatave dhe tribunaleve të tjera në Evropë, të cilat po ashtu i konsiderojnë viktimat e trafikimit (në këtë rast gratë që kanë qenë të trafikuar për qëllime prostitucioni) “grup i veçantë shoqëror” me qëllim që të tregohet se ka një arsye apo shkak për përndjekjen e tyre të pretenduar në bazë të Konventës së Refugjatëve të vitit 1951.

Gjithashtu, vendimi thekson rëndësinë, për gjykatën apo tribunalin kombëtar, të marrjes në konsideratë të mundësisë që një person i trafikuar të “ri-trafiko-

het” apo t’i nënshtrohet dëmtimeve të rënda në qoftë se kthehet në zonën e tyre. Në çështjen në fjalë, për gjykatën franceze ishte i mjaftueshëm fakti që azilkëruesja do të përballej me një rrezik real të një dëmtimi të tillë në rajonin e Nigerisë, që ishte vendbanimi i saj (shteti Edo).

Megjithatë duhet thënë, se në kohën kur ky vendim është marrë, gjykata franceze ishte e vetmja në Evropë që nuk aplikonte alternativën e mbrojtjes së brendshme. Në shumicën e vendeve të tjera evropiane, një aplikant nuk do të mund të merrte statusin e refugjatit vetëm duke treguar që në rajonin ku ai banonte përballej me një rrezik real të lëndimit të rëndë; ata duhet të tregojnë gjithashtu se nuk ka rajone të tjera të vendit në të cilat ata mund të zhvendoseshin të sigurt ose pa vështirësi të tepërta. Për Shtetet Anëtare të BE-së, neni 8 i Direktivës së Kualifikimit përcakton kriteret përkatëse. Kështu, në qoftë se nuk ka prova që banda apo agjentë në vendin e origjinës që kanë trafikuan personin, mund ta ndjekin atë edhe në një pjesë tjetër të vendit, ku ajo mund të zhvendosej, do të ishte e vështirë që t’i njëhej statusi i refugjatit. Megjithatë, në rrethana të veçanta, për shembull në rastet veçanërisht vulnerabel kur një grua në një vend afrikan zhvendoset në një rajon tjetër nga ai i vendbanimit të saj, larg nga jeta shoqërore në fshatin, fisin, grupin e saj etnik, pa ndihmën e të afërmeve, mund të thuhet se, edhe nëse ishte e sigurt për të që të zhvendosej brenda vendit, nuk do të ishte e arsyeshme të pretendohet prej saj një gjë e tillë.

Për Shtetet Anëtare të BE-së që aplikojnë alternativën e mbrojtjes së brendshme kërkesat përkatëse ligjore përcaktohen në nenin 8 të Direktivës së Kualifikimit. Formulimi i kësaj dispozite, sidomos në versionin e ndryshuar të saj, është modeluar sipas jurisprudencës së nenit 3 të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, e cila gjithashtu aplikon testin e alternativës të zhvendosjes së brendshme. Për këtë arsye, neni 8 i Direktivës së Kualifikimit dhe vendimet e marra në përputhje me të mund të jenë një udhëzues i dobishëm për gjykatat dhe tribunalet e vendeve evropiane jashtë BE-së. Shumë shtete në Evropë janë gjithashtu palë në Konventën e Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Seria e Traktateve të Këshillit të Evropës nr. 197, 16 maj 2005, e cila përmban një sërë masash mbrojtjeje për viktimat e trafikimit.

## Vlerësimi i besueshmërisë së dëshmisë në kërkesat për azil

**Direktiva e Këshillit nr. 2004/83/EC, 29 prill 2004 (Direktiva e Kualifikimit), neni 4 dhe Direktiva nr. 2013/32/EU e 26 qershorit 2013 (Direktiva mbi Procedurat e Azilit, e ndryshuar), neni 46**

*Azilkërkuesi është përgjegjës për të provuar faktet në lidhje me kërkesën e tij për azil, ndërsa detyrimi për të përcaktuar dhe vlerësuar të gjitha faktet përkatëse është përgjegjësi e përbashkët e azilkërkuesit dhe gjykatës që shqyrton kërkesën e azilit.*

**Suedia: Gjykata e Apelit për Emigracionin, UM 122-6  
18 shtator 2006**

### 1. Faktet kryesore

Azilkërkuesi deklaroi se që nga viti 1998 ishte marrë shumë herë në pyetje nga shërbimi i inteligjencës së policisë egjiptiane, për të dhënë informacion mbi aktivitetet politike të vëllait të tij. Gjithashtu, ai deklaroi se gjatë marrjes në pyetje ishte rrahur dhe torturuar me goditje elektrike. Në vitin 2001 dhe 2002, azilkërkuesi ishte arrestuar sa herë që në Egjipt kishte trazira. Ai iu referua edhe një vendimi të Gjykatës së Sigurimit të Shtetit në vitin 2003. Kjo gjykatë e kishte dënuar azilkërkuesin, së bashku me gjashtë persona të tjerë, me tre vjet burgim me akuzën, ndër të tjera, të themelimit të një partie të paligjshme.

Bordi Suedez i Emigracionit refuzoi kërkesën për azil me arsyetimin se kishte boshllëqe në rrëfimin e azilkërkuesit të cilat e bënin jo shumë të besueshëm atë. Ky qëndrim u bazua në dyshimet në lidhje me pretendimin e azilkërkuesit se ishte marrë në pyetje për shkak të aktiviteteve politike të vëllait të tij, kur ai vetë, sipas deklaratës së tij, nuk ishte i angazhuar në aktivitete të tilla në Egjipt dhe kishte dhënë përshtypjen që nuk kishte shumë informacione rreth aktiviteteve të vëllait të tij. Gjithashtu, Bordi i Emigracionit theksoi se azilkërkuesi nuk kishte pasur probleme të merrte pasaportë dhe kartë identiteti në vitin 2002, pavarësisht faktit të pretenduar nga kërkuesi se vëmendja e qeverisë ndaj tij ishte rritur në vitin 2001 dhe 2002. Bordi i Emigracionit, pohoi se fakti që të bën përshtypje është edhe arratisja e pretenduar e azilkërkuesit nga një spital ku mbahej pasi ishte arrestuar dhe burgosur për prodhim pamfletesh në vitin 2002. Kontradiktor ishte edhe informacioni se kur azilkërkuesi mori dijeni për vendimin e gjykatës dhe për dënimin e dhënë ndaj tij. Bordi i Emigracionit konstatoi si të çuditshëm faktin që azilkërkuesi nuk u përpoq të njihej

me përmbajtjen e vendimit shumë më herët, para se të udhëtonte nga Libia për në Suedi dhe gjithashtu në hetimin fillestar ai nuk e përmendi faktin se kishte kërkuar t'i dërgohej vendimi. Vetëm në parashtrimet avokatit, përmendej një fakt i tillë. Për më tepër, Bordi i Emigracionit deklaroi se azilkërkuesi nuk kishte ndihmuar autoritetet për të përcaktuar identitetin e tij duke kontaktuar familjen e tij në Egjipt dhe duke u kërkuar atyre t'i dërgoni pasaportën dhe kartën e identiteti. Bordi i Emigracionit i kërkoi Ambasadës Suedeze në Kajro verifikimin e vendimit të dorëzuar nga azilkërkuesi dhe ata iu përgjigjën se kopja dukej e rregullt.

Vlerësimi i Bordit të Emigracionit ishte se azilkërkuesi ishte përpjekur qëllimisht të fshehte informacione që ishin thelbësore për vlerësimin e rastit dhe vuri në pikëpyetje nëse ai me të vërtetë ishte personi që rezultonte në vendim. Azilkërkuesi iu drejtua Gjykatës së Emigracionit, e cila la në fuqi vendimin e Bordit të Emigracionit dhe rrëzoi ankesën. Më pas ai apeloj në Gjykatën e Apelit për Emigracionin.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Gjykata e Apelit për Emigracionin konkludoi në vendimin e saj se Manuali i ZKLKBR-së është një burim i rëndësishëm ligjor për procesin e përcaktimit të nevojës për mbrojtje. Gjykata e Apelit për Emigracionit deklaroi se barra e provës për saktësinë e fakteve të parashtruara i takonte si fillim azilkërkuesit, por detyrimi për të përcaktuar dhe vlerësuar të gjitha faktet relevante ndahej ndërmjet azilkërkuesit dhe autoriteteve shtetërore. Sipas Manualit të ZKLKBR-së, azilkërkuesi i cili ka parashtruar fakte të besueshme duhet t'i jepet “avantazhi i dyshimit”, në rastet kur në përgjithësi ka arsytet të mjaftueshme për t'i dhënë atij mbrojtje. Sipas kapitullit 8 të Ligjit të Procedurës Administrative, gjykata ka përgjegjësinë për të siguruar shqyrtimin e një rasti në masën që rrethanat e rastit e kërkojnë. Gjykata e Apelit për Emigracionin theksoi se këto parime janë veçanërisht të rëndësishme kur parashtrohen arsytet e mbrojtjes, pasi vendimet janë të pakthyeshme dhe gabimet mund të çojnë në ekspozimin e individëve ndaj shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Edhe pse aplikanti ka barrën e provës për pretendimet e tij dhe pavarësisht se një procedurë ka dy palë, gjykata, kur është e nevojshme, ka për detyrë të hetojë. Kështu, gjykata mund të kryejë hetime të mëtejshme ose të japë udhëzime për palët se për çfarë duhet hetuar më tej. Gjykata e Apelit për Emigracionin theksoi se në disa raste të tilla, kur lind nevoja për të përcaktuar besueshmërinë e informacioneve të ndërlikuara, gjykata me nismën e vet mund të thërrasë një seancë dëgjimore.

Gjykata e Apelit për Emigracionin konstatoi se rrëfimi i azilkërkuesit përmante disa deklarata kontradiktore dhe të pambështetura, çka nënkuptonte se atij nuk mund t'i njihej avantazhi i dyshimit. Nga ana tjetër, Gjykata e Apelit për Emigracionin vërejtë se pohimet e aplikantit mbështeteshin nga një dokument autentik. Bordi i Emigracionit kishte zhvilluar dy seanca dëgjimore me azilkërkuesin dhe doli në një vendim me një arsytim të hollësishëm se pse nuk e konsideronin atë të besueshëm. Megjithatë, Gjykata e Emigracionit nuk kishte zhvilluar asnjë seancë dëgjimore dhe as kishte ndërmarrë ndonjë veprim për të hetuar mbi dënimin e pretenduar të azilkërkuesit, duke u përpjekur të sqaronte identitetin e tij apo të merrte informacion të mëtejshëm nga Ambasada Suedeze mbi çështjen e autenticitetit. Përkundrazi, Gjykata e Emigracionit vendosi se ishte dakord me vlerësimin e Bordit të Emigracionit pa dhënë arsye të tjera për vendimin e saj.

Gjykata e Apelit për Emigracionin vuri në dukje, duke pasur parasysh se Egjipti ishte i njohur për shkelje masive të të drejtave të njeriut dhe se pretendimet e azilkërkuesit provoheshin nga një vendim i gjykatës egjiptiane të sigurisë që mund të ishte i vërtetë, se Gjykata e Emigracionit nuk e kishte përbushur detyrimin e saj për të hetuar. Gjithashtu, pretendimet e aplikantit se mund t'i nënshtrohej torturës, e bënë edhe më të nevojshëm një vendim të plotë nga ana e gjykatës.

Gjykata e Apelit për Emigracionin rrëzoi vendimin e Gjykatës së Emigracionit dhe ia përcolli përsëri çështjen kësaj gjykate për rishqyrtim.

### 3. Koment

Gjatë vlerësimit të ankesës së azilkërkuesit kundër vendimit të Bordit të Emigracionit të Suedisë që refuzoi kërkesën e tij për azil për arsye besueshmërie, Gjykata suedeze e Emigracionit nuk mbajti parasysh në mënyrë të veçantë nenin 4 të Direktivës së Kualifikimit, i cili përcakton kriteret e ndryshme që Shtetet Anëtare duhet të aplikojnë në vlerësimin e provave dhe besueshmërisë së pretendimeve të një azilkërkuesi. Megjithatë, kjo dispozitë është veçanërisht e rëndësishme dhe siguron një udhëzim të rëndësishëm në shqyrtimin e rasteve të tilla si rasti në fjalë. Neni 4(1) parashikon detyrimin për azilkërkuesin që të paraqesë sa më shpejt të jetë e mundur të gjitha elementet e nevojshme për të mbështetur kërkesën e tij. Më tej, ajo parashikon se, në bashkëpunim me azilkërkuesin, Shteti Anëtar detyrohet të vlerësojë të gjithë elementet përkatëse të aplikimit. Neni 4 (5) pranon se nganjëherë një aplikant nuk mund

të jetë në pozicionin që të mbështesë deklaratat e tij me prova dhe për rrjedhojë parashikon që në kushte të caktuara azilkërkuesi nuk ka nevojë të sigurojë prova konfirmuese. Neni 4(5) nuk parashikon parimin e “avantazhit nga dyshimi”, por shumë komentues e shikojnë që kjo dispozitë e përfshin një parim të tillë. Në rastin konkret, Gjykata suedeze e Apelit për Emigracionin theksoi rëndësinë e një seancë dëgjimore, kur provat në dispozicion nuk i jepnin mundësinë gjykatës për të bërë vlerësimin e saj. “E drejta për t’u dëgjuar” është një nga komponentët e mbrojtjes së ofruar nga neni 47 i Kartës Evropiane edhe pse GJDBE-ja në rastet kryesore nuk e ka konsideruar atë si një të drejtë absolute. Ndryshe nga neni 6 i KEDNJ-së, i cili është konsideruar së nuk zbatohet për rastet e emigracionit dhe azilit, neni 47 mund t’u ofrojë garanci të forta procedurale azilkërkuësve.

Në çështjen C-277/11, *MM k. Ministrit të Drejtësisë, Barazisë dhe Reformës Ligjore të Irlandës*<sup>205</sup>, GJDBE-ja konfirmoi se vlerësimi i një pretendimi për mbrojtje ndërkombëtare zhvillohej në dy faza të ndara: faza e parë kishte të bënte me përcaktimin e rrethanave faktike të cilat mund të përbënin prova që mbështesnin kërkesën; ndërsa faza e dytë kishte të bënte me vlerësimin ligjor të provave. GJDBE-ja vuri në dukje se neni 41 i Kartës parashikon se e drejta për mirëadministrim përfshin të drejtën e çdo personi për t’u dëgjuar para dhënies së ndonjë mase të veçantë e cila do të ndikonte negativisht tek ai. Gjithashtu u referua edhe neni 47 i Kartës.

Hyrja në fuqi e Direktivës për Procedurat e Azilit, e ndryshuar ka sjellë pasoja të rëndësishme për Shtetet Anëtare në lidhje me procedurat e tyre. Sistemet e tyre të brendshme tashmë duhet të sigurojnë një shqyrtim të themelit të çështjes në apel. E drejta për ankim efektiv<sup>206</sup> kërkon nga Shtetet Anëtare të garantojnë një mjet ligjor efektiv i cili të mundësojë “një shqyrtim të plotë dhe *ex nunc* të fakteve dhe çështjeve të ligjit». Në këtë drejtim vendimi i Gjykatës së Apelit të Migracionit tregon shqetësimin në rritje të gjykatave dhe tribunaleve për t’u garantuar aplikantëve, të cilët e humbin rastin e tyre para autoriteteve përkatëse në shkallë të parë, të drejtën që të ankohen dhe të dëgjojnë në një seancë, duke pasur kështu mundësi t’i ngrenë pretendimet e tyre personalisht. Në këtë drejtim e drejta e BE-së mund të jetë disi përpara jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut.

Është një standard i mirë vendosur në praktikën gjyqësore të shumë vendeve

205 C-277/11, *M.M. k. Ministrit të Drejtësisë, Barazisë dhe Reformës Ligjore të Irlandës*, vendim i 22 nëntorit 2012.

206 Shih nenin 46.

evropiane që, në vlerësimin e provave dhe besueshmërisë së pretendimeve, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet Manualit të ZKLBKBR-së të vitit 1979, siç bëri edhe Gjykata e Apelit e Migracionit në këtë rast. Kohët e fundit, në një botim të titulluar *Përtej Provës: Vlerësimi i Besueshmërisë në sistemet e azilit të BE-së*, maj 2013, ZKLBKBR-ja ka shkruar se: “përsa i përket deklaratave, dokumenteve apo provave të tjera të paraqitura, ZKLBKBR-ja u kërkon autoriteteve të sigurohen që procedura të lejojë dhe politikat udhëzuese t’i drejtojnë vendimmarrësit të marrin parasysh rrethanat individuale dhe kontekstuale të aplikantit, duke përfshirë mjetet në dispozicion të tyre për të marrë dokumente ose prova dhe përkthime të tjera, kur është e nevojshme” (p.102). Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, gjithashtu, ka një qasje të ngjashme në vlerësimin e provave dhe besueshmërisë.

## **Legjislacioni i brendshëm dhe Direktiva e Këshillit nr. 2005/85/EC, 1 dhjetor 2005 (Direktiva mbi Procedurat e Azilit)**

*Mbrojtja e rendit publik, me anë të deklaramit i padëshirueshëm, nuk është një nga përjashtimet ndaj të drejtës për të qëndruar dhe Ligji Holandez për të Huajt sipas të cilit një i huaj, i cili është shpallur i padëshirueshëm, nuk ka të drejtë për të qëndruar është në kundërshtim me nenin 7 të Direktivës për Procedurat e Azilit.*

### **Holandë: Seksioni i Juridiksionit Administrativ i Këshillit të Shtetit (ABRvS), 201103520/1/V3 25 qershor 2012**

#### **1. Faktet e kryesore**

Një shtetas i huaj u shpall i padëshirueshëm më 6 janar 2008. Ankesat kundër vendimeve të shkallës së parë dhe të dytë u hodhën poshtë. Më 25 shtator 2009, vendimi u bë përfundimtar. Më 17 gusht 2009, Ministri hodhi poshtë kërkesën për azil nga shtetasi i huaj. Më 25 shtator 2009, gjykata vendosi papranueshmërinë e ankesës të paraqitur nga shtetasi i huaj kundër këtij vendimi. Shtetasi i huaj u dëbua në Bosnjë-Hercegovinë më 24 shtator 2009. Më 15 shkurt 2011, shtetasi i huaj deklaroi në aeroportin Schiphol se donte të aplikonte për azil. Në po atë ditë, ai nuk u lejua të hynte në territor dhe u arrestua. Më 14 mars 2011, gjykata e hodhi poshtë ankesën e tij kundër këtij vendimi. Shtetasi i huaj apeloj kundër këtij vendimi.

#### **2. Vendimi i Gjykatës**

Këshilli i Shtetit konstatoi se më 15 shkurt 2011 personi kishte deklaruar përpara Royal Netherlands Marechaussee se donte të aplikonte për azil. Kjo klasifikohet si një aplikim për azil sipas kuptimit të nenit 2, paragrafi hyrës dhe nenit 2(b) të Direktivës për Procedurat e Azilit.<sup>207</sup> Prandaj, shtetasi i huaj ishte një

207 Direktiva e Këshillit 2005/85/EC e 1 dhjetorit 2005 mbi standardet minimale për procedurat për dhënien dhe heqjen e statusit të refugjatit në Shtetet Anëtare. Direktiva mbi Procedurat e Azilit përcakton standarde të përbashkëta të masave mbrojtëse dhe garancive për akses në një procedurë të drejtë dhe efikase azili. Kjo Direktivë merret me çështje të tilla si aksesit në procedura (përfshirë procedurat kuftare), ndalimi, shqyrtimi i kërkesave, intervista personale dhe ndihma ligjore. Gjithashtu, Direktiva përcakton koncepte të tilla si vendi i parë i azilit, vendeve të sigurta të origjinës, vendeve të treta të sigurta, dhe vende të treta evropiane të sigurta. Më e rëndësishmja, Direktiva për Procedurat e Azil, e ndryshuar, u miratua më 26 qershor 2013 (Direktiva 2013/32/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013 mbi



azilkërkues, sipas përcaktimit në atë dispozitë. Në bazë të Direktivës së Kthimit,<sup>208</sup> sipas Këshillit të Shtetit, një person lejohej të qëndronte nëse dhe për aq kohë sa, plotësoheshin kushtet e qëndrimit. Kushti për të drejtën e qëndrimit, i përcaktuar në nenin 7 (1) të Direktivës për Procedurat e Azilit, është që personi të ketë aplikuar për azil dhe të mos ketë ende një vendim në shkallë të parë në lidhje me aplikimin e tij. Nëse, dhe për aq kohë sa, një shtetas i një shteti jo-anëtar të BE-së është në këtë pozicion dhe për rrjedhojë në përputhje me kushtin sa më sipër, qëndrimi i tij kategorizohet si i ligjshëm. Këshilli i Shtetit nuk u pajtua me qëndrimin e Ministrisë se neni 7 (1) i Direktivës mbi Procedurat e Azilit lidhet vetëm me qëndrimin aktual të një aplikuesi për azil në territorin e një Shteti Anëtar.

### *E drejta e qëndrimit dhe rendi publik*

Sipas nenit 7 (2) të Direktivës për Procedurat e Azilit, Shtetet Anëtare mund të bëjnë një numër të kufizuar përjashtimesh ndaj të drejtës për qëndrim, të parashikuar në nenin 7 (1) të Direktivës. Mbrojtja e rendit publik, nëpërmjet deklarimit i padëshirueshëm të personit, si në këtë rast, nuk është një nga përjashtimet e përmendura në nenin 7 (2) të Direktivës për Procedurat e Azilit. Neni 7 (1) të Direktivës për Procedurat e Azilit, i lexuar së bashku me nenin 7 (2) të kësaj Direktive, është i pakushtëzuar dhe mjaft i saktë për t'u zbatuar nga gjyqtarët vendas duke pasur kështu efekt të drejtpërdrejtë. Prandaj, kjo dispozitë e bën të pazbatueshëm nenin 67 (3) të Ligjit për të Huajt të vitit 2000 në rastin e një të huaji i cili është deklaruar më parë i padëshirueshëm, por është në pritje të dorëzimit të një kërkesë formale për azil ose vendimit për një kërkesë të bërë tashmë. Rrjedhimisht të huajt nuk mund t'i refuzohet e drejta për të qëndruar për arsye të mbrojtjes së rendit publik.

### *E drejta për qëndruar dhe kërkesa e dytë apo e mëvonshme për azil*

Kërkesa për azil që i huaji dorëzoi më 15 shkurt 2011 duhet të shihet si një kërkesë e dytë ose e mëvonshme për azil, në kuptim të neneve 32 dhe 34 të Direktivës për Procedurat e Azilit. Neni 32 i Direktivës mbi Procedurat e Azilit

procedurat e përbashkëta për dhënien dhe heqjen e mbrojtjes ndërkombëtare). Masat mbrojtëse procedurale dhe garantitë për azilkërkuesit, të përcaktuara në Direktivën e ndryshuar për Procedurat e Azilit, përbëjnë një përmirësim të konsiderueshëm krahasuar me Direktivën e 2005 për Procedurat e Azilit

208 Direktiva 2008/115/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 16 dhjetorit 2008 mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta në Shtetet Anëtare për kthimin e shtetasve të vendeve të treta të cilët qëndrojnë në mënyrë të paligjshme (Direktiva e Kthimit).

është transpozuar në nenin 4(6) të Ligjit mbi të Drejtën Administrative. Parimi se nuk mund të merret dy herë vendim për të njëjtën çështje përbën bazën e kësaj dispozite. Ky parim ligjor nuk është në kundërshtim me nenin 32 të Direktivës mbi Procedurat e Azilit. Në bazë të nenit 32 (3), lexuar në lidhje me paragrafin hyrës të nenit 34 (3) dhe nenin 34 (3) (a) të Direktivës mbi Procedurat e Azilit, një kërkesë e mëvonshme për azil është subjekt i një shqyrtimi paraprak për të parë nëse ka elemente apo gjetje të reja të ofruara nga azilkërkuesi. Azilkërkuesi njoftohet për rezultatin e shqyrtimit. Sapo azilkërkuesi njoftohet se kërkesa e tij për azil, sipas neneve 32 dhe 34 të Direktivës së Procedurave të Azilit, nuk do të shqyrtohet më tej gjen zbatim përjashtimi nga e drejta për të qëndruar, e parashikuar në nenin 7(2) të kësaj Direktive. Sipas sistemit të krijuar nga Ligji për të Huajt i vitit 2000, njoftimi i vendimit se nuk ka fakte apo rrethana të reja është momenti, të cilit i referohet Direktiva për Procedurat e Azilit, kur azilkërkuesi mëson se kërkesa e tij për azil nuk do të shqyrtohet më tej. Kjo do të thotë se i huaji ka të drejtë të qëndrojë, siç përmendet në nenin 7 (1) të Direktivës mbi Procedurat e Azilit, deri në momentin që njoftohet për këtë vendim. Pasi njoftohet, shtetasi i huaj, në bazë të së drejtës së brendshme, nuk ka të drejtë më të vazhdojë të qëndrojë. Me bërjen e njoftimit në fjalë, përjashtimi nga neni 7(1) i Direktivës mbi Procedurat e Azilit (i cili njeh të drejtën për të qëndruar), i parashikuar nga neni 7(2) i kësaj Direktive, bëhet i zbatueshëm. Përjashtimi nga e drejta për të qëndruar, i parashikuar nga neni 7(2) i Direktivës mbi Procedurat e Azilit nuk është i zbatueshëm kur personi mbahet i ndaluar dhe as kur është marrë vendimi i kundërshtuar.

Këshilli i Shtetit arriti në përfundimin se shtetasi i huaj kishte të drejtë për të qëndruar në Holandë, kur ai u arrestua dhe kur gjykata dha vendimin e saj. Këshilli i Shtetit hodhi poshtë apelin. Vendimi i kundërshtuar u la në fuqi, me një përmirësim në arsyet që e justifikonin atë. Kërkesa për dëmshpërblim u rrëzua.

### 3. Koment

Direktiva mbi Procedurat e Azilit parashikon në nenin 2 (neni 3(1) i Direktivës së ndryshuar) se “kjo Direktivë zbatohet për të gjitha kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare të bëra në territorin, përfshirë në kufi, në ujërat territoriale, ose në zonat e transitit të Shtetit Anëtar...”.

Neni 7 i Direktivës mbi Procedurat e Azilit (tani neni 9 i Direktivës së ndryshuar) parashikon që personat që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare “lejohen të qëndrojnë» në territorin e Shtetit Anëtar, ndërkohë që janë në pritje të një

vendimi në lidhje me kërkesën e tyre, sipas procedurave të zbatueshme dhe para autoritetit vendimmarrës në shkallë të parë. Edhe pse kjo e drejtë për të qëndruar konsiderohet se nuk përbën një leje qëndrimi, në fakt përbën një qëndrim të ligjshëm. Qeveria holandeze argumentoi se kjo mbrojtje nuk duhet të zbatohet për rastin e kërkuarit pasi ky ishte shpallur më parë i padëshiruar nga autoritetet holandeze. Këshilli i Shtetit e hodhi poshtë këtë argument, duke theksuar se të qenit i padëshiruar nuk ishte një nga përjashtimet e parashikuara në nenin 7 (tani neni 9) i Direktivës për Procedurat e Azilit. Qeveria holandeze argumentoi gjithashtu se një e drejtë e tillë është vetëm në dispozicion të një personi i cili ka pasur një vendbanim aktual në Shtetin Anëtar. Ky argument gjithashtu u refuzua nga Këshilli i Shtetit. (Në qoftë se ky argument do të pranohej, kjo mbrojtje do të ishte e paefektshme për të ndihmuar personat që kërkonin azil në kufi ose në aeroporte).

Gjithashtu, Qeveria holandeze u përpoq të argumentonte se azilkërkuesi mund të përjashtohet nga mbrojtja e nenit 7 (tani neni 9), pasi binte në fushëveprimin e përjashtimit për ata që kanë bërë një kërkesë të mëvonshme. Këshilli holandez i Shtetit vuri në dukje se ky përjashtim zbatohet vetëm në momentin që azilkërkuesi njoftohet për vendimin se kërkesa e tij e mëvonshme për azil nuk parashtron fakte ose rrethana të reja. Megjithatë, në rastin e azilkërkuesit në fjalë, nuk ishte marrë ende një vendim i tillë.

Nëse konstatohej se azilkërkuesi nuk kishte të drejtë për të qëndruar, atëherë do të zbatoheshin dispozitat e Direktivës së Kthimit, i cila parashikon, ndër të tjera, kthimin e shpejtë të azilkërkuesve të refuzuar.

Ky vendim i Këshilli i Shtetit është gjithashtu një shembull i mirë i doktrinës së të drejtës së BE-së për efektin e drejtpërdrejtë. Dispozitat e të drejtës së BE-së që vendosin detyrime në terma të qartë dhe të pakushtëzuara janë të detyrueshme për të gjitha Shtetet Anëtare dhe si pasojë çdo dispozitë e të drejtës së brendshme që nuk mund të interpretohen në përputhje me këto dispozita duhet të mos zbatohet. Në rastin në fjalë, Këshilli holandez i Shtetit arriti në përfundimin se neni 67 (3) i Ligjit për të Huajt i 2000 nuk duhej zbatuar në rastin e një të huaji i cili ishte deklaruar më parë i padëshirueshëm, por në pritje të dorëzimit të një kërkesë formale për azil ose të vendimit mbi një kërkesë të dorëzuar tashmë.

*Kur një kërkesë e dytë ose e mëvonshme për azil nuk është e bazuar në fakte të reja ose rrethana të reja të parashtruara nga personat e huaj, gjyqtari nuk është i detyruar të zhvillojë një procedurë të re shqyrtimi të plotë.*

**Holandë: Seksioni i Juridiksionit Administrativ i Këshillit të Shtetit (ABRvS),  
201112955/1/V4, 29 qershor 2012**

## 1. Faktet kryesore

Ky rast ka të bëjë me procedurën për një kërkesë të dytë ose të mëvonshme për azil. Faktet e rastit nuk janë të pasqyruara në vendim.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Azilkërkuesi apeloj me arsyetimin se kuadri ligjor i aplikuar nga gjyqtari holandez për vlerësimin e kërkesës së dytë dhe asaj të mëvonshme të azilit cenonte të drejtën e tij për mjete ligjore efektive, të parashikuara në nenin 47 (1) të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (KDTHBE) dhe gjithashtu cenonte zbatimin e kësaj të drejte siç përcaktohej nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian në rastin *Brahim Samba Diouf k. Ministre du Travail, de l'Emploi et de L'Immigration*<sup>209</sup>. Sipas kornizës së vlerësimit të kundërshtuar, në qoftë se, pas një vendimi që refuzon kërkesën për azil jepet edhe një vendim i mëtejshëm refuzues, ankesa kundër këtij të fundit nuk mund të shqyrtohet nga gjyqtari administrativ si të ishte vendimi i parë i refuzimit. Vetëm nëse, dhe deri në masën që dalin fakte të reja ose sillen rrethana që kanë ndryshuar, apo ndodh një ndryshim përkatës ligjor gjatë fazës administrative, vendimi mund të shqyrtohet nga gjyqtari administrativ.

Si pasojë, Gjyqtari në vendimin e ndërmjetëm nuk shqyrtoi arsyet e ankimit të azilkërkuesit. Azilkërkuesi e kundërshtoi këtë vendim. Këshilli i Shtetit vërejti se arsyet për kundërshtim e këtij vendimi ishin parashtruar korrektësisht nga ana e azilkërkuesit, por kjo nuk mund të sillte detyrimisht pranimin e ankesës.

Këshilli i Shtetit konstatoi se neni 47 (1) i KDTHBE-së nuk pengon miratimin e rregullave procedurale në legjisllacionin e brendshëm dhe në këtë pikë është në përputhje me nenin 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KED-NJ). Duke qenë se azilkërkuesi nuk parashtroi fakte apo rrethana të veçanta, ankesa e tij në bazë të nenit 47 (1) të KDTHBE-së u rrëzua.

209 C-69/10, *Brahim Samba Diouf k. Ministre du Travail, de l'Emploi et de l'Immigration*, vendim i 28 korrikut 2011.

Këshilli i Shtetit vuri në dukje se vendimi i Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian në rastin *Brahim Samba Diouf k. Ministre du Travail, de l'Emploi et de l'Immigration* nuk ndryshon aspak me këtë qëndrim. Ky vendim nuk ka të bëjë me një procedurë për shqyrtimin e kërkesë të mëvonshme për azil, e rregulluar me një kuadër të veçantë vlerësimi. Ky vendim nuk mund të përdoret për të pohuar se, kur një kërkesë të dytë ose e mëvonshme për azil nuk bazohet në një fakt të ri ose rrethana të ndryshuara të referuara nga i huaji, gjyqtari duhet ta rishqyrtojë rastin në themel për të bërë vlerësimin e tij. Pra, Këshilli i Shtetit, konstatoi se nuk kishte baza për të kërkuar një vendim paraprak.

Këshilli i Shtetit hodhi poshtë ankesën e mëtejshme nga azilkërkuesit si hap-tazi të papabuar dhe la në fuqi vendimin e ndërmjetëm të gjyqtarit.

### 3. Koment

Direktiva mbi Procedurat e Azilit (Direktiva 2005/85/EC) ka bërë shumë për të harmonizuar procedurat e azilit në Shtetet Anëtare të BE. Sipas dispozitave të Direktivës së ndryshuar (Direktiva 2013/32/EU), një Shtet Anëtar mund ta konsiderojë të papranueshëm (dhe i nënshtrohet një procedure të përshpejtuar) një aplikim të mëvonshëm, në të cilën nuk ka elemente apo gjetje të reja që të jenë parashtruar apo konstatuar (neni 33 (2) (d)).

Vendimi i Këshillit holandez të Shtetit është konfirmuar nga vendimi GJDBE në çështjen C-239/14, *Tall k. Centre public d'action sociale de Huy*<sup>210</sup>. Në çështjen *Tall* GJDBE-ja deklaroi se ishte e dukshme nga paragrafi 15 i preambulës (në Direktivën e ndryshuar paragrafi 33) se kur një azilkërkues ka bërë një kërkesë të mëvonshme në të cilën nuk parashtrohen prova apo argumente të reja, do të ishte e tepërt të detyroheshin Shtetet Anëtare për të kryer një procedurë të re shqyrtimi të plotë. Neni 7 i Direktivës (tani neni 9 (2)) i jep mundësi Shteteve Anëtare të parashikojnë, si përjashtim, që një apel ndaj një vendimi që refuzon të shqyrtojë një kërkesë të re për azil, të mos ketë efekt pezullues.

Ashtu si në rastin e Holandës, edhe në rastin *Tall*, azilkërkuesi kishte kërkuar zbatimin e nenit 47 të Kartës së të Drejtave Themelore, i cili afirmon parimin e mbrojtjes efektive gjyqësore dhe siguron që çdo person të cilit i shkelen të drejtat dhe liritë e garantuara nga e drejta e BE-së, ka të drejtë për një mjet efektiv ligjor. GJDBE-ja vuri në dukje se neni 19(2) i Kartës përmban garanci të ngjashme me ato të nenit 3 të KEDNJ-së për sa i përket ndalimit të largimit të

210 C-239/14, *Abdoulaye Amadou Tall k. Centre public d'action sociale de Huy*, vendim i 17 dhjetorit 2015

një personi drejt një shteti ku rrezikon seriozisht t'i nënshtrohet keqtrajtimi. Gjithashtu, neni 13 i KEDNJ-së kërkon që personi i huaj të ketë në dispozicion *ipso jure* një mjet ligjor me efekt pezullues, çka do të ndalonte largimin e tij nga vendi. Megjithatë, bazuar në faktet e rastit *Tall*, mosmarrëveshja kishte të bënte vetëm me ligjshmërinë e vendimit për të mos shqyrtuar më tej një kërkesë të mëvonshme për azil për qëllimet e nenit 32 (tani 33) të Direktivës për Procedurat e Azilit. GJDBE-ja vendosi se mungesa e efektit pezullues të ankesës së ngritur kundër një vendimi të tillë, ishte në parim në përputhje me nenet 19 (2) dhe 47 të Kartës. Mungesa e mjetit ligjor me efekt pezullues kundër një vendimi të tillë si ky në fjalë në procedurën kryesore, nuk përbën shkelje të së drejtës për mbrojtje gjyqësore efektive, të parashikuar në nenin 39 (tani neni 46 i Direktivës së ndryshuar) lexuar në dritën e neneve 19 (2) dhe 47 të Kartës, pasi zbatimi i tij nuk do të sillte ekspozimin e një personi të vendi të tretë ndaj të rrezikut të keqtrajtimit në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së.

## AIRE Centre

AIRE Centre është një organizatë joqeveritare që përhap njohjen e të drejtës evropiane dhe u ofron ndihmë viktimave të shkeljes së të drejtave të njeriut. Ekipi i juristëve ndërkombëtarë ofron informacione, përkrahje dhe këshilla për standardet juridike të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Eksperiencë të veçantë ka në çështjet gjyqësore para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg dhe ka marrë pjesë në më shumë se 150 çështje. Gjatë 20 viteve të kaluara, AIRE Centre ka mbajtur dhe ka marrë pjesë në seminare të ndryshme në Evropën Qëndrore e Lindore, në favor të avokatëve, gjyqtarëve, zyrtarëve të qeverisë dhe organizatave joqeveritare.

AIRE Centre vëmendje të veçantë i kushton vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku është e pranishme prej mbi një dekade e gjysmë, duke realizuar një sërë programesh për sundimin e ligjit në partneritet me institucionet dhe gjykatat vendore. Synimi ynë nëpër të gjitha këto programe është të çojmë përpara zbatimin vendor të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të ndihmojmë procesin e integritimeve evropiane nëpërmjet forcimit të sundimit të ligjit dhe respektimit të plotë të të drejtave të njeriut, si dhe me nxitjen e bashkëpunimit rajonal ndërmjet gjyqtarëve dhe përfaqësuesve të profesionit juridik.



Foreign &  
Commonwealth  
Office

Përgatitja e këtij botimi është mbështetur nga Zyra e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Bashkuar dhe Komonuelthit. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pozicionin zyrtar të Zyrës së Punëve të Jashtme dhe të Komonuelthit.

---